

Viktor Canosinaj



Meryll

roman

1980

854-31

C 19

Biblioteka e Fëmijëve dhe të Rinjve

VIKTOR CANOSINAJ

Merizyll

- roman -



1.

Nëna qëndronte shtrirë, e zbehtë, me vështrimin ngulur nga dritarja e dhomës, përtej perdes gjysmë të hapur të së cilës dallohej një degë kumbulle e mbushur me lule. Në fytyrën e saj, sidomos në cepat e buzëve, kishte ngrirë një grimcë buzëqeshjeje që e bënte të ngjante si Shën Maria. Meri i qëndronte pranë duke kapërthyer duart me njëra-tjetrën në mënyrë që ato të mos i dridheshin.

- Ma, - mëmëriti, - më kërkove?

E ëma ktheu paksa kokën dhe e ftoi të ulej buzë krevatit.

- Meri, ti tani je e madhe, - foli me një fije zë. - Po mbaron klasën e shtatë. Shumë gjëra je në gjendje t'i kuptosh. Unë... pas pak ditësh... mbase... Kjo sëmundje që kam, nuk shërohet më. Nuk ka spital që e shëron. Më kupton?

Më në fund vajza u bind se në pëshpërimat, fragmentet me zë të ulët të bisedave të njerëzve nëpër shtëpi apo spital, kishte një të vërtetë mbytëse për të cilën ajo po dyshonte prej kohësh. Askush nuk guxonte ta përmendte fjalën vdekje, por Meri e kuptoi se ajo ishte fare pranë. Nuk mund të fshihej më.

- Ti duhet të bëhesh e fortë dhe të kujdesesh për shtëpinë, - vazhdoi nëna. - Të kujdesesh për vëllanë dhe motrën e vogël, për babanë. E ke vënë re? Ai ka filluar të pijë nga dëshpërimi.

Meri pohoi me kokë, duke bërë një stërmundim për të mbajtur lotët që të mos i shpërthenin.

- Babi të do shumë, o ma.

- E di. Edhe unë e kam dashur shumë. Jemi dashur që të vegjël. Atij i dukej se unë isha më e bukura në botë. Edhe kur linde ti, ishte i bindur se do të bëheshe e bukur si yll. Vajza do të të ngjajë ty, më thoshte. Ke për të parë. Donte të të vinte emrin Yllka. Por mua më pëlqente Meri. Atëhere bëmë një shpikje. Thamë se Meri jonë do të ishte e bukur si yll dhe të quajtëm Meriyll. Dhe nuk u gabuam. Ti u bërë vërtet e bukur.

Edhe e mirë...

Ajo u mbush thellë me frymë, me vështirësi. Vajza nuk po e kuptonte se si fjalët vazhdonin të dilnin nga ai trup krejt i dërrmuar.

- Meri... edhe një gjë... shumë të rëndësishme. Mund të ndodhë që , më vonë, babi të martohet me një grua tjetër. Ju mos u zemëroni për këtë. Rëndësi ka që ajo grua të sillet mirë me ju dhe t'ju dojë. Më kuptove?

- Jo, - gati sa nuk thirri vajza, - babi nuk do ta bëjë kurrë këtë!

- Edhe unë kështu mendoj. Por jeta vazhdon, është e gjatë. Meri, kam shumë besim te ty. Të ka mami zemër. Tregohu e fortë. Kanë ardhur kohë të vështira. Më premton se do të bëhesh e zonja për shtëpinë?

Vajza nuk mundi të duronte dot më.

- Të premtoj, - tha me zë të mbytur nga lotët dhe pështeti fytyrën mbi krahun e së ëmës. Ndenji gjatë ashtu. Kur u ngrit, iu duk se nëna po flinte. U përpoq të dilte nga dhoma pa zhurmë.

Në korridor u ndesh me të atin. Ai po tymoste një cigare me një pamje krejt të përhumbur. Merit iu duk më i plakur se kurrë. Trupi shpatullgjerë i qe kërrusur, flokët i qenë thinjur, fytyra e parruar i qe hequr dhe në sy i lexohej një zhgënjim i thellë. Ai ngriti vështrimin nga e bija.

- Fole me të? - pyeti.

Meri pohoi me kokë.

- Tani kujdesu për Albin dhe Norën.

Kishte aq ditë që ai e porosiste për të njejtën gjë, ndonëse Meri e kishte kuptuar se shtëpia kishte mbetur ne duart e saja që kur nëna ishte shtruar në spital dhe pastaj kishte zënë krevatin për të mos u ngritur më. Ajo e mbante mend mirë një ditë dimri kur babai ishte nisur për në Greqi së bashku me një shok. Atë ditë ai e kishte ftuar të ulej në tavolinë, përballë vetes dhe për herë të parë i kishte treguar se nëna ishte sëmurë.

- Meri, jemi të varfër, - i kishte thënë. - Unë kam mbetur pa punë. Më duhet të shkoj në Greqi. Do ta provoj njëherë. Mbase mbledh ndonjë lek dhe arrijmë ta çojmë nënën në ndonjë spital jashtë shtetit.

- Pse, nuk mund të shërohet dot këtu në Shqipëri? - kishte

pyetur ajo.

- Mjekët thonë që jo.

Meri e kishte vështruar e trembur.

- Po ne, si do të jetojmë këtu?!

- Ju? Ja, si më parë. Ti do të kujdesesh për të gjitha. Do të mbeteni ngusht për para, por nuk kemi nga ia mbajmë. Duhet të bëjmë diçka për nënën.

Babai qe nisur me një çantë hedhur supit, ndonëse nëna i qe lutur të mos e merrte atë rrugë të panjohur e plot rreziqe. Kishte ndenjur në Greqi afro tre muaj, deri sa një ditë e kishte kthyer policia së bashku me një grup të madh shqiptarësh që punonin pa dokumenta. Ai kishte mbërritur në shtëpi krejt i dërrmuar. I kishte përqaftuar fëmijët me radhë, pastaj kishte qëndruar para nënës si fajtor, duke mermëritur: jam pa fat, jam njeri pa fat.

Nëna ishte përpjekur ta ngushëllonte, por që pas kthimit nga Greqia ai kishte filluar të pinte dhe të ndryshonte në një mënyrë të frikshme...

Vetëm tani që Meri e kishte përballë dhe më në fund e kishte marrë vesh ç'po ndodhte me nënën, arriti ta kuptonte pse i ati ishte ndryshuar ashtu. Ajo e ndoqi në bisht të syrit se si ai hyri në dhomën ku dergjej nëna, duke u munduar të mos bënte zhurmë. Doli prej aty vetëm natën vonë. Meri e ndjeu. Nuk arrinte dot të mbyllte sy.

Ajo gjendje vazhdoi edhe tri netë të tjera. Në shtëpi njerëzit e afërt u shtuan. Gdiheshin aty; gjyshja nga nëna, një teze, dy halla dhe daja që ishte emigrant në Itali. Ata prisnin të gjithë me krahët varur, me fytyra të shqetësuara dhe vështrimet drejtuar nga dhoma e nënës. Një mëngjes gjyshja e porositi Merin të mos shkonte në shkollë.

Nga pasditja nëna vdiq.

Ndonëse të gjithë mundoheshin ta ngushëllonin, Meri ndjeu një frikë të përgjithshme. Ishte hera e parë që ndeshej me vdekjen aq pranë. Vetëm atë e lejuan ta shikonte nënën për herë të fundit. E mësuan ta puthte në ballë dhe t'i jepte lamtumirën. Ajo u përkul mbi atë njeri të dashur pa e besuar se pas pak çastesh nuk do ta shikonte më për tërë jetën.

- O ma, - i foli, - të lutem më shiko edhe njëherë! Vetëm një

herë!

Por nga nëna nuk erdhi përgjigje. Atëhere Meri filloi të qante mbytur. Njëra prej hallave e mori në krahë dhe e nxori jashtë. Ajo u përmend vetëm pas varrimit, kur pa mësuesen kujdestare dhe një grup shokësh e shoqesh të klasës. Ata ishin të gjithë të përlotur. Mësuesja e përqafoi gjatë.

- Meri, kurajo! - tha. - Ti nuk je vetëm. Na ke ne të gjithëve.

Ato të dyja u vështruan përmes lotëve. Pastaj radha i erdhi Sidritit. Shoku i klasës iu duk ndryshe nga të tjerët. Ai u përkul dhe e përqafoi. Dora e tij e shtërngoi dorën e saj fort, sikur të donte t'i thoshte se tani e tutje ata do të ishin shokë edhe më të ngushtë.

Atë mbrëmje Meri ndjehej krejt e dërrmuar. Fjeti herët. Por të nesërmen, sapo hapi sytë, fjala e parë që i ra ndër mend që nëna. U ngrit dhe doli jashtë në kopësht. Qëndroi pranë shtratit me zambakë, për të cilët nëna kujdesej në veçanti çdo pranverë. Pastaj i ktheu sytë nga trëndafilët, nga hardhia që bënte përpjetë fikut dhe murit të vjetër të avllisë. Iu bë se do ta shihte nënën si çdo mëngjes, duke ujitur e pastruar. Por jo. Ajo nuk dukej askund. Për herë të parë, atë mëngjes fillimprilli të vitit 1995, ajo e ndjeu tmerrin e asaj mungese.

Pastaj kaloi dita e dytë, e tretë, e katërt...

Njerëzit e afërt u larguan nga shtëpia pothuaj të gjithë. Një mbrëmje ata mbetën më në fund vetëm. Shkoi edhe gjyshja, duke premtuar se do të kthehej të pasnesërmen. Babai, Albi dhe Nora ishin ulur në tavolinë dhe po prisnin me duart anash pjatave. Meri kishte gatuar një supë të thjeshtë me vezë e me limon, të cilën e kishte mësuar nga nëna. E ndau atë, pastaj u ul.

- Domethënë, sa të kthehet mami, do ta zëvendësojë Meri? - pyeti papritur Nora.

Ajo ishte vetëm 6 vjeçe dhe ende nuk kishte kuptuar gjë.

- Po, - ia ktheu babai. - Meri do të kujdeset për ty dhe për Albin.

- Unë jam i madh, - tha djali pa e ngritur kokën. - I bëj vetë të gjitha.

- Urdhërat e Merit nuk do t'i kundërshtojë askush, - vazhdoi babai.

Albi tundi kokën mbi pjatën e supës, duke e nuhatur se ato fjalë i drejtoheshin atij.

Pas ndonjë ore ra zilja e telefonit. Albi vështroi nga motra e madhe.

- Siguro që është Sidi, - tha.

Meri u ngrit. Ishte vërtet ai. Pyeti në se ajo do të vinte të nesërmen në shkollë.

- Po Sid, të thashë që dje se do të vij.

- E dija, po... unë mora kot... Mendova se do të ishe e mërzi-tur dhe thashë të të tregoj ndonjë gjë të re andej nga shkolla.

- Mirë, - pranoi ajo. - Më trego ç'të duash.

Ai i foli nja pesë minuta për gjëra krejt të përgjithshme, pastaj pyeti gati me trishtim:

- Meri, a e di si ngjan banka jonë?

- Si?

- Mu si kurriz deveje.

- E pse?

- Vendi yt është bosh, kurse unë jam gunga. Detyrohem të përkulem shumë që deveja të mos ngjajë e shëmtuar.

Meri ndjeu se si buzët iu hapën paksa duke dashur të buzë-qeshnin.

- Sid, më fal, nuk qesh dot, - tha. - Nuk të imagjinoj dot si gungë deveje.

- Po si kaktus shkretëtire?

Më në fund ajo u detyrua të buzëqeshte dhe provoi mall.

- Falemnderit për telefonatën, - tha. - Mirupafshim nesër!

*

*

*

Të nesërmen ajo qëndroi para pasqyrës duke dalluar fare lehtësisht ndryshimet te vetja. Fytyra iu duk e zbehtë. Sytë të lodhur nga pagjumësia dhe të qarët e atyre ditëve. U kaloi një krehër flokëve të zinj e të dendur, të ngatërruar në dhjetra rrica të imët, të cilët i binin deri mbi supe. Krehja e atyre flokëve e vononte gjithmonë dhe Albi, që priste për krehërin, ankohej: ufa, më je bërë si ato këngëtalet zezake.

Si shpeshherë ata muajt e fundit ajo ndjeu ndrojtje nga vetja tek shikonte tërë atë zhvillim që kishte marrë. Ishte më e gjata në klasë dhe e kishte kuptuar se tashmë ishte bërë një vajzë që nuk mund të shkonte rrugës pa u vënë re.

Veshi mbi këmishën e zezë një pulovër në ngjyrë kafe të errët dhe mori çantën.

- Albi, po vjen? - i foli të vëllait.

- Vazhdo ti, - ia ktheu ai duke kërkuar diçka në çantë me nervozizëm. Kur nuk e gjeti dot, i derdhi të gjitha në dysHEME me zhurmë.

- Dëgjo ti, nevrík, ata janë libra dhe nuk hidhen ashtu, - i foli e motra me qortim. - Mblidhi shpejt!

Albi u tregua i bindur. Ndonëse ishte në klasë të pestë, Merit nuk guxonte t'i kundërshtonte. Megjithatë, marrëdhëniet e tyre ishin aq të mira sa në shtëpi nuk mbahej mend të ishte bërë ndonjëherë sherr. Ajo e trajtonte Albin si shok dhe këtë gjë ai e vlerësonte.

Meri hapi portën e vjetër, kanati i drunjtë i së cilës kërciti si me ankim dhe doli. Sidriti po priste matanë rrugës, me çantën hedhur supit të djathtë e me rrjetën e një topi basketbolli në dorën e majtë. I gjatë afro 180 cm, ai ishte njeriu që binte më shumë në sy në shkollë mes nxënësve e mësuesve. Kishte një këmbë të frikshme me numër 44 dhe mbathte atlete aq të mëdha sa, kur ecte, u ngjante atyre zhytësve që dalin nga deti me lopata në këmbë. Flokët i mbante të prerë fare shkurt dhe në fytyrën hollake i dalloheshin që larg syzet optike me skelet të trashë plastik, të cilat nuk i hiqte edhe kur luante.

Basketbolli ishte ëndrra e madhe e Sidrit Arbanës. Ai i kush-tonte atij dy ose tri orë në ditë. Vishej vetëm me rroba sportive, ndiqte në televizor vetëm ndeshje basketbolli, në shtëpi kishte një sirtar plot me videokaseta nga ndeshjet gjigande amerikane të kategorisë NBA. Muret e dhomës së tij ishin të mbushur me postera të yjeve botërorë të basketbollit, ashtu si dhe kapakët e librave dhe të fletoreve. Madje edhe mbi çantë ishin shkruar me stilolaps emra basketbollistësh të njohur.

Meri qëndroi para tij kokulur.

- Më vjen shumë keq për mamin tënd, - tha ai. - Ishte shumë

e mirë. Sa herë që vija te ju, më jepte lule për t'i çuar në shtëpi.

Ajo psherëtiu.

- Falemnderit Sid!

Ata ishin bërë shokë të ngushtë që në klasë të pestë. Në atë kohë Sidi kishte qenë shumë i dobët. Nga që qe zgjatur dukshëm, rrobat i tundeshin nëpër trup si vela anijeje.

Lëvizjet e ngathta dhe syzet i jepnin pamjen e një djali mamaje që s'ishte mësuar me rrugën dhe me tipat që kacafyten për një fjalë goje. Ai kishte ardhur nga një shkollë tjetër dhe djemtë e klasës, që nuk e njihnin, kishin filluar ta quanin me tallje "Kallamsheqeri". Ai qe prekur shumë nga ajo nofkë. I qe dukur vetja njeriu më i shëmtuar në botë dhe nga turpi, kishte dashur të ndërronte shkollën. Meri e kishte njohur nga afër pikërisht kur Sidi ndodhej në atë gjendje mërzie. Një ditë, pas orës së Fizkulturës, ai kishte qëndruar në cep të oborrit dhe po qante me inat dhe keqardhje përzier bashkë. Ajo i qe afruar dhe e kishte prekur në krah.

- Sid, ç'ke kështu? - e kishte pyetur.

- Nuk duroj dot më, - i kishte thënë ai.

- E pse?

- Sepse të gjithë më tallin.

- Nuk është e vërtetë. Për mua ti je një nga djemtë më të mirë të klasës.

Ai e kishte vështruar me mosbesim.

- Sid, nuk të gënjej.

- Nuk të dukem i shëmtuar?

- Aspak! Do të doja të ulesha në bankë me ty. Sid, pse nuk futesh në një rreth basketbolli? Me këtë gjatësi që ke, nuk do të të lënë të ikësh më.

Ajo njohje kishte qenë vendimtare për Sidin. Vetëm prej Merit nuk kishte ndërruar shkollë. E kishte ndjekur këshillën e saj tepër i bindur dhe me ndërhyrjen e të atit, ishte pranuar në një ekip basketbolli për të rinj.

Nga fillimi i klasës së gjashtë Sidi ndryshoi dukshëm. U shëndosh, fytyra iu mbush e zbukurua, u zhdërvjelltësua sa nuk e mbante më vendi. Gjatë pushimit të madh dhe pas mësimit e gjeje gjithmonë te fusha e basketbollit ose të paralelet duke bërë

ushtrime force. Djemtë e tjerë të klasës mezi i vinin deri te supi dhe askush nuk guxoi ta përmendte më fjalën "Kallamsheqeri". Sidi u bë jo vetëm krenaria e klasës, por edhe e gjithë shkollës.

Shoqëria e Merit me të erdhi duke u bërë gjithnjë e më e ngushtë. Ata filluan të hynin e dilnin nëpër shtëpitë e njëritjetrit për të përgatitur mësimet, ndonëse ajo gjë nuk kishte qenë për Merin aq e lehtë. Familja e Sidit sapo ishte vendosur në një apartament të ri, tepër të madh, të mobiluar me orendi të shtrenjta. Babai i tij ishte mjek i njohur kockash, ndërsa nëna i punonte në një fondacion të huaj kulturor. Merin e kishte hutuar shkëlqimi i atij apartamenti. Sidi e kishte ftuar për herë të parë në shtëpinë e tij një ditë pasi kishin luajtur basketboll së bashku dhe ishin bërë tërë djersë. Eja të freskohemi e të pijmë ndonjë limonadë, i kishtë thënë. Ajo kishte pranuar me ndrojtje.

Ndërsa po pinte limonadën në dhomën e ndenjes, ulur në një kolltuk të gjerë lëkure, u skuq e tëra kur mendoi se shumë shpejt do t'i duhej ta ftonte shokun në shtëpinë e saj. Ç'do të mendonte ai vallë për atë ngrehinë të vjetër që s'ishte meremetuar prej vitesh? Çatia kishte zënë myshk dhe vende-vende ishte shtrembëruar, muret e oborrit ishin rrjepur dhe kishin bërë bark. Dukeshin sikur do të shembeshin nga minuti në minutë. Porta e drunjte po ashtu qe anuar nga njëri krah dhe kanati tjetër nuk i hapej fare. Pa folur për orenditë e brendshme që s'mbahej mend se kur ishin blerë. Që nga viti 1992 prindërit e Merit kishin mbetur të dy pa punë, pas mbylljes së Parkut të Automjeteve të Ndërtimit. Kishin jetuar për muaj me radhë me ndihmë shoqërore. Pastaj mjekët kishin zbuluar sëmundjen e nënës dhe...

Por Meri nuk ishte trembur nga ajo e vërtetë e hidhur. E kishte ftuar Sidin në shtëpi pas disa ditësh dhe për habinë e saj, ai kishte mbetur jashtë mase i kënaqur. Ishte maj, kohë lulësh. Ta kishte ënda të rrije në kopësht. Ai ishte njohur me qenin e shtëpisë, të cilit Albi i kishte vënë emrin Sparki, emër ky i një personazhi - qen tepër të njohur të një filmi amerikan. Kishin luajtur volejball mbi bar dhe pastaj qenë ulur në një stol druri për të pirë një kakao.

- Këtu qenka mrekulli, - kishtë thënë Sidi. - Nëpër pallate të shpifet. Nuk ke ku nxjerr kokën.

Pas asaj vizite Meri ishte çliruar disi nga sikleti që i shkaktonte fakti se ata ishin familje me nivel ekonomik shumë më të ulët se familja e Sidit. Por ajo nuk mundi ta harronte dot përshtypjen që i la takimi i parë me nënën e Sidit. Elona Arbana ishte një grua simpatike, tepër e mbajtur, në prag të të dyzetave, me një pamje tepër të kënaqur nga jeta që bënte.

- Ah, ti je Meriyll që im bir të lavdëron aq shumë!- ia kishte bërë ajo duke i shtërnguar dorën. - Po prindërit, ç'punë bëjnë?

Meri i qe përgjigjur se ata kishin qenë të dy punëtorë dhe tani i kishin futur në listën e ndihmës shoqërore.

- Vërtet?! - kishte thënë tjetra me një zhgënjim fare të hapur.- Atëhere, gëzohem që u njohëm dhe... më vjen mirë që Sidi ka një shoqe si ti.

Meri i kishte buzëqeshur me ndrojtje, por pamja e zhgënjimit në fytyrën e saj i kishte mbetur e ngulitur në mendje...

*

* *

Ata të dy hynë në oborrin e shkollës dhe Meri ndjeu mbi vete vështrime keqardhjeje. Disa nga shoqet dhe shokët e klasës u afruan ta takonin. Orën e parë të mësimit mësuesja kujdestare filloi të bënte emërthirrjen pa e vënë re. Meriyll Gjoka, lexoi dhe u mat të vinte mungesë.

- Mësuese, jam këtu, - foli Meri.

Tjetra ngriti sytë dhe provoi të buzëqeshte.

- Ah, paske ardhur! Mendova se...

Ajo e vështroi një copë herë e menduar, sikur kërkonte në pamjen e vajzës diçka të largët, të fjetur prej vitesh në kujtesën e saj. Papritur, në cepat e syve iu formuan dy bula loti të cilat ajo arriti t'i fshihte me mjeshteri. Nxënësit po e ndiqnin në heshtje.

- Mirë, - tha mësuesja, - fillojmë.

Pas orës së fundit të mësimit Meri priti Sidin për ta përshëndetur.

- Do të vij pas stërvitjes të të jap një dorë për mësimet, - tha ai. - Ke mbetur shumë prapa.

- Lëre, ç'e pyet!

- Meri, po ... për stërvitjen?

Ajo tundi kokën.

- Harroje sportin Sid. Në stërvitje nuk vij dot më. Ti e kupton. Kam shumë punë në shtëpi. Duhet të kujdesem për të gjithë. Edhe për motrën e vogël që do një njeri prapa kur vete në banjo.

- Edhe për Sparkin.

- Po, edhe për zotin Sparki. Edhe ai do pastruar e ushqyer.

Sidi nuk mundi ta fshihte dot keqardhjen. Kishte qenë ai që e kishte ftuar Merin nga fillimi i klasës së shtatë që të hynte në një klub me emrin "Miqte e basketbollit". Ajo kishte pranuar dhe prindërit nuk e kishin penguar. Bëheshin atje një grup djemsh e vajzash. Meri që miqësuar me ta shumë shpejt.

- Bëju të fala të gjithëve, - tha kokulur.

Ai e përcolli me sy i menduar, ndërsa ajo po largohej paksa e kërrusur nën pulovrin e errët që e tregonte ndryshe, krejt ndryshe nga më parë.

2.

Kishte kaluar më shumë se një muaj nga vdekja e nënës kur, një mbrëmje, babai u vonua më shumë se zakonisht. Fëmijët po ndiqnin një film në televizor. Meri i kthente herë pas here sytë nga ora e murit, e merakosur. Ndërsa Albi shtirej sikur ishte i përqëndruar te filmi.

- Albi, di gjë pse po vonohet babi? - e pyeti ajo pasi filmi mbaroi.

- Po dal njëherë në rrugë të shoh, - ia ktheu ai pa e vështruar.

Por rruga dukej krejt e zbrazur. Ata kishin qëndruar të dy te pragu i derës duke menduar të njëjtën gjë, por pa guxuar t'ia thoshin njëri-tjetrit. Kishte kaluar ora 23 kur figura e babait u duk në rrugë duke u lëkundur.

- O bo, bo, - mermëriti Albi. - Paska pirë.

Djali i doli para duke dashur ta ndihmonte. Por trupi i bëshëm i babait dukej sikur do ta merrte Albin me vete dhe ata do të binin të dy në asfalt. Meri u afrua e trembur dhe i futi të atit

krahun. Hynë në oborr dhe papritur Sparki filloi të lehte. Babai u kthye drejt tij si me inat.

- Pse leh ky qen? Nuk e kuptoj... pse leh...

- Ej, ti, rri urtë aty! - i foli Albi kafshës.

Qeni tundi njëherë bishtin, pastaj u ul mbi këmbët e pasme dhe angulliti njëherë si me ankim.

- Unë të kuptoj shumë mirë ty o qen, - i foli babai. - Ne të dy jemi vetëm. Ne jemi... shumë shokë.

Fëmijët e ndihmuan atë të zhvishej e të shtrihej.

- Qen, i dashur qen, pse nuk leh më? - vazhdoi të fliste ai gati përçart. - Unë të kuptoj. Unë jam njeri, por me fat qeni...

Albi nuk duroi dot më dhe filloi të qante. Meri e mori për dore dhe e nxori nga dhoma.

- Harroje këtë të sotmen, - i foli të vëllait. - Nuk do të ndodhë më.

- Po babi, pse pi kështu? - pyeti ai.

- Ti e kupton... Që kur mami... Fli tani se je i lodhur.

Meri priti deri sa shtëpia ra në qetësi, pastaj doli për pak minuta në verandë. Aty qau vetëm, me ballin pështetur në parakrah. Nuk donte që i vëllai ta shikonte të përlotur. Lotët e saj me siguri do ta trembin atë edhe më shumë. Kur ankthi dhe trishtimi i asaj nate i kaluan disa, hyri brenda. Bëri një gjumë të trazuar.

Kur u ngrit në mëngjes herët për të pastruar oborrin dhe për të ujitur lulet, e gjeti të atin jashtë, duke pirë një cigare. Ajo e përshëndeti dhe i buzëqeshi sikur të mos kishte ndodhur gjë.

- Mirëmëngjesi! - tha ai pa e vështruar.

- Ba, po të bëj një kafe. Të lutem mos e pij atë cigare pa ngrënë!

Ai e flaku cigaren tutje. Ndërsa u ul te shkallët e verandës të pinte kafënë, hapi papritur problemin e parave të shtëpisë.

- Edhe sa ditë mund të shtyjmë? - pyeti.

- S'ka mbetur pothuaj asgjë, - iu përgjigj e bija.

Ai psherëtiu njëherë në mënyrë të pakontrolluar.

- Kam për të marrë disa lekë te një shok, - tha pastaj. - Kam rregulluar nja dy makina këto ditë. Meri, ti e kupton. Nuk ka punë. Nuk është se unë nuk dua të punoj. Ai shoku ka oficinë

private, por ka punësuar njerëzit e vet. Mua më thërret vetëm kur ka nevojë.

- Të kuptoj ba. Do të shpenzojmë aq sa kemi.
- Meri... më falni! Unë dje... nuk mbaj mend... mbase...
- Dje nuk ndodhi asgjë.
- Mos u mundo të më shfajësosh.

Meri u shtir sikur ishte tepër e përqëndruar në punë dhe nuk dëgjoji. I ati buzëqeshi me mirënjohje, pastaj i ktheu sytë i menduar nga shtrati me zambakë rrëzë múrit që ndante oborrin me shtëpinë ngjitur. Ajo duhej të ishte tani atje, mendoi. Është koha e zambakëve. Fat i poshtër, pse më dënove kështu?

Ai doli nga shtëpia herët, pa e ditur as vetë në se atë ditë do të gjente dot ndonjë punë. Meri u detyrua t'i shkundte Albin dhe Norën për supesh që t'u dilte gjumi. I vëllai u ul në tavolinë duke fërkuar sytë e duke çapëlyer gojën.

- Ufa! Kur do të mbarojë kjo shkolla! - ia bëri. - Meri, çfarë ka për të ngrënë?

Ajo hapi frigoriferin duke e ditur fare mirë se aty brenda do të gjente vetëm një copë djathi dhe një kavanoz salce. E mori djathin, e ndau në dy pjesë, pastaj preu një fetë buke, kulloi mbi të nga një shishe plastike pikat e fundit të vajit të ullirit dhe ia vuri të vëllait para.

- Urdhëro. Një copë djathi është e jotja, një copë e Norës.
- Prapë bukë me djathë? - thirri Albi me inat.
- Siç e shikon.
- Çfarë shtëpie është kjo ku hahet vetëm bukë me djathë!
- Është shtëpia jote! - thirri edhe Meri. - Dhe qepe gojën! Dije mirë se nuk ta ka njeri qejfin. E more vesh?
- Meri, ndonjë ditë, kur të mungojë drejtoresha e shkollës, zëvendësoje ti, - tha Albi duke nënqeshur. - Je talent për të vendosur qetësi.

Ajo u detyrua të ndërronte takt.

- Albi, unë nuk të mbaj më për kalama, - tha duke e zbutur zërin. - Nuk na dalin paratë. Duhet të jetojmë me pak.
- Pra, jemi të varfër? - pyeti ai i zhgënjyer.
- Ajo pohoi me keqardhje.
- Pse, edhe në demokraci, ka të varfër?

- Unë di që babi është pa punë dhe kur një njeri është pa punë, nuk merr rrogë.

- Po pse nuk ka punë?

- Sepse parku u mbyll.

- Po pse u mbyll?

- Albi, të lutem!

Pas disa përdredhjesh e nazesh, ai u detyrua t'i kthehej bukës me djathë, pastaj mori motrën e vogël për dore ta çonte në kopësht, detyrë kjo që s'para i pëlqente. Meri u detyrua të dilte nga shtëpia pa ngrënë. Por ndërsa po kalonte poshtë ballkonit të një fqinje, ballkon i cili qe përshtatur alla shqiptarçe në byrektore, dëgjoi një zë gruaje që i foli. Ajo u ndal dhe u afrua. Një dorë i zgjati dy byrekë të ngrohtë, mbledhur me një letër të bardhë.

- Teta Bardha, falemnderit, por sot nuk më hahet, - tha Meri duke u skuqur.

- Mos m'i kthe xhan. Haji më vonë.

- Po unë... nuk mund të paguaj.

- I ke nga unë. S'dua të më paguash.


Vajza i mori byrekët kokulur. Aroma e tyre e këndshme e bëri të ndjente një ngacmim në stomak.

- Kujdes andej nga shkolla! - i foli teta Bardha.

Meri i buzëqeshi për t'i treguar se do ta mbante parasysh atë porosi. Bardha kishte patur miqësi me nënën. Dikur kishin punuar bashkë. Ajo kishte mbetur e ve që prej disa vjetësh, në një moshë ende të re, me një vajzë tetëvjeçe. Tashmë jetonte së bashku me të ëmën, një grua ende e mbajtur që ia thoshte për të bërë byrekë. Mbanin shtëpinë me atë biznes. Byrekët bliheshin në masë nga nxënësit e shkollës që ndodhej aty pranë dhe nga kalimtarë te rastit.

Meri hëngri vetëm njërin prej byrekëve. Tjetrin ia ruajti të vëllait.

Ajo ditë shkollë qe e zhurmshme. Mësimëve po u vinte fundi. Ditët e ngrohta të verës kishin nisur. Djemtë e vajzat e klasës po përpiqeshin të organizonin një ekskursion për në Durrës. Flitej vetëm për det, rroba banje, vaj plazhi, çadra dielli dhe për një autobus. Meri nuk diti si të shmangej. Duhej paguar për



autobusin, pa llogaritur ndonjë lek që do të nevojitej me vete. Por Bona, një nga vajzat e shkathta të klasës, që po merrej me mbledhjen e lekëve, i tha duke i rënë supeve:

- Meri, ti je në rregull. Ka paguar zysha kujdestare.

Ajo mbeti e hutuar nga ato fjalë. Megjithatë, Sidritit nuk i premtoi gjë për ekskursionin. Mbase vij, i tha, të shoh. Ai e vështrroi njëherë i menduar.

*

*

*

Kur Meri u kthye në shtëpi, gjeti te porta gjyshen. Ajo po priste. Veshur e tëra në të zeza, dukej edhe më e plakur, ndonëse sapo i kishte kapërcyer të gjashtëdhjetat. I shoqi i kishte vdekur që para tre vjetësh dhe pas emigrimit të të birit në Itali, ajo kishte mbetur pothuaj vetëm. Ishte një natyrë e dashur dhe e dhembshur. Vetmia dhe fatkeqësitë që kishte pësuar sikur e kishin bërë edhe më të ndjeshme.

Gjyshja i hodhi një sy shtëpisë, me një pamje të për-malluar.

- Ku është yt atë? - pyeti pastaj.

- Shkoi në punë që në mëngjes.

- Punëzeza! - ia bëri gjyshja. - Po për drekë, ç'do të hani?

- Si gjithmonë, - ia ktheu Meri duke u skuqur.

Gjyshja hapi njëherë sirtarët e bufesë, pastaj frigoriferin, ndonëse e dinte mirë gjendjen e tyre. Doli pa folur dhe u kthye pas ndonjë çerek ore me duart mbushur me qese plastike. Kishte blerë nga të gjitha. Përgatiti shpejt e shpejt drekën, pastaj pyeti pa e vështruar të mbesën:

- Kishte pirë yt atë mbrëmë?

- Jo, - gënjeu Meri, duke qenë e bindur se ashtu ishte më mirë.

Por të pasnesërmen babai u kthye në shtëpi edhe më vonë. Ishte përsëri i dehur. Meri e Albi mbetën edhe më të trembur. Vajza nuk mundi të mbyllte sy deri vonë. Kur mendonte se të nesërmen e prisnin në oborrin e shkollës për t'u nisur për në Durrës, plazhi i dukej gjëja më e largët e më pa kuptim në botë.

U zgjua nga të lehurat e Sparkit. Në portë trokisnin. Ora e

kishte kaluar tetën. Ajo u ngrit dhe doli në oborr duke fërkuar sytë e buhavitur. Ishte Sidi. Ai mbeti tepër i zhgënjyer kur e pa ashtu.

- Meri, si... nuk...? - mërmëriti.

- Më vjen keq, - tha ajo. - Ashtu kam një problem.

Ai nuk po lëvizte nga vendi. E mbante kokën paksa përkulur për të mos prekur traun e sipërm të portës.

- Pra... është e sigurtë që nuk vjen?

- Sid, ju kërkoi falje të gjithëve, por...

Pas syzeve optike vështrimi i tij u bë lutës.

- Meri, unë sot lashë edhe stërvitjen.

- Sid, të lutem më kupto!

Ai iku pa folur më, kokulur, me duart në xhepat e xhin-seve të gjera, me një tundje ritmike të supeve, tipike si të basketbollistëve kur ecin me top. Por në ecjen e tij mungonte gjallëria e zakonshme, detaj të cilin vetëm ajo ishte në gjendje ta dallonte. U kthye brenda e mërzitur. Kaloi një ditë tepër të bezdisshme. Vinte vërdallë nëpër shtëpi si një lodër e kurdisur, por mendjen e kishte atje larg në breg të detit ku shokët e shoqet e klasës luanin të gëzuar.

Babai nuk guxoi t'i fliste. U ngrit, u vesh me ngut dhe u mat të dilte gati fshehurazi. Pasi i dilte pija, ai zotëronte një kthjelltësi të plotë. Merrte me mend gjithçka që mund të kishte ndodhur kur kishte qenë i dehur dhe ajo gjë e bënte të ndjehej fajtor.

- Ba, nuk do të pish kafe? - i foli e bija.

- Jo, - tha ai. - Po e pi jashtë.

Ajo e kishte të qartë se ai do të mblidhej tani në shtëpi vetëm në darkë. Sikur kishte ankth nga ajo shtëpi. Donte të rrinte sa më pak brenda. Të djeshmen kishte sjellë edhe një dorë lekë të cilat mund të dilnin me kursime e shumta për një javë.

Vonë pasdite Meri iu afrua telefonit dhe formoi numrin e Sidit. Ai sapo ishte kthyer.

- Hë, si ia kaluat? - pyeti ajo.

- Të gjithë u kënaqën, vetëm mua mu ngritën nervat, - tha ai. - Ishte një ditë koti.

- E pse?

- Nuk e di. Më mbeti mendja tërë kohën që ti nuk erdhe.

- Pse, ti pandeh se unë u kënaqa mbyllur brenda? - ia ktheu ajo me ankim.

Pasoi një heshtje e shkurtër.

- Sid, më ke falur që nuk erdha?

- Sigurisht që të kam falur. A di kujt ia nxora inatin?

- Jo.

- Një gaforreje.

- E çfarë i bëre?

- E torturova një orë deri sa mësoi të dredhonte mes topave të leshterikut.

Meri u detyrua të qeshte. Të nesërmen e pati më të lehtë të shkonte në shkollë.

*

*

*

Ishin ditët e fundit të mësimit dhe ajo e kuptoi se e priste një verë e gjatë dhe e mërzitshme. Nuk ishte më si përpara. Gjyshja i kishte folur disa herë e merakosur. Shumë gjëra duhet t'i harrosh, i kishte thënë ajo, muzikëra, të kërcyera, shëtitje e sporte. Një vit më e madhe se ty unë u martova dhe shkova te burri. Tani është ndryshe. Vajzat martohen të mëdha, por ama dashuriçkat i fillojnë ende pa mbaruar librat e shkollës. Ti me djemtë nuk ke punë. U kuptuam? O nëna, as me Sidin, e kishte pyetur ajo e trembur. Kush është Sidi, ai shtylla e telefonit që luan me top, ia kishte bërë gjyshja e vrenjtur. As me të! Tani... kur është fjala për punë shkolle... edhe mund të takoheni. Meri e kishte përqafuar dhe i kishte premtuar se nuk do të gabonte. Eh, edhe një gabim yti më duhet mua, kishte psherëtirë gjyshja... Ditën e fundit të shkollës, ndërsa po dilte nga porta kryesore, Meri ndjeu trishtim. Dëgjoi zërin e mësueses kujdestare që i foli dhe u përmend.

- Meri, në se gjatë verës do të kesh nevojë për mua, më kërk,

- tha mësuesja. - Numrin tim të telefonit e ke. Mund të takohemi sa herë të duash. Kur të të mbushet mendja, eja edhe nga shtëpia.

Vajza u zgjat dhe e puthi me mirënjohje.

- Falemnderit mësuese Linda!

- Deri tani unë s'të kam bërë asnjë nder.
- Ju... ju jeni ndryshe. Më e mirë nga mësueset e tjera.
- Nuk e besoj.
- E besoj unë.

Mësuesja i buzëqeshi dhe i shtërngoi dorën.

Me të mbërritur në shtëpi, Meri e futi çantën në një raft dhe ia nguli sytë kalendarit. Iu duk sikur qershori, korriku e gushti kishin ditë sa gjithë pjesa tjetër e vitit. Po fillova kështu, vera vërtet s'do të mbarojë, mendoi. Përveshi mëngët dhe u hyri punëve të shtëpisë. Vonë pasdite, kur gjyshja ia mbërriti aty dhe hodhi një vështrim rrotull, nuk mundi ta përmbante kënaqësinë.

- Ja, kështu duhet, - tha. - Vajzat duhet të jenë punëtore dhe jo ta kenë mendjen te tualeti sapo dalin nga veza. Pikë e zezë! Ç'kohë kanë ardhur! Apo s'më lyhen edhe me lloj-lloj bojrash e marifetesh. Po kur më zbulojnë ca edhe barkun! Kiamet i zi! Kur isha unë vajzë, s'të linin të zbuloje as fytyrën.

Meri filloi të qeshte.

- Po yt atë, s'është kthyer akoma? - pyeti gjyshja pas pak.

- Jo.

- E ku ndodhet?

- Nuk e di.

- Mesiguri në ndonjë pijetore, - ia bëri gjyshja me një mllef të lehtë. - Ndihej o Zot! Edhe të pirit e tij kishim mangut.

Ajo ndenji deri pas darke. Kuptohej se e kishte ndarë mendjen të priste deri sa babai të kthehej. Kur ai hyri në shtëpi, ajo ia nguli sytë e merakosur. Babai e përshëndeti si me ndrojtje.

- Meri, Albi, na lini pak vetëm, - tha gjyshja.

Fëmijët dolën kokulur.

- Mesiguri do të bësh moral, - dëgjoji Meri zërin e të atit.

- Bashkim, dua të flas me ty hapur, - tha gjyshja. - Mos merr për keq asnjë nga fjalët e mia. Unë e kuptoj fare mirë dëshpërimin që të ka shkaktuar vdekja e time bije. Por për hatër të fëmijëve duhet të mbledhësh veten. Të heqësh dorë nga pija. Është një ves që do të të shkatërrojë ty dhe gjithë familjen.

- Të kuptoj, - ia ktheu babai. - Do të mundohem të heq dorë.

- M'i thua këto që të mos e zgjas më. Kështu?

- Po të them atë që mendoj.

- Të shohim.

Gjyshja u largua duke vështruar prapa me dyshim.

Dhe dyshimi i saj nuk qe pa baza. Babai vazhdoi të pinte njëlloj si më parë. Ajo gjë ra në sy të fqinjëve. Shumë prej tyre pothuaj i ndërprejnë hyrje-daljet në shtëpi. Merit i vinte turp kur dilte në rrugë. I dukej sikur të gjithë e vështronin shtrembër, sidomos shoqet e klasës që banonin aty rrotull. Ndonëse ato nuk kishin në plan të lëviznin nga Tirana gjatë verës, Merit nuk i bëhej t'u shkonte për vizitë. Shoqet mblihdeshin paraditeve nëpër shtëpitë e njëra-tjetrës, por ajo u shmangej qëllimisht. E kapërcente portën e shtëpisë rrallë. Vetëm kur shkonte me gjyshen në varreza për të parë varrin e nënës ose kur dilte me Albin për të ndjekur ndonjë ndeshje basketbolli ku luante Sidi.

Gjendja në shtëpi sa vinte e bëhej më e çrregullt. Nuk kishte një dorë që të mbante llogarinë. Lekë herë gjendeshin e herë mbeteshin pa gjë fare. Njerëzit më të afërt, përveç gjyshes, filluan të dukeshin rrallë e më rrallë. Tezja po përga-titej të largohej jashtë shtetit. Ajo do të linte në Shqipëri për të ndenjtur me gjyshen vetëm vajzën e madhe që ndiqte Fakultetin e Mjeksisë. Daja po ashtu kishte problemet e familjes së tij në Itali. Halla e vogël jetonte në Elbasan. Një ditë, pasi u largua pa e takuar dot të vëllanë, ajo e përqafoi Merin duke thënë me lotë në sy:

Xhan i hallës, të lutem më kupto. Unë nuk vij dot shpesh. Jemi ngushtë nga ekonomia. Rruga po rrugë. Më vjen keq, nuk mundem t'ju ndihmoj dot.

- Të kuptoj, - ia ktheu Meri.

- Nuk ma merrte kurrë mendja që Bashkimi të katandisej kështu, - psherëtiu ajo. - Ka qenë njeri i fortë, punëtor me nam. E respektonte tërë ndërmarrja, tërë lagjia. E dënoi Zoti padrejtësisht. Nuk e meritonte këtë fat.

Ajo u largua duke fshirë lotët me shami...

Mbështetja e vetme ekonomike mbeti halla e madhe, Donika. Ajo jetonte në Tiranë dhe i shoqi merrej me tregti. Kishte një veturë të shtrenjtë dhe sa herë vinte në shtëpi, e parkonte atë para portës, duke tërhequr vëmendjen e fqinjëve. Halla kishte kohë që notonte në bollëk. Një djalë e kishte çuar për të studjuar

në Sh.B.A. Sa herë vinte te i vëllai, ajo i kishte duart ngarkuar. Por për habi, babai donte më shumë motrën e Elbasanit që ishte e varfër. Motra e madhe i dukej ndryshe. Pa folur për të shoqin që nuk e duronte dot.

- Nuk më pëlqen fare ky njeri, - i tha një mbrëmje Merit. - S'është i sinqertë. Që kur vuri ca para, është bërë i padurueshëm.

- Rëndësi ka të na dojë halla, - ia ktheu e bija.

- Edhe ajo ka filluar t'i ngjajë atij.

- Ba, po ajo po na ndihmon!

- Më duket sikur na sjell ndihma humanitare. Unë s'kam nevojë për lëmoshë.

E bija u mundua ta qetësonte.

- E vërteta është se nganjëherë kemi.

- Meri, të lutem më besoj, unë nuk flas kështu nga inati se ai njeri është i pasur, kurse vetë jam katandisur në ditë të hallit.

Burri i sime motre nuk më pëlqen si tip dhe pikë!

Ajo ishte ngutur të ndërronte bisedë...

3.

Ishte një ditë mesgushti, me një zagushi mbytëse, kur Meri u përmend nga zilja e telefonit. U ngrit me ngut. Ishte Sidriti.

- Meri, je shumë e zënë sot pasdite? - pyeti.

- Si gjithmonë, - ia ktheu ajo.

- A mund të dalim për të ngrënë një akullorë? Unë duhet të nisem nesër për në Ohër. Do të shkoj me këta të shtëpisë me pushime dhe... thashë... sikur...

- Mirë, dalim.

- Po vij te shtëpia. Ej, Meri, sikur të marrim edhe Sparkin?

- E marrim.

Gjëja e parë që ajo mendoi pas asaj telefonate qenë rrobat që do të vishte dhe sandalet. U bë nervoze. Nuk kishte asgjë të modës. Sidomos nga këmbët. Sandalet që kishte përdorur edhe verën e kaluar, i binin të vogla. Një fund i mirë i qe shkurtuar. E vetmja gjë e saktë që një bluzë mëndafshi me mëngë të shkurtëra

që ia kishte sjellë daja nga Italia. Vendosi ta vishte atë me xhinse. Ndërsa nga këmbët u detyrua të mbathte një palë atlete të përdorura që ia kishte falur goca e hallë Donikës. Nuk mbahej mend që kur nuk kishte blerë asgjë për vete. Kur shikonte shumë nga shoqet e klasës se si visheshin, i dukej vetja më e humbura.

Qëndroi para pasqyrës dhe filloi të kalonte e menduar krëhërin nëpër flokët rrica-rrica.

- Pse nuk i lyen me xhel? - pyeti Albi që ishte ulur aty pranë me një libër në duar.

- Të lutem mos u tall, - ia ktheu ajo me ankim.

Ndërkohë Sidriti hyri në oborr dhe filloi t'i fliste Sparkit me nota miqësore. Tashmë qeni e njihte dhe nuk lehu. Meri dhe Albi dolën në oborr.

- Ç'kemi Sid, a ke shtuar ndonjë centimetër?-foli Albi.

- Nuk jam matur.

- Dëgjo, bëjmë një biznes të vogël?

- Ta dëgjojmë.

- Ça më jep po të të jap një fotografi të Shek O'Neillit?

Sidi lëshoi një fërshëllimë habie.

- Vërtet ke gjetur fotografi të Shekut?! Atëhere sikur ta ndërronim me një kasetë të "Duran-Duranëve"? Apo "883"?

- Apo s'më bëhet vonë mua për "Duranët" dhe "883"!

- Me një fjalë, nuk do kasete?

- Jo.

- Po sikur të të jap një top futbollit të përdorur?

Albi u mendua një hop.

- Mirë, - pranoi pastaj. - A e do tani fotografinë?

- Jo, kur të kthehem. Dëgjo, do të vish me ne të të qerasim me një akullore?

- Problemi është se nuk më pëlqen të shoqërohem me njerëz më të gjatë se vetja.

Meri e përkëdheli të vëllanë duke qeshur. Ai ishte natyrë e zgjuar. Albi ishte mësuar lehtë me Sidin dhe një ditë i kishte thënë së motrës me një pamje serioze: këtë Sidin e ke vërtet shok për së mbari...

- Albi, të lutem zgjidhe pak Sparkin se do ta marrim me vete, - i foli ajo.

Qeni filloi të kërcente i gëzuar kur e kuptoi se e priste një shetitje e këndshme. Ai ishte një leshtor veshvarur, në ngjyrë kafeje, me këmbë të shkurtëra dhe bisht të shkurtër po ashtu, që i ngjante nga prapa si një lulebore. Meri e mori për rripi dhe e urdhëroi të sillej mirë. Qeni iu fërkua te këmbët për t'u treguar sa më i bindur.

- Po xhaxhi Bashkimi, ku është? - pyeti Sidi papritur.

Motër e vëlla u vështruan për pak çaste në bisht të syrit.

- Ka shkuar nga halla, - tha Albi pa vonesë.

- U bë ditë që s'e kam parë.

- E po... punon tërë ditën në një ofiçinë.

- Mbase e takoj kur të kthehem.

Ata të dy morën drejt qendrës. Ndonëse nuk ishte hera e parë që dilnin bashkë, Meri u hutua. I dukej vetja ndryshe dhe po habitej se si Sidi nuk po e vinte re ndryshimin. Por ai ishte tip që nuk i kushtonte vëmendje veshjes apo pamjes së jashtme. Mbase asgjë s'ka ndryshuar, mendoj ajo. Ai nuk e ka marrë vesh që babai ka filluar të pijë. Ç'do të bëjë vallë kur ta mësojë?

- Këto pushimet në Ohër dolën befaz, - tha Sidi. - Njëherë nuk desha të pranoj, por më urdhëruan. Do të shkojmë bashkë me familjen e Anës. Të marrin në pushime me detyrim!

Ana ishte një moshatare e tyre që ndiqte Liceun Artistik në degën e muzikës. Studjonte për piano. Banonte në një pallat me Sidin dhe familjet e tyre kishin miqësi.

- Atje me siguri do të ketë ndonjë fushë basketbolli, - foli Meri.

- E di, por... s'e marr vesh pse nuk më shkohet. Janë tri javë.

Ajo provoi një turbullim të lehtë pas atyre fjalëve. Ecën gjatë pa folur. Po i afroreshin bulevardit kryesor kur Sidi pyeti se ku do të uleshin. Meri u skuq.

- Sid, nëpër lokale më vjen turp. Jam ende e vogël.

Ai qeshi.

- Po akulloret për të vegjël janë!

- Më mirë i marrim në dorë dhe ulemi te shkallët e piramidës.

- Si të duash.

Ata iu afruan një tregtize përbri së cilës qe vendosur një banak-frigorifer mbushur me akullore të mbështjella.

- Zgjidh, cilën do? - tha Sidi.
- Zgjidh ti i pari, - ia ktheu ajo. - Do të paguaj unë.
- Meri, të lutem! Të ftova unë.
- Po... unë... nuk mbahet mend sa kam pa të qerasur.
- Ashtu? Atëhere kur të kthehem nga pushimet do të ha tri akullore njëherazi.

Ajo u detyrua të nxirrte dorën nga xhepi i xhinseve ku kishte ca të holla nga të llogarisë së shtëpisë. Zgjodhi një akullore me reçel qershie, nga e cila mori edhe Sidi. U ulën te shkallët e mermerta ku në atë orë të buzëmbremjes njerëzit dyndeshin me shumicë pasi ishte i vetmi vend ende i papushtuar plotësisht nga tregtizat dhe lokalet. Sparki u ul në bisht pranë tyre. Por pas pak pa një qenushe bardhoshe aty pranë dhe u lëshua drejt saj.

Papritur, diku nga Dajti, u dëgjua një bubullimë. Qielli po nxihej, megjithatë njerëzit nuk tundeshin nga vendi.

- Do të bjerë shi, - tha Meri.
 - E pastaj? - qeshi Sidi. - Le të lagemi ca se na vdiq vapa.
- Ajo psherëtiu pa dashur.
- Ç'pate? - pyeti ai.
 - Hiç, se si më erdhi.
 - Je akoma e mërëzitur për shkak të mamit?

Asaj iu njomën sytë brenda sekondit. Sikur të ishte vetëm mami, mendoj.

- Më fal, - tha Sidi i prekur. - Nuk doja.
- S'ka gjë. Ja, do të më kalojë. Më trego pak për atë ndeshjen e fundit.

- Ndeshjen që luajtëm në Durrës me "Delfinët"? Eh, s'kanë lindur akoma as delfinë e as peshkaqenë që të mundin "Të pamposhturit".

Ekipi ku Sidi bënte pjesë quhej "Të pamposhturit" dhe mes ekipeve të të rinjve të shkollave 8-vjeçare ishte ndër më të fortët. Sidi filloi të tregonte me qejf për ndeshjen e Durrësit. Ndenjën aty te shkallët deri sa ra mbrëmja. Bubullimat u shtuan. Qielli ishte mbyllur cep më cep. Njerëzit filluan të largoheshin. U largua edhe qenusnja e bardhë. Sparki mbeti vetëm. Ai filloi të lehte me inat.

Sidi e mori dhe ata u nisën për t'u kthyer. Por s'kishin bërë as pesë minuta rrugë kur ia krisi një shi me pika të mëdha. Nëpër lokalet e hapur tavolinat u zbrazën. Rrugët po ashtu. Sparki filloi të angullinte dhe nuk po dinte ku të strukej. Meri u lag e tëra. Sidi hapte krahët dhe qeshte. Syzet e veshura nga uji e bënë të dukej sikur po vështronte që prapa ndonjë vitrine. Meri vrapoi drejt strehës së ulët të një tregtize aty pranë. Qeni u tulat te këmbët e saj. Ia mbërriti edhe Sidi me tre-katër kërcime.

Shiu u shtua. Ishte një rrebesh inatçor që i mbushi rrugët me ujë brenda pak minutave. Streha ku ata ishin futur ishte e ngushtë dhe mezi arrinte t'i mbronte. Sidi qe përkulur paksa. Meri shkundi njëherë flokët, pastaj mblodhi krahët duke u dridhur. Bluza e lagur i qe ngjitur për trupi. Rrëkezat që vareshin nga streha i binin mbi supe e qafë. Nuk po dinte si të mbrohej prej tyre. U afrua më pranë Sidit.

Papritur ndjeu mbi supe krahun e tij. U struk nën atë krah si nën mburojën më të sigurtë në botë. Provoi një turbullim të ëmbël dhe harroi se ku ndodhej. Sidi nuk fliste. Krahu i tij i ngrohtë dridhej i pasigurtë mbi supet e saja. Nuk ishte hera e parë që ata qëndronin pranë njëri-tjetrit. Jo rrallë ajo kishte hipur në biçikletë pas tij kur ktheheshin nga stërvitja. Por atë lloj turbullimi nuk e kishte provuar kurrë.

Nuk u kuptua sa kohë kaloi. Shiu kishte pushuar. Ata u përmendën nga një lehje ankuese e Sparkit. Nuk guxuan të vështroheshin. U nisën me ngut duke kërcyer herë pas here për t'u shmangur pellgjeve dhe rrëkeve të ujit. Deri pranë shtëpisë nuk folën. Vetëm kur ndalën para portës, i ngritën sytë nga njëri-tjetri dhe e kuptuan brenda sekondit se gjërat nuk ishin më si më parë.

- Mirupafshim! - foli ai pas pak.
- Po atë... fotografinë e Shekut? - u kujtua ajo.
- Ah, po, - ia bëri ai i hutuar.

Sidi hyri në oborr dhe papritur Meri ndjeu një alarm trembës. Po sikur babai të ishte kthyer i dehur si shpeshherë ato kohët e fundit? Por brenda dukej qetësi. Albi po ndiqte një film në televizor. Ajo i foli, pastaj shkoi të lidhte qenin. Albi doli me fotografinë e mbledhur me një gazetë.

- Qenkeni lagur sa për gjithë dimrin, - ia bëri duke qeshur.
- Albi, topin do të ta sjell kur të kthehem, - tha Sidi.
- Në rregull. Ia kalofsh mirë andej!
- Edhe ti këtej!
- Apo s'shtyhet vera këtu ore!

Ai u kthye brenda për të mos u shkëputur nga filmi.

Sidi i zgjati Merit dorën. Ajo pati ndrojtje t'ia shtërngonte. Dora e vet ende i dridhej. Preku vetëm gishtat e tij dhe mezi arriti të mermëriste një "Mirupafshim". Tërë mbrëmjen e kaloi e hutuar. Sikur Nora të mos ishte ankuar se e kishte marrë uria, do ta kishte lënë pa darkë. Ndërsa Albi hëngri vetë, ç'i doli para. Kur ora e kaloi dhjetën, ata të dy filluan t'i kthenin sytë nga porta.

- Sa do të vazhdojë kjo punë kështu? - pyeti Albi me ankim.

Meri nuk i ktheu përgjigje. Priti vetëm, deri vonë, kur i ati u kthye. Ndërsa u ndeshën ballëpërballë, ai uli kokën si fajtor.

- Meri, më fal, e di që është vonë, - mermëriti. - Nuk doja, por... një shok... ndodhi...

Ajo e pyeti në se donte të hante, por ai kërkoi vetëm ujë të ftohtë. Fjeti në një minder të vjetër në verandë, duke hedhur sipër një batanije pambuku. Që kur nëna kishte vdekur, nuk kishte kaluar asnjë natë në dhomën e dikurshme bashkëshortore. Binte për të fjetur ku të mundte, vetëm në atë dhomë jo. Meri nuk po arrinte ta kuptonte atë lloj veprimi.

Atë natë ajo mezi arriti të flinte. Kërcitja e shiut mbi strehën e asaj tregtizës i ushtonte ende në vesh, e ëmbël, e afërt. I dukej sikur supët i kishte ende të ngrohtë. Të nesërmen u zgjua vonë. Bënte vapë. U ngrit me veprime të ngathta për të nisur punët e zakonshme të mëngjesit. Idea se e priste një ditë e bezdisshme, pafundësisht e gjatë, e bëri të psherë-tinte ende pa larë sytë.

Mëngjese të atillë filluan të kalonin njëri pas tjetrit dhe Meri i numëronte ata gjoja sikur nuk i interesonin. Nuk doli nga porta për ditë me radhë. Kur ndonjëra nga shoqet e klasës vinte për ta marrë, mundohej ta sqaronte se nuk mund ta linte dot shtëpinë vetëm. Mund të vinin njerëz për vizitë dhe ajo duhej të ishte aty.

Një pasdite, ndërsa qe ulur në kopshtin prapa shtëpisë, sytë i shkuan te një kosh i vjetër basketbolli, i cili qe montuar në

mur kohë më parë. Koshi kishte shkuar shtrembër. Rrjeta i qe grisur. Me të nuk luante më njeri. Asaj iu fanitën para syve dy krahë të njohur që zhytën brenda koshit një top. Sid, ç'po bën tani, mëmëriti me mall.

*

*

*

Që nga dritarja e hotelit tabela e plastiktë e basketbollit dukej vezulluese. Dielli i perëndimit binte pjerrtazi mbi të. Sidi e vështroi për ca çaste i menduar, pastaj mori topin dhe doli. Trokiti njëherë në derën e dhomës së prindërve. Ata ishin ngritur. Nëna kishte vënë në prizë një ekspres elektrik italian dhe era e këndshme e kafesë kishte mbushur dhomën. Ai përshëndeti.

- E Sid, ç'thotë jeta? - ia bëri i ati duke qeshur.

Djali përplasi njëherë topin në dysheme.

- Jetë hoteli.

- Na vdiqe me këtë basketboll, - ia bëri e ëma. - Sikur erdhe këtu për stërvitje.

- E ç'të bëj tjetër?

- Je i pakënaqur, ë?

- Çka.

- Duhet të jetë më mirë në Tiranë, - vazhdoi të qeshte babai. I biri e ftoi të dilnin të luanin.

- Posi! - ia bëri Elona. - Po unë, me kë të luaj këtu?

- Eja dhe ti o ma.

- Ti bën mirë të luash me Anën.

- Ana nuk merr vesh nga basketbolli.

- Mësoje! Edhe ti nuk merr vesh nga pianoja. Më duket se nuk po sillesh si duhet me të.

- E pse?! - u habit djali.

- Sepse edhe ajo po mërzhitet.

- Ana ka ca naze të padurueshme.

Elona hodhi kafënë nëpër filxhanë.

- Ana është vajzë model, - tha me një ton që s'pranonte kundërshtim.

- Ju bëftë mirë kafeja!

Ai doli me topin nën krah.

- Po ndodhin gjëra të habitshme me këtë djalë! - iu drejtua Elona të shoqit. Arian Arbana qeshi përsëri.

- Nuk ka asgjë të çuditshme. Janë probleme të moshës që në kohën tonë ne kishim ndrojtje t'ua tregonim prindërve tanë. Bëmë gabim që e morëm me vete. Ai e ka mendjen në Tiranë, tek ajo vajza e klasës. Si e ka atë emrin e veçantë?

- Meriyll.

- Kur isha sa Sidi, kisha edhe unë një Meriyll në klasë. S'ngopesha duke e patur pranë. Doja të flisja tërë ditën me të, por atëhere s'kishim telefona.

Elona qeshi.

- E ke dëgjuar tët bir kur flet në telefon? Më duket se ka filluar të ndjejë diçka për atë vajzë. Çudi! Ana nuk e tërheq fare.

- Ana është tip egoisteje që kërkon të jetë gjithmonë në qendër të vëmendjes. E vure re? Sapo në hotel erdhi ai djali nga Hungaria që i binte violinës, gati e harroi Sidin dhe filloi të shoqërohej me të. Sapo hungarezi u largua, u kujtua për Sidin dhe provoi ta afronte duke u llastuar. Pikërisht këtë gjë djali ynë nuk e duron dot.

- Ti mendon se Meri është më e pjekur?

- Duhet të jetë. Mesiguri, edhe shumë e sinqertë.

- Mbase Sidi është ca naiv.

- Mbase. Djemtë janë gjithmonë më naivë në këtë moshë.

- Nuk më besohet kur e shoh ashtu të lartë sa dera. Kur u rrit xhanëm!

- Eh, ikin vitet e dashur! - Ariani la filxhanin mënjanë dhe u ngrit. - Sikur të isha edhe njëherë sa Sidi!

Ai vështroi poshtë nga fusha e basketbollit ku i biri po bënte gjuajtje të lira drejt koshit.

Topi bëri një hark të gjatë dhe ra mbi hekurin e koshit. Sidi mblodhi buzët dhe u përpoq të mos nervozohet. Mori topin, e përplasi disa herë pranë këmbës, pastaj e lëshoi rishtazi drejt koshit. Por përsëri hekur. Ai hoqi syzet dhe filloi t'i fshinte me pjesën e poshtme të bluzës. Kishte bërë fare pak kosha nga distanca ndonëse kishte kryer me dhjetra gjuajtje.

I vuri syzet përsëri, por fajin nuk ia kishin ato. Topi hynte në kosh një herë në katër-pesë gjuajtje. Ai e la fare atë dhe filloi të

vraponte anash fushës.

- Ej, Sidi, çfarë po bën? - dëgjo ndërkohë zërin e Anës.

- Ja, stërvitje.

- Dëgjo, desha të të pyes një gjë.

Ai u ndal dhe u afrua.

- A më shkojnë mua flokët tip iriçi, të ngritura përpjetë? A t'i pres ?

- E pse do të bëhesh iriçi?

Përgjigja që se ashtu që bërë edhe një këngëtare e famshme rroku. Ai tundi kokën në shenjë kundërshtimi.

- Ana, ti je pianiste dhe jo këngëtare rroku. Të gjitha pianistet që unë kam parë kanë pamje tepër serioze.

- Ke të drejtë, - tha ajo.- S'po i pres fare. Dëgjo, a do të vish të bëjmë një shetitje bashkë?

- Jo.

- E pse?

- Nuk më shetitet. Mbase nga darka... Eja edhe ti të bësh ca vrap.

- Nuk më vrapohet. Ta dish që edhe basketbollin e kam inat!

Ajo u largua duke u munduar të tregohej sa më e mërzi-tur. Ai e harroi pas pak sekondash. Kur u bë ujë në djersë nga të vrapuarit, filloi përsëri me gjuajtjet në kosh. Por atë ditë, me një kryeneçësi të habitshme, topi përplasej sa në tabelë e sa në hekur. Sidi e kuptoi se nuk po përqëndrohej dot. Ia ngjeshi njëherë topit me shkelm, pastaj e mori atë dhe u kthye në dhomë. Bëri një dush, pastaj u nis drejt një kabine telefonike që ndodhej aty pranë hotelit. Kishte blerë që të djeshmen një kartë, por nuk e kishte përdorur.

- Me kë do të flasësh? - e kishte pyetur nëna pasi kishte nxjerrë të hollat nga çanta.

Ai ishte skuqur.

- Elona, të lutem jepi lekët! - kishte ndërhyrë babai.

- Pse, nuk paskam të drejtë unë të di se me kë flet im bir në telefon?

- Sigurisht që ke, por kur ai të ta thotë vetë.

- Ah, e kuptova! - ia kishte bërë nëna duke zgjatur të hollat...

Sidi u fut në kabinë dhe formoi gati me ngut numrin e Merit.

- Sid, jam unë, - dëgjoji pas pak zërin e saj.
- Nga e dije që do të të merrja?
- Po prisja. Kisha një parandjenjë.
- Meri, unë... nuk e di... më ka marrë malli...
- Edhe mua.
- Si po ia kalon andej?
- Çka. Po ti?
- Edhe unë çka.
- Më trego ndonjë gjë.
- Më mirë më trego ti.
- Të kam bërë një dhuratë.
- Ma thuaj.
- Jo, më mirë kur ta shohësh vetë. Aja! Nuk di ç'të tregoj më.
- S'ke luajtur ndonjë ndeshje?
- Ah, po! Kam luajtur një ndeshje me ca çuna shqiptarë këtu nga Ohri.

- Ishe në formë?

- Jo edhe aq. Bëra vetëm 14 pikë.

Ai vazhdoi të tregonte për ndeshjen deri sa impulset filluan të mbaroheshin.

- Meri, fluturoi kjo karta! - ia bëri pastaj. - Do të të marr prapë! Mirupafshim!

- Sid, je shumë i mirë që më telefonove.

- Unë jam koti. E mirë je ti. Me yll. Bëji të fala Albit! Edhe Sparkit! Edhe gjashtë...

Pas atyre fjalëve, matanë linjës u dëgjua një sinjal me ndërprerje të vazhdueshme që tregonte se karta kishte mbaruar. Edhe gjashtë ditë kanë mbetur, tha Meri me vete. E di. I kam numëruar.

4.

Por kurrë nuk e kishte menduar se kthimi i Sidit dhe takimi me të do të përfundonte në një mënyrë të dhimbshme. Meri nuk mundi ta harronte dot për ditë me radhë atë takim.

Po ulej mbrëmja kur ai i ra portës me dorezën e vjetër prej bronxi. Meri e njihte mirë atë lloj trokitjeje. Zemra filloi t'i rrihte vullshëm dhe u skuq brenda sekondit, gjë që i ra në sy edhe Albit.

- Erdhi ky i shkurtri, - ia bëri ai duke qeshur. - Meri, po ti ç'pate?

- Hiç, - ia bëri ajo kokulur.

- Sid, kujdes mos vrasësh kokën! - thirri Albi.

Tjetri hyri, edhe ai i skuqur. Kishte veshur një palë pantallona të shkurtëra deri te gjunjët, një bluzë të gjerë hedhur mbi to dhe një palë atlete blu që ngjanin si dy govata. Kishte vënë syzet me skelet metalik të lara në flori që përdorte zakonisht kur rrinte larg fushës së basketbollit. Ato e tregonin më simpatik.

- Erdha, - tha duke hapur krahët. - Mirë se ju gjeta!

- Mirë se erdhe! - ia ktheu Meri duke i zgjatur dorën. E vështroi fare shkurt. Kishte frikë se vështrimi i tij do ta bënte të skuqej edhe më shumë.

- Hallall plazhi! - ia bëri Albi. - Të paska prirë.

Ata u ulën në verandë, nën tendën e një pjergulle, degët e së cilës kishin marrë deri mbi çati. Sidi filloi të tregonte për Ohrin dhe vendet e tjera që kishte parë. Ndërkohë, jashtë në rrugë, u dëgjuan zëra. Meri u pre. Ishte i ati. Hyri brenda bashkë me një burrë tjetër që dukej mjaft i nxehur. Merit iu kujtua në çast fytyra e tij. Kishte ardhur para nja dy orësh dhe kishte pyetur për të atin. Mbante në kokë një kapele doku ku qe shkruar "Juventus".

- Bashkim, unë dua paratë, - thirri ai. - Të dhashë borxh se kishe hall, tani më kthe paratë!

Babai hapi krahët duke dashur të kërkonte falje.

- E mora vesh. Paratë do të t'i kthej. Mos dysho për këtë.

- Unë nuk kam kohë të bredh pas teje. Hajt, tund paratë!

Burri me kapelen e "Juventusit" në kokë e ngrinte zërin kasten, duke dashur ta vinte Bashkim Gjokën në pozitë sa më të vështirë para fqinjëve.

- Javën tjetër, - ia ktheu babai me ton lutës.

- Ke dy javë që më thua javën tjetër. Unë s'kam asnjë faj pse ti i bën paratë rrush e kumbulla nëpër lokale!

Babai nuk mundi të duronte dot më.

- Dil jashtë! - thirri duke treguar portën.

- Ashtu? Atëhere po të jap vetëm dy ditë afat! Po nuk më ktheve paratë, më ke përsëri këtu!

Sidi u ngrit nga vendi dhe vetëm atëhere burri që po bënte fjalë me babanë i vuri re ata të tre në verandë.

- Më falni, - tha. - Nuk është faji im. Ju duhet të më kuptoni.

- Sigurisht që ju kuptojmë, - foli Albi.

- Mbylle ti! - iu kthye i ati. - S'është punë për ju kjo. Punët e mia i zgjidh vetë unë.

Ai u lëkund dhe mend ra. Albi nxitoi ta mbante për krahu dhe e ndihmoi të futej brenda. Sidi kishte ngrirë me krahët varur. Përshëndeti dhe u mundua të buzëqeshte, por Bashkimi as që e vuri re. Ndoshta iu duk si kolona anësore e verandës. Burri i parave borxh u largua duke përshëndetur ftoht.

Meri nuk po dinte nga t'i hidhte sytë. U hutua aq shumë sa filloi të ngatërronte fjalët. Lotët i kishte gati në të shpërthyer.

- Unë po dal, - tha Sidi. - Mbase...

- Ku po shkon? - pyeti ajo.

- Po kthehem në shtëpi.

- Ah... unë... do të të telefonoj... Prit, po të përcjell.

Ajo e shoqëroi deri te porta.

- Oh, desh harrova dhuratën, - tha ai duke futur dorën në xhepin e bluzës. Nxorri prej aty një kuti të vogël plastike.

- Për mua?! - ia bëri ajo.

- Më duket se të thashë që të kam bërë një dhuratë.

- Ah, po. Falemnderit Sid! Unë...

- Meri, shko qetësohu. Do të shihemi prapë.

Ajo u fut brenda, u pështet pas portës dhe filloi të qante duke ndjerë një dhimbje mbytëse në fyt. Për herë të parë provoi mëri për të atin, një mëri të cilën u përpoq ta shtypte. Por nuk ishte edhe aq e lehtë.

Albi ishte ulur i hutuar te shkallët e verandës.

- Si u bë ky njeri kështu! - psherëtiu duke vështruar nga e motra. - Edhe borxhet kishim mangut. E ku do t'i gjejmë paratë?

Meri, ty po të pyes!

- Nuk e di.

- Po ai burri i botës të vjen të merr televizorin!

- Le ta marrë! - ia bëri ajo me inat.

Shkoi u mbyll në dhomën e saj dhe doli prej aty vetëm të nesërmen në mëngjes. Kur veshi fustanin veror me të cilin rrinte në shtëpi, u kujtua se në xhepin e tij ndodhej dhurata e Sidit. E nxori atë, pastaj filloi ta hapte kutinë e plastiktë ngadalë, fare ngadalë, sikur të donte që ato çaste të zgjasnin sa më shumë. Pa disa guacka të vogla, të ngjashme në formë, por me ngjyra të ndryshme, të cilat ishin shkuar në një zinxhir të hollë argjendi. Ajo s'kishte parë kurrë guacka aq të bukura. E mori zinxhirin dhe e vari në qafë me duar të dridhura. Vargu i guackave, shtatë guacka ne formën e një kokrrë lajthie, krijoi mbi kraharorin e saj një ylber të vockël. Meri iu afrua pasqyrës dhe mbeti e mrekulluar.

Nxitoi te telefoni, por pastaj u kujtua për atë që kishte ndodhur të djeshmen dhe buzëqeshja i ngriu. Filloi ta mundonte rishtazi shqetësimi që e kishte torturuar gjatë natës, se çfarë duhej të kishte menduar Sidi pas atyre që kishte parë e dëgjuar. E ngriti receptorin dhe formoi numrin e tij e pasigurtë.

- Urdhëroni, familja Arbana, - dëgjoi zërin e nënës së tij.

- Mirëmëngjesi teta Elona! Jam Meri.

- Ah, Meri! Si je ti xhan?

- Mirë.

- Po nga shtëpia?

- Ashtu, mirë.

- Je e sigurtë?

Ajo u kapërdi tërë siklet.

- Po, jam.

- Nuk e kuptova pse Sidi u kthye dje nga ty disi i tronditur.

- ...

- Mirë, ja një minutë, t'i flas. Sidi nuk është zgjuar akoma.

Meri iu vesh balli me bula djerse. Nuk mund të fshihet më dot asgjë, mendoi. Pse o babi u bëre kështu, pse?

- Mirëmëngjesi! - dëgjoi zërin e Sidit.

U mundua të mblidhte veten.

- Sid, unë... të mora për të të kërkuar falje për atë... që ndodhi dje. Babi...

- Meri, të lutem! S'ke pse kërkon falje. Ti s'hyn fare në atë mes.

- Nuk dua që ti të mendosh keq.
- Aspak! Janë gjëra që ndodhin.
- Sid, shumë falemnderit për atë... dhuratën! Ishte gjë e rrallë.
- Të pëlqeu?
- Shumë. Nuk mund ta besosh sa shumë. Po ti, harxhove...
- Jo, s'kam harxhuar gjë. I ati i njërit prej atyre shqiptarëve që luajta basketboll ishte argjendar. Ma bëri varësen falas. Po ta dish ç'kam hequr për të gjetur guackat! Dy ditë kam kërkuar bregut të liqenit si ata qentë e gjahut. Sidomos ajo jeshilja ma nxiu jetën.

- Edhe njëherë falemnderit Sid!

- Mirupafshim!

Ajo nuk diti ç't'i thoshte se kur do të shiheshin.

E përmendi e qara e motrës së vogël që nga banja. U ngrit dhe nxitoi atje.

- Më dhemb barku, - u ankua Nora.

Meri vuri duart në bel dhe psherëtiu.

- Si të dhemb? Ku të dhemb?

- O le le barku! - vazhdoi të qante e motra.

Meri e mori për dore. Gjëja e vetme që i shkoi ndër mend që një çaj i ngrohtë. Ndërkohë dëgjoi në oborr zërin e teta Bardhës. I bëri përshtypje ajo ardhje e papritur e saj. Tjetra mbante në duar një pako. Duhej të ishin byrekë të ngrohtë. Meri e ftoi të ulej. Iu lut ta ndihmonte për Norën.

- Mos u tremb, - tha teta Bardha. - Do të ketë ngrënë ndonjë gjë pa larë. I ka vera këto. Ja, do t'i japim një hapje dhe do t'i vemë mbi bark diçka të ngrohtë. Më prit vetëm pesë minuta.

Ajo i la në duar pakon me byrekë dhe doli. Meri vuri në prizë hekurin e rrobave dhe filloi të ngrohte një peshqir. Ndërkohë përgatiti edhe një filxhan çaj. Teta Bardha u kthye pa vonesë dhe e bëri Norën të pushonte brenda pak minutave.

- Po yt atë, si është? - pyeti papritur.

Vajza vetëm psherëtiu.

- Dëgjo Meri, në se ju, domethënë ai, babi yt, ka nevojë për para... unë mund t'ju ndihmoj.

Meri u skuq.

- E paske marrë vesh ç'ndodhi dje?

- E dëgjova pa dashje. Ata filluan të bënin fjalë në rrugë.
- Pra, e mori vesh gjithë lagja?
- Eh, syrit e veshit të njerëzve nuk i shpëton kurrëgjë.
- Ç'turp!
- Nuk jeni ju të parët që ju zë ky hall. Mos harro se ka halle edhe më të mëdha. Tani unë po shkoj se kam punë.

Vajza i zgjati ca të holla.

- Për byrekët, - tha.
- Meri, ti më kupton. Unë s'erdha këtu për të shitur byrekë.
- Të kuptoj teta Bardha. Do të bisedoj njëherë edhe me gjyshen.
- Mirë. Dhe mbaj mend një gjë: sa herë të kesh nevojë, eja më kërkko.

Meri falenderoi kokulur. Porositi Albin të përgatiste ndonjë gjë për mëngjes dhe u nis për nga gjyshja. Ajo banonte në një apartament të vogël në Rrugën e Dibrës. Sapo e pa mbesën te dera, e nuhati se duhej të kishte ndodhur diçka.

- Jeni mirë? - pyeti me një tronditje të lehtë.

Vajza i tregoi për problemin e borxhit.

- E po, dihet! - psherëtiu gjyshja. - Pas rakisë do të vijmë borxhet, hallet, sherret. Ah, moj vajzë ç'më bëre me atë sëmundje të mallkuar!

Ajo u vesh dhe që te shkallët u mbajt te krahu i Merit. E mundonte reumatizma në njërin këmbë. Me tensionin kishte gjithashtu probleme. Me të hyrë në shtëpi, Meri e ndjeu se do të plaste ndonjë sherr. Babai përshëndeti ftoht. Gjyshja iu përgjigji po ftoht.

- Për ç'borxh është fjala? - pyeti pastaj.

Bashkimi vështroi nga e bija me inat.

- Meri, po ty, kush të autorizoi të merrresh me borxhet e mia?

- Koka e vet e autorizoi! - ndërhyri papritur Albi. - Sepse ai tipi që ulërinte, vjen nesër dhe na merr televizorin. Ku të shohim ne filma pastaj?

Të gjithë shtangën. Ishte herë e parë që Albi i drejtohej të atit me atë gjuhë. Ai e mbërtheu për krahu dhe thirri i nxehur:

- Ç'është kjo e folur? Kujt i flet ti kështu?

- Ty të flas! - thirri edhe Albi. - Prej teje po ndodhin të gjitha

këto.

Babai u mat ta godiste, por gjyshja ndërhyri në çast.

- Të lutem, fëmijët mos i prek!

- Ata janë fëmijët e mi! - thirri babai.

- Nëna, lëre të më rrahë, - tha Albi. - Mezi po pres t'ia mbath nga shtëpia.

Meri u tremb nga ato fjalë.

- Albi, mbylle gojën!-iu drejtua të vëllait. - Ky s'është problem për ty. Ti s'merr vesh as nga borxhet e as nga paratë.

- Posi moj! Marr që ç'ke me të!

- Albi mjaft! - ndërhyri gjyshja. - Bashkim, sa është borxhi?

Babai uli kokën.

- Është punë për mua, - tha.

- Unë do të të ndihmoj ta shlyesh.

- Ti nuk ke pse shlyen borxhet e mia.

- Më mirë të mbetesh borxh te mua se sa te ai boti.

Ai u detyrua të dorëzohej.

- Është një borxh i vjetër, - tha. - Ato para nuk...

- Sa janë?

- Dyqindmijë lekë të vjetra.

- Atëhere, këtë punë do ta zgjidh unë.

- Do të të lutesha shumë... ti e di... të kam respektuar gjithmonë... por biseda të tilla mos më hap më në sy të fëmijëve.

Gjyshja tundi kokën me keqardhje.

- Gabohesh! Ata nuk janë më fëmijë. Kuptojnë gjithçka. Meri për punë ditësh hyn në klasë të tetë. Dëgjo Bashkim, edhe unë të kam respektuar gjithmonë. Bile të kam dashur si djalin tim. Po vazhdove të pish, do të largosh fëmijët nga vetja. Më kuptove? Hiq dorë nga ajo e flamosur raki! Edhe nga ai drej duhani!

Babai pohoi me kokë, pastaj u tërhoq mënjanë.

- Po dal, - tha pas pak. - Kam një punë.

Meri iu afrua dhe e preku në krah.

- Ba, të lutem mos dil! Më mirë bëj ndonjë punë këtu. Rrushi është pjekur. Duhet mbledhur.

Ai vështrroi njëherë nga pjergulla e verandës.

- Me rrushin do të merrem nesër. Mos ki merak. Nuk do të pij. Të premtoj!

- Atëhere, ndërrohu. Vish një këmishë të larë. Prit, të të llustros edhe këpucët.

Para se të dilte, ajo i dha edhe një të puthur. Atij iu drodh mjekra.

- Meri, të ka babi zemër, - mërmëriti. - Edhe ty, edhe Albin.

- Edhe ne të kemi o ba.

Ajo u kthye dhe i hodhi të vëllait një vështrim qortues.

- Unë po shkoj me nënën, - tha Albi, duke iu shmangur vështrimit.

Gjyshja ndenji ca me Norën, pastaj u ngrit.

- Jepu një dorë punëve, - i foli të mbesës.

- O nëna, po dje lava e pastrova!

- Shtëpia do për ditë. Dje ishte dje.

Kur ishte fjala për punët e shtëpisë, gjyshja bëhej si ato inspektoret e higjienës. Meri u detyrua të merrte fshesën dhe filloi të mblidhte ca gjethe të rëna aty në oborr. Gjyshja e ndoqi ca me sy, pastaj doli me Albin për dore. Meri i hodhi gjethet në një gropë pranë trungut të një kumbulle dhe u ul te shkallët. Goja iu hap për gjumë. Aty ishte ende freskët dhe pas pak atë e mori dremia.

*

*

*

U përmend vetëm nga hapja e portës. Ishte Klara, një fqinjë që jetonte në pallatin përballë. Në qershor ajo kishte mbaruar klasën e tetë në të njëjtën shkollë me Merin. Por gjithmonë e kishte mbajtur veten për më të madhe. Ishte një tip që binte menjëherë në sy dhe për të cilën gjithmonë kishte patur fjalë. Nga fundi i vitit shkollor Klara qe lidhur me Genc Kalanë, një djalë tre vjet më të madh, duke i hapur shumë telashe familjes. Librat e shkollës i kishte lënë mënjanë dhe për nja tri javë kishte munguar fare në mësim. Atëhere u fol se ajo kishte ikur me Gencin në Greqi. Prindërit e saj u alarmuan. E kërkuan ngado. U vu në lëvizje edhe policia. Por Klara kishte qenë e fshehur në një shtëpi në Tiranë. Ndonëse ai detaj kurrë nuk u tha hapur, u mor vesh nga shumëkush. Klara u fejua me Gencin me të

mbaruar provimet, ndonëse prindërit e saj bënë çmos ta largonin prej tij. Ata u detyruan të dorëzoheshin pasi ajo i kërcënoi se do t'ia mbathte përsëri nga shtëpia...

- Çao Meri! Ç'kemi? - ia bëri Klara çapkënçe, duke nderuar ushtarakisht. - Mos është pjekur gjë ai fiku i bardhë andej prapa shtëpisë?

- Duhet të jetë pjekur.

- Më hahen ca fiq. Uf, ç'ditë koti! Genci s'erdhi. I është prishur makina. Do të shkonim në plazh sot.

Meri e shoqëroi prapa shtëpisë. Klara kishte veshur një fund të ngushtë e të shkurtër të cilin e ngriti deri rrëzë kofshëve për t'u ngjitur në fik. Ishte një natyrë që nuk e vriste fare mendjen për ato që mund të thoshin e mendonin të tjerët. Në shkollë vinte gjithmonë e veshur në mënyra nga më befasueset. Një mëngjes drejtoresha e kishte dërguar në shtëpi të ndërrohej sepse kishte veshur një bluzë fare të shkurtër, poshtë së cilës i dallohej barku. Veç kësaj, kishte lyer sytë dhe flokët i kishte prerë aq shkurt sa ua kalonte të gjithë djemve. Në njerin vesh kishte vënë tre vëthë të vegjël floriri, ndërsa në veshin tjetër kishte varur një yll. Xhinset i kishte të grisura te gjunjët dhe poshtë vitheve. Drejtoresha ishte tmerruar kur e kishte parë.

- Shko ndërrohu menjëherë! - e kishte urdhëruar.

- E pse?- ia kishte pritur Klara.

- Sepse nuk vihet kështu në shkollë.

- Në cilën rregullore është shkruar se nuk vihet kështu? Zonja drejtoreshë, nuk jemi më në kohën e qepës! I ke parë si vishen nxënësit në Amerikë?

Drejtoresha kishte mbetur ca çaste e hutuar.

- Vajzë, ti mund të hysh në këtë shkollë vetëm me urdhër të ministrit! - kishte thirrur pastaj. Njëra prej mësueseve e kishte marrë Klarën për krahu dhe e kishte bindur të ndërrohej...

Pasi u ngop mirë me fiq, Klara kërceu poshtë, fërkoj njëherë barkun, pastaj u ul në hije, drejt e mbi bar.

- Kjo është Shqipëria! - psherëtiu. - Vapë, pluhur, plehra, makina të prishura. Hajde jetë, hajde! Meri, ty sikur s'të kam parë të dalësh.

- Ja, kështu erdhën punët.

- Eh, mami jot ishte aq e bukur, aq e re! Në Shqipëri vdes robi kot së koti. Siç jeton kot, edhe vdes kot. Jetë bëhet në Amerikë, në Europë. Sikur të bënte Zoti ndonjë mrekulli e të lindja prapë! E di ku do të doja të lindja? Në Nju-Jork.

Meri u detyrua të qeshte. Me Klarën nuk kishte patur ndonjë afrimetet të veçantë, përveç faktit që ishin rritur në një lagje. Në shtëpinë e saj kishte qenë fare rrallë. Për herë të fundit para dy vjetësh. Ndërsa Klara vinte aty për të marrë ndonjë tufë lule, gjethe rrushi për japrak, mendërz apo mardanoz.

- Meri, po ai... Mexhik Arbana, ç'thotë? - pyeti ajo papritur duke qeshur.

Tjetra u skuq brenda çastit dhe uli kokën.

- Ç'pate, pse u skuqe? - vazhdoi të qeshte Klara. - Ej, po për t'u puthur, si e arrini njëri-tjetrin?

- Klara, të lutem! Nuk di nga këto gjëra unë!

- E lashë. Dëgjo, ai Sidi është djalë i mirë. Por kam frikë se do të të largohet shumë shpejt. Është çun që e komandon mami. Mamaja e tij është me pozitë. Ata janë familje intelekt-tuale. Kurse ju, këtu...

Meri ia nguli sytë e shtangur.

- As që dua të mendoj të tilla gjëra, - tha.

- Po i mendojnë të tjerët se!

- Unë kam shok vetëm Sidin.

Klara bëri një gjest pajtues.

- Nuk po të mërzis më. Dëgjo, kam një bluzë që s'më pëlqen ta vesh. Them se ty duhet të të shkojë. E do? Është e mirë për fillimin e shkollës.

- Nuk mundem ta blej, - ia ktheu Meri.

- Do të ta jap falas. Nuk shes lecka unë.

Tjetra nguroi të përgjigjej.

- E shoh që ke turp, - tha Klara. - Mos u bëj budallaqe. Po të llogarisësh fiqtë që unë kam ngrënë këtu, bëhen baraz me një bluzë. Do të ta sjell këto ditë. Ika tani.

Porta u mbyll dhe Meri u gjend përsëri vetëm, në pritje që të kalonte edhe një ditë e gjatë vere. Ja, edhe pak fillon shkolla, mendoi. Pastaj do të jetë ndryshe. Rëndësi ka që babi të mos pijë më dhe të gjejë një punë të përhershme.

5.

Por ditën e parë të mësimimit edhe ajo edhe Albi qëndronin turivarur, duke kërkuar poshtë e lartë sendet e shkollës dhe rrobat që do të vishnin. Të djeshmen ishin kthyer vonë në shtëpi. Njëri nga fqinjët i kishte lajmëruar nga ora 22 se babai kishte mbetur në një lokal buzë Lanës. Ata ishin detyruar të shkonin ta merrnin. Pamja e tij i kishte trembur si rrallë ndonjëherë. Mezi e kishin sjellë deri në shtëpi. Aty babai kishte pësuar një shpërthim të frikshëm dhe kishte filluar të thyente ç'ti dilte përpara. Fëmijët nuk kishin mundur ta ndalnin dot. Albi ishte strukur i tmerruar në një qoshe, ndërsa vajza i lutej me lotë në sy që të mblidhte veten. Ai ishte ndalur vetëm pasi kishte çarë dorën keqazi me një copë qelqi.

Meri qe detyruar të thërriste teta Bardhën. Ajo i kishte dalë babait përballë me një guxim të çuditshëm dhe i kishte folur me vrazhdësi: Bashkim, në emër të Zotit, mjaft. Ai e kishte vështruar i hutuar, megjithatë nuk kishte kundër-shtuar kur ajo i kishte lidhur dorën e prerë, pasi i kishte vënë plagës ca duhan. Tani fli, i kishte thënë. Zonjë, kush jeni ju, kishte pyetur babai pa kuptuar asgjë. Ku është Meri? Ku është vajza ime?

Ato të dyja e kishin çuar në krevat, pastaj kishin pastruar e rregulluar korridorin. Por Albi kishte frikë. Nuk arrinte të flinte dot dhe teta Bardha qe detyruar të qëndronte pranë tij deri vonë. Edhe Meri kishte qenë në gjumë kur ajo ishte larguar...

Sikur të mos mjaftonte ajo situatë e nderë, u kujtua edhe Nora të qante. Nuk donte të shkonte në klasë të parë se kishte frikë.

- Mos më bëj si debile! - i thirri Albi me inat. - Atje në shkollë nuk ka as ujk e as kuçedër. Nga kush ke frikë?

Meri iu lut që të mos i bërtiste dhe filloi ta merrte të motrën me të mira. Ora e kishte kaluar tetën kur ajo filloi të vishej për vete. E mori disa herë në duar bluzën që i kishte falur Klara dhe, ndonëse ajo ishte vërtet gjë e bukur, e la mënjanë. Veshi një këmishë fare të thjeshtë, një fund të sajuar nga rrobat e

nënës, ndërsa në këmbë mbathi sandalet e vjetshme. Kur po dilnin nga shtëpia, u kujtua për varësen me guacka. U kthye dhe e vuri atë duke buzëqeshur paksa me cepat e buzëve.

Sapo hyri në oborrin e shkollës, vuri re se Sidi po e priste. Meri u mundua të tregohej sa më e gëzuar. Përplasi dorën me të, pastaj me radhë me shoqet e shokët e tjerë të klasës. Vajzat ia panë pa vonesë guackat në formë ylberi dhe filluan të pyesnin tërë kureshtje se ku e kishte gjetur atë lloj varëseje.

- E kapa! - thirri njëra duke qeshur. - Sidi ka qenë në plazh, plazhi ka guacka, guackat bëhen varëse. Ku shkoi varësja? Ekuacion me një të panjohur. X baraz me Meri.

Edhe të tjerat filluan të qeshnin.

- Ai Genti më vdiq mua, - u ankua Monda. - Vetëm çokollata di të bëj dhuratë. Si nuk i shkon mendja te ndonjë gjë romantike xhanëm! Bravo Sidi, bravo!

Të qeshurat u shtuan. U detyrua të qeshte edhe Meri. Iu duk habi që nuk kishte harruar të qeshte. Por kur u takua me mësuesen kujdestare, nuk qe fort e lehtë.

- Meri, pse je kaq e lodhur? - e pyeti ajo pasi e puthi.

Vajza uli kokën.

- Gjithçka në rregull nga shtëpia?

- Po mësuese.

Tjetra ndërroi temë dhe vajza mori frymë e lehtësuar.

Por ajo zgjidhje nuk mundi të punonte për shumë kohë. Dramën që po kalonte në shtëpi Meri nuk mundi ta fshihte dot në shkollë. Treguesi i parë qenë notat. Treguesi i dytë pamja e jashtme. Shpesh ishte e lodhur, e grindur, i hapej goja për gjumë. Nuk i pëlqente të merrte pjesë nëpër lojra. Pa folur për diskot apo aktivitete të tjera.

Një ditë, në orën e Matematikës, sapo iu përmend emri, u ngrit dhe tha pa e zgjatur:

- Nuk kam mësuar.

Mësuesja u befasua nga ajo lloj përgjigjeje.

- Gjoka, nuk e prisja nga ty, - tha e zhgënjyer. - Gjithësesi, nuk po të vë 4.

Në klasë u bë heshtje. Nuk kishte ndodhur kurrë që Meri t'i përmendej katra apo që ajo të mos pranonte të ngrihej në mësim.

Shumë prej shokëve e shoqeve e vështruan në bisht të syrit, duke bërë hamendje për atë që po ndodhte. Meri e mbante kokën ulur. Aty pranë saj Sidriti vërtiste nëpër duar një stilolaps.

- Meri, si e ke hallin? - pyeti pas pak.
- Hiç, - ia bëri ajo. - Nuk kam asnjë hall.
- Pse nuk më kërkove ndihmë në Matematikë?
- Mendova se nuk do të ngrihesha.

Ai nuk e ngacmoi më.

Një ditë tjetër e njejta gjë u përsërit në lëndën e Historisë. Meri nuk pranoi të ngrihej në tabelë. Mësuesja e vështroi njëherë me inat. Ajo ishte një tip inatçor e autoritar, rreth të pesëdhjetave, beqare dhe kurrë nuk falte kur kapte njeri të papërgatitur.

- Të lumtë Gjoka! - ia bëri me ironi. - Për sot 4. Kështu ndodh kur e ke mendjen për të tjera punë. Kur kërkon të luash Zhuljetën para kohe.

- Ç'hyn Zhuljeta me katrën time mësuese?! - tha Meri e prekur.

- Hyn që ç'ke me të! Se në këtë klasë ua keni nisur dashuriçkave një çikë si herët. U bë Amerikë fare këtu. Ne në kohën tonë as nuk i çonim nëpër mend këto gjëra. Ishim nxënës model.

- E kujt po i rreh se si ishit ju në kohën tuaj! - ia bëri papritur Bledar Belshi, një nga djemtë e klasës që fliste rrallë dhe në përgjithësi ishte tip i mbyllur.

- Belshi, ç'është kjo e folur? - thirri mësuesja.

- Ju nuk keni të drejtë të bëni ironi me ne! - thirri edhe Bledari.

- Brezi juaj i famshëm na la këtë Shqipëri të varfër e me plehra. Plehra të çdo lloji! E ç'na duhen të tjerat?

Nga klasa u dëgjua një mbështetje në kor.

- Ju nuk keni të drejtë të jepni alarmin për dashuriçkat tona sepse Shqipërisë nuk i vjen e keqja prej nesh, por nga ju të rriturit që s'dini të bëni as shtet e as politikë!

- Belshi, qepe! Mos më trego përralla mua!

- Ah, tani kërkon të më qepni edhe gojën! Siç ua qepnin juve në kohën tuaj.

Nëpër klasë filluan mërmërimat. Mësuesja vështroi njëherë nëpër banka, pastaj tha me ngut:

- Me ty Belshi do të merrem vesh ndryshe. Vazhdojmë mësimin tani.

- Do të më vini 4 nga inati? - vazhdoi Bledari.

- Atë do ta shohim! Gjoka, babanë tënd dua ta takoj pak. I kam dy fjalë edhe me mësuesen kujdestare.

Meri pështeti kokën në parakrah e turbulluar. Nuk e ngriti më deri sa mbaroi mësimi. Sidi nuk guxoi t'i fliste atë ditë. Vetëm të nesërmen në mëngjes ai i doli para në oborr dhe pyeti i mërzitur:

- Meri, a mund ta di të lutem ç'po ndodh?

Në fillim ajo u mat t'i tregonte, por pastaj ndërroi mendje.

- Nuk po ndodh asgjë, - tha me kokëfortësi.

- Meri, të lutem!

- Përse më lutesh Sid?

- Ti se si po bëhesh.

- Si?

- Nuk e di. Po ndryshon.

- Ashtu të duket ty.

Por ajo këmbëngulje e saj nuk ia vlejti sepse një mbrëmje fundtetori Sidi u dha te porta e shtëpisë së saj duke mbajtur babanë për krahu. Biçikletën e kishte pështetur te këmba. Meri ngriu kur e pa.

- Mirëmbërëma! - tha ai qetësisht. - Po kthehesha nga stërvitja dhe pashë xhaxhi Bashkimin në rrugë. Ishte... ishte në gjendje... dhe vendosa ta ndihmoja.

- Sidrit, je një djalë flori, - foli babai. - Falemnderit që u kujdese për mua!

Meri i zgjati krahun dhe e shoqëroi deri brenda. Kur doli rishtazi në oborr, supet i dridheshin nga të qarët.

- Sid, më fal! - mërmëriti.

- Domethënë, babi yt vazhdon të pijë? - pyeti ai i tronditur.

- Siç e pe...

- Meri, më thuaj, si mund të të ndihmoj.

- Nuk e di. Nuk di ç'të them.

E qara e saj u bë e dëshpëruar. Ai zgjati dorën dhe e preku në sup.

- Meri, të lutem mos qaj!

Ajo u afrua dhe u struk në kraharorin e tij sikur të kërkonte mbrojtje.

- Unë të kuptoj.
- Të lutem mos mendo ndryshe për mua!
- E pse duhet të mendoj ndryshe?
- Ai i ra supeve.
- Shkundu Meri! Gjërat do të ndryshojnë.
- Ajo i buzëqeshi përmes lotëve.

*
* *

E si do të rregullohen gjërat, pyeti veten Sidi. As vetë nuk i kishte besuar ato fjalë kur i kishte thënë. I hipi biçikletës dhe mori rrugën e shtëpisë i menduar. Nuk kishte patur kurrë të bënte në jetën e tij me të atilla probleme. Kur e kishte ndeshur të atin e Merit para një lokali, gati-gati kishte provuar frikë. Ai i qe dukur njeri i mbaruar. Në fillim kishte dashur të largohej, por pas pak idea se ai njeri ishte babai i Merit, e kishte shtyrë të ndalej. I qe dukur njëlloj sikur po braktiste shoqen e tij në vështrësi.

Hyri në shtëpi i lodhur dhe shkoi drejt e në dush. E ëma la mbi tavolinë një revistë dhe i përgatiti një çaj të shoqëruar me dy copa keku. Zakonisht ajo ishte zemra e tij pas stërvi-tjes. Sidi u ul dhe piu një gllënjë çaj. Elona po e vështronte në bisht të syrit.

- Sikur u vonove sot.
- E filluam stërvitjen me vonesë, - gënjeu Sidi.
- Mos ke ndonjë problem tjetër?
- Ai ngriti sytë dhe u mundua të tregohej i habitur.
- Më dukesh shumë i menduar.
- Njerëz jemi, edhe mendohemi.
- Ashtu, ë? Sid, lëri këto filozofime dhe më trego si është puna. Ke bërë fjalë me Merin?
- Ai dha një shenjë dorëzimi.
- Jo ma, pse duhet të bëj fjalë?
- Po Meri, mos ka ndonjë problem?
- Ato, problemet e shtëpisë.
- Nëna mori përsëri revistën, por nuk e hapi.

- Sot bisedova në telefon me mësuese Lindën, - tha papritur.
- Ajo është e shqetësuar për Merin.

- E pse?

- Sepse Meri ka filluar të bjerë në mësim.

Ai bëri një lëvizje nervoze.

- Ti i telefonove mësueses për ta pyetur për Merin?

- Pse, ç'të keqe ka sikur ta pyesja për Merin? Unë duhet ta di se me kë shoqërohet im bir. Apo jo?

- Domethënë, ti s'ke besim te mua?

Ajo tundi kokën në shenjë kundërshtimi.

- Sid, të kuptohemi. Nuk është problem besimi. Është problem njohjeje jete. Pavarësisht se ke hedhur tërë këtë shtat, ti je ende i vogël në moshë. Shumë gjëra nuk i di. Dhe... dhe mund të gabosh, siç po gabojnë shumë të tjerë.

- Pra, ti nuk ke besim te Meri?

Pasoi një heshtje munduese.

- Tani për tani nuk kam arsye të dyshoj te ajo.

- Pse, më vonë mund të kesh?

- Kurrë nuk i dihet.

- Ma, të siguroj se me Merin nuk do të gaboj.

- E nga e ke tërë këtë siguri?

- Sepse ka vite që e njoh.

Elona hapi krahët duke buzëqeshur jo edhe aq e bindur.

- Uroj të ndodhë kështu si thua !Veç dije se diçka po më fsheh.

Djali nuk i ngriti sytë.

- Atë që fshihja unë ta paska thënë mësuese Linda.

- Sipas teje, pse Meri ka rënë në mësim?

- Sepse tani ka mbi supe tërë problemet e shtëpisë.

- Po ajo ka edhe një baba! Apo jo?

Ai nuk diti si të shmangej.

- Ma, Meri është nga ato që di të marrë përsëri dhjeta, - tha duke u ngritur nga tavolina. Trokiti në derën e studios të të atit. Ai po punonte në kompjuter, rrethuar nga të dy krahët me libra dhe letra pa fund.

- Tungjat ba! - e përshëndeti i biri, në një mënyrë që ata të dy e përdornin shpesh në afrimitet.

- O, tungjat miku im! - ia ktheu tjetri.
- A të duhet edhe shumë kompjuteri?
- Sonte as mos e ço nëpër mend ta prekësh. Kam shumë punë. Po përgatitem për një seminar.
- Po me Anglishten time, s'do të merremi? Sikur e lamë për sot.
- Sid, mëshirë! Jam i mbytur. Ti e sheh.
- Po ti gjithmonë i mbytur je!
- Sa të heq qafe edhe këtë seminar dhe pastaj...
- Pastaj do të dalë ndonjë konferencë apo shërbim jashtë shtetit.

- Sid, kështu është jeta miku im. Të kërkoj falje.

I biri i ra njëherë supit, pastaj doli nga studioja. Hyri në dhomën e tij dhe hapi çantën. Por nuk mundi të përqëndrohej në mësim. I dukej sikur e kishte ende pështetur në kraharorin e tij Merin që dridhej nga të qarët. Jeta qenka e vështirë për disa, mendoi. Bile e egër. Po sikur të më kishte rastisur mua ky fat?

Hapi librin e Gjuhës Shqipe dhe u përqëndrua në mësimin "Mbiemri si karakterizues i emrit".

*

* *

Roli kryesor për karakterizimin e një emri i takon në radhë të parë mbiemrit, mermëriti Meri duke psherëtirë e lodhur mbi librin e Gjuhës. Në cepin tjetër të dhomës Albi kishte vënë mbi gjunjë librin e Gjeografisë, ndërsa sytë ia kishte qepur tavanit. Ishte tërësisht i hutuar. Nja dy herë e motra vuri re se po fliste me vete.

- Albi, a ke ndër mend të mësosh? - i foli me ton qortues.
- Ai i dha librit një të shtyrë dhe e hodhi për tokë.
- Nuk dua të mësoj! As e kam ndër mend të mësoj më!
- E pse?! - ia bëri Meri e tronditur.
- Nuk ka ç'më duhet shkolla. Do t'ia mbath për te daja në Itali.
- Albi, ç'i ke këto?!

Ai filloi të qante papritur.

- Meri, nuk duroj dot më. Ne jemi familje e shkatërruar. Më vjen turp nga shokët. Të gjithë e kanë marrë vesh për babin. Edhe Erlinda. Rrezik tani do të largohet nga banka ime.

Meri bëri një stërmundim për ta mbajtur veten.

- Po Erlinda, si e kishte marrë vesh?

- Mami i saj kishte biseduar me një grua këtu në lagjen tonë. Ti kujton se gjërat e këqija nuk merren vesh?

- Albi, dëgjo, në shtëpinë tonë nuk po ndodh asgjë e keqe. Ka plot njerëz që pijnë.

- As më duhen fare të tjerët! Unë kam hallin tim. Jam robi më shtesë aty në klasë. Nuk kam asgjë të bukur për të veshur. Vetëm rroba GABI. Të tjerët kanë biçikletë, kompjuter, video-lojra, kasetofon, kompakt disk. Ne edhe një magnetofon që kishim është bërë si lavaman i bllokuar, i mbledh shiritët e kasetave tufa-tufa. Pse, jetë është kjo?

E motra nuk diti ç'të thoshte. I hyri një frikë alarmuese.

- Nuk jemi vetëm ne kështu, - i foli. - Ka plot familje me vështirësi. Ka edhe nga ata që nuk kanë bukë të hanë. E di ti këtë apo jo?

-Të thashë që s'më interesojnë të tjerët!-thirri ai duke fshirë lotët me kurrizin e dorës.

Ajo u detyrua të ndërronte temë.

- Po Erlinda... ka filluar të të largohet?

- Jo. Ajo është shumë e mirë. Edhe bukën që merr me vete e ndan me mua. Edhe çdo gjë që blen. Po unë, me se ta qeras, me fara kungulli? Apo luledielli?

- Edhe unë ndihem keq kur më qeras Sidi.

- Lëre, lëre! Sonte u turpëruam fare me të. Po ai, ka filluar të të largohet ty?

- Deri tani jo.

- Meri, të të bëj një pyetje?

- Bëje.

- Çfarë e ke Sidin ti?

- Ti e di shumë mirë. Shok të ngushtë.

- Vetëm kaq?

- Vetëm kaq.

- Po pas shokut të ngushtë, kush vjen?
- S'të duhen ty këto gjëra. As mua.
- E po sikur Sidi të afrohet me ndonjë vajzë tjetër, ti çfarë do ta kesh?

Meri tundi kokën e lodhur.

- Vetëm shok, si të tjerët në klasë.
- Sikur Erlinda të më largohet nga banka, unë do ta lë shkollën fare.

- E pse?

- Sepse jam njeri koti. Jam djali i një pijaneci.

- Albi, mos mendo të tilla gjëra.

Ai psherëtiu duke e nxjerrë frymën me ndërprerje.

- Të siguroj unë se po vazhdoi kështu...

- Nuk do të vazhdojë kështu, jo...

- Posi! Ti kërkon të më gënjesh. Nuk jam kalama unë.

- Mirë, tani të lutem, merr librin.

- Ta marr që ta mbaj hapur kot? Meri, të thashë, nuk mësoj dot.

-- Po sikur të ndihmoje Norën në Abetare?

- E si ta ndihmoj Norën kur s'mësoj dot për vete?!

Motra e vogël që ulur në karrike, mbi dy shilte të trasha, në menyrë që krahët t'i pushonin mbi tavolinë. Kokën e kishte anuar nga krahu që shkruante. Trupin gjithashtu. Meri u detyrua të ndërpriste leximin e Gjuhës dhe të ulej pranë saj. Albi u ngrit dhe doli nga dhoma.

U kthye pas ndonjë çerek ore dhe ndezi televizorin.

- Ç'po bën babi? - e pyeti e motra.

- Nuk e pashë, - ia ktheu ai ftoht.

- Shko, shikoje njëherë.

- S'dua! S'më intereson më kjo shtëpi e shkatërruar.

- Albi, të mos t'i dëgjoj më këto fjalë! Ai është babi ynë.

Tjetri filloi përsëri të qante.

- Po pse pi kështu xhanëm, pse?

- Nuk e kupton pse? - iu kthye edhe ajo duke shpërthyer në një të qarë të mbytur.

- Më duket sikur ai nuk na do më si më parë kur mami ishte gjallë.

- Gabohesh! Ai na do njëlloj. Bile më shumë. Ma ka thënë edhe gjyshja këtë.

Ata ia ngulën sytë njëri-tjetrit përmes lotëve.

6.

Jashtë, mbi oborrin e shtruar me çimento, binte një shi inatçor që merrte me vete gjethet e fundit të rrëzuara nga era e nëntorit. Meri i ngriti sytë nga qielli e lëkundur. U fut brenda për të tretën herë dhe vështroi orën. Kishte kaluar pesa. Jashtë ishte errur plotësisht. Atë mbrëmje Sidi festonte ditëlindjen. Shokët e shoqet e klasës e kishin lënë të takoheshin në afërssi të shkollës që në orën katër. Zilja e telefonit kishte rënë tri herë. Meri ku je, e pyesnin shoqet nga shtëpia e Sidit. Ja, erdha, u qe përgjigjur ajo. Do të vonohem pak se kam motrën e vogël sëmurë.

Me sa dukej Norën e kishte mbërthyer gripi. Temperatura i qe ngritur dhe vetëm grindej. Meri i dha një gjysmë aspirine dhe çaj. U detyrua të dilte përsëri në verandë. Si për inat të saj, atë mbrëmje nuk po kthehej në shtëpi as Albi. Kishte ikur që pasdreke, pa thënë se ku.

Ajo vendosi të bëhej gati. Nuk u mendua gjatë se ç'do të vishte. E dinte fare mirë se e prisnin të njëjtat rroba me të cilat kishte qenë në shkollë. Mblodhi me kujdes në një letër një palë çorape basketbolli, të cilat i kishte blerë duke kursyer njëren monedhë pas tjetrës në një kuti kartoni. Brenda njëres prej çorapeve futi një pusullë ku kishte shkruar: "Çorape magjike për t'u bërë numër 1".

Më në fund Albi ia mbërriti.

- Po ti, ku ishe deri tani? - e pyeti e motra me rreptësi.

Ai mori një pamje të pakënaqur duke dashur të tregonte se nuk kishte ndër mend të jepte llogari.

- Te një shok, - tha shkurt.

- Kaq vonë?

- Po ti, ku po shkon kaq vonë?

- Dëgjo, nuk do të vonohem shumë. Sidi ka ditëlindjen dhe...

po më presin. Ki kujdes Norën se është sëmure dhe babi... nuk është kthyer akoma.

- Unë nuk rri vetëm këtu.

- E pse?

- Po sikur ai të jetë i dehur? Unë kam frikë.

- Albi, të lutem!

Meri filloi të vinte vërdallë e hutuar.

- E mirë, shko, - ia bëri Albi pas pak. - Vetëm kthehu shpejt.

Ajo mori një çadër dhe vrapoi përmes shiut. Mbërriti në festë e lagur dhe me këpucë e pantallona të përbaltura. Brenda po kërcenin. Sapo e panë, të gjithë u ndalën dhe filluan të thërrisnin në kor:

- Meriyll! Meriyll!

Sidi buzëqeshi duke u skuqur. Meri iu afrua, i shtrëngoi dorën duke e uruar, pastaj la aty pranë dhuratën. Vuri re se shoku ishte pak nervoz.

- Kujtova se nuk do të vije, - tha i lehtësuar.

- Sid, erdha për pak. Vetëm për hatrin tënd.

- Dukesh shumë e lodhur. Vërtet Nora...

- Po, e lashë me temperaturë. Edhe babi nuk ishte kthyer akoma. Sid, edhe një gjë, të lutem, nuk mundem të kërcej.

- Të kuptova. Rëndësi ka që erdhe.

Meri u ul dhe atëhere dalloj mësuesen kujdestare që po bisedonte me nënën e Sidit ulur në një kolltuk. Ajo i përshëndeti me kokë. Ato i buzëqeshën. Aty pranë tyre që ulur një vajzë simpatike, me flokë të mbledhur topuz mbi kokë. Kishte veshur një fustan aq të bukur sa mund t'i tërhiqte vëmendjen kujtdo. Vetëm pas pak Meri u kujtua për të. Ishte një fqinjë e Sidit. Ai e kishte njohur një ditë me të. Vajza ishte pianiste dhe quhej Ana.

Një nga djemtë e klasës e ftoi të kërcenin dhe Ana u ngrit me lëvizje nazike. Pas pak e zonja e shtëpisë iu afrua Merit me një tabaka të mbushur me të ëmbla. Ajo mori një amaretë.

- Njëqind vjet për Sidin! - tha.

Vuri re se Elona Arbana po e vështronte me vëmendje.

- Meri, si ke qenë? - pyeti. - Ç'thotë shkolla?

- Çka teta Elona, mirë.

- Po nga shtëpia? Babi?

Meri e tradhëtoi veten në çast. E mbuloi të kuqtë.

- Në përgjithësi... mirë, - mërmëriti.

Tjetra buzëqeshi dhe u kthye përsëri te mësuesja. Djemtë dhe vajzat vazhdonin të kërcenin duke thirrur e duke qeshur. Sidi u ul pranë Merit. Ajo i harroi ato që kishte lënë prapa. Festa e mori me vete. Kishte kohë pa kërcyer e pa bërë qyfyre si të tjerët. E kuptoi se përtej mureve të shtëpisë jeta ishte krejt ndryshe. Të tjerët kishin fat ta gëzonin atë. Te askush nuk vërehej ndonjë gjurmë shqetësimi. Pse duhet ta pësoja unë, pyeti veten ajo.

Ndërkohë që festa kishte arritur kulmin, papritur muzika pushoi. Të gjithë ngritën kokat dhe u kthyen nga Donjet Brajha, një nga tipat më të lëvizur e më qyfyrexhi të klasës, që tundte në dorë spinën e impiantit të CD-së.

- Ç'ndodh këtu?- ia bëri ai duke imituar një zë shumë të njohur. - U bë Amerikë fare! Ne në kohën tonë ishim model. Nuk kërcenim kështu. Bile s'dinim të kërcenim fare.

Të gjithë filluan të qeshnin. Kur u ulën për të bërë pak pushim, Donjeti vendosi përsëri qetësi dhe pyeti serioz:

- A e dini se ç'bën një lepur i zi, pa mustaqe, kur mbush 14 vjeç, si puna e Sidit?

Në fillim plasi të qeshurit, por pastaj shumëkush e mori seriozisht atë pyetje dhe filloi të vriste mendjen se ç'mund të bënte një lepur i atillë. Përgjigjet qenë nga më të çudit-shmet; ndërron ngjyrë, vë syze optike, bëhet katragjysh, shkon refugjat në Itali, merret me kontrabandë, i dalin mustaqet. Por Donjeti tundte kokën duke bërë i kënaqur:

- Jo, jo dhe jo.

- Na e thuaj dreqin ç'bën ai lepur se na vdiqe! - thirri njëra prej gocave.

Donjeti i vështroi njëherë të gjithë duke nënqeshur, pastaj tha:

- Ç'injorantë që më rrethojnë! Nuk ka asnjë lepur në botë, qoftë i zi, i kuq apo i bardhë, që të jetojë 14 vjet.

Të qeshurat plasën përsëri.

Meri i ngriti sytë nga një orë e madhe muri. Duhet të iki,

mendoi. Por pas pak ata që ishin më hamës filluan të thërrisnin: duam tortën, duam tortën. Filloi ceremonia e nxjerrjes së tortës në skenë, me qirinjtë e ndezur dhe e shoqëruar me kengën "Shumë urime për ty". Po rri edhe ca, tha Meri me vete.

Të gjithë u mblodhën rreth tortës. Ajo ishte e madhe, me tre kate dhe i ngjante një kështjelle. Sidi u mbush me frymë dhe i fiku qirinjtë brenda sekondit. Ndërkohë Donjeti erdhi që nga kuzhina me një thikë të frikshme mishi dhe ia këputi tortës mespërmes. Preu disa copa të majme për grupin e llupësve, pastaj ia dorëzoi thikën të zonjës së shtëpisë.

Meri hëngri në këmbë një copë të vogël torte, pastaj kërkoi leje të largohej. Mësuesja kujdestare i kërkoi ta shoqëronte deri në shtëpi.

- Falemnderit mësuese, nuk jam shumë larg, - ia ktheu ajo.

- Meri, në ke ndonjë hall, unë mund të vij të të ndihmoj, - këmbënguli tjetra. - Me këtë rast po takoj edhe babanë tënd.

- Më mirë... sikur... të vinit ndonjëherë tjetër...

- Dakort. Të fala babait!

Meri përshëndeti dhe doli bashkë me Sidin, i cili e shoqëroi deri poshtë, te hyrja e pallatit.

- Këtu ke një çokollatë dhe disa gjëra të ëmbla, - tha ai duke i zgatur një pako të vogël të mbledhur me letër të bardhë. - Ke edhe për Albin e Norën.

Ajo falenderoi dhe u mat të largohej. Jashtë vazhdonte të binte shi. Ata vështruan pikat e shiut që përplaseshin në asfalt. Meri bëri një hap e pasigurtë.

- Do ikësh kështu? - mermëriti ai. - Tamam sonte që unë jam 14 vjeç?

Ajo mbuloi fytyrën me duar dhe u afrua pranë tij.

- Hiqi syzet, - foli me zë të dridhur. - Mbylli sytë.

Ai ngriti dorën e djathtë, hoqi syzet, pastaj uli qepallat. Meri u detyrua të ngrihej në majë të gishtave, u mbajt me duar në supet e tij dhe e puthi fluturimthi, pa parë se ku. Pastaj vërpoi nëpër shi. I dukej vetja e lehtë, e papeshtë. Buzët i përvëlönin. Vetëm kur mbërriti te porta, u përmond.

Për habinë e saj gjeti brenda të atin duke ndjekur lajmet në TV. Mbi tavolinë ishin disa qese me fruta e ushqime. Albi dhe

Nora pa hanin nga një portokall. Ajo iu afrua të atit dhe i vuri dorën në sup.

- Hë, si ia kalove andej nga ditëlindja? - pyeti ai.

- Mirë ba.

- Thuaji Sidit u bëftë 100 vjeç.

- Do t'i them. Po ti, si ia kalove?

- Sot më eci. Gjeta një punë të mirë.

Ajo e përqafoi e gëzuar.

- Po Nora, si ka qenë?

- Gripi do të bëjë të vetën.

Meri iu afrua Albit dhe i la në duar pakon me ëmbëlsira.

- Ndaji me motrën.

Ajo fluturonte nëpër shtëpi. E bëri gati darkën për dhjetë minuta. Por në tavolinë u ul vetëm babai.

- Po ju të tjerët? - pyeti ai.

- Unë s'kam uri, - tha Meri. - Po ha vetëm një mollë.

Albi dhe Nora u përgjigjën se ishin ngopur me ëmbëlsira. Albi vërtiste nëpër duar letrën me të cilën kishte qenë e mbledhur pakoja dhe qeshte. Meri e vështroi me dyshim. Ai i bëri shenjë të afrohej.

- Mbështjellësja ishte për ty, - tha duke i lënë letrën në dorë.

Ajo njohu shkrimin e Sidit. Doli në korridor dhe lexoi në faqen e brendshme të letrës:

«Je më e bukura në botë, edhe më e bukur se Dielli».

Ishin fjalët e refrenit të një kënge tepër të njohur. Mbuloi fytyrën me atë letër për ca çaste, pastaj e palosi dhe e futi në xhep duke mermëritur: ç'është kjo mbrëmje e çuditshme kështu. Albi doli në korridor pas pak.

- E Meri, ç'kemi? - ia bëri duke u kollitur.

Ajo nuk guxoi ta vështronte.

- Dëgjo, do të m'i japësh t'i kopjoj ato vargjet?

- E ç'të duhen?

- Dua t'ia shkruaj Erlindës në ndonjë faqe libri. Atë Diellin s'po ta kopjoj. Hëna më duket bajate. A t'i shkruaj je edhe më e bukur se Marsi? Apo Jupiteri?

E motra u detyrua të qeshte.

- Albi, Marsi dhe Jupiteri nuk duken fare nga Toka.

- E ça pastaj? Megjithëse... prit... gjeta një tjetër origjinale: je më e bukur se gjithë yjet e qiellit marrë së bashku! E fortë, ë?

- Kryevepër! - ia priti Meri. - S'më kishte shkuar kurrë në mend.

Albi qeshi i kënaqur.

- Kjo tregon se unë nuk kam tru sido-kudo.

- Sigurisht. Tani eja bëjmë ndonjë mësim.

Ajo hapi Historinë 8, e lexoi mësimin " Qëndresa e popullit shqiptar ndaj pushtimit osman" tri herë, megjithatë në kokë i hyri vetëm fakti se Sulltani, para se të kalonte në Itali, u nis kundër Himarës kryengritëse. Atëhere iu kthye Mate-matikës dhe filloi të merrej me Pohimin e Anasjelltë. Por mendja i shpiku vetëm një variant pohimesh: në qoftë se Meri është më e bukura në botë, këtë e ka thënë Sidi dhe anasjelltas: në qoftë se jam më e bukura në botë, këtë e ka thënë Sidi. Pastaj u kujtua se për të nesërmen mësuesja kishte shpjeguar mësimin pasardhës. U detyrua të fillonte nga e para. Ndërkohë Norës iu ngrit rishtazi temperatura. Meri la librat dhe iu afrua.

- Jo, mos u shqetëso, - i foli i ati. - Do të kujdesem unë. Do të fle pranë saj për çdo rast.

- Ba, po... e di se ç'duhet të bësh në se temperatura kalon 38 gradët?

I ati buzëqeshi.

- Po ti, a e di se kush kujdesej për ty kur ishe e vogël dhe sëmureshe?

- Mami.

- Unë isha më frikacak se mami. Rrija zgjuar tërë natën. Mbaja vesh se si t'i merrje frymë me vështirësi për shkak të temperaturës. Më dukej sikur nga çasti në çast do të ndodhte diçka. Kishte raste që së bashku me mamin gdiheshim ulur pranë krevatit tënd.

Vajza u mallëngjye.

- Kurrë nuk do ta kuptoj pse duhej të vdiste mami. Ishte aq e mirë.

- Ishte! - psherëtiu babai. - Do të doja shumë që t'i ngjaje asaj.

- Do të mundohem t'i ngjaj o ba.

- Të falemnderit! Shko e qetë tani.

Ajo nuk donte ta besonte atë natë. Gjithçka ishte ndryshe. Kishin ndodhur tërë ato gjëra të bukura. Ndjehej e lumtur. Nuk i flihej. Nuk donte të flinte. I dukej sikur ajo natë ishte e magjishme dhe do të mbaronte për të mos u përsëritur më.

*
* *

Dhe ajo lloj frike nuk e gaboi. Babai mbeti përsëri pa punë. Për disa ditë e mbërtheu gripi. Një mbrëmje Meri gërrmoi në njërin prej sirtarëve të bufesë ku mbanin lekët e shtëpisë, por siç pritej, gjeti aty vetëm disa monedha. Po me këto ç'të bëj, pyeti veten. Gjendja e ushqimeve ishte pothuaj zero.

Sikur të mos mjaftonte ajo mërzi, para se të binin për të fjetur, Albi iu lut për disa lekë.

- Më duhen për nesër, - tha me sytë përdhe. - Ti e di, babit nuk i kërkoj dot.

- Të duhen patjetër? - pyeti e motra.

- Po, më duhen.

- Albi, me vjen keq. Nuk kemi.

- E dija këtë përgjigje! - u nxeh ai. - Nuk kemi, nuk kemi!

Ajo u mundua ta qetësonte, por atë nuk e bindnin më fjalët.

Të nesërmen Meri u detyrua të shkante nga dyqani i teta Bardhës për byrekë.

- Eja pak brenda, - i foli ajo. - Dua të të them diçka.

Vajza hyri në kuzhinën ku gatuheshin dhe piqeshin byrekët.

- Si të duket kjo punë? - e pyeti papritur teta Bardha pa e vështruar.

- Punë e nderuar.

- Atëhere, në se s'të mbetet hatri, a pranon të punosh këtu me mua dy ose tri orë në ditë? Do të të jap një rrogë të vogël e cila do t'ju ndihmonte.

Meri mblodhi supet.

- Po unë... nuk di.

- Është gjë fare e thjeshtë. Do ta shohësh.

- Mirë teta Bardha. Të falemnderit!

- Ky nuk është nder. Më thuaj, a ngrihesh dot në orën 6? Në mëngjes kam shumë nevojë për ndihmë. Pastaj mund të vish edhe pas shkolle. Kurdo që të gjesh kohë.

- Më prit nesër, - ia ktheu Meri e gjallëruar.

Në mbrëmje ajo kërkoi për një orë të vjetër me zile që kishte kohë pa u përdorur. E gjeti në një sirtar dhe e kurdisi. Ora punoi, zilja po ashtu. Meri e vuri zilen në orën 6 pa 10 dhe e la orën pranë krevatit.

- Ç'e ke këtë rrangallinë të kohës së dinozaurëve? - ia bëri Albi me bezdi.

- Më duhet për t'u ngritur herët, - ia ktheu ajo.

- E pse?

- Për të përsëritur mësimet.

- Atëhere unë po zë veshët me pambuk.

- Mos ki merak se ty nuk të zgjoj.

Ajo kishte vendosur të mos i tregonte as të atit e as të vëllait për punën. Kur të nesërmen zilja ra me tërsëllëmë, kërcëu për-pjetë e trembur dhe i vuri asaj dorën sipër. Tringëllima pushoi. Ajo fërkoj sytë. Qepallat i ndjente ende të rënduara. Megjithatë, u ngrit pa e zgjatur. U vesh, u la dhe doli nga shtëpia pa bërë zhurmë.

Teta Bardha e priti me buzëqeshje. I dha një përparëse të gjatë dhe i tregoi ca toptha brumi mbi tavolinën e madhe të punës.

- Ja, këta duhen hapur me petës, - tha. - Të tjerat i vazhdoj unë.

Vajza mori me majat e gishtave ca niseshte, e hodhi mbi tavolinë, pastaj vuri para brumin dhe mori një petës të shkurtër. I ra brumit sipër me të duke e zgjeruar nga të gjitha anët.

- Më shpejt se nuk e vret, - i foli teta Bardha.

Meri u mëshoi krahëve më fort. Dalëngadalë peta u hap e u hollua. Teta Bardha e mbërtheu atë me katër gishta, e leu me gjalp, pastaj e mbushi me gjizë dhe e palosi në formë trekëndëshi brenda pak sekondave.

- Tjetrën! - tha.

Meri u përqëndrua e tëra në atë punë dhe nuk e ngriti më kokën deri sa ora shkoi 7.

- Mjaft me kaq, - ia bëri teta Bardha. - Tani shko se të presin në shtëpi. Merr nja dy byrekë për vete. Është rregull kuzhine.

Vajza i buzëqeshi me mirënjohje.

- Atëhere, të të pres pasdite? - pyeti tjetra. - Nuk besoj se u trembe.

- Më prit.

Meri hyri në shtëpi dhe zgjoi me të tundura Albin dhe Norën. Ndërkohë dëgjoi prapa nga kopshti kollën e të atit. Mesiguri kishte ndezur cigaren e parë.

- Ba, kam diçka për ty, - i foli ajo.

Vuri një byrek në një pjatë dhe ia çoi.

- Ku i blen këta byrekë të shijshëm? - pyeti ai.

- Te teta Bardha.

- Ah, po, Bardha, - ia bëri babai me një hutim të lehtë. - E dënoi Zoti edhe atë njëlloj si mua. Është zonjë grua. Por fati...

7.

Albi hyri në oborrin e shkollës në mëdyshje. Atë ditë, orën e parë, kishte Matematikë dhe ishte e sigurtë që mësuesja do ta pyeste. Nuk po dinte si t'ia bënte. Iu afrua njëherë derës kryesore, pastaj ndërroi drejtim dhe shkoi nga fusha e basketbollit. Për habi, pa aty Françesk Dodën, një nga djemtë e klasës që shumë rrallë vinte në mësim orën e parë. I mbledhur nën një xhakavento xhinsi, me një kapele stofi që i mbulonte kokën tullace, ai po përtypte fara kungulli. Në krahun e djathtë mbante një pako të mbledhur me një gazetë. Në shkollë nuk vinte kurrë me çantë.

Sytë i kishte gjithmonë të skuqur e si të përgjumur. Kur hiqte kapelen, në kokën tullace i dalloheshin disa vraga, që tregonin se ajo kokë ishte çarë me gurë apo nga rrëzimi, të paktën gjashtë herë. Nën kapele, fytyra e Françeskos merrte pamjen dyshuese të një njeriu që nuk beson te askush.

- E Keko, ke qënë rojë dje? - i foli Albi.

Tjetri qeshi duke flakur me buzë lëkurat e një fare kungulli.

- A ke ndonjë mendje për t'ia mbathur?

- E ku të shkojmë?

- Kam një plaçkë për të shitur. Po e hoqa qafe, do marrësh edhe ti pjesën tënde. Hë, si thua?

Albi u lëkund. Deri atë ditë rrallë ishte larguar nga mësimi.

- Hajde mo dhe ti se shkollë ka për ditë! - ia bëri Keko.

Albi vështroi njëherë nga dera kryesore, pastaj i bëri tjetrit shenjë. Dolën prapa godinës së shkollës, kapërcyen murin rrethues dhe ranë në një rrugicë.

- Shkojmë nga Pazari i Ri, - tha Keko.

Albi hodhi çantën supit duke u munduar të gjente se ç'ishte ajo plaçkë që shoku kishte për të shitur. Ai e njihte Françesk Dodën fare pak. Tjetri ishte përsëritës. Vitin e kaluar e kishte humbur sepse kishte qenë disa muaj në Greqi. Askush nuk e dinte se me çfarë ishte marrë andej. Keko ishte djali më i madh i një familjeje me shumë fëmijë. Të atin e kishte të paralizuar. Fatkeqësia kishte ndodhur pas një aksidenti dhe ai kishte mbetur lidhur në një karrocë me rrota.

Në fillim, kur Keko kishte ardhur në klasën e Albit, ata të dy gati ishin zënë me grushte. I kishte ndarë mësuesi i Fizkulturës. Shkaku i sherrit kishte qenë një lojë me letra që Keko e sajonte mbi një arkë bananesh dhe që quhej "Gjej letrën me shenjë". Ai qe bërë tmerri i shkollës me atë lojë. Ua fitonte të hollat shumë djemve që kërkonin të luanin. Gjithçka ishte një mashtrim. Fillimisht Keko e tregonte letrën me shenjë, pastaj, kur vinte radha për ta vendosur mbi kutinë e bananeve, e fuste atë tinëzisht në mëngë dhe në vend të saj lëshonte një letër tjetër. Ndërkohë, Redi Gunga dhe Sajmir Molla, dy shokë të tij, të cilët gjithashtu ishin qethur tullacë, luanin rolet e të zgjuarve, duke fituar kur i lejonte Keko. Ajo dredhi bëhej thjesht për të joshur djemtë e tjerë që të futeshin në lojë.

Një ditë Albi e zbuloi mashtrimin pasi kishte humbur lekë disa herë radhazi.

- Mashtrues! - iu drejtua Kekos duke ia ngjeshur kutisë së bananave me shkelm. I nxehur nga ai zbulim i papritur i hilesë, Keko i ishte hedhur në fyt. Por, më vonë, kur kishte parë se Albi nuk ishte trembur, i qe afruar duke thënë:

- Dëgjo, ti qenke grup sherri. Le të bëhemi shokë. Lekët që

ke humbur do të t'i jap. Bile e ke hallall edhe një të qerasur.

Albi, i mbetur shkundur nga xhepat, i kishte pranuar lekët, ndërsa qerasjen jo. Që nga ajo ditë Keko kishte hequr dorë nga loja e tij...

Vetëm kur ata të dy mbërritën te Pazari i Ri, Keko e ndërpreu ngrënien e farave të kungullit. Hapi pakon e mbledhur me gazetë dhe Albi pa një radio me bateri. Ishte e firmës "Sony", një prodhim i kohëve të fundit.

- Ja, këtë duhet të shesim, - tha Keko.

- E ku e gjete? - pyeti Albi.

- E kam sjellë nga Greqia që në verë.

Albi e vështroi njëherë radion me dyshim, megjithatë nuk pyeti më gjatë. Ata iu afruan një burri që shiste fruta në një tezgë.

- Zotëri, kemi një radio të mirë, - tha Keko. - Sa e blen?

Tjetri vështroi njëherë pa pikë interesi.

- Nuk më hyn në punë, - ia bëri pastaj.

- Zotëri, po është radio japoneze! - këmbënguli Keko.

- Akoma nuk është kanadeze!

Keko shau njëherë nëpër dhëmbë, pastaj kaloi te një djalë i ri, i cili po lagte me ujë një piring me sallatë. Ai e ndërpreu punën, e mori radion në duar dhe e ndezi. Pas pak afroi një çmim qesharak dhe Keko ia tërhoqi mallin me inat.

- Ej, mos bëj si trim se të vjedhur e ke, - tha shitësi i sallatës.

- Ajo është punë për mua, - ia ktheu Keko.

Kur e pa se nuk po i ecte, ai ia la radion në duar Albit.

- Provoje njëherë ti se do ta thyej fare! - tha me inat.

Albi iu afrua i pasigurtë një shitësi ullinjsh, pastaj disa të tjerëve me radhë. Më kot. Por kur po matej t'ia kthente radion shokut, një shitëse frutash i foli. Ai iu afrua.

- Ku e keni zgrepur këtë radio të bukur? - pyeti shitësja duke qeshur me cepat e buzëve.

- Më vjen keq zonjë, - ia ktheu Albi. - Është plaçkë e shtëpisë. E shes sepse nuk na dalin lekët për bukë.

Gruaja pyeti për çmimin. Kur dëgjoji 10 000 lekë të vjetra, mblodhi njëherë buzët.

- Për 8 000 e marr, - tha pastaj.

Albi vështroi nga Keko. Jepja, ia bëri ai me padurim. Kur mori paratë në dorë, Albi u skuq. Falenderoi gruan, pastaj u largua.

- Të lumtë! - ia bëri Keko duke i rënë shpatullave. - Mbajti 2.000 lekë. Të takojnë.

Albi u mundua të kundërshtonte, por tjetri këmbënguli.

- Dëgjo, ne jemi njëlloj, - tha. - Ti pa nënë, unë gati pa baba. Kemi po ato halle. Sa herë të kesh nevojë, hap gojën se Keko nuk të lë pa gjë.

Albi u prek nga ato fjalë të shokut. E futi kartmonedhën dymijëlekëshe në xhep duke e lëmuar me butësi sikur të ishte një thesar. Keko iu duk njeriu më i afërt.

Kur u kthyen në shkollë gjetën në oborr Redi Gungën dhe Sajmir Mollën. Ndonëse ishin në klasë tjetër, ata të dy rrinin tërë kohën me Kekon. Për shkak të kokave të tyre të qethura tullë dhe mbarëvajtjes së dobët në mësim, një mësuese i kishte quajtur grupi Zero në Kub dhe me atë nofkë kishin filluar të talleshin të gjithë nxënësit. Por zerove as që u bëhej vonë. Përkundrazi, qeshnin duke thënë se tullacë qetheshin repistët në Amerikë, gjë që provonte se ajo lloj e qethure ishte në modë.

- Hë mor ti, nga u zhduke? - iu drejtua Redi Kekos.

- Ja, mbaruam një punë me Albin.

- Më duket se paskeni dalë mirë, - ia bëri Sajmiri duke fërkuar duart. - Do të përlajmë ndonjë hamburger apo jo?

- Ua ka qejfi, ë? - nënqeshi Keko. - Mirë, s'po jua prish. Albi, hajde edhe ti. Paguaj unë.

Albi u mundua të kundërshtonte, por Keko e tërhoqi për krahu. Shkuan të katër te një tregtizë aty pranë shkollës ku shiteshin hamburger dhe sanduiçë. Djemtë e grupit Zero në Kub ishin të tmerrrshëm për hamburger. S'kishte ditë që të mos kalonin nëpër oborrin e shkollës duke u përtypur, me buzët përlyer me salcë apo mustardë. Askush nuk mund t'i përgjigjej pyetjes se ku i gjenin të hollat që i prishnin ashtu pa kursim, ndërkohë që dihej se të tre vinin nga familje me probleme.

Redin e kishin braktisur prindërit që të vogël. Ishin ndarë dhe pastaj ishin larguar jashtë shtetit, secili në punë të tij. Redi kishte përfunduar ca kohë në jetimore nga ku ishte arratisur dy herë. Tani jetonte te gjyshja nga i ati, e cila me pensionin që

merrte mezi mbahej për vete. Redi ishte i imët në trup e fytyrë dhe mbërdhinte shumë. Thoshin se mbajtja e kokës tullë ishte për të një torturë e vërtetë, por ai e bënte atë sakrificë për hir të Kekos që ia kishte kërkuar atë gjë.

Ndërsa Sajmiri jetonte që prej disa vitesh në shtëpinë e njerikut. Nëna e tij qe ndarë nga i shoqi kur djali kishte qenë fare i vogël dhe më vonë qe martuar me një burrë tjetër. Në fillim Sajmiri nuk kishte kuptuar gjë nga ajo martesë. Vetëm kur qe rritur e kishte mësuar të vërtetën në lidhje me njerikun. Nuk shkante mirë me të. Ai ishte një tip i shkathët, sidomos për të luajtur futboll. Kishte një kokë të fortë me cepa dhe në mjekër i dallohej gjurma e një të çare të thellë. Tregonin se atë plagë ai e kishte marrë gjatë një kacafytjeje me Kekon, pas së cilës ata ishin bërë shokë të ngushtë...

Ata i morën hamburgerët në duar dhe u kthyen përsëri në shkollë. Albi hante me kafshata të mëdha. Byreku i mëngjesit qe tretur me kohë dhe ai e ndjente stomakun krejt bosh. Veç asaj, hamburgeri kishte një aromë ngacmuese, së cilës nuk mund t'i rezistojë. Ai ishte nga ata fëmijë që rrallë i takonte të hante hamburger dhe ajo gjë i dukej padrejtësia më e madhe në botë. Ç'kuptim ka, pse të mos ha dot nga një hamburger në ditë, pyeste veten.

Ndërkohë në oborr po bënte fizkulturë një klasë e shtatë. Vajzat po vraponin rreth fushës së basketbollit. Njëra prej tyre, një tip i shëndoshë me flokë të shkurtëra, binte në sy për mënyrën e veçantë se si i hidhte këmbët. Djemtë po e ndiqnin me vështrime.

- O Linka, o komshije! - i thirri Keko. - Eh, si je, si akullore me tas.

Vajza me emrin Linka u shtir sikur nuk dëgjoji.

-O hamburger me dy kate! - vazhdoi Keko.

Disa prej vajzave filluan të qeshnin, por Linka nuk e kthente kokën. Atëhere Keko lëshoi një fishkëllimë të zgjatur si ato lokomotivat e vjetra me avull dhe thirri:

- O Linka, o t'hongsha dyllin e veshit!

Djemtë ia plasën gazit. Linka u detyrua më në fund të kthehej.

- Keko, më vjen keq, por ti je zero edhe brenda edhe jashtë

kokës, - tha me inat.

Mësuesja e Fizkulturës i fryu bilbilit me rreptësi dhe u kërkoi djemve të largoheshin. Ata u bindën. Pas pak ra zilja e mbarimit të orës së dytë. Albi vrapoi në klasë dhe hapi çantën me ngut.

- Eri, m'i jep detyrat e Gjuhës t'i kopjoj pak, - iu lut shoqes së bankës.

Ajo i la para fletoren e hapur.

- Ku ishe dy orët e para? - pyeti pas pak.

- Kisha një punë te shtëpia e gjyshes, - gënjeu ai.

Tjetra tundi kokën me keqardhje.

- Albi, ti... se si je bërë kështu.

- Si?!

- Ke ndryshuar fare. Më parë i kopjoja unë detyrat te ti, ndërsa tani

Ai u shtir sikur nuk e kishte mendjen.

- Dhe mos gënje, - vazhdoi Erlinda e mërzhitur. - Unë të pashë nga dritarja. Ike me Kekon që në mëngjes.

Albi u detyrua të ngrinte kokën.

- Eri, më fal, - tha. - Nuk do të të gënjej më. E di, gënjeshttrat nuk më ecin kurrë.

Ai arriti ta mbaronte kopjimin pasi mësuesja kishte hyrë në klasë. Ndërkohë që Erlinda nuk e kishte mendjen, e afroi fletoren e saj pranë vetes dhe shkroi me ngut në fund të detyrës një fjali. Pastaj e mbylli fletoren dhe e shtyu nga shoqja.

Kur mësuesja filloi të kontrollonte detyrat, u ndal te banka e tyre më gjatë. Ndërkohë që Erlinda ende s'e kishte vënë re atë që kishte ndodhur, mësuesja e mori fletoren e saj në duar dhe pas pak lexoi me zë:

- Je më e bukur se të gjithë yjet marrë së bashku. Interesant! Kush e ka krijuar këtë fjali?

E gjithë klasa u kthye nga banka e Albit dhe Erlindës. Ajo po vështronte e hutuar, pa kuptuar asgjë.

- Albi, ç'loj fjalie është kjo? - vazhdoi mësuesja.

- Fjali krahasore zysh, supersipërore, - u përgjigj ai.

Klasa filloi të qeshte.

- Të lumtë Albi! - ia bëri mësuesja. - E shpikë edhe një shkallë të re krahasimi.

Vetëm kur i ra fletorja në duar, Erlinda pa se ç'ishte shkruar në të. Njohu shkrimin e shokut të bankës dhe duke u skuqur pëshpëriti: Albi, do ta mbash mend këtë. Ai vetëm i buzëqeshi. Megjithatë, humori i asaj dite nuk i zgjati shumë. Orën e fundit u ngrit në Gjeografi dhe mori 4. Kur mësuesja i tha se atë vit shkollor nuk ishte më si më parë, atij iu kujtuan fjalët e Erlindës "Ke ndryshuar fare". Doli nga klasa me kokën varur.

Por sapo vuri këmbën në oborr, i harroi të gjitha. Djemtë po bëheshin gati të fillonin një ndeshje futbolli me një klasë të shtatë. Keko po zgjidhte ekipin dhe kuptohej menjëherë që ndeshja do të luhej me ndonjë bast të fortë. Keko nuk luante kurrë pa baste. Bile një ditë kishte vënë bast me një nga djemtë e klasës se me cilën këmbë do të hynte mësuesja në mësim.

Ata që kërkonin të luanin ishin të shumtë, por Keko nuk ua zgjaste.

- Nuk dua biberona në skuadër unë, - tha me inat. - Do të futen vetëm ata që bëjnë lojë të egër dhe nuk kanë frikë nga shqelmat.

Për të "biberonë" ishin të gjithë djemtë e mamit që rrinin pastër dhe visheshin bukur, që merrnin dhjeta dhe nuk përdornin fjalë të pista. Keko nuk e duronte dot atë kategori.

- Po për mua, ka vend? - iu drejtua Armand Hoxha, një nga djemtë e klasës që mbante gjithmonë këmisha serioze, të mbërthyera deri në fyt dhe këpucë të lyera për merak. Keko e vështrroi njëherë shtrembër.

- Ik mor çun supe! - ia ktheu pastaj. - Shko se të ka bërë mami supë me karrota.

Armandi u largua nga fusha turivarur.

Albi e pa veten në skuadër ndonëse nuk ishte nga më të mirët e klasës në futboll. Franoi të luante edhe pse e dinte mirë se ajo ndeshje do të përfundonte me sherr. Dhe nuk u gabua. Skuadra kundërshtarë u mundua të quante të pavlefshëm një gol dhe Keko vendosi ta zgjidhte problemin me grushte. Të tjerët nuk e lanë vetëm. Edhe Albi u detyrua të futej në mbështetje të tij. Ajo kacafytje kushedi si do të kishte përfunduar po sikur të mos kishte dalë nëndrejtoresha e pasdites për të ndërhyrë. Ajo i urdhëroi të largoheshin nga oborri i shkollës.

Albi po pastronte rrobat nga pluhuri kur pa Merin.

- Albi, ku dreqin je? - thirri ajo e nxehur. - A do të vish në shtëpi apo jo?

Ai u ndie ngusht para shokëve nga ajo sjellje e së motrës.

- E grupo, edhe ty po të ftohet supa? - ia bëri Keko me tallje.

Të tjerët qeshën. Albi i bëri shenjë Merit të largohej. Ajo i vështroi njëherë djemtë me radhë, pastaj bëri pak hapa më tutje.

- Albi, ja pjesa jote e bastit, - tha Keko duke zgjatur lekët e fituara në ndeshje. - Shko se po të presin. Kur të duash, shihemi andej nga rrugica ime. Ç'është sot, e premte? Shyqyr që e bënë këtë shkollën pesë ditë në javë!

Albi futi lekët në xhep dhe i përshëndeti të gjithë.

- Po ti, ç'dreqin ke që më flet ashtu? - shfryu sapo iu afrua së motrës. - S'guxon njeriu të luajë njëherë futboll!

- E ku ta dija unë se po luaje futboll? - tha Meri me ankim. - U bëra merak dhe erdha.

-E mirë, e mora vesh, - ia ktheu ai me ton pajtues.

Kur mbërriti në shtëpi, nxori nga xhepi lekët e fituara atë ditë dhe i vështroi me habi. Kurrë s'kishte patur aq të holla në duar. Sikur nuk qenka edhe aq e vështirë për t'i fituar, tha me vete.

*

*

*

Të nesërmen *paradite* u mor ca me mësimet, pastaj vendosi të *shkonte* njëherë nga shtëpia e Altin Bardhit, një shok i klasës, i cili *kishte* kompjuter dhe një sërë programesh me lojra nga më të ndryshmet. Ai banonte aty pranë. Ata ishin rritur bashkë dhe Albi e shtyu derën pa trokitur. Por në oborr u ndesh me të atin e Altinit, i cili mori menjëherë një pamje serioze.

- Hë? - ia bëri.

Albi u befasua nga ajo sjellje.

- Desha pak Altinin, - tha.

- Më vjen keq, por Altini është shumë i zënë, - u përgjigj tjetri pa e vështruar. - Do të ishte mirë të mos e shqetësoje.

Albi u kthye me vrull dhe doli. Nuk po e mblidhte dot veten.

- Ç'pate kështu? - e pyeti Meri.

Ai i tregoi për pritjen e bukur që i kishin bërë në shtëpinë e shokut. Edhe Meri mblodhi buzët e hutuar.

- Më duket se të gjithë do të na e mbyllin portën, - tha Albi.

Motrës i dogjën ato fjalë të të vëllait. Pak a shumë e njëjta histori i kishte ndodhur edhe asaj me Klaudetën, një shoqe të klasës që banonte në të njëjtën rrugë. Meri i kishte telefonuar asaj për ta ftuar që të mësonin bashkë për një detyrë kontrolli në Matematikë. Në fillim shoqja kishte pranuar, por pastaj kishte thënë: Meri, më vjen keq, por mami nuk më lë të dal. Ajo e kishte ulur telefonin pa kuptuar dot gjë...

- Mos e mbaj mendjen aty, - u mundua ta qetësonte të vëllanë.

- Atij babait të Altinit nuk i pëlqen t'i hyjnë njerëz të huaj në shtëpi.

Por Albin nuk e bindën ato fjalë.

- Posi! E pse më parë i pëlqente?

- Më mirë lexo ndonjë libër, - tha Meri duke ndërruar temë.

Por Albit nuk i lexohej. Iu kujtua Keko dhe ftesa që ai i kishte bërë për të dalë nga rrugica e tij. Vajtja atje me ngut iu duk servilosje. Kushedi ç'mund të mendonin edhe Sajmiri me Redin. Ata të dy Albi nuk para i njihte mirë. Kur e pa se s'kishte ç'bente tjetër, vendosi të shkonte nga gjyshja.

E diela iu duk edhe më e mërzitshme. Ngacmimi për të shkuar nga rrugica e Kekos u bë edhe më i fortë. Doli duke i thënë Merit se ishte aty rrotull. U afrua njëherë te oborri i shkollës, por atje po luanin vetëm disa fëmijë të vegjël. Si pa kuptuar, këmbët e shpunë pikërisht në atë vend të cilit ai donte t'i shmangej. E gjeti Kekon duke bërë xhiro me një biçikletë të vjetër, bashkë me Redin. Pas pak ia mbërriti edhe Sajmiri.

Keko e plasi biçikletën pas një muri.

- Ç'do të bëjmë sot?- pyeti.

- Është bërë keq për lekë, - tha Redi. - Kam mbetur pa gjë.

- E gjeta! - thirri Sajmiri. - Shkojmë nga kisha. I lutemi motër Donatës mos na jep ndonjë ndihmë.

Redi ia ngjeshi Sajmirit me shpullë kokës tërë qejf.

- Sajme, sa i zgjuar je mor dreq!

- Redo, shko na gjej ca rroba të vjetra! - urdhëroi Keko.

Albi po vështronte pa kuptuar dot gjë.

- Eja dhe ti, - i foli Keko. - Nuk do të dalim pa gjë.

Redi u kthye pas pak me një tufë zhelesh në duar. Djemtë e grupit Zero në Kub i ndanë ato duke qeshur, futi secili pjesën e tij nën krah dhe u nisën. Albi shkoi me ta. Pas ndonjë çerek ore mbërritën te një kishë e vogël katolike, pranë së cilës banonin disa murgësja. Te porta e banesës së tyre qëndronin në radhë disa gra të moshuara dhe një burrë me paterica.

Keko, Sajmiri dhe Redi u futën në një qoshe dhe ndërruan rrobat. Zbathën edhe këpucët. Pasi morën një pamje që të këpuste shpirtin, u afruan te porta e murgësive. Zunë radhë duke u dridhur nga të ftohtit. Keko i bëri shenjë Albit të qëndronte aty pranë.

Te porta u duk një murgëshë e thyer në moshë. Ajo filloi t'u shpërndante njerëzve në radhë nga një pako me ushqime. Kur pa zerot që dridheshin të kërrusur nën zhele, qëndroi një hop.

- Po ju, a i çoni ndihmat në shtëpi? - pyeti.

- Po motër Donata, - u përgjigj Redi.

- Po prindërit, ç'ju thonë?

- Ju falenderojnë ju dhe Zotin.

Murgësja u la nga një pako në duar.

- Motër Donata, kemi edhe atë shokun tjetër, - i foli Keko duke treguar me dorë nga Albi. - I ka vdekur nëna, kurse babanë e ka pa punë.

Murgësja i bëri shenjë Albit të afrohej. Djali qëndroi para saj i emocionuar.

- Bir, a ishte e re nëna jote? - pyeti motër Donata.

Albit iu drodh mjekra e buzët.

- Po zonjë. Ishte shumë e re për të vdekur.

Murgësja e përkëdheli në flokë.

- Qoftë i bekuar shpirti i saj!

Ajo mori një kuti me ushqime dhe ia zgjati Albit. Djali falenderoi disa herë radhazi. Zerot po ashtu. Bile Redi ia mori motër Donatës dorën dhe ia puthi tërë përgjërim. Me t'u larguar nga kisha, ata u ndërruan dhe mbathën këpucët.

- Tani, te dyqani i Tixhes! - thirri Sajmiri.

Dyqani i Tixhes ishte një pikë shitjeje mallrash ushqimore

me shumicë. Zerot nxorën nga kutitë e tyre ç'kishte brenda dhe ia afruan shitëses me gjysmë çmimi. Ajo, një grua e shëndoshë, që patjetër duhej të ishte Tixhja, i vështroi ushqimet me radhë.

- Hë, ku i peshkuat këto? - pyeti pastaj.

- Ndihma nga Italia, - tha Keko. - E di ti.

Shitësja filloi të bënte llogari pa e zgatur shumë.

- Ja, këto janë tuajat, - tha pastaj duke hedhur mbi banak disa kartmonedha. Keko i mori ato dhe i ngjeshi në xhep.

- I ndajmë pastaj, - u foli shokëve.

Albi po lëkundej. Nuk dinte ç'të bënte me pakon e tij. Ta çonte në shtëpi, kishte frikë se Meri nuk do ta besonte se ku e kishte marrë. Veç kësaj, ajo dhe babai mund ta qortonin se kishte kërkuar lëmoshë pa lejen e tyre. Nuk ia vlente të hynte në historira pa fund. Iu lut Kekos ta kthente në lekë edhe pakon e tij. Shitësja me emrin Tixhe përsëri nuk ia përtoi. Albi as që i numëroi të hollat që mori.

- E fortë, ë? - ia bëri Redi duke fërkuar duart. - Sot e kanë radhën suflaqet.

- Predhë fare! - ia priti Keko. - Na lekët. Na merr edhe katër kanoçe birra.

- Jo, tre, - kundërshtoi Albi.

Keko e shtyu në sup.

- Mbylle mor biberon! Nuk të bën gjë një kanoçe birra.

Ata u futën prapa një lokali, u ulën në një shesh të vogël me bar ku binte dielli dhe filluan të hanin e të pinin tërë qejf.

- Hajt, shëndeti i motër Donatës! - ia bëri Keko duke ngritur lart kanoçen e tij.

Albit desh i ngeci birra në fyt. Iu duk e hidhur, tepër e hidhur. E shkreta motër Donata kë ndihmon, tha me vete. Apo s'e çajnë kokën këta zerot për shtëpinë! Megjithatë, janë të shkathët. Nuk shkojnë të ankohen te gjyshja si puna ime.

- Tani ta ndezim nga një, - tha Keko pasi mbaroi së ngrëni. Nxori një paketë dhe ua zgjati shokëve. Ata gromësinë të kënaqur dhe morën nga një cigare. Albi nuk pranoi të merrte.

- Ndize se nuk je kalama, - i foli Keko.

Albin e mbërtheu një ndjenjë turpi. Të tjerët shfrynin shtëllunga tymi dhe e shikonin gati me tallje. Ai u detyrua ta ndizte.

Por mënjëherë e mbërtheu kolla. Zerot ia plasën gazit. Albi e thithi cigaren disa herë, pastaj e flaku anash.

- Unë *po iki*, - *tha pas* pak duke u ngritur. - Takohemi nesër në shkollë.

Keko u kthye drejt tij.

- Grupo, sikur s'më dukesh edhe aq në qejf, - tha. - Mos ke ndonjë hall? Apo ndonjë sherr? Ta zgjidhim ne në vend.

- Jo, s'kam gjë, - ia ktheu Albi. - Mirupafshim!

Zerot e përshëndetën me gjysmë zëri.

- A ha! - ia bëri Redi. - Keko, s'më duket dora jonë ky.

- Edhe mua s'ma mbush syrin, - e mbështeti Sajmiri.

- Prisni njëherë, të shohim, - tha Keko. - Nuk është zor për ta përzënë.

Albi mbërriti në shtëpi me një ndjenjë faji brenda vetes. Nuk dinte ç'të bënte me tërë ato lekë që i përvëltonin në xhep. Dha e mori dhe më në fund vendosi ta fuste shumicën e tyre në sirtarin e bufesë ku mbaheshin paratë e shtëpisë. Edhe sikur Meri ta vinte re ndryshimin, ai do të luante rolin e të paditurit.

8.

Ato ditë dimërore me shi e vranësirë hynë në një rrjedhë që filloi të sillte një rën të papritur pas tjetrës. Ishin të lodhshme. Meri vazhdoi të ngrihej në 6 pa 10. Shkonte në shtëpinë e teta Bardhës dhe punonte pa u ankuar deri në 7. Pastaj kthehej për të zgjuar e bërë gati për në shkollë Albin e Norën. Pas shkollës merrej me punët e zakonshme të shtëpisë; lante, hekuroste e gatuante. Kur gjente pak kohë të lirë, merrte librat e shkollës. Pasdite shkonte përsëri për të hapur petë për byrekë. Ndërkohë ishte errur dhe fillonte ankthi i zakonshëm për të atin.

Sikur të mos mjaftonte ai ankth, vajzës iu shtua edhe meraku për Albin. Ai filloi të zhdukej nga shtëpia me orar e pa orar. Mbrëmjeve kthehej vonë, duke gënjyer në mënyrë trashanike se kishte qenë duke mësuar te një shok. Ndonëse Meri e kishte ngarkuar të ndihmonte Norën në Abetare dhe bukurshkrim, ai

rrallë ulej me të. Kishte raste që e linte vetëm në shtëpi dhe kur Meri kthehej nga teta Bardha, e gjente të motrën duke qarë.

Një mbrëmje, ndërsa Albi u ul në tavolinë dhe kërkoi të hante, Meri ndjeu erë duhani nga duart e tija. Afroi hundët te to dhe pas pak u tërhoq mbrapsht e trembur.

- Albi, ke pirë cigare!

- Jo, - u përgjigj ai qetësisht.

- Mos më gënje! Pse ke pirë cigare?

- Nuk kam pirë.

Meri e kapi për mjekre dhe ia ngriti kokën lart.

- Dije se po vure përsëri cigare në gojë, do t'i them babit!

Albi nënqeshi.

- Thuaji. E çfarë do të fitosh? Meri, dëgjo, le t'i sqarojmë ca gjëra. Me mua mos u sill si drejtoreshë kopshti.

- Ti je vëllai më i vogël, - ia ktheu e motra.

- Tani s'dua të jem më.

- Atë do ta shohim.

- Okej drejtoresha! A mund të ha tani?

Meri e vështroi në bisht të syrit edhe më e trembur. Që Albi s'ishte më ai i pari, kjo kuptohej fare lehtë.

S'kaluan as dy ditë nga ajo mbrëmje kur ajo, ndërsa po hidhte në lavatriçe xhinset e të vëllait, gjeti në njërin prej xhepave dy kartmonedha njëqindlekëshe. U tremb shumë më tepër se herën e parë. Iu afrua Albit duke u dridhur.

- Po këto... ç'janë?

Në fillim ai u nxeh.

- Ç'do që më kontrollon xhepat? - thirri.

Ajo e sqaroi se nuk kishte kontrolluar. Albi ruajti qetësinë.

- Janë lekë, - tha. - Si gjithë të tjerat. Shkarkuam me dy shokë një maune me banane andej nga magazinat e shumicës. I zoti i maunes na pagoi.

- Ti ke shkarkuar maune?!

- Pse, s'ta mbush syrin? Dhe ato lekë kisha në plan t'i dorëzoja për llogarinë e shtëpisë.

- Atëhere, bëj be për shpirtin e mamit.

Tjetri u kapërdi. Një fytyrë i ikte e një tjetër i vinte.

- Be nuk bëj, - tha ftoht.

- Atëhere, këto nuk janë lekë bananesh.

- Meri, ti kujton se janë lekë të vjedhura?

Ajo po e vështronte ende duke u dridhur.

- Albi... po arrite deri këtu... dije se... dije se...

Por nuk diti ç'të vazhdonte më.

- Nuk dua të të shoh më lekë nëpër xhepa, - psherëtiu pastaj.

- Me këto do të blej pluhur larës. Në rregull?

Albi nuk e kishte pritur atë gjë.

- Në rregull, - ia bëri si i penduar.

Meri u mendua gjatë para se t'i fuste kartmonedhat në sirtar. Nuk donte ta besonte kurrë se ato ishin lekë të vjedhura. Por edhe puna e bananeve nuk e bindte. I nxori lekët nga sirtari përsëri dhe u mat t'i griste. Por vlera që ato kishin, e frenoi. Ato ditë kishin mbetur keq. Gjyshja që rënduar nga këmba dhe vinte më rrallë. Edhe ajo duhej të kishte mbetur ngusht sepse dy herët e fundit i kishte patur duart bosh. Tezja që larguar më në fund për në Gjermani duke lënë te gjyshja vajzën e madhe e cila studjonte për mjeksi. Halla e Elbasanit kishte kohë pa ardhur, ndërsa me atë të Tiranës diçka po ndodhte. Meri kishte vënë re shenja ftohjeje mes saj dhe babait, pa folur për burrin e hallës, të cilin e ndante nga babai një akullnajë e tërë. Herën e fundit që ata kishin ardhur për vizitë me veturën e tyre të shtrenjtë, kishin bërë fjalë. Burri i hallës ishte nxehur dhe pastaj ishte larguar i ofenduar. Meri e kishte pyetur të atin se ç'kishte ndodhur, por ai nuk kishte pranuar t'i tregonte. Eshtë një problem i vjetër, i kishte thënë, më mirë të mos e dish...

Më në fund, pas një lëkundjeje torturuese, ajo gjeti një zgjidhje të mesme. I futi lekët në një vend të fshehtë duke menduar se herët a vonë do të merrej vesh në se ato ishin fituar duke shkarkuar banane apo jo.

Atë mbrëmje babai u kthye me një pamje tepër të lodhur e të mërzitur, por nuk kishte pirë. Meri u mat t'i tregonte për ç'kishte ndodhur me Albin, por si edhe herë të tjera më parë, ndërroi mendje shumë shpejt. Ai vetëm se do të mërzitet më keq, mendoi. Pastaj, edhe Albi nuk do të ma falte. Do të më quante spiune.

U mundua të harronte gjithçka, por ishte e pamundur. Idea

se i vëllai ishte përzier në ndonjë vjedhje, e tmerronte. Albi, nuk duhet ta bësh këtë, mërmëriste. Të lutem, vetëm këtë jo. Për hatër të mamit!

Bëri një gjumë të trazuar, duke u vërtitur nëpër krevat për të kushedi të satën herë. Kur ra zilja e orës, mezi zgjati krahun. Për herë të parë u lëkund. Sikur të mos shkoj sot, mendoj. Por pastaj fërkoj fort fytyrën dhe u ngrit. Doli në oborr ende e përgjumur dhe papritur u ndesh me të atin. Ai me sa dukej kishte kuptuar gjithçka.

- Meri, - mërmëriti. - Ti...

- Ba, të lutem mos më pengo, - foli ajo. - Duhet të punoj.

Kemi nevojë.

- I gjithë faji është imi.

- Jo, ti s'ke asnjë faj. Tani shko brenda se këtu është ftoht.

Ai tërhoqi mbi shpatulla një xhaketë të vjetër stofi. Ndërsa e vështronte të bijën, dy bula loti i ndritën në cepat e syve.

- Meri... unë... do të ndryshoj, - tha. - Të premtoj!

E bija u mundua të buzëqeshte.

- Po ba, e di. Unë kam shumë besim te ty.

Ajo hapi portën dhe doli.

Atë mëngjes mbërriti në shkollë më e lodhur se zakonisht. Ajo gjë i ra në sy shumëkujt, por tashmë në klasë ishin mësuar me pamjen e saj. Mësuesja kujdestare iu afrua si shpeshherë, duke dashur të tregonte se, pavarësisht nga rënia në mësim, ende e vlerësonte njëlloj.

- Hë Meri, ka shumë telashe shtëpia, ë? - pyeti.

Nxënësja pohoi me kokë.

- Ma merr mendja se për mësimet s'tepëron shumë kohë.

- Jo mësuese. Mësoj kur të mundem.

- Po në darkë vonë?

- Mundohem, por më mbyllen sytë.

- Zotësia është të mos të të mbyllen sytë! Meri, rasti yt do shumë sakrifica, kurajo, durim. Mësimet nuk duhen lënë pas dore. Kjo është kryesorja.

Tjetra u ndie e ngopur nga ai lloj morali. Eh, moj mësuese, të ishe vetë dhe ta provoje, mendoj. Gjëja më e lehtë në botë qenka t'u bësh moral të tjerëve. Ajo u ul në bankë ku Sidi po e priste

me një mbetje hatri të lehtë. Vetëm atëhere ajo u kujtua se të djeshmen skuadra e tij kishte patur ndeshje. Ai e kishte ftuar dhe Meri i kishte premtuar se do të vinte të bënte tifozllëk për të.

- Sid, më fal, - tha duke e prekur në sup. - Dje nuk erdha dot se...

- S'ka gjë, - e qetësoi ai.

- Sa pikë bëre?

- 20. Fituam pa problem. Të telefonova pas ndeshjes, por në shtëpi ishte vetëm Nora. Filloi të qante.

- E pse?

- Kishte frikë se mos hynte dhelpra dinake nga dritarja. I thashë se ty të mbron Sparki i cili e bën dhelprën dinake fërtele.

Në atë kohë kam qenë te teta Bardha, mendoj Meri, por nuk guxoi ta sqaronte tjetrin se ku ishte ndodhur në çastet e telefonatës.

- Mos ke futur gjë ndonjë byrek në çantë? - pyeti Sidi papritur.

- Jo, - ia ktheu ajo e hutuar.

- Vjen një erë e këndshme byreku.

Budallaqë, i foli Meri vetes. Ke ardhur në shkollë me ato rroba që ishe në punë. Vuri re se gjunjët e pantallonave kishin ende pluhur mielli. E kapërceu atë situatë duke i kërkuar shokut detyrat e Matematikës. Ai nxori fletoren nga çanta si me mëdyshje.

- Për këto detyra mund të më kishe pyetur dje, - tha.

- Nuk kisha kohë, - ia ktheu ajo.

- Meri, ti ke filluar vetëm të kopjosh dhe kjo nuk është zgjidhje.

Ajo u nervozua në çast.

- Pse, u bezdise ti nga kopjet e mia?

- Nuk është punë bezdie. Problemi është se kështu nuk vazhdohet më.

- Ah, vërtet?! Ç'na the! Edhe ty të kisha mangut për këshilla! Edhe Sidi u nervozua.

- Më duket se s'ke patur ndonjë të keqe nga këshillat e mia.

- Nuk duroj dot më këshilla! Kuptove?

Mësuesja kërkoi të vendosej qetësi dhe ata u detyruan të

heshtnin. Deri në pushimin e gjatë i ndjenjën ftoht njëri-tjetrit dhe shkëmbyen më të rrallë ndonjë fjalë. Kur dolën jashtë në oborr, Sidi e ftoi të hanin një hamburger.

- Nuk mundem, - tha ajo prer.

- Nuk të hahet?

- Sid, nuk mund të pranoj më qerasje prej teje sepse hamburgerët blihen me lekë.

- E pastaj?

- Dhe unë këto qerasje nuk t'i kthej dot.

- Po kush të ka kërkuar që të m'i kthesh xhanëm?!

- Sid, të lutem!

Ai tundi kokën i zhgënjyer.

- Sot qenke vërtet e habitshme. S'po e kuptoj dot çfarë ke.

- Kam vetëm hallet e mia dhe asgjë tjetër.

Sidi u largua. Meri shkoi në një cep të oborrit ku binin rrezet e një dielli të zbehtë dhjetori. Por nuk pati kohë të qetësohej sepse një nxënës i klasës së gjashtë e njoftoi se e kërkonte mësuesja kujdestare e Albit. Ajo e nuhati se ç'e priste. U afrua me ndrojtje te dera e sallës së mësuesve.

Alma, mësuesja kujdestare e Albit, që jepte Anglisht, i bëri shenjë të priste. Erdhi pas pak si reja me shi, duke vështruar me inat dy djem që i kaluan përbri me vrap për të hyrë në klasë.

- Ju mori dreqi! - shfryu e bezdisur. - Jeni bërë si kuaj të hazdisur. A thua se nuk është shkollë këtu, por han. Moj, ti, Gjoka, - iu kthye pastaj Merit. - E di ti moj se yt vëlla është bërë rrugaç fare? Më është bashkuar edhe me disa rrugeçë të tjerë, nga ata që nesër do të bëhen kriminelë me revole në brez. I di këto familja jote apo jo? A pyet ai yt atë për të birin që është mbytur në katra apo jo?

Meri u skuq e tëra.

- Vajzë e mbarë, hapni sytë! - vazhdoi mësuesja. - Unë nuk të paralajmëroj më. Kam 36 nxënës në klasë, jo vetëm Albin tuaj.

Ajo u largua me tërsëllëmë, ashtu siç kishte ardhur. Këtu do të përfundonte puna, mendoi Meri e hutuar. Cigarja, ato lekët, kthimi vonë. Po tani, ç'të bëj? Kujt t'i kërkoj ndihmë?

Atë ditë u kthye në shtëpi tepër e nervozuar. Filloi të bënte ecejake nëpër oborr deri sa ia mbërriti Albi. Ai e vërviti çantën

te shkallët pa pikë kujdesi.

- Po ti, pse më vështron ashtu sikur kam hyrë në shtëpi pa vizë? - iu drejtua së motrës.

- Të vështroj se po na turpëron, - ia ktheu ajo. - Je mbushur me katra, ke filluar të shoqërohesh me djem jo të mirë.

- E kush t'i tha këto?

- Mësuesja jote kujdestare.

- Aha, e kuptova. Ajo ia fut kot.

Meri e mbërtheu për supi dhe e tundi aq fort sa që Albi u lëkund i tëri.

- Ti duhet të mbledhësh mendjen! Dëgjove apo jo? Që sot nuk do të dalësh më nga shtëpia! Do të merresh vetëm me mësimet dhe...

Por papritur Albi u shkëput nga dora e saj, pastaj e shtyu me inat.

- Meri, mos guxo të më prekësh më! Po guxuat të më prekni, ti ose babi, do të iki fare nga shtëpia! Mbaje mend këtë që të thashë!

Meri ngriu pas atyre fjalëve. E mbërtheu paniku edhe më keq. Po sikur Albi të ikte nga shtëpia, ç'do të ndodhte? Ishte e kotë. Ajo nuk mund ta trembte më. Duhet folur me babin, mendoi. Duhet folur sa nuk është vonë.

Atë mbrëmje ia tregoi atij gjithçka, në sy të të vëllait.

- E prisja edhe këtë, - psherëtiu babai. - Në këtë shtëpi shumë gjëra po shkojnë keq e më keq dhe shkaktari kryesor jam unë. E di mirë këtë. E pranoj. Por ju... ju... nuk jeni më të vegjël dhe... Albi, ngrije kokën, më shiko në sy. Unë e di ç'është rruga dhe ç'të pret prej saj. Ruhë nga shokët e këqinj!

- Unë nuk kam shokë të këqinj o ba! Ata janë djem si gjithë të tjerët.

- Domethënë, mësuesja i quan kot rrugaçë?

- Për mësuesen, kush merr katra dhe nuk vjen në shkollë, është rrugaç.

Babai përplasi dorën mbi gju.

- Ato që thotë mësuesja janë të drejta! Albi, më dëgjo, kam vetëm dy fjalë me ty: më mirë të mbys me duart e mia se sa të përfundosh në rrugë. Më kuptove? E di, vetë nuk jam një baba

shembullor, por ama tim bir nuk do ta lë të shkasë. Ndryshe mallkimi i nënës tënde do të më ndiqte pas që nga varri.

Albi po e vështronte të atin në mëdyshje.

- Hë, nuk po të bindin fjalët e mia? - e pyeti ai.

Djali ndryshoi qëndrim në çast.

- Më bindin. Në rregull. Të kuptova.

- Dua që ti të marrësh përsëri nota të mira, siç merrje vjet.

- Ja, po shkoj të filloj mësimet.

Meri nuk besoi në atë qëndrim të të vëllait. Albi nuk pyet më për babin, mendoi me frikë. Është i sigurtë se ai do të vazhdojë të pijë dhe fjalët e tij do t'i marrë era. Atë mendim ia përforcoi qëndrimi i Albit.

- Meri, do të ma paguash këtë! - e kërcënoi ai. - Më nxore mua më të rrezikshmin e botës, kurse për vete dole shpëtimtare. Pse s'i tregove babit edhe për katrat e tua dhe për ato që bën me Sidin?

Ajo nuk i kishte pritur ato fjalë.

- Albi, ç'e ke këtë idiotizëm? - foli e prekur. - Ku e di ti se çfarë bëj unë me Sidin?

- Pse, ato varëset me guacka dhe ato "Je më e bukur se Dielli", ç'janë?

- Albi, mos guxo të flasësh të tilla gjëra! Ta dish se sa vjen e po bëhesh më i keq.

- Posi! Ti bërtet nga inati se unë them të vërtetën.

- Ti e di shumë mirë se si është e vërteta.

Albi nënqeshi.

-E vërteta është se ti duhet t'u japësh fund atyre guackave, Diellit, telefonatave. Nuk ke punë të shoqërohesh me djem. Unë jam vëllai yt dhe nuk të lejoj të rrih me asnjë djalë!

- As me... Sidin?!

- Sidomos me Sidin!

Meri mendoi se ai lloj qëndrimi i të vëllait do të ishte një mllef i çastit. Por të pasnesërmen e ndjeu veten shumë keq kur Sidi i tha i hutuar:

- Nuk po e marr vesh atë Albin. Çfarë ka me mua?

- Pse? - ia bëri Meri duke u skuqur.

- Telefonova dje dhe më doli ai. U soll sikur nuk më njihje

fare. Në fund i këputi një "Dëgjo djalosh, me motrën time nuk ke më punë". Në fillim pandeha se po tallej, por...

- Sid, të kërkoj falje. Albi nuk ka gjë me ty. E ka inatin me mua.

- Pse jeni grindur?

- Flasim njëherë tjetër.

Meri u kthye në shtëpi duke e kuptuar se marrëdhëniet e saj me të vëllanë po vështirësoheshin për ditë e më shumë. Megjithatë, atë ditë nuk e hapi fare problemin e telefonatës së Sedit. U shtir sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ndërkohë Albi po priste për të vazhduar sherrin.

- Të lutem, merr çantën dhe fillo mësimet, - i foli ajo qetësisht. Ai mblodhi njëherë vetullat.

- A hu! Pasnesër janë Krishtlindjet. Shkolla mbaroi.

- Ti do të merresh me mësimet dhe nuk do të lëvizësh nga shtëpia!

Djali turfulloi njëherë me inat, pastaj u detyrua të bindej.

Edhe në ditët para vitit të ri nuk mundi të bashkohej me djemtë e grupit Zero në Kub sepse babai u mor me rregulli-min e dy veturave, aty në oborr.

- Albi, kam nevojë për ndihmën tënde, - i tha të birit. - Do të jesh ndihmësi im. Ke rast të mësosh se ç'është makina dhe se si fitohet leku me djersën e ballit.

Djali u mat njëherë të kundërshtonte, por i ati ia kishte ngulur sytë me një pamje tepër serioze.

- Kam nevojë për një ndihmës, - përsëriti.

Albi u detyrua të vishte një palë rroba të vjetra dhe të fillonte të nxirrte nga një depo në cep të oborrit një pirg të tërë me vegla. Për tri ditë me radhë punoi me të atin nga mëngjesi deri në mbrëmje. Ndaleshin vetëm një orë nga dreka për të ngrënë. Njerës prej veturave ia zbrërthyen e mbërthyen pjesët dy herë, deri sa u bë siç e kërkonte i zoti. Kohë pas kohe, që nga porta e hapur, Albi i hidhte sytë vjedhurazi nga rruga tërë zili. Djemtë e grupit Zero i fërshëllyen disa herë, por ai nuk kishte si t'u përgjigjej. Kur fërshëllimat u bënë bezdisëse, babai ngriti kokën dhe vështroi nga i biri i mërzitur.

- Shko thuaju se nuk ke për të dalë! - urdhëroi.

Albi vështroi njëherë rrobat e bëra tërë pluhur ,vaj e graso. Bëri drejt portës në mëdyshje. Zerot filluan të qeshnin kur e panë.

- Nuk vij dot, - foli ai me inat.

Keko i shkeli syrin.

- Kemi ca gjëra për të shitur, - tha.

- Keko, më vjen keq.

- Eh, ç'thotë! Keq na vjen neve. Shko lyeu me graso,shko.

Ata u larguan duke u tallur.

- Albi, vazhdojmë! - thirri babai pa e ngritur kokën.

Mbrëmjen e 29 dhjetorit, kur kishin mbaruar punë dhe veturat ishin larguar, Albi u ul te shkallët e verandës duke mbajtur mezin me duar.

- E shoh që u lodhe, - i foli i ati. - Por kjo është lodhje që të nderon. Albi, po ta përsëris edhe njëherë: rruga aty është, pret viktima që t'i nisë drejt krimit, burgut. Dije se po nuk mësove e punove, ajo rrugë nuk do të të nxjerrë nëpër stacione të tjerë.

9.

Atë mbrëmje Meri u kthye nga shtëpia e teta Bardhës me një tufë kartmonedhash në xhep. Po i mbante ato ende shtërnguar në dorë. Janë djersa jote, i kishte thënë teta Bardha. Do t'ju duhen tani për vitin e ri. Besoj se do të mbetesh e kënaqur. Meri e kishte falenderuar dhe i kishte marrë lekët pa i numëruar. I kishte ardhur turp ta bënte atë veprim në sy të teta Bardhës. Vetëm kur mbërriti në shtëpi, i vuri kartmonedhat mbi krevat dhe po i shikonte e menduar. Ja, për këto para bëhet gjithçka, tha me vete. Këto janë jeta. Me to njerëzit ushqehen, vishen bukur, blejnë vetura, ndërtojnë vila. Pa to shkatërrohen. Si dreqin është ndërtuar kjo botë kështu?

Gjëja e parë që i ra ndër mend pasi numëroi kartmo-nedhat, qenë një palë këpucë me majë katrore e me taka të larta që atë dimër ishin tepër në modë. Vërtet kushtonin shumë, por ishin të bukura e të forta. Do t'i blej, vendosi. Këpucët që kam nuk

mbahen më, fusin ujë. Por pastaj u kujtua se i detyrohej një shumë jo të vogël parash shitëses së ushqimores aty pranë shtëpisë. Sa herë që llogaria e familjes mbeste zero, ajo detyrohej të merrte ushqime pa paguar, të cilat shitësja i shënonte në një bllok. Ajo lloj zgjidhjeje ishte për Merin vërtet torturoese, sidomos në çastin kur hynte në dyqan, por nuk kishte nga ia mbante tjetër.

Filloi të lëkundej. E ç'kuptim ka të blej këpucë tani, mendoj. Sado që të ketë fituar babi nga rregullimi i atyre dy veturave, lekët kurrë s'kanë për të na mjaftuar. Pas pak doli nga shtëpia dhe shkoi te ushqimorja duke folur me vete.

Por të nesërmen arriti të bëhej edhe me këpucë edhe me xhinse, pothuaj të reja. Gjithçka ndodhi për shkak të Klarës. Ajo erdhi të merrte te teta Bardha një byrek të madh me porosi dhe e pa Merin aty duke hapur petë.

- Po ti?! - pyeti duke qeshur.

- Ja... kështu, - ia bëri Meri duke u skuqur. - Punoj nga pak.

- Si punon?! Punon tamam, me rrogë?

- Teta Bardha e bëri për të më ndihmuar. Ti e di... ne jemi ngushtë.

- Ik se tallesh! Nuk ma kishte marrë mendja. U fa! Ç'jetë e shpifur!

Klara vështroi njëherë rrotull si me bezdi.

- Si duron këtu brenda!

Meri mbledhi supet për të treguar se nuk shihte ndonjë të keqe.

- Po kjo Bardha, të trajton mirë?

- Shumë mirë.

- Ah Meri, Meri!!! Mund të shihemi prapë sot.

Klara pagoi byrekun, futi një copë në gojë për ta provuar, pastaj doli duke fërshëlyer një këngë angleze që ishte nga më të dëgjuarat ato javët e fundit.

- Kjo vajzë nuk më pëlqen, - tha teta Bardha duke vështruar nga dera.

- Pse? - pyeti Meri duke ngritur kokën.

- Është e llastuar, nuk ka respekt për prindërit që e duan shumë. Por më e keqja është se u ka hyrë ca punëve për të cilat

është ende e papjekur. Plotësisht e papjekur. Nuk do ta lejoja kurrë vajzën time të fejohej në këtë moshë.

- Megjithatë, si njeri, si zemër, është e mirë, - tha Meri.

- Mbase. Por mua më duket nga ato vajza që herët ose vonë përfundojnë keq. Qofsha e gabuar! Do t'i uroja tjetër fat.

Meri nuk foli më. Iu duk sikur teta Bardha kishte një lloj inati të vjetër ndaj Klarës. Pse duhej t'i shprehte mendimet e saj për Klarën pikërisht para meje, pyeti veten. Apo pse ajo më tha se mund të shihemi prapë sot?

Nga mbrëmja Klara erdhi në shtëpi duke tundur në dorën e djathtë një qese të stamposur nga ato të dyqaneve të modës. Meri e ftoi të ulej.

- Është babi yt aty? - pyeti tjetra me siklet.

Kur mësoi se brenda ndodheshin vetëm Albi me Norën, hyri duke vazhduar të tundte qesen.

- A ka nga ajo likoja e famshme e portokallit? - pyeti tërë neps. - Kam ngrënë njëherë vjet dhe akoma më shkon goja lëng.

Meri psherëtiu.

- Atë liko nuk ka kush e përgatit më.

- Po të sjell nja dy portokaj, - ndërhyri Albi.

- Rrofsh, - ia ktheu Klara. - Më mirë nja dy limona. Ore, Albo, ke zënë ndonjë shoqe të bukur andej nga shkolla?

- Ahu, keq për shoqe! - ia ktheu Albi duke dalë.

Klara qeshi, pastaj nxori nga qesja një palë këpucë dhe një palë xhinse.

- I solla për ty, - iu drejtua Merit. - Duhet të të bëjnë. Mua nuk më pëlqejnë më. Në këtë vend s'ke ç'i do edhe gjërat e bukura. Vend ku njerëzit hanë byrek me gjizë dhe nuk kanë ujë të lahen!

Meri mbeti e hutuar për ca çaste.

- Sa kushtojnë? - pyeti pastaj.

- Ja, po marr ca kokrra limona, - ia ktheu Klara me indifrentizëm.

- Jo, - kundërshtoi Meri, - nuk mundem. Kësaj here do të paguaj. Sa do?

- Vërtet do të paguash? Atëhere më jep nja njëmijë lekë.

- Kaq pak?!

- Meri, dynjaja po ikin në Itali e Amerikë, kurse ne diskutjmë akoma për xhinse e budallallëqe. Vishi njëherë, të shohim si të rrinë.

Meri doli të ndërrohej dhe u kthye pas pak me një pamje krejt tjetër.

- Kryevepër! - ia bëri Klara. - I gëzofsh! A nuk është krim që të merresh ti me peta byreku? E ç'kanë ato italianet e amerikanet pordhace më shumë se ti? Apo se mua?

Meri kishte ngrirë me vështrimin poshtë, nga këpucët.

- Kjo verë nuk më zë këtu, - vazhoi Klara. - Do të shkoj në Greqi.

- Me kë? - pyeti Meri si me frikë.

- Me Gencin. Ai tani ndodhet atje, por nga pranvera do të vijë të më marrë. Nuk më bëjnë më përshtypje as veshjet e as bizhuteritë. E kupton?

Meri tundi njëherë kokën, pastaj shkoi te një sirtar aty pranë dhe mori disa kartmonedha. Klara i futi ato në xhep e shkujdesur. Pas pak Albi solli limonët dhe e motra përgatiti nga një limonadë për të tre.

- Klara, ç'thotë Viti i Ri? - foli Albi.

Ajo mblodhi njëherë buzët.

- Ç'është ky vit i ri?! Këtu gjithë vitet njëlloj janë. Njerëzve s'u ka dalë ende babëzia, e kanë mendjen vetëm të hanë e të pijnë. Lëre, ç'vete! Tani, unë po iki. Meri, ndonjë ditë, kur të duash ti, mund të dalim bashkë.

Tjetra nuk e priste atë ftesë.

- Unë... nuk kam kohë... Ti... e di. Megjithatë, të shoh.

Kur fqinja doli, Meri qëndroi para pasqyrës për pak çaste. U zgjidh edhe ky hall, mendoi. Të nesërmen doli me ato xhinse dhe ato këpucë për të bërë nja dy blerje të vogla. Papritur i shkoi ndër mend se Sidi mund të ishte duke bërë stërvitje edhe ditën e fundit të vitit. U kthye te fusha e basketbollit dhe e gjeti atë atje së bashku me një grup djemsh. Meri u afrua te rrjeta kufizuese e fushës.

Sidi e vuri re pas pak.

- Ej, kush paska ardhur! - ia bëri i gëzuar.

Ajo priti si me frikë se mos ai e pyeste për xhinset dhe këpucët,

por tjetrit as që i shkuan sytë te to. Kurrë nuk i kishte kushtuar vëmendje veshjes së saj, sigurisht as të vetës. Kishte raste që vinte në shkollë me ca tuta të gjera sportive, pa folur për këpucët e lëkurës që mund t'ia shihje në këmbë njëherë në muaj.

- Do të më presësh sa të mbaroj? - tha ai. - Do të të shoqëroj deri në shtëpi.

Ajo pranoi. U ul në një stol dhe e ndoqi shokun me sy në çdo lëvizje. Sidi u gjallërua papritur. Bëri një sërë koshash njëri pas tjetrit. Luftonte nën tabelë dhe e mbulonte kundështarin hap pas hapi. Sapo gjente një mundësi, kthehej drejt saj dhe i buzëqeshte. Ajo i tundte dorën për t'i treguar se ishte tifoze e tij.

U kthyen deri pranë shtëpisë duke biseduar për natën e vitit të ri.

- Sonte, para orës 12, do të lëshoj një fishekzjarre për ty, - tha Sidi. - Do ta kesh të lehtë ta dallosh. A do të dalësh ta shohësh?

Meri i premtoi se do të dilte. U ndanë duke i shtrënguar dorën njëri-tjetrit.

- Po Albi, vazhdon të mbajë inat? - pyeti Sidi papritur.

- Ja, ashtu, - ia bëri Meri. - Do t'i bjerë edhe inati një ditë. Sid, ia kalofshi mirë!

- Edhe ju!

Ajo hyri në shtëpi dhe gjeti aty gjyshen dhe Aldën, vajzën e tezes që ndiqte universitetin. Kishin ardhur për të kaluar së bashku Vitin e Ri. Merin e gëzoi shumë prania e tyre.

- Po Albi, nga bëhet? - pyeti gjyshja.

- Duhet të jetë këtej rrotull, - ia ktheu Meri, pa e patur idenë se ku mund të ndodhej i vëllai në ato çaste.

*

* *

Trotuaret ishin plot me njerëz. Të gjithë mbanin qese dhe shporta pazari nëpër duar. Shumë prej tregtarëve vazhdonin të qëndronin hapur. Albi çapitej i mërzitur mes rrëmujës. Herë pas here përplasej me ndonjërin që nxitonte. Ishte i mërzitur. Në xhep mbante një dhuratë të vogël që ia kishte blerë Erlindës

me rastin e festës. Por kur i kishte telefonuar dhe i kishte kërkuar të dilte vetëm pesë minuta, ajo i qe përgjigjur se nuk kishte mundësi. Do të shkonte bashkë me familjen për ta kaluar natën e Vitit të Ri në Durrës dhe po bëheshin gati për t'u nisur.

Kur u mërzit së sorollaturi kot, vendosi të dilte njëherë nga lagjja e djemve të grupit Zero në Kub. Por nuk gjeti asnjërin prej tyre. Një shok shkollë i tha se ata të tre duhej të ishin nga bulevardi kryesor duke shitur fishekzjarre. U nis andej dhe në trotuarin e ngushtë të urës së Lanës pa Sajmirin me një tufë fishekzjarresh në duar.

- Hë mor Alb, ku je? - foli ai me qejf. - Pare e madhe sonte. Shko tako njëherë Kekon.

Albi bëri ca më tutje. E pa Kekon me një çantë hedhur krahëqafë. Po shiste videokaseta dhe fishekzjarre.

- Ou, po ti?! - ia bëri. - Dëshëm të vinim të të merrnim, por s'patëm kohë. Kam këtu në çantë ca videokaseta boshe. Do ta provossh njëherë mos shesësh gjë?

- Ku i ke gjetur? - pyeti Albi.

- A, fillove nga pyetjet ti! Çuni i tezes time shet me shumicë gjëra nga këto elektroniket. Janë të tijat. Hë, si ma ke syrin?

Albi vështroi njëherë rrotull.

- Po e provoj, - tha pastaj.

Keko nxori nga çanta disa videokaseta dhe i tregoi çmimin. Albi i mori ato dhe u largua pak më tutje. I kaloi vetëtimthi nëpër mend idea se atë natë kushdo mund të donte të rregjis-tronte festën dhe do të kishte nevojë për ndonjë videokasetë boshe. Por kaloi gati një orë dhe askush nuk u ngacmua nga idea e tij. Ahu, sonte të gjithë e kanë mendjen për të ngrënë e për të lëshuar fishekzjarre, tha Albi me vete.

Shkoi nga Keko dhe i kërkoi fishekzjarre.

- S'ecin fare këto drej kasetash, - ia bëri ai me inat. - Futi duart në çantë dhe merr ç'të gjesh aty brenda.

Albi mbushi duart me fishekzjarre dhe i shiti ato brenda një kohe të shkurtër. Kur në çantën e Kekos nuk mbeti më asgjë, u ul në një bordurë dhe filloi të numëronte lekët. U detyrua ta ngrinte kokën vetëm pas një fishkëllime të mprehtë me disa ndëprerje të shkurtëra, të cilën zerot e përdornin si sinjal me

njëri-tjetrin. I pa ata tek po ngjiteshin në një veturë që ishte ndalur buzë trotuarit. Redi i bëri shenjë të nxitonte. Albi u ngrit dhe hyri në veturë.

Pa në timon një djalë rreth të tridhjetave, tullac, me një vëth floriri në veshin e djathtë dhe me një mjekër të hollë në formë O-je që i rrethonte gojën.

- Albi, ky është Sandri, çuni i tezes time, - e njohu Keko. - Lali, ky është ai shoku për të cilin të kam folur.

- Çao Albi! - përshëndeti Sandri duke kthyer paksa kokën. - Ç'kemi?

- Hiç, - ia bëri tjetri i hutuar.

Sandri vështroi njëherë nga Keko që ishte ulur përbri tij.

- Po hë, si dolët sot?

- Grenxë fare, - ia ktheu ai.

- A doni t'ju bëj një shetitje para darkës së Vitit të Ri?

- Ou!Jepi! - thirrën zerot me qejf duke vështruar nga xhamat e veshur me avull.

Vetura i ra njëherë nga kreu në fund bulevardit kryesor, pastaj mori Unazën, drejt lagjes së Kekos, Redit e Sajmirit. Ndali mbi një trotuar gjysmë të shkatërruar dhe djemtë i dorëzuan të hollat Kekos. Ndërsa ai filloi t'i numëronte, ata zbritën.

- Lëri, ç'm'i numëron! - ia bëri Sandri. - Kam besim te ty. Mbaj pjesën e fitimit dhe të tjerat plasi këtu në xhepin e xhaka-ventos sime.

Keko numëroi me shkathtësi një tufë me monedha.

- Po ky shoku i ri, si të duket? - pyeti Sandri. - A mund t'i zihet besë?

- Them se po, - u përgjigj Keko.

- I pëlqen leku?

- E kujt nuk i pëlqen leku?

- Mund ta fusësh në grup?

- Të shoh. Nuk i dihet si ecën.

- Dëgjo, unë nuk dua të na hapi ndonjë telash me policinë!

- Për këtë mos ki merak. Do ta provoj mirë.

Sandri nxori një kuletë, mori aty një kartmonedhë pesëqind-lekëshe dhe ia zgjati Kekos miqësisht.

- Merri këto me rastin e Vitit të Ri. Janë vetëm për ty.

Tjetri falenderoi dhe u mat të dilte.

- Dëgjo, atë shtëpinë që të kam porositur, vazhdon ta përgjosh? - pyeti Sandri.

- Po.

- Kur ta ha mendja se mund të hyhet më kollaj?

- Paradite.

- Atëhere, prit fjalën time. Ik tani!

Keko doli nga vetura me një pamje të kënaqur.

- Sonte do të bëhem djalë i mbarë, - tha. - Do të blej ca gjëra të mira për shtëpinë. Kush do të vijë me mua?

- Unë, - tha Redi.

- Sajmë? Albi?

Por ata të dy vendosën të ktheheshin nëpër shtëpia.

- Atëhere, ia kalofshi gëzuar! - tha Keko.

Albi përshëndeti dhe u nis drejt shtëpisë. Në njërin xhep i tringëllin monedhat e fituara. U kujtua papritur për gjyshen dhe hyri në një tregtare që ende ishte hapur. Bleu një palë çorape të zeza.

Gjyshja mori frymë e lehtësuar kur e pa.

- Hë more bir, nga ishe? - pyeti duke e puthur në të dyja faqet.

- Ja, bëra një xhiro, - tha ai. - Me falni që u vonova. Nëna, po këtu nuk vika fare era Vit i Ri. A do të na bësh ndonjë gjë të mirë për të ngrënë?

- Do të bëj nëna ç'të duash ti. Ja, kam edhe çupat që do të më ndihmojnë.

Ndonëse e mundonte shumë këmba, gjyshja u mor me gatimet. U ulën në tavolinë herët, duke e ndjerë të gjithë mungesën e nënës.

- Mos ardh të më kurrë vit si ky! - tha gjyshja.

- Vit i mallkuar, - e pasoi babai.

Ai ndenji shumë pak në tavolinë. Hëngri diçka, piu një cigare jashtë në verandë, pastaj shkoi të flinte. Gjyshja po ashtu u hoq mënjanë dhe filloi të qante. Alda u mundua të krijonte në tavolinë një çikë atmosferë të gëzuar për fëmijët. U tregoi se si e festonin vitin e ri në Indi dhe në Kinë.

- Unë po dal të shoh fishekzjarret, - tha Meri kur ora shënoi

12 pa 5.

Ajo hodhi një pulovër supeve dhe qëndroi te parmaku i verandës me fytyrën kthyer në drejtimin nga binte pallati i Sidit. Ishte një natë e kthjellët. Alda dhe Albi dolën aty pas pak. Papritur, diku lart, u dëgjua një kërcitje dhe pas saj një mori shkëndijash ngjyra-ngjyra u përhapën në formën e një këpurde. Ndriçimi i tyre zgjati për disa sekonda. Meri i ndoqi ato shkëndija me sy, e lumturuar, deri sa u shua edhe dritëza e fundit.

- Po ky budalla që i shkon ora para, ç'ishte? - tha Albi.

Ajo uli kokën dhe filloi të qeshte.

*

*

*

Ai fillim i vitit 1996 solli në shtëpi një periudhë tjetër qetësie. Babai në të vërtetë vazhdonte të pinte, por rrallë nëpër lokale. Mbrëmjeve ulej vetëm në një cep të kuzhinës dhe zbrazte disa gota deri sa e merrte dremia nga lodhja e ditës. Kishte gjetur një punë të rregullt. Dilte nga shtëpia në mëngjes herët dhe kthehej në të errur. Albi nuk i shpëtonte më dot kontrollit të tij. Nuk ia mbante të kthehej më vonë. Pas mësimit Meri nuk e lejonte të sorollatej rrugëve me djemtë e grupit Zero në Kub. E priste në oborr të shkollës dhe ktheheshin në shtëpi bashkë. Pasi hanin drekë, uleshin në tavolinë po bashkë për të bërë detyrat e për të mësuar.

Por edhe ajo qetësi nuk zgjati shumë. Shkak u bë një sherr që plasi një mbrëmje mes babait dhe hallë Donikës e burrit të saj. Ishte një problem që Meri nuk e kuptonte fort mirë. Bëhej fjalë për shtëpinë e tyre. Me sa dukej burri i hallës kërkonte ta blente atë, ta rrafshonte të tërën për toke dhe aty të ndërtonte një vilë të madhe. Merit i qe ngulitur mirë në mendje një ditë kur halla kishte ardhur në shtëpi së bashku me të shoqin dhe një inxhinier ndërtimi. Babai nuk ndodhej aty. Inxhinieri kishte bërë disa matje ndërkohë që diskutonte me burrin e hallës për punë ndërtimi...

Ditën e sherrit ajo ndjeu frikë kur filluan të përmendeshin milionat.

- Bashkim, ti je hallelxi, - iu drejtua burri i hallës babait. - Kështu erdhi jeta. Ke nevojë për para. Ne të japim një apartament të mirë me dy dhoma e kuzhinë dhe 10 milionë lekë në dorë që t'i kesh për çdo rast.

Babai nënqeshi.

- Dhe çfarë kërkoni nga unë?

- Shtëpinë. Edhe jot motër është rritur këtu. Apo jo?

Halla nuk i ngrinte sytë.

- Ti pandeh se mund të më gënjesh me ato para të qelbura, të fituara me kontrabandë? - u nxeh babai. - Pse ty dhe sime motre nuk ju shkon mendja të ndërtojme këtu diçka së bashku, por kërkoni të më hiqni qafe? Këtu ka vend për shtëpi, magazina e dyqane. Jam unë, është edhe motra tjetër. Apo juve nuk ju duhemi ne fukarenjtë? Pse kini para, pandehni se mund të zhvatni gjithçka për vete? Dijeni se planet tuaja janë të neveritshme. Edhe mënyra se si veproni është e neveritshme.

Edhe burri i hallës u nxeh.

- Ne s'po të heqim qafe, kemi plane të pastra. Po të japim para më duket. Apo harrove se je mbytur në borxhe? Me 10 milionë mund të nisësh një biznes.

Babai tundi kokën vrullshëm.

- Unë s'i kam borxh askujt. Dëgjove? Edhe në se kam, ky është problemi im. Unë mbeta i varfër sepse nuk bëra pislleqe si puna jote.

- Bashkim, mos përdor me mua këtë gjuhë!

- Ti këtë gjuhë meriton. Dhe tani ta mbyllim këtë histori. Unë nuk kam shtëpi për të shitur. Do të rri këtu deri sa të më zërë çatia përfund.

Tjetri vështoi njëherë nga e shoqja.

- Jot motër mund t'i drejtohet edhe gjykatës, - tha. - Kjo shtëpi nuk është vetëm jotja. Dhe ta dish se ne mund të fitojmë çdo lloj gjyqi. Ti je i mbaruar. Nuk ke para as për avokat.

Babai u ngrit në këmbë dhe iu afrua së motrës.

- Janë të vërteta këto që thotë yt shoq?

- Ne... ne po mëndojmë për mirë, - mëmëriti ajo.

- Është e vërtetë që ti do të më hedhësh në gjyq për këtë shtëpi?

- Unë do të bëj atë që thotë im shoq.

- Ah, të lumtë motër e dashur! Ti e di shumë mirë se kjo shtëpi me dokumente ligjore më takon mua dhe përsëri e ke mendjen te gjyqi. Te ai gjyq që doni ta fitoni me para. Atëhere, shporruni të dy! Nuk dua t'ju shoh më këtu!

Halla u mundua të thoshte diçka, por babai i tregoi derën.

- Jashtë! Nuk dua të dëgjoj më asgjë. Shkoni ne gjykatë, polici, ku të doni!

Merit po i mbahej fryma. Iu afrua të atit dhe e kapi për krahu.

- Ba, të lutem, qetësohu!

Burri i hallës bëri për nga dera turilëshuar.

- Nuk mund të presësh sjellje tjetër nga një pijanec, - tha me përçmim.

- Më mirë pijanec se sa mashtrues e kontrabandist si puna jote, - ia ktheu Bashkimi.

Meri vështroi nga burri i hallës e prekur. Për herë të parë ai iu duk vërtet njeri i keq.

- Mos guxoni t'i thoni babit tim pijanec! - iu drejtua.

Tjetri bëri një gjest mospërfilljeje dhe doli me hapa të mëdhenj.

- Do të shihemi Bashkim Gjoka! - thirri. - Do të jesh ti ai që do të më lutesh e të më biesh në gjunjë.

- Kurrë! - ia ktheu babai.

Halla i shkoi të shoqit pas me një bindje të heshtur.

- Bashkim, e ke gabim, - tha para se të dilte nga porta. - Ne duam të të ndihmojmë se je ngushtë.

- Nuk më duhet një motër që kërkon të më blejë me para, - ia ktheu i vëllai ftoht.

Ai u ul në verandë dhe ndezi një cigare. Filloi ta pinte atë me duf. Meri vuri re se duart i dridheshin. Në fytyrë i kishte mbetur e fiksuar pamja e e një zhgënjimi të thellë.

- E prisja këtë, - ofshau. - E kisha nuhatur se do të ma punonin kështu. Mund të më shkatërrojnë edhe me anë të gjyqit. Meri, bija ime, ka ardhur koha t'i njohësh edhe ti njerëzit. Janë bërë të poshtër. E kanë mendjen vetëm te paraja. Kërkojnë-vetëm të mashtrojnë e të përfitojnë për vete. Qoftë edhe në kurriz të njeriut më të afërt. Kjo më neverit. Nuk mundem ta duroj dot.

Meri vështroi me dhimbje profilin e hequr të fytyrës së tij.

- Ba, mos u mërzit kështu. Ka edhe njerëz të mirë.

- Si the? Ka njerëz të mirë? Po ku janë këta njerëz të mirë? -
pyeti i ati gati me dëshpërim. - Të lutem, m'i trego ku janë!

- Janë rrotull nesh.

- Ashtu?! Mbase. Atëhere ka të ngjarë të mos jem në rregull
unë.

Pas asaj dite ai filloi të kthehej përsëri në shtëpi vonë në
mbrëmje e pothuaj i dehur. Nuk pyeste për asgjë. Thoshte vetëm
një "natën e mirë" dhe shkonte të flinte. Ndonëse në mëngjes
dilte herët, nuk kuptohej a shkonte në punë apo jo. Shumë shpejt
Meri mbeti pa lekë për të blerë gjërat më të nevojshme. U detyrua
t'i kthehej listës te ushqimorja. I vinte keq të shkonte të shqetë-
sonte gjyshen e sëmurë.

Albi përfitoi pa vonesë nga hurabja e kontrollit. Filloi të shoqë-
rohej përsëri rregullisht me djemtë e grupit Zero në Kub. Largo-
hej nga shkolla, mbrëmjeve kthehej vonë. Meri nuk po dinte si
ta mbante brenda. I vëllai zhdukej fshehurazi. Një pasdreke,
kur ajo e uli në tavolinë duke e kapur për krahu, ai u rebelua
fare hapur.

- Mos më rri si polic te koka se nuk dua të mësoj! - thirri. -
Do të dal jashtë.

Meri i preu rrugën.

- Nuk do të dalësh!

Atëhere ai e shtyu. E motra u hap anash e trembur.

- Albi... dëgjo... ti... kthehu se do t'i them babit!

- Thuaji ç'të duash!

Ndërsa ai doli, asaj iu duk vetja plotësisht e pafuqishme. Si
gjithmonë në të atilla raste, qau për pak minuta, pastaj u mundua
të mblidhte veten e të vazhdonte punët e zakon-shme. U detyrua
ta linte Norën vetëm ndërkohë që ndodhej duke punuar te teta
Bardha. Shpresoi se i vëllai do të kthehej para saj.

Por kur hyri në shtëpi e gjeti të motrën pështetur mbi librin
e Matematikës. E kishte zënë gjumi. Meri e mori në krahë dhe e
çoi në krevat. Albi ia mbërriti më vonë se zakonisht. Tundte
sipër kokës një shall dhe këndonte nëpër dhëmbë një këngë të
Eros Ramazotit. Xhakaventon e kishte mbërthyer shtrembër. Sytë
i kishte të përgjumur. Disa herë u lëkund. Merin e tmerroi ajo

pamje.

- Albi... ke pirë? - ia bëri duke u tërhequr mbrapsht.

- E, pimë një birrë, - tha ai.

- Ti ke pirë në lokal?!

- Në fakt, ishte jashtë lokalit. Pse, ça ka për t'u habitur këtu? Si thotë Eros Ramazoti, janë gjëra që i ka jeta, ndodhin midis nesh. Birrë ishte o Meri dhe ti, s'ishte drogë.

- Po a e di se ç'vjen pas asaj birrës?

- Vjen çici, - ia bëri Albi duke qeshur. - Meri, do të dëgjosh një të fortë me zyshën e Historisë? E kapi sot Blendin që kam unë në klasë duke pirë sprajt në orë të mësimit. Ore Blendi, u fryve duke pirë sprajt e koka-kola, i tha. Pandeh se duke pirë ato lëtyra do të bëhesh më i zgjuar? Apo më i shëndetshëm? Ne në kohën tonë pinim vetëm ujë dhe u rritëm bukuri. Zysh, problemi është se në pallatin tim ka dy vjet që nuk vjen ujë, ia ktheu Blendi. E fortë, ë?

Meri e kuptoi se ishte e kotë të lodhte frymën.

- Albi, bën mirë të flesh, - tha.

- Të fle? Siurdhëron zonja togere!

- Në fillim ndërrohu! Vish pizhamat!

- Ah, po! Pizhama! Ku jeni? Pi-zha-ma!

- Je bërë tamam palaço, - ajo i ktheu kurrizin. Po rrinte tërë frikë se mos në ato çaste kthehej i ati dhe e gjente Albin në atë gjendje. Por për fat, kur babai hyri në shtëpi, vëllanë e kishte zënë gjumi. Meri ishte ulur pranë sobës që vazhonte të lëshonte nxehtësinë e fundit. Kishte hapur mbi gjunjë librin e Fizikës. U ngrit dhe qëndroi pranë tavolinës. I ati përshëndeti me gjysmë zëri.

- Po Albi, ku është? - pyeti papritur.

- Fjeti, -iu përgjigj e bija.

- Me se është marrë sot?

Merit ia mbajtën dhëmbët fjalët " Edhe ai ka filluar të pijë".

- Është marrë me mësimit, - tha me sytë përdhe.

- E di mirë? - këmbënguli babai.

- Po. Ishim bashkë.

Ai u ul të hante dhe nuk foli më.

10.

Marrëdhëniet e Albit me babanë u ftohën pothuaj plotësisht kur një pasdite ai e gjeti të birin duke luajtur me letra me djemtë e grupit Zero në një qoshe të oborrit të shkollës. E kishte pritur gjatë në shtëpi, por, që pasi kishte ngrënë drekë, Albi ishte zhdukur pa lënë gjurmë. Atëhere babai kishte dalë ta kërkonte. Atë ditë ishte shumë i mërzhitur. S' duhej ta kishte lënë të dilte, i kishte thënë Merit. Ai nuk më pyet më, ia kishte kthyer ajo, duke mos mundur ta mbante më të ndrydhur më gjatë të vërtetën...

Albi ngriu me letrat në duar kur pa të atin. Mbi gazetën ku po luanin ishin shpërndarë disa qindra lekë në monedha. Djemtë e tjerë ngritën sytë me indiferentizëm.

- Pra, po luani bixhoz, - tha babai duke nënqeshur. - Ju lumtë! Kini tamam moshë për të tilla punë!

Askush nuk i ktheu përgjigje.

- Albi, eja me mua! Dëgjoni ju të tjerët, me tim bir nuk dua t'ju shoh më!

- Ça ke mor vëlla?! - ia bëri Redi. - Ne s'e morëm djalin tënd me zor. Erdhi vetë.

Albi qëndroi para të atit kokulur. Ai e mbërtheu për krahu dhe e tërhoqi pas vetes.

- Unë të paralajmërova se nuk dua të të shoh më rrugëve, - i tha sapo hynë në shtëpi. - Ti jo vetëm që ikën pa lejen e motrës, por më luan edhe bixhoz!

- Të luash me letra nuk është e ndaluar, - foli Albi. - Tirana është e mbushur me bingo dhe bilardo.

- Për ty është e ndaluar! - thirri babai. - Ti duhet të ishe këtu, duke bërë mësimet.

- A hu! Mesimet, mësimet! - djali bëri një gjest mospërfilljeje.

- Pse, vetëm mësimet qenka jeta?

Pas atyre fjalëve një shpullë e fortë e të atit ia çoi kokën anash.

- Jeta është mësimet dhe punë!

Meri mbeti e shtangur nga ajo skenë. Babai kurrë nuk kishte

vënë dorë mbi ta. Vetëm njëherë, para nja dy vjetësh, ia kishte skuqur Albi veshët pasi ai kishte përplasur me biçikletë një plakë dhe e kishte rrëzuar për tokë. Albi gjithashtu nuk po e mblidhte dot veten pas goditjes. Sytë i shndritën nga një inat i vjetër.

- Ti nuk je baba për të më edukuar mua! - thirri. - Shiko njëherë atë rakinë dhe ato borxhet e tua.

- Si?! Ti guxon të flasësh me mua me këtë gjuhë?! Rruçaç!

Babai e mbërtheu Albin për krahu dhe e goditi rishtazi me shpullë. Kur ngriti dorën për herën e tretë, Meri u fut mes tyre duke thirrur e trembur:

- Babi, të lutem, mos!

I ati ngriu me krahun në ajër. Albi i shpëtoi nga dora tjetër dhe vrapoi jashtë. Meri nxitoi pas tij.

- Albi, kthehu! - i thirri. - Të lutem!

- S'dua! Nuk rrihet më në atë shtëpi! Nuk kthehem më!

Meri u pështet te porta dhe e ndoqi me sy deri sa ai humbi në kthesën e rrugës. Kur u kthye brenda, e gjeti të atin në korridor duke tymosur i tronditur një cigare.

- Ku shkoi? - pyeti ai.

- Mesiguri nga gjyshja. Ba, nuk duhej ta kishe goditur.

- Nuk doja, - psherëtiu ai, - por ti e pe çfarë gjuhe përdori.

Ata nuk folën më. Mendonin të dy të njëjtën gjë.

Vonë në mbrëmje, në shtëpi ia mbërriti gjyshja, tepër e shqetësuar. I mbahej fryma. Në dorën e djathtë shtërngonte një shkop ku mbështetej herë pas here. Nuk përshëndeti. I qëndroi babait përballë duke e vështruar me një qortim fare të hapur.

- Hë, fillove edhe t'i rrahësh tani? - ia bëri.

Babai u mundua ta përmbante veten.

- Nëna, ishte vetëm një shpullë, - ndërhyri Meri. - Albi kishte faj.

- Kishte faj?! E pastaj, yt atë duhet t'i japë arratinë duke e rrahur? Qante djali me kokrrën e lotit.

- E morëm vesh, - tha babai. - U bë tani.

- Unë nuk dua të përsëritet më! Të lutem shumë fëmijët mos i rrih sepse ata nuk të kanë asnjë faj. I gjithë faji është yti. Se po të ishte ti në rregull, s'do të ndodhnin të gjitha këto. E pale se ç'mund të na ndodhë nesër!

Babai u nxeh papritur.

- Mos më lodh kokën! - thirri. - Më ler në hallin tim!

- Ashtu? - ia bëri gjyshja e prekur. - Të falemnderit! Dije se këta fëmijë janë halli im dhe jo yti.

- Të lutem, po ta përsëris: te fëmijët mos ndërhy!

- Unë do të ndërhyj sepse ti je i pazoti t'i edukosh. Nuk mundesh t'i edukosh me atë ves që ke.

- Unë nuk kam asnjë ves! - thirri babai edhe më fort.

Meri kapërthente gishtat e duarve e shqetësuar. Nuk po dinte si t'i qetësonte ata të dy.

- Ti ke një ves nga i cili duhet të heqësh dorë menjëherë! - vazhdoi gjyshja.

- Edhe ti hiq dorë nga ky ves për të bezdisur të tjerët!

- U bezdise zotrote?

- U bezdisa dhe shumë bile!

Gjyshja ktheu kurrizin me lëvizje të ngathta.

- Bashkim, bën mirë t'i vësh gishtin kokës se nga fjalët e mia nuk të vjen ndonjë e keqe, - tha duke dalë e prekur.

Meri e shoqëroi gjyshen një copë rrugë. Kur u kthye, nuk shkëmbeu me të atin asnjë fjalë. Vetëm të nesërmen, ndërsa ajo po bënte gati mëngjesin, babai tha papritur me sytë ulur:

- Meri, të kërkoj falje që u solla dje ashtu me gjyshen tënde. Ajo është njeri i mirë.

E bija iu afrua dhe i vuri dorën në sup.

- Ba, nëna nuk mban inat, - tha duke u munduar ta qetësonte.

- Jo, - psherëtiu ai, - nuk besoj se është aq e lehtë. Edhe Albit ia kam shumë frikën. Nuk di si do të veprojmë me të.

- Mundohu ta mbash afër si ato ditë kur rregulluat ato veturat.

- Më duket se ai nuk më beson më.

- Ba, ne të besojmë të dy. Mos dysho për këtë!

I ati filloi të hante i menduar.

Mëria e Albit ndaj tij zgjati disa ditë. Më në fund Meri e bindi të vëllanë të kthehej në shtëpi.

- Po vij vetëm për hatrin tënd, - tha ai i lëkundur.

Ajo i hodhi krahun dhe e afroi nga vetja.

Ai u përshëndet ftoht me të atin, pa e vështruar. Babai u soll sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Nuk i foli e nuk kërkoi llogari

për ato ditë që kishte munguar në shtëpi. Por hende-kun që ishte krijuar mes tyre filloi ta vuante Meri. Nuk ndjehej kurrë e qetë. Nuk përqëndrohej dot në mësim. Frika se mos Albi bënte ndonjë faj të rëndë, iu kthye në një ankth të përhershëm, ashtu si edhe merakë se mos babai kthehej mbrëmjeve i pirë apo i mërztur.

Lodhjen dhe hutimin vazhdonte ta pasqyronte rregullisht në shkollë. Me rënien e saj në mësim tashmë ishin pajtuar të gjithë, përveç Sidit dhe mësueses kujdestare që këmbë-ngulnin më kot se ajo duhej të merrte përsëri nënta e dhjeta. Kishte raste që Sidi bëhej nervoz nga mospërfillja e saj për notat. Ata filluan të qëndronin gjithmonë e më pak së bashku. I afronte vetëm banka. Në kohën e lirë po harroheshin pothuaj të gjitha. Edhe një të shtunë që e lanë të dilnin shetitje me biçikleta me një grup vajzash e djemsh të klasës, Meri nuk mundi të shkonte dot. Ndodhi që babait i erdhi te porta një shok me një veturë të vjetër që dukej sikur kishte përshkuar pa u ndalur gjithë rrugët më shkatërtaqe të botës.

- Ku është Albi? - pyeti babai duke vështruar rrotull.

Por ai kishte dalë. Meri e kërkoi më kot nëpër lagje dhe nga oborri i shkollës.

- Dikush duhet të më ndihmojë, - i tha i ati.

Meri vështroi orën. Për pesë minuta duhej të ndodhej në vendin ku grupi i djemve dhe vajzave e kishin lënë të takoheshin. Megjithatë, u përgjigj qetësisht:

- Jam unë ba.

Nxitoi te telefoni dhe formoi numrin e Sidit. Por me sa dukej ai ishte nisur. Iu përgjigj e ëma.

- Ah, Meri, - ia bëri ajo me një ton të çuditshëm. Asgjë më tepër. As përshëndetje e as pyetje si më parë.

- Desha Sidin, - foli vajza e hutuar.

- Sidi doli.

- Ju... ju falemnderit! Ditën... e mirë!

Meri nuk e mbledhi dot veten tërë pasditen. Ndërsa ndihmonte të atin, duart i dridheshin. Babai e vuri re që ajo ishte e shpërqëndruar.

- Meri, mos bëra gabim që të mbajta këtu? - foli si fajtor. - Kishe ndonjë plan tjetër?

Ajo u mundua të buzëqeshte.

- Jo ba, s'bëre gabim. Para kësaj veture asnjë plan nuk ka vlerë.

- Të falemnderit për këto fjalë!

Ajo priti gjatë deri sa Sidi i telefonoi.

- Meri, pse nuk erdhe? - pyeti ai i mërzhitur. - Sa herë organizojmë ndonjë gjë dhe ti nuk vjen, më ngrihen nervat.

- Pse, ti pandeh se mua nuk më ngrihen nervat?

- Meri, e sa do të vazhdojë kështu?

Ajo u prek nga ato fjalë.

- Sid, ti i di hallet e mia, - tha. - Në se je mërzhitur...

- Nuk është se jam mërzhitur, por më duket se ti nuk do të gjesh kurrë kohë të rrish me mua.

- Të premtuj se do të gjej!

Por ai premtim e vuri në pozitë edhe më të vështirë. Që në fillim të javës tjetër Sidi e njoftoi se të dielën ekipi i tij kishte një ndeshje finale. Ishte fjala për një kampionat të vogël kushtuar figurës së shquar të një basketbollisti shqiptar. "Të pamposhturit" do të ndesheshin me "Tigrat e Tiranës së Re", një ekip i kategorisë së të rinjve që shquhej për teknikë dhe gjuajtje në distancë. Sidi e kishte marrë tepër seriozisht atë ndeshje. Një nga shokët e ekipit të tij ishte sëmurë dhe trajneri i kishte thënë se pesha kryesore e takimit do të binte mbi të.

Atë të dielë marsi Meri i kërkoi Albit të shkonin bashkë për të parë ndeshjen, por ai nuk pranoi. Ajo vendosi të shkonte vetëm, por tamam kur po bëhej gati të dilte nga shtëpia, ra zilja e telefonit. Ishte Alda, vajza e tezes. Meri, ejani shpejt, foli ajo e trembur. Gjyshja është rëndë. U rrëzua dhe humbi ndjenjat.

Meri njoftoi të atin dhe të vëllanë. U nisën të tre me ngut. Kur mbërritën te shtëpia e gjyshes, derën e gjetën mbyllur. Atë e kishin çuar në spital. U detyruan të shkonin atje. Një mjek i drejtoi për te reparti i reanimacionit. Gjetën Aldën duke pritur pranë një dëre. Ajo buzëqeshi e lehtësuar.

- Është më mirë, - tha. - Fola me një mjek.

Gjyshen e nxorën nga njëra prej sallave të reanimacionit pas ndonjë gjysmë ore. Dy infermiere e çuan me një shtrat të lëvizshëm në një dhomë ku pacientët me sa dukej qëndronin përko-

hësisht.

- Nga dreka mund ta çoni në shtëpi, - tha njëra prej tyre.

Albi u afrua i pari pranë gjyshes dhe e puthi.

- Këtë herë pata fat, - psherëtiu ajo, - por herën tjetër Zoti nuk do të më falë më.

Meri u ul në një stol dhe e mori dorën e zbehtë të gjyshes në duart e saja. Vetëm atëhere i shkuan sytë te ora dhe u kujtua se duhej të kishte filluar pjesa e dytë mes "Të pamposhturve" dhe "Tigrave të Tiranës së Re". Më fal Sid, tha me vete. Unë doja të vija. Doja shumë.

*

* * *

Nuk do të vijë, mendoi ai duke vështruar nga krahu i shikuesve. Mes grupit të vogël të djemve dhe vajzave të klasës që po e ndiqnin ndeshjen që nga fillimi, nuk kishte asnjë ndryshim. Meri mungonte.

- Arbana, përqëndrohu! - thirri trajneri. - Kërkoje topin! Forca! Shko poshtë tabelës!

Sidi u fut mes kundërshtarëve dhe zgjati duart për të kapur një top të gjuajtur nga njëri prej shokëve të tij, që përfundoi në hekur. Arriti ta kapte atë. Por në çastin që ra në tokë, njëri nga mbrojtësit e "Tigrave" ia rrëmbeu topin nga duart me një ndërhyrje grabitqare. Sidi vështroi nga arbitri për të kërkuar ndërhyrje të gabuar, por tjetri bëri shenjë që loja të vazhdonte. Tifozët e "Tigrave" filluan të thërrisnin edhe më fort. Ekipi i tyre ishte shkëputur 8 pikë dhe pas atij topi të rrëmbyer Sidit, shkëputja arriti në 10.

Trajneri i "Të pamposhturve" kërkoi pushim. Sidi u afrua pranë tij i pasigurtë.

- Arbana, nuk e kuptoj, ç'ke kështu sot?! - ia bëri trajneri duke hapur krahët me një gjest habie. - Pse duhet të hutohesh xhanëm?! Këtë ekip e kemi mundur gjithmonë. Dua vetëm saktësi dhe vëmendje. Hajde, 10 pikë nuk janë asgjë. Kemi kohë ta përmbysim rezultatit. Unë kam shumë besim te ju. Arbana, dua një 3-pikësh nga ty në aksionin më të parë. Shkoni!

Djemtë e ekipit përplasën duart për t'i dhënë zemër njëritjetrit dhe u kthyen në fushë. Pas një gabimi të kundërshtarit topi ra në duart e tyre. Organizatori e vërviti atë pa vonesë në drejtim të Sidit. Ai iu shmang njërit prej tigrave, pastaj u ngrit dhe gjuajti në distancë. Por në çastin e fundit dora iu drodh. **Nuk ndjente siguri.** Topi përfundoi nën kosh. Tifozët lëshuan në kor një pasthirmë zhgënjimi.

Pas pak trajneri u detyrua ta nxirrte Sidin në stol, gjë që ndodhte rrallë.

- Mundohu të qetësohesh, - i foli. - Ndodhin edhe këto.

Sidi veshi një bluzë, pastaj fshiu fytyrën me peshqir, të cilin e hodhi rreth qafës. Ndjeu një dorë në sup.

- Të kërkojnë, - i tha njëri prej lojtarëve rezervë, duke treguar me dorë nga shikuesit. Sidi u kthye andej dhe pa të atin. Ai i buzëqeshi.

- Sid, ke lojë akoma, - thirri sikur donte t'i thoshte se nuk kishte ndodhur asgjë. - Kërkoji trajnerit të të fusë prapë.

Djali bëri një shenjë me dorë për ta falenderuar për kurajon që po i jepte. Për disa minuta nuk e ndoqi ndeshjen fare. U mundua ta harronte Merin. E mbërtheu inati me sjelljen e saj. Mungesa në atë finale iu duk e qëllimshme. Si mund të tregojë ajo aq e pavëmendshme ndaj tij? Ai nuk e meritonte aspak atë sjellje. Më në fund Meri e kishte tepëruar.

Sapo u dha pushimi i radhës, Sidi i kërkoi trajnerit që ta fuste përsëri në lojë. Tjetri pranoi në mëdyshje.

- Arbana, më duhen pikë, - tha i nervozuar. - Vetëm pikë. Për të shënuar, Sidi vendosi të ndiqte taktikën e luftës në zonën e kundërshtarit. Ajo taktikë jepte vetëm 2 pikë, por ishte më e sigurtë se sa gjuajtjet në distancë. Pas një kalimi të vështirë mes mbrojtësve, ai arriti më në fund të shënonte. Tifozët u gjallëruan disi. U desh edhe një kosh tjetër nga një pozicion shumë i vështirë që ata të fillonin të thërrisnin:

- Sidi! Sidi! Duam fitore!

Por megjithë përmbysjen e lojës, fitorja nuk u arrit dot. "Tigrat" arritën ta merrnin ndeshjen me katër pikë diferencë. Sidi u largua nga fusha gati-gati me një ndjenjë faji për atë humbje. Trajneri u mundua ta qetësonte. I ati po ashtu. Kur u ngjiten në

veturë për t'u kthyer në shtëpi, ai qeshi njëherë, pastaj i ra të birit miqësisht supeve, duke thënë:

- Unë e di pse luajte dobët.

Sidi e vështrroi në mënyrë pyetëse.

- Sepse nuk ishte Meri.

Djali u skuq.

- Ba, janë ca ndeshje nganjëherë, që kur marrin ters...

- E di, - ia bëri tjetri. - Kjo ndodh edhe me operacionet në mjeksi. Harroje tani atë ndeshje. Në sport ka edhe humbje. Është normale. Kudo në jetë ka humbje dhe njeriu duhet të mësohet me to.

Ata hynë në shtëpi në heshtje. Nëna zgjati kokën që nga kuzhina si me dyshim.

- Humbëm, - tha babai. - S'bëhet shaka me tigrat.

- E dija që ekipi i Sidit do të humbte, - tha Elona papritur.

Ata të dy ngritën sytë.

- E nga e dije? - pyeti Ariani me kureshtje.

- Ma mori mendja se Sidi do të luante dobët.

- E pse do të luaja dobët? - pyeti djali.

- Sepse ke ditë që nuk je i qetë. Bile ka raste që je i nervozuar.

- Nuk është e vërtetë! - kundërshtoi i biri me ngut.

- Po, është e vërtetë. Ndoshta nuk e ke vënë re ti, por e kam konstatuar unë.

- Ma, e ç'lidhje ka qetësia apo nervozizmi im me ndeshjen?

- Ka dhe shumë bile. Që të shkëlqesh në një ndeshje, duhet të jesh i qetë shpirtërisht. Apo jo Ariani?

- Argumenti qëndron, - e mbështeti i shoqi.

- Ma, unë isha i qetë shpirtërisht, - këmbënguli Sidi. - Por topi është top dhe kur nuk do të hyjë në kosh, nuk do.

- Mbase është ashtu. Megjithatë, ti ke një problem që nuk pranon të na e tregosh.

- Unë nuk kam asnjë problem!

- Sid, të lutem mos gënje veten!

- Ma, unë po vij nga një ndeshje e humbur. Të lutem, ç'kërkon?

- Dua të di shkaku pse ti je i mërzitur këto kohët e fundit.

Në të vërtetë dua të ma thuash ti, sepse unë e di shumë mirë.

I biri nuk pati guxim t'i ngrinte sytë drejt saj.

- Pa ta dëgjojmë, - tha Ariani.

- Shkaku janë marrëdhëniet me Merin. Djali ynë po vuan pasojat e problemeve që Meri ka në familjen e saj. Kjo është e gjitha.

- Fantastike! - ia bëri babai. - Ju femrat i zbuloni problemet e të tjerëve me nuhatje, sikur të jenë gjellë që zien mbi sobë.

- Jo vetëm me nuhatje, - këmbënguli ajo. - Unë jam interesuar dhe i di të gjitha.

- Për shembull? - pyeti Sidi.

- Di që Meri ka rënë në mësim, që i ati i saj ka probleme me pijen, që ata fundja janë një familje pa perspektivë.

Ariani bëri një gjest kundërshtimi.

- E dashur, jetës nuk i dihet. Sidomos në Shqipëri!

- Arian, këto janë gjëra që duken dhe mua më vjen shumë keq që im bir nuk pranon të m'i thotë.

- Ai nuk është nga ata që pranon të ulë shoqen e vet të ngushtë para prindërve. Meri është për të më e mira dhe pikë.

- Unë nuk mendoj aspak kështu! - ia ktheu e shoqja e nervozuar.

- Rëndësi ka që mendon Sidi. Tani lëre viktimën e tigrave të bëj një dush dhe të shlodhet. Na jep edhe ne të tjerëve ndonjë gjë të mirë për të ngrënë.

Elona bëri një gjest dorëzimi.

- Unë mund ta mbyll këtë bisedë, por dijeni mirë se ajo do të hapet përsëri. Dhe shumë shpejt bile!

Sidi i qe mirënjohës të atit për atë zgjidhje të situatës. Është e kotë, mendoi. Mamit nuk mund t'i fshihet më asgjë. Ndërsa u ulën të hanin darkë, ai vazhdoi t'i shmangej vështrimit të saj. Babai e kishte harruar ndërkohë ç'kishin biseduar. Filloi të fliste për një seminar shkencor mjeksie që do të mbahej në Danimarkë dhe ku ai duhej të shkonte medoemos. Nëna e pyeti për datat e seminarit. Ah, shumë mirë, tha kur dëgjoji përgjigjen. Ti kthehesh dy ditë para se të nisem unë. Më duhet të shkoj në Hungari nga fundi i muajit.

Pas atij diskutimi udhëtimesh jashtë shtetit, ata filluan të flisnin për blerjen e një veture të re, për gjetjen me një çmim të leverdisshëm të një trualli ku pas disa vitesh të ndërtonin një vilë. Por Sidi nuk e kishte mendjen te ato që thuheshin. Mundo-

hej të gjente shkakun pse Meri nuk kishte ardhur në atë finale tersi. I dukej sikur telefoni do të binte nga njëri çast në tjetrin. E kapi inati përsëri dhe vendosi të mos përgjigjej. Por deri në mbrëmje vonë, nga Meri nuk pati asnjë telefonatë.

Të nesërmen, që në oborin e shkollës, ai i ndenji asaj gjithë turinj. I kaloi pranë dhe nuk e përshëndeti. Ndërkohë Meri po lexonte te kronikat sportive të gazetës "Tirana ekspres" ato që ishin shkruar në lidhje me ndeshjen mes "Të pamposhturve dhe "Tigrave të Tiranës së Re". Kronisti sportiv, një student i degës së gazetarisë, nuk kishte harruar të theksonte se një nga shkaqet e humbjes të "Të pamposhturve", ishte loja e dobët e Sidrit Arbanës, kapitenit të ekipit. Meri i ngriti sytë nga gazeta dhe u mat t'i fliste, por pamja e shokut e stepi.

Me t'u ulur në bankë, ajo e kuptoi se Sidi nuk kishte ndër mend të hapte gojë. Ata ndenjën tërë orën fare pranë, pa u vështruar, duke u munduar që asnjeri të mos e kalonte gjysmën e vet të bankës qoftë edhe me bërryl apo me libra e fletore. Ishte një situatë vërtet e sikletshme. Nuk kishte ndodhur kurrë më parë. Meri u mat disa herë të fliste, por nuk mundi. Sidi ishte pështetur mbi krahun e majtë, që binte mbi fundin e bankës dhe shtirej tepër i përqëndruar në mësim.

Ajo gjendje vazhdoi edhe orën e dytë. Meri filloi të bëhej nerveze. Nuk e kishte menduar se Sidi mund të sillej ashtu. Arriti të duronte edhe orën e tretë. Në fund të saj mori çantën, e hodhi supit dhe u nis për në shtëpi, pa i thënë askujt se ku po shkonte. Por ndërkohë që po kalonte portën e madhe të oborrit, u ndesh me mësuesen kujdestare.

- Meri, ç'ke kështu? - pyeti ajo. - Pse po largohesh?

Tjetra arriti ta kapte situatën pa vonesë.

- Kam gjyshen sëmurë, - u përgjigj. - Dje ishim në spital.

Mësuesja u mendua një hop.

- Kaq e domosdoshme është të lësh mësimin? - tha pastaj.

Meri la të kuptohej se nuk kishte ndër mend të kthehej më në klasë.

- Mirë, shko - ia bëri mësuesja me një lëkundje të dukshme.

- Meri... je e sigurtë që është vetëm shqetësimi i gjyshes?

Nxënësja pohoi me kokë.

- Atëhere, të shkuara!

11.

Meri po i afrohej shtëpisë kur dëgjoji një zë që e thirri. Ishte Klara. Kishte veshur një pallto në ngjyrë vishnjeje, të gjatë pothuaj deri te kyçet e këmbëve. Mbi jakën e saj kishte hedhur një shall të zi, i cili i varej deri te gjunjët. Nën pallto i dallohej një fund i shkurtër dhe një bluzë në formë U-je, tepër e hapur mbi gjoks. Në rrugën e përbaltur këpucët e saja me qafa, me tokëza metalike anash, nuk mund të mbroheshin dot nga ndotja dhe ai detaj e nervozonte Klarën dukshëm.

Ajo i bëri shenjë të afrohej dhe Meri shkoi. I ngacmoi hundën një aromë e këndshme e një parfumi të shtrenjtë me esencë trëndafili. U detyrua të buzëqeshte e hutuar. Klara kishte bërë një tualet të rënduar sikur të ishte 30 vjeçe. Flokët i shndrisnin nga xheli. Buzët i kishte lyer në ngjyrën e palltos dhe i kishte konturuar me laps të zi. Dukej më e madhe në moshë. Askush nuk do t'i jepte 15 vjet.

- Meri, ç'kemi? - pyeti tepër e kënaqur nga pamja e vet. - A po vjen me mua?

- Ku?

- Në një bar këtu afër. Pijmë nga një kapuçino dhe bisedojmë ca.

- Unë... në të vërtetë...

- Hajt, mos sajo gënjeshtër tani!

Meri u lëkund. Në shtëpi nuk i hyhej. E prisnin njëqind punë. Por edhe vajtja në bar nuk ishte gjë e lehtë. Sidomos me Klarën. Tjetra e nuhati mëdyshejn e saj.

- Meri, si është puna? - foli ftoht. - Nuk do të vish me mua?

- Jo... unë... thashë të çoja njëherë çantën brenda.

- Mirë, çoje një vrap.

Ato bënë një copë rrugë në këmbë duke u ruajtur nga gropat me ujë dhe trotualet e përbaltur ku po shtrin linja telefonike.

- Nuk guxon njeriu të dalë në këmbë! - shfryu Klara. - Të

shpifet.

Ndërkohë një veturë kaloi përbri me shpejtësi. Rrotat e saja hynë në një pellg dhe hodhën anash me dhjetra stërkala të ndotura. Një pjesë e tyre ranë mbi pallton e Klarës. Ajo klithi njëherë me inat, pastaj u kthye në drejtimin nga kishte ikur vetura duke mallkuar:

- Të raftë pika ishalla! Uf, ç'fat o Zot, ç'fat!

Klara shau e mallkoi edhe disa herë të tjera deri sa mbërritën në një bar me emrin "San Marino". Në atë vend mblidheshin kryesisht djem e vajza të reja, sidomos nga një gjimnaz aty pranë. Në lokal dëgjohej vetëm muzikë moderne. Ajrosja nuk ishte e bollshme dhe mbi tavolina davaritej një shtresë tymi duhani. Ndriçimi ishte i zbehtë dhe të krijonte idenë se ndodheshe në një diskotekë.

Meri provoi një lloj frike nga ai vend.

- Më mirë shkojmë në një lokal tjetër, - tha duke e kapur Klarën për krahu.

- Jo, këtu, se pres Gencin, - ia ktheu tjetra. - Pse skuqesh kështu? S'ke hyrë ndonjëherë në bar?

- Jo.

Klara qeshi dhe e tërhoqi për dore. U ulën në një tavolinë pranë derës. Klara përsëndeti disa vajza. Me sa kuptohej, ai vend ishte tepër i njohur për të. I ngriti dorën një kamarieri, porositi dy kapuçino, pastaj buzëqeshi e lehtësuar. Meri rrinte si e ngrirë, me duart mbi gjunjë. Ishte kthyer nga muri që të tjerët të mos e shihnin.

- Aman dhe ti, mos bëj kështu sikur vjen nga katundi, - tha Klara. - Mos e vrit shumë mendjen se nuk je më e vogël. Ma kalon edhe mua me trup.

Meri u mundua të buzëqeshte.

- Shiko këtu, - tha Klara duke treguar një varëse floriri që i shndriste në kraharor. - Të pëlqen?

- Shumë e bukur.

- Ma solli Genci nga Greqia.

- Kur u kthye?

- Ka pak ditë.

- Po tani... ç'do të bëni?

- Nga vera... uau! Në Athinë!

Meri ia nguli sytë e mekur.

- Po ti, ç'e kë këtë varëse të çuditshme? - pyeti Klara papritur.

- Janë guacka.

- Guacka?! Oh, Meri, më shkrive. Nuk është kohë guackash tani. Kam një varëse turke në shtëpi. Po të pëlqeu, ta jap.

- Jo, nuk më pëlqejnë gjërat e floririt, - tha Meri me ngut.

- Si të duash.

Ato kishin nja njëzet minuta që ishin ulur, kur para lokalit u ndal një veturë ngjyrë gri. Prej saj dolën dy djem të rinj.

- Ja, erdhi Genci, - tha Klara duke lëvizur vendit.

- Sikur unë... të shkoja, - mërmëriti Meri.

- Jo, do të të prezantoj me të. Edhe me Aldon, shokun e tij të ngushtë.

Djemtë u afruan te tavolina dhe përshëndetën. Genci u puth njëherë me Klarën, pastaj u kthye nga Meri.

- Eh, si rriten gocat e shkollës! - ia bëri duke buzëqeshur. - Meri, si je? Besoj më mban mend.

Tjetra pohoi me ndrojtje.

- Aldo, Meri është komshija ime, - tha Klara.

Vetëm kur Aldo u ul përballë saj dhe u dha njëherë sipër flokëve të gjatë që i binin pothuaj deri mbi supe, Meri e kujtoi. Ai kishte mbaruar klasën e tetë në shkollën e saj para tre vjetësh, së bashku me Gencin. Edhe atëherë mbante flokë të gjatë dhe shquhej mes shokëve për të kërcyer. Kur organizohej ndonjë mbrëmje, vajzat mbanin radhë për të kërcyer me të.

- Meri, më vjen keq, po unë nuk të mbaj mend, - tha. - Jam i gëzuar që u njohëm.

Ajo i buzëqeshi duke u skuqur.

- Unë të mbaj mend kur kërcjeje, - ia ktheu. - Njëherë bëre një rrotullim në ajër dhe të gjithë thirrën të trembur.

- Eh, të shkuara të harruara! - psherëtiu Aldo. - Tani nuk na bie më radha për të kërcyer. Punojmë andej nga Greqia. Lodhemi si kuaj.

Ndryshe nga Genci që të krijonte përshtypjen e një njeriu dinak e të gatshëm për ta zgjidhur çdo gjë me anë të grushteve, Aldo dukej një natyrë e butë. Fytyra e tij me tipare të ëmbla

rrezatonte një qetësi dhe një shprehje tepër paqësore.

Pasi ndenji edhe pak, Meri kërkoi leje të largohej.

- Sikur të pije edhe ndonjë gjë tjetër, - ndërhyri Aldo. - Mos ki ndrojtje nga ne.

Ai i kërkoi kamarierit të sillte lëng frutash dhe dy çokollata.

- Ju lutem, mos shpenzoni, - ndërhyri Meri.

Pas atyre fjalëve djemtë u vështruan njëherë, pastaj filluan të qeshnin.

- E kush pyet për lekë! - ia bëri Genci me mospërfillje.

Ndërkohë që ata të dy dhe Klara filluan të bisedonin për probleme që lidheshin me Greqinë, Meri filloi të ndjente siklet. Tymi i duhanit rreth e rrotull u bë mbytës. Në lokal hynin vazhdimisht njerëz dhe ajo vazhdonte të kishte merak se mos ndonjëri prej tyre e njihte. Papritur në tavolinën e tyre u afrua një djalë me pamje të dyshimtë. Duart i mbante në xhepat e një xhakaventoje të gjerë xhinsi.

- Çuna, ndonjë cigare nga ato, - foli duke vështruar nga Genci dhe Aldo. - Është mall i mirë.

Aldo tundi kokën në shenjë kundërshtimi. Tipi me xhakavento xhinsi u kthye nga një tavolinë tjetër. Disa djem që ishin ulur aty, filluan të nxirrnin nga xhepat lekët. I bashkuan ato të gjitha, i numëruan, pastaj ia dhanë tipit me xhakavento. Ai la diçka mbi tavolinë, gjysmë vjedhurazi.

- Tani unë po shkoj, - tha Meri duke u ngritur.

- Të të çoj me makinë? - pyeti Aldo.

- Jo, falemnderit! E kam shtëpinë afër. Ditën e mirë!

- Gjithë të mirat!

- Meri, falemnderit për shoqërinë! - tha Klara. - Do të shihemi.

Meri po dilte nga lokali kur Aldo, që e kishte ndjekur hap pas hapi me sy, tha me një pamje serioze:

- Klara, si mund ta takoj prapë këtë vajzë?

Tjetra qeshi.

- Të pëlqen, ë? Më mirë harroje.

- E pse? Është e zënë?

- Më duket se do një shok klase që luan basketboll.

- Genc, e dëgjove? Ne që nuk luajmë basketboll qenkemi koti.

Tjetri qeshi duke afruar te buzët një gotë birra.

- Ne i luajmë të gjitha llojet e sporteve.
- Klara, ç'vajzë është ajo Meri? - këmbënguli Aldo.
- Është nga ato ku ti nuk arrin dot, - tha tjetra.
- Atë do ta shohim. Ti vetëm më ndihmo ta takoj prapë. Ç'njerëz ka?

- Nëna i ka vdekur. I ati është mekanik. Merret me makina, por nuk e di se ku punon. Thonë se ka filluar të pijë. Një ditë e kam parë edhe unë të dehur.

- Po vëllezër, ka?

- Një, më të vogël.

Pas atyre fjalëve Aldo lëvizi i gjallëruar.

- Ishte e bukur, - tha. - Do ta takoj prapë.

Ndërkohë, jashtë në trotuar, Meri vazhdonte të mbushej thellë me frymë. I dukej sikur edhe rrobat i kishin marrë erën e lokalit. Me të mbërritur në shtëpi, freskoi fytyrën, pastaj u mundua ta harronte vendin ku kishte qenë. U hyri me vrull punëve të përditshme.

Ora e kishte kaluar njëshin kur papritur telefoni Sidi.

- Meri, jam unë, - tha. - Desha të të kërkoj falje për sjelljen e sotshme. Më kishte kapur vërtet një inat prej budallai prej asaj humbjes. Luajta dobët, megjithëse kisha veshur çorapet e tua magjike. Të premtoj se nuk do ta përsëris më.

Ajo mori frymë e lehtësuar.

- Edhe unë të kërkoj falje për ndeshjen Sid. Dje çuam gjyshen urgjent në spital.

- Ma mori mendja se do të kishte ndodhur diçka. Edhe njëherë më fal.

- Të kam falur njëmijë herë.

- Dhe... nuk do të mbash inat?

- Jo, aspak.

- Meri... unë...

Ajo u skuq.

- Lëre... e di se ç'do të më thuash, - pëshpëriti duke e mbyllur telefonin me dorë të dridhur. Buzëqeshi njëherë si nëpër ëndërr, pastaj filloi të përgatiste drekën. Nora po priste ulur në tavolinë, ndërsa Albi ende nuk ishte kthyer. Ajo doli te porta dhe e kërkoi me sy. U mpi papritur kur e pa atë në fund të rrugës me tipat e

grupit Zero në Kub.

Bëri disa hapa para dhe i thirri. I vëllai tundi dorën për t'i treguar se nuk do të vonohej. Meri vazhdoi ta ndiqte me sy e trembur.

*
* *
*

Zerot morën një pamje të pakënaqur.

- Albo, ty më duket se të komandon akoma motra, - tha Keko.
- Ne nuk duam shoqëri me tipa që ndërrojnë mendje çdo javë.

- Ajo nuk më urdhëron aspak, - ia bëri Albi i prekur.

- Domethënë, do të bashkohesh prapë me ne?

Tjetri pohoi me kokë i lëkundur.

Keko nxori nga xhepi i brendshëm i një xhakaventoje lëkure një tufë me kartmonedha të zhubrosura.

- Kemi gjetur një punë fantastike, - tha me qejf. - Do të vish edhe ti?

- Çfarë pune?

- Ta tregojmë në darkë. Takohemi te piceria "Gloria".

Albi ende po lëkundej.

- Hë mor ti, çfarë mendje ke? - i foli Redi duke e goditur në sup.

- Në rregull. Takohemi te piceria.

Ndërkohë një tip me flokë të prerë shkurt e të ngritur përpjetë si gjemba, kaloi aty pari.

- Ku jeni, o grup sherri? - thirri duke qeshur. - O tullacët e lalës!

Keko ngriti sytë.

- E Zaku, e ke kap veten, ë? - ia ktheu me tallje. - I lyen flokët me xhel dhe kujton se dukesh i bukur? Ik o Zak, se ma ke surratin si veturë e përplasme! Mos harxho xhel kot.

Të tjerët filluan të qeshnin me të madhe. Tipi me emrin Zaku u mendua një hop.

- Shih, kush flet, - tha pastaj. - Po ti ma ke kaptinën si kovë pusi mor dreq!

Keko preku njëherë me dorë kokën tullace, pastaj qeshi pa të keq.

- Dëgjo, andej nga zona ime mos u duk sonte, - vazhdoi

Zaku. - Kap ndonjë trotuar tjetër.

- Me gjithë mend e ke?

- As mos e diskuto! Ndryshe plas grushti.

- Kur të duash.

Sajmiri e tërhoqi Kekon për mënge.

- Lëre dhe ti se nuk është zor për të gjetur një vend.

Ata i kthyen Zakut kurrizin.

- A i fusim nga një kanoçe birra? - tha Redi.

Keko dhe Sajmiri u treguan të gatshëm.

- Unë po shkoj të ha drekë, - tha Albi.

- Si të duash, - ia priti Sajmiri.

Albi u ul në tavolinë turivarur.

- Ti nuk ke pse del në rrugë për të më thirrur, - i foli së motrës.

- Unë nuk jam as dele e as pulë.

- Ti e di shumë mirë pse të thirra, - ia ktheu ajo.

- E pse?

- Kush ishin ata tipat?

- A hu!

- Alb, të lutem mos bëj si nevrík! Me ata nuk duhet të shoqërohesh më!

- Pse i takova, nuk do të thotë se shoqërohem.

- Në rregull. Ha tani.

Albi ndenji mbi libra tërë pasditen. Ndihej edhe Norën për të bërë detyrat. Megjithatë, kur u mat të dilte, Meri e paralajmëroi me një ton të rreptë:

- Kthehu para se të bëhet natë!

Ai shkoi nga piceria "Gloria" dhe i gjeti djemtë e grupit Zero në Kub atje. Kishin ndarë një picë më trash dhe po përtyreshin me qejf. Albi përshëndeti. Keko zgjati pjesën e vet të picës.

- Jo, falemnderit, ka shumë salcë, - ia ktheu tjetri.

Keko gëlltiti edhe kafshatën e fundit, fshiu duart për pantallonash, gromësiu njëherë i kënaqur, pastaj nxori që thellë xhaka-ventos një grusht me varëse dhe përkyçëse (braçaleta) floriri. Albi vështroi njëherë rrotull me frikë. Keko filloi t'ua ndante mallin shokëve.

- Për çdo copë që shet, fiton dymijë lekë, - tha kur i erdhi radha Albit. - Sikur edhe një copë të shesësh, je me qarin.

- E ku i gjetët këto?

- A, këtë të keqe ke ti, se do t'i dish të gjitha! Janë gjëra të përdorura. E kuptove? Jepen me gjysmë çmimi që të shiten sa më shpejt. Hë mor, e more vesh? Ti e di shumë mirë se kush m'i ka dhënë.

- E kush më siguron mua se ato nuk janë të vjedhura?-pyeti Albi.

- Janë të përdorura! - thirri tjetri me inat. - E sikur te jenë të vjedhura, ç'të plas ty! A do të fitosh para apo jo? Mos e zgjat shumë. Fundja, ne nuk dimë gjë. Ne vetëm shesim.

Albi zgjati dorën i pushtuar nga frika dhe dyshimi. Kishte ditë pa një qindarkë në xhep. Sikur të shiste qoftë edhe një varëse, nuk do të ishte keq. Tundimi i lekut ishte i fortë.

- Duhet të dish edhe një gjë, - ia bëri Keko. - Po të kapi njeri, mos trego gjallë në botë se të kujt janë këto! Po tregove, të piu e zeza ty dhe ne të tjerëve!

Albi e tërhoqi dorën mbrapsht instiktivisht.

- Hë mor frikacak se nuk na kap njeri! - i foli Redi. - Këtu po shiten edhe vetura të vjedhura.

- Po deshe mendohu, - tha Keko. - E lemë për nesër.

Redi dhe Sajmiri morën pjesën e tyre të mallit dhe dolën në trotuarin para picerisë. Albi vështroi njëherë rrotull. Njerëzit kalonin në punë të tyre. Askush nuk e kishte mendjen te ai. Ta provojë njëherë, mendoi. Fundja, edhe sikur të jenë të vjedhura, unë s'kam faj. Vetëm po i shes. Nuk rrihet si qelbanik pa një lek në xhep.

Keko gati po i kthente kurrizin kur Albi foli me gjysmë zëri:

- E mirë, më jep edhe mua ndonjë gjë.

Tjetri i la në dorë dy varëse dhe një përkyçëse duke i treguar çmimin për secilën prej tyre.

- Hap sytë se mos t'i përlajnë, - ia bëri. - Ka plot halabakë Tirona.

Albit iu duk sikur sendet e florinjta i dogjën pëllëmbën. I vështroi njëherë ato në bisht të syrit, siç vështrohet një gjë e huaj, pastaj e mblodhi veten dalëngadalë. Iu afrua të parës një gruajë.

- Zonjë, mos dëshëroni ndonjë gjë floriri? - foli me zë të pa-

sigurtë.

Tjetra vështroi njëherë shtrembër, pastaj vazhdoi rrugën pa u përgjigjur. Albit iu duk sikur të gjithë do të sillleshin ashtu. Për të qenë më i mbrojtur nga rreziku, ai u afrohej vetëm grave e vajzave. I tregonte sendet e florinjta me ndrojtje, duke folur nën zë, siç veprohet me gjërat e ndaluara. Shumë prej grave e vajzave dyshonin fare hapur për mallin. I hidhnin një sy, pastaj largoheshin. Por kishte edhe nga ato që nuk besonin se bëhej fjalë për flori të vertetë.

Kishte kaluar një orë aty në trotuar, duke u vërtitur mes njerëzve dhe Albi po e humbte durimin, kur papritur, dy vajza të reja, ndoshta gjimnaziste, u ndalën për shkak të çmimit që dëgjuan.

- Qenkan falë fare, - tha njëra prej tyre, një flokëkaçurrelse veshur me të zeza. - Më pëlqeka kjo varësja e shkurtër. Paska punim shumë të bukur.

Shoqja e mbështeti.

- Çuno, ku i ke gjetur këto? - pyetën vajzat.

- Në një dyqan sendesh të përdorura, - ia ktheu Albi. - Merrini pa merak.

Flokëkaçurrelsja futi dorën në çantë dhe filloi të numëronte ca lekë.

- Kam këtu ca para të shtëpisë, - tha. - Po e marr. Të bëhet, ç'të bëhet.

Ajo e vuri varësen në qafë dhe nuk e hoqi më. Albi i futi paratë në xhep me ngut.

- E gëzofsh! - tha.

Vajzat u larguan pa i kthyer përgjigje. Ai vendosi të zhdukej nga ai vend sa më shpejt. I dorëzoi Kekos mallin e mbetur dhe lekët e varëses së shitur, nga të cilat kishte hequr fitimin e tij.

- Pse po ikën kaq shpejt? - pyeti tjetri. - Si fillim nuk je keq.

- Ashtu kam një punë.

- Po për nesër, çfarë mendje ke?

- Të shoh.

Ai u largua duke prekur herë pas here thellë në xhep kartmonedhat e fituara nga shitja e varëses. Nesër s'do ta bëj më, mendoi. E shtyu portën e shtëpisë me sup dhe hyri brenda si

me një ndjenjë faji. U ndesh fillimisht me vështrimin e së motrës, pastaj pa të atin që ishte ulur pranë sobës dhe po lexonte një gazetë.

- Mirëmbërëma! - përshëndeti.
- Hë Albi, nga ishe? - pyeti babai.
- Te një shok. Po luanim me kompjuter.
- Po me mësimet, je marrë?
- Po, - ndërhyri Meri. - Ka mësuar tërë pasditen.

Babai vazhdoi të lexonte gazetën, pa e ngritur më kokën. Albi vështroi njëherë nga e motra, pastaj u ul të hante darkë. Atë natë fjeti keq. Herët në mëngjes i doli gjumi nga një ëndërr e frikshme. Sirenat e makinave të policisë binin me zhurmë. Atë po e ndiqnin nëpër një rrugë të ngushtë e të panjohur. Xhepat i kishte të mbushur me sende të florinjta dhe nga pesha e tyre nuk vraponte dot. I zihej fryma. Në çastin kur dora e një polici trupmadh e mbërtheu për zverku, brofi ndenjor duke dihat. Vetëm kur pa se ku ndodhej, psherëtiu i lehtësuar.

Atë ditë, nga grupi Zero, erdhi në shkollë vetëm Redi. Dukej në qejf.

- Bëre gabim që ike dje, - tha. - Na eci grenxë fare.

Albi bëri me dorë një gjest mospërfilljeje për t'i treguar se nuk e kishte mendjen atje. Por në të vërtetë kishte kohë që kishte filluar të pyeste veten se ç'do të bënte kur të binte mbrëmja. A do të dilte përsëri në trotuar apo jo? Ajo pyetje e torturoi tërë ditën. Paratë e fituara të djeshmen i fluturuan nga xhepi. Gjysmën e harxhoi për hamburger dhe koka-kola, ndërsa me gjysmën tjetër bleu një rrip pantallonash nga Armand Tezga, një shok klase, të cilit ia kishin ngjitur atë nofkë sepse i pëlqente të shiste lloj-lloj sendesh, duke e mbushur çantën me to si një tezgë pazari.

Por për atë blerje Albi u pendua shumë shpejt. Si për inat, Armandi nuk pranoi të bënte më ndërrim dhe Albi e flaku rripin në një kosh plehrash.

Mbetja përsëri pa të holla e lëkundti keqazi. Ndoshta mund të mos kishte dalë atë mbrëmje, por Kekos i ra rruga nga shtëpia e tij dhe e thirri. Albi ndodhej vetëm me Norën. Meri kishte shkuar nga teta Bardha. Vendosi njëherë të mos përgjigjej, por Keko

vazhdoi të thërriste edhe më me ngulm. Albi u detyrua të dilte. Si edhe herë të tjera, e la motrën e vogël vetëm, para televizorit që po jepte filma vizatimor.

Atë mbrëmje dolën në trotuar përballë picerisë "Gloria" që para se të errej. Të gjithë ishin çliruar nga frika e parë, përfshi Albin. Sendet e florinjta i mbanin në duar në mënyrën më të dukshme. Nuk i hidhnin sytë anash për të parë se mos afrohej ndonjë person i dyshimtë. Albi arriti të shiste një varëse tjetër dhe një përkycëse. Ia bleu të dyja një grua e shëndoshë, e cila e futi zinxhirin e përkycësës mes dhëmbëve dhe e kafshoi aq fort sa e shtrembëroi.

- Ah, matrapaz i vogël! - ia bëri e kënaqur. - Qenka vërtet flori. Ku i ke vjedhur këto gjëra kaq të shtrenjta?

- Zonjë, unë nuk vjedh - ia ktheu Albi me inat.

- E kush është ai që pranon se vjedh! - ia bëri gruaja duke u larguar me një ecje tërë lëkundje si prej pate.

Mbrëmjen e tretë, pasi Albi kishte dalë në trotuar pa provuar më atë lëkundjen munduese të fillimit dhe tamam kur po mendonte se edhe për ca ditë të tjera ndoshta nuk do të ndodhte ai ters që ta njihte njeri, papritur një dorë e butë gruaje iu ul në sup. Djali fshehu me vrull sendet e florinjta, pastaj ktheu kokën i trembur. Fytyra iu pre kur njohu mësuesen kujdestare të Merit. Pranë saj qëndronte një burrë shtatlarë. Duhej të ishte i shoqi.

- Albi, ç'po bën këtu? - pyeti ajo tepër e shqetësuar.

- Ja... unë...po prisja një shok, - mermëriti ai.

- Je i sigurtë?

- Po zysh.

- Atëhere, të urdhëroj të kthehesh menjëherë në shtëpi! Nuk dua të të shoh më asnjë sekondë këtu në trotuar. Për të tjerat do të flasim më vonë.

Albi u tërhoq një hap mbrapsht, mermëriti me ngut një "natën e mirë", pastaj çau mes njerëzve pa parë ku shkelte.

12.

Mësuese Linda vazhdoi të qëndronte aty, në mes të trotuarit. I shoqi e tërhoqi për krahu.

- Linda, të lutem, ka edhe më keq se kaq, - tha i mërzhitur. - Eja se jemi vonë.

- Ai ishte vëllai i Merit, asaj nxënëses sime për të cilën të kam folur.

- Babai i së cilës ka probleme me alkoolin?

Linda pohoi me kokë.

- Këto janë gjëra të pritshme në një rast si ky dhe sot raste të tillë ka me dhjetra. Të lutem, mos e rëndo trëurin më shumë se ç'duhet! Shqetësimi yt nuk mund të zgjidhë dot asgjë.

- Agim, unë nuk mund të rri e të shoh se si ai djalë që deri para një viti ishte një fëmijë për së mbari, të përfundojë këtu në trotuar duke shitur sende të vjedhura.

- E ç'kërkon të bësh tani?

- Duhet të shkoj në shtëpinë e tij.

- E po sikur i ati të jetë akoma në ndonjë lokal? - Agimi filloi të bëhej nervoz. - Linda, po e tepëron!

- Duhet të takoj të paktën Merin.

- Pse, nuk pret kjo punë deri nesër? Të thashë, jemi vonë. Ato drej problemesh të shkollës, lëri për në shkollë.

- Të lutem, mos u nxeh! Këto nuk janë vetëm probleme shkolle.

- Po çfarë tjetër?

- Janë probleme të një familjeje, probleme të njerëzve si puna jonë.

- Ah, tani po flet tamam si Nënë Tereza!

Agimi tregoi në drejtimin nga duhej të shkonin.

- Të lutem, a mund të vazhdojmë?

- Në rregull. Vazhdojmë, - ia ktheu ajo pa i ngritur sytë. - Ti kurrë nuk do të më kuptosh dot.

- E dashur, unë të kuptoj shumë mirë. Ti shqetësohesh për gjëra të cilat nuk ke fuqi t'i ndryshosh dot. Dhe po vazhdove kështu, do të fitosh vetëm dhimbje koke. Asgjë më shumë. Këtu

nuk bëhet fjalë për të shpëtuar një nxënës, një familje. Ka me dhjetra familje që kanë probleme shumë më të rënda. Po ato, kush do t'i shpëtojë?

- Dikush duhet t'i ndihmojë.
- Kush është ky dikush?
- Dikushë ka plot.
- Deri tani unë të kam njohur vetëm ty.

Linda bëri një gjest pajtimi.

- Më mirë ta mbyllim këtë diskutim. Je shumë nervoz. Megjithatë, unë jam shumë e bindur se me zemër ndjen krejt ndryshe.

I shoqi psherëtiu i lodhur.

- Linda, me zemër do të doja të ndreqja gjithë padrejtësitë e botës. Të betohem për këtë.

Të nesërmen mësuese Linda e priti Merin te porta e madhe e shkollës. Nxënësja e kuptoi pa vonesë se bëhej fjalë për diçka serioze. Përshëndeti, pastaj priti kokulur që mësuesja të fliste e para.

- Meri, ç'bëhet nga shtëpia? - pyeti ajo.

- Ja... ju e dini.

- Babi vazhdon... të pijë?

Nxënësja pohoi me turp.

Tjetra i hodhi krahun supeve, pastaj i tregoi për ngjarjen e djeshme me Albin.

- Im vëlla... shiste varëse të vjedhura floriri?! - u tmerrua vajza.

- Meri, më vjen keq. E pashë me sytë e mi. Duhet të bëni diçka patjetër. Mos e lejoni të shoqërohet me ata djemtë që qethen tullacë. Ti i njeh. Ata kanë marrë që tani një rrugë të mbrapshtë, nga e cila zor se do të largohen më.

Të kuptova mësuese.

- A është nevoja të vijë të flasë unë me babin?

- Babit kam frikë t'i tregoj. Albi do të ikte fare nga shtëpia.

- Po atëhere?

- Do të mundohem ta zgjidh vetë.

- Beson se Albi mund të ta dëgjojë fjalën?

Meriyll ngriti supet e hutuar.

- Për çdo rast mos nguro të më kërkosh ndihmë, - tha mësuesja.

- Unë do të bisedoj edhe me mësuesen kujdestare të Albit.

Ajo arriti ta takonte kolegen e saj vetëm në pushimin e gjatë. Alma sapo kishte ardhur në shkollë dhe dukej pa humor.

- Alma, kisha një problem, - i foli Linda me një pamje tepër serioze.

- Po qe fjala për budallallëqe nxënësish, nuk dua të dëgjoj, - ia ktheu tjetra. - Boll kam telashet e mia dhe të fëmijëve të mi.

- Të lutem, është fjala për një nxënësin tënd të kujdestarisë.

- Kush është ky?

- Albin Gjoka.

Alma bëri një gjest padurimi.

- A hu! Dava familjesh të mbaruara! E pse duhet të merrem unë me të? Kush më paguan? Boll më bëhet fyti plagë për një rrogë mizerabël.

- Ti je mësuese!

- Aman, lëri këto idealizma bajate! Unë jam një rrogëtare e një shteti që tallet me mua duke më dhënë një rrogë qesharake. Koha e idealizmit ka vdekur.

Linda nuk pranoi të dorëzohej.

- Të paktën mundohu t'i gjesh Albit një shok që ta kthejë në rrugë të mbarë.

- As e kam ndër mend! Ai pati shoqe banke Erlindën dhe ajo iu largua.

- Alma, më dëgjo, ky është problem serioz. Puna ka shkuar larg.

Ajo ia tregoi gjithë të vertetën. Tjetra nuk u befasua.

- E po, si të shoqërohesh me ata tre tullacët e famshëm, atje do të përfundosh, - ia bëri duke nënqeshur. - Motër e dashur, unë kam për detyrë të njoftoj prindërin e tij dhe kaq. Nuk më paguan njeri për të ndrequr kalamajtë e botës.

Linda u tërhoq mënjanë e zhgënjyer. Ndërkohë kolegja e saj i harroi brenda minutit ato që kishin biseduar. U kujtua për Albin vetëm orën e pestë kur hyri në mësim në klasën e Merit.

- Moj, Gjoka, a e dinë në shtëpinë tënde se ç'bën yt vëlla apo jo? - iu drejtua asaj me inat.

Meri shtangu. Nuk e kishte pritur atë gjë. Filloi të dridhej e tëra. Aty pranë saj Sidi uli kokën.

- Më falni mësuese, nuk po ju kuptoj, - mërmëriti ajo.

- Ti më kupton shumë mirë! - vazhdoi mësuesja. - Yt vëlla ka filluar të merret me punë të pista, shet rrugëve bizhuteri të vjedhura.

Meri mbuloi fytyrën me duar.

- Po ai, yt atë, është në terezi apo jo?

Vajza ndjeu një dhimbje në kraharor, pastaj një shtërngim në fyt. Lotët iu varën faqeve.

- Ju nuk keni të drejtë të më përmendi babanë këtu në mes të klasës, - tha e prekur.

- Ta përmend që ç'ke me atë punë! Sepse ai është prind i përgjegjshëm.

- Ju lutem, mos përdorni këtë gjuhë!

- Do ta përdor që ç'ke me atë punë!

- Mos harroni se ai është babai im! - thirri Meri duke tërhequr çantën e duke dalë nga banka.

Bëri drejt derës me hapa të mëdhenj.

- Edhe ti motra e Albit je! Do ta shohim si do të përfundosh! - i foli mësuesja nga pas.

Papritur u dëgjua një kërcitje e fortë. Ishte Sidi që i kishte rënë bankës me grusht.

- Ju nuk keni asnjë të drejtë të përdorni këto fjalë me Merin! - thirri ai. - Kështu mund të flasë vetëm një shitëse plaçkash të përdorura.

Mësuesja shtërngoi nofullat.

- Arbana, si guxon?! - ia bëri duke tundur në ajër gishtin tregues të dorës së djathtë.

- Guxoj sepse ne e njohim të gjithë se kush është Meri.

Shumë nga nxënësit e mbështetën. Mësuesja filloi të vështronte me inat majtas e djathtas.

- Arbana, do ta shohim këtë punë, - tha duke u afruar te njëra prej dritareve, prej nga, poshtë në oborr, dalloi Merin që po shkonte drejt portës. - Edhe të kësaj shoqes tënde kryeneçe!

*

*

*

Meri mori rrugën e shtëpisë me sytë ende të mbushur me

lotë. Boria e një veture e detyroi të hapej anash e trembur. Rruga ishte pa trotuare dhe ajo vazhdoi të çapitej e hutuar rrzëzë mureve të oborreve. E përmendi papritur një zë i panjohur. Ishte Aldo Burimi, shoku i Gencit, të fejuarit të Klarës. Ai kishte qëndruar nën strehën e një porte me një çadër të madhe në dorën e djathtë. Vetëm atëhere ajo u kthjellua dhe vuri re se po binte shi.

- Mirëdita! - tha Aldo. - Meri, ç'paske kështu?

Ajo i fshiu lotët me ngut dhe u mundua të buzëqeshte. Dalja e tjetrit aty në rrugë e turbulloi. Edhe të djeshmen, pothuaj në të njejtën kohë, ai kishte qenë po aty kur ajo po kthehej nga shkolla. Meri ishte shtirë sikur s'e kishte parë. Ai ishte matur ta përshëndeste, por ftohtësia e saj e kishte frenuar.

- A mund të të shoqëroj deri në shtëpi? - tha Aldo i pasigurtë.
- Je bërë qull.

Meri nuk mundi ta kundërshtonte.

- Ke nevojë për ndihmë? Ç'të ka ndodhur? - vazhdoi Aldo. - Dukesh shumë e mërzitur.

- Jo, s'kam gjë, - ia ktheu ajo. - Vetëm bëra fjalë me një mësuese. Ecën një copë rrugë në heshtje.

- Meri, ti më bëre shumë përshtypje kur u takuam për herë të parë, - foli Aldo pastaj. - A mund të mblidhemi përsëri bashkë me Gencin dhe Klarën në ndonjë lokal?

- Më vjen keq, - u përgjigj ajo pa vonesë. - Unë nuk shkoj nëpër lokale.

- Atëhere, mund të mblidhemi në ndonjë vend tjetër.

- Nuk mundem. Nuk kam kohë.

Tjetri tundi kokën si me keqardhje.

- Më duket sikur ti ke frikë nga Genci dhe unë. Kushedi si të dukemi.

- Jo... nuk është punë frike. Unë thjesht nuk ju njoh.

- Meri, të siguroj se ne jemi djem për së mbari. I hymë emigracionit për një jetë më dinjitoze. Sa për njohjen, s'është vëshirë për t'u njohur.

- Unë nuk kam të drejtë të dyshoj për ju. Problemi është se nuk kam moshë për t'u njohur e për të ndenjtur me ju.

Tjetri nënqeshi.

- Të kuptova. Nuk jam aq torollak sa të vazhdoj me budalla-

- Na grupo, - ia bëri pa e zgjatur. - M'i jep më vonë.

Albi u lëkund.

- A do të shkoni sonte atje? - pyeti pastaj.

- Besoj se po.

- A ka edhe për mua?

- Sa të duash.

Albi e rراسi bluzën në çantë, por shumë shpejt e pati të qartë se ajo nuk ishte send që mund të fshihej. U detyrua ta gënjente Merin duke i thënë se Armandi ia kishte dhënë bluzën në mirëbesim. Lekët do t'ia jepte kur të kishte mundësi.

- Je i sigurtë? - pyeti e motra.

- Po, - u përgjigj ai.

Atë pasdite, Albi doli nga shtëpia pak minuta pasi Meri ishte nisur për te teta Bardha. Këmbët e shpunë nga piceri "Gloria". Priti atje deri sa djemtë e grupit Zero në Kub ia mbërritën duke fërshëlyer. Ata përshëndetën njëri pas tjetrit si me përtim. Albi vështroi nga Keko.

- Ta kam ruajtur pjesën, - tha ai duke futur dorën në xhep.

Albi mori një letër të mbledhur shukë. Brenda kishte tri varëse dhe dy përkjçëse. Priti edhe ca, sa filloi të errej, pastaj filloi t'u afrohej vajzave dhe grave që kalonin në trotuar. Arriti të shiste vetëm një varëse. Iu duk se nuk do t'i ecte më dhe vendosi të largohej. Kur papritur pa Kekon dhe Sajmirin që u hodhën në rrugë dhe vrapuan si të krisur mes makinave. U dëgjuan disa frenime të frikshme. Albi vështroi anash i trembur, por nuk pati kohë të bënte asnjë veprim. Një dorë me ca gishtërinj si prej metali e mbëtheu për krahu. Brenda pak sekondave ai e pa veten në një furgon policie bashkë me Redin.

I çuan në një rajon ku një polic i shoqëroi në zyrën e një oficeri të thyer në moshë.

- Mos guxo të tregosh gjë! - dëgjoi Albi zërin e Redit.

- Ah, më në fund erdhët, ë? - ia bëri oficeri. - Dëgjoni, nuk kam kohë të merrem me ju. Kini ditë që shisni bizhuteri të vjedhura dhe unë dua të di se kush ju furnizon me to. Për kë punoni?

Ndërkohë që Albi dridhej i tëri, Redi iu drejtua oficerit shpenguar:

- Shefo, me mua mos u lodhni kot. Vetëm dy varëse kisha në xhëp. Ato janë të miat. Po të doni, ecni pyesni në shtëpi. Kaq di të them unë. Po të duash futi policët të më rrahin e të më bëjnë peshk.

Oficeri nuk u habit nga ato fjalë. Nuk ishte hera e parë që Redi shkelte nëpër rajone policie. Dukej krejt i qetë.

- S'kam ç'u bëj ligjeve se e dija unë si veproja me fytyra si ti, - iu drejtua oficeri. - Do të dalësh nga ky rajon vetëm kur të vijnë të të marrin prindërit. Tani m'u zhduk nga zyra!

- O shefo, ça prindërish thua ti mor shef! Apo s'çan kokën njeri të vijë këtu për mua ore! S'kam prindër këtu në Tiranë unë. Nuk e di ku janë.

- Po me kë jeton?

- Me gjyshen. A e di si thotë gjyshja? Ishalla të kap policia mor pizeveng që të shpëtoj edhe unë! Store shefo, ë?

Oficeri hapi krahët në shenjë dorëzimi.

- Vetëm një Zot e di se kush do të merret me sërën tënde.

Ndërkohë që Redi doli i shoqëruar nga një polic, Albi filloi të dridhej edhe më keq. Oficeri e vuri re lehtësisht trembjen e tij.

- E ke herën e parë që vjen këtu? - pyeti.

- Po, - mermëriti djali.

- Atëhere, ke ndër mend të flasësh? Kush ju furnizon me bizhuteri të vjedhura?

- Unë... unë s'di gjë. I gjeta ato për tokë.

- Ashtu?! E pse dole t'i shesësh?

- Për të fituar ndonjë lek.

- Djalosh, e shoh që të kanë porositur të mos hapësh gojë. Ju jeni bërë më të rrezikshëm se ata kriminelët që bredhin me revole në brez. E mori dreqi këtë punë! Ku banon ti? A ke telefon në shtëpi?

- Zoti oficer, ju lutem, më falni! Nuk do ta përsëris më!

- Falje shko kërkoi nesër priftit në kishë. Të pyeta a ke telefon? Si mund t'i kontaktoj prindërit e tu?

Albi e shqiptoi numrin e telefonit duke belbëzuar.

13.

Zilja e telefonit ra si zakonisht, megjithatë Meri pati një ndjesi se do të kishte ndodhur diçka.

- Familja Gjoka? - u dëgjua një zë burri. - Flas nga Rajoni i Policisë numër 2. Kam këtu djalin tuaj.

Ajo e pati gjithçka të qartë.

- Duhet të vini këtu për ta marrë. Alo, më dëgjoni?

- Ju dëgjova zotëri.

Meri vështroi rrotull e trembur. I ati nuk ndodhej në shtëpi. Ajo u vesh me ngut dhe shkoi nga teta Bardha. Gjeti atje vetëm nënën e saj dhe Lirën, vajzën e vogël. U kthye përsëri në shtëpi dhe filloi të vinte vërdallë e hutuar. Mendoi njëherë t'i telefononte gjyshes, por ai mendim iu duk budallallëk. Përveç se do të alar-mohej, gjyshja nuk mund të ecte dot në këmbë as 50 metra.

Sidi, mëmëriti ajo papritur. Formoi numrin e tij pa u menduar më gjatë.

- Urdhëroni, - dëgjoi matanë linjës zërin e Elona Arbanës.

- Mirëmbërëma, jam Meri, - foli e pasigurtë.

- Sidi po mëson, - tha tjetra. - Kishit ndonjë problem të ngut-shëm?

Është e kotë, tha Meri e prekur. Më mirë ta mbyll fare. Por fakti se nuk kishte ku të përplasej më, e përmbajti.

- Po, kisha një hall, - foli.

Ia tregoi Sidit me zë të dridhur ç'kishte ndodhur.

- Nuk ka mundësi! - u befasua ai. - Do të jetë ndonjë ngatërresë.

- Jo Sid, nuk është ngatërresë. Të lutem, merr biçikletën dhe eja!

- Ja, më ke aty për pesë minuta.

Ai nxitoi të vishej, por e ëma qëndroi te dera e dhomës me një pamje tepër të pakënaqur.

- Sid, ku po shkon? - pyeti.

- Meri ka një problem.

- Çfarë problemi? Unë duhet ta di ku shkon ti në këtë orë.

- Duhet ta dish patjetër?

- Sigurisht.

- Vëllanë e Merit e kanë çuar në një rajon.
- Si?! Në rajon policie?! Me siguri ka vjedhur.
- Jo, ai nuk është djalë i atillë.

Elona nënqeshi pa e përmbajtur ironinë.

- Megjithatë, unë nuk e kuptoj se ç'hyn ti në këtë histori.

- Duhet të shkoj me Merin në rajon sepse ajo nuk ka njeri në shtëpi.

- Si?! I ati i saj bredh poshtë e lartë nëpër lokale dhe ti duhet të shkosh në polici! Sid, je shumë naiv. Më vjen keq, por kjo nuk ka asnjë kuptim. Ty mund të të tërheqin për hunde në çdo lloj historie.

- Ma, të lutem!

- Unë s'të lejoj të shkosh! - thirri e ëma e nxehur. - Nuk paska njerëz të tjerë ajo vajzë, por duhet të dalësh ti shpëtimtar?

- Duhet të shkoj ma.

Pas atij dialogu të acaruar, babai doli nga studioja e tij dhe i vështroi të dy me një buzëqeshje të lehtë habie.

- Interesant! - ia bëri. - Filloi edhe këtu konflikti modern adoleshencë - brezi i vjetër?

E shoqja e vështroi me inat.

- Brez i vjetër mos je ti, i dashur!

- Ti dhe unë bashkë, e dashur.

- Ashtu?! Dëgjoje njëherë, dëgjoje për se bëhet fjalë.

Djali i tregoi të atit se ku duhej të shkonte.

- Po të isha unë, do të shkoja, - tha Arian Arbana qetësisht.

Elona u nxeh edhe më keq pas atyre fjalëve.

- Si kështu?! Po yt bir është kalama për vete!

Tjetri buzëqeshi.

- A quhet kalama një djalë që e ka këmbën më të madhe se i ati?

- Dale, dale, se do t'ju shikoj të dyve, - iu drejtua e shoqja.

Sidi mori biçikletën dhe doli pa e zgjatur.

- Duhet të bëhet i zoti, - iu drejtua Ariani të shoqes. - Të mësohet me të gjitha sa ka jeta. Edhe me policinë.

Tjetra vetëm nënqeshi. Priti sa i shoqi u kthye në studio, pastaj iu drejtua telefonit e nervozuar. Formoi numrin e familjes Gjoka dhe pa duruar që nga ana tjetër e linjës të dëgjohej zë,

foli me një ton të ashpër:

- Mamaja e Sidit jam. Vajzë e mbarë, unë nuk e kuptoj veprimin tënd. Më dëgjon? Pse duhet të vijë im bir me ty në polici? Të lutem shumë, të jetë e para dhe e fundit herë që e shqetëson Sidin për gjëra të tilla. Ai s'ka fare lidhje me problemet e familjes tënde. U kuptuam?

Merit mend i ra telefoni nga dora.

- Më falni zonjë, - belbëzoi. - Ju kërkoj falje... për shqetësimin.

U mundua t'i mbante lotët me çdo kusht deri sa doli te porta. Sidi ia mbërriti aty pas pak. Kur pa që ajo s'po lëvizte nga vendi, pyeti i hutuar:

- Meri, si është puna?

- Sid, më fal që të mundova, - ia ktheu ajo. - Teta Bardha u kthye. Do të shkoj me të. Shumë të falemnderit që erdhe!

- Meri, s'po të kuptoj dot.

- Është më mirë të shkoj me teta Bardhën. E kupton? Ajo është grua. Mund të paraqitet si halla ose tezza ime.

- A ka nevojë të vijë edhe unë?

- Jo, kthehu i qetë në shtëpi. Nuk do të ta harroj këtë.

Ai u largua ende i hutuar. Të ëmën e kapi në befasi kthimi i tij. Duke dyshuar se Meri do t'i kishte treguar të birit të vërtetën, ajo nuk guxoi t'i ngrinte sytë.

- Ma, t'u bë qejfi që nuk pata rast të shkoja në polici? - foli duke dashur të tregonte hapur se i kishte mbetur hatri.

- E pse u ktheve? - pyeti ajo.

- Merin e ndihmoi një fqinja e saj. Rri e qetë tani.

- Unë ngul këmbë që ajo punë s'të takonte ty. Shoqëria me një vajzë ka edhe një kufi.

I biri iu drejtua derës së dhomës së tij pa folur më.

*

*

*

Ndërkohë Meri nxitonte drejt rajonit të policisë duke qarë. Sid, ç'ka ajo mami jot që sillet ashtu, mermëriste duke fshirë lotët me kurrizin e dorës. Ç'të keqe i kam bërë? Po ti mor Alb,

ç'na bëre kështu?Ku do të mbytemi tani?Kush do të na ndihmojë?

Mbërriti te porta e rajonit dhe u mundua të sqaronte një polic se ç'kërkonte. Tjetri e mati njëherë me sy, pastaj iu afrua si me dyshim një telefoni.Por me sa duket e urdhëruan që Meri të hynte sepse ai i kërkoi asaj ta shoqëronte. Pas pak vajza hyri në një zyrë dhe pa të vëllanë ulur në një karrike. Qante me fytyrën fshehur pas duarve. Oficeri u ngrit nga tavolina e tij e punës duke e vështruar Merin jo pa habi.

- Po ti, kush je? - pyeti. - Unë kërkova prindërit e Albinit.

- Jam motra e madhe zotëri. Babi nuk vinte dot se është sëmurë.

- Po nëna?

- Mami... mami na ka vdekur një vit më parë.

Pamja e fytyrës së oficerit ndryshoi në çast. Ai iu afrua Albit, e mbërtheu për veshi dhe ia shkuli atë aq fort sa koka e djalit shkoi shtrembër.

- S'të vjen keq për tët atë dhe për motrën mor faqezi?-i foli vrazhd. - Jeni familje e ndershme, me halle dhe ti të hysh në rrugë të këtilla? Dëgjo këtu, po ndodhi që të sollën prapë te unë, do të të çoj në një shkollë riedukimi ku s'ke për ta parë më Tiranën me sy! More vesh?

- Ju mora zoti oficer. Po më pe më këtu, më hidh në mes të detit.

- Ashtu, ë? Të shohim. Dil tani dhe prit aty në korridor.

Oficeri u kthye nga Meri.

- A mundem të ta dorëztoj ty vëllanë? - pyeti si me dyshim.

- Po zotëri. Mos kini merak.

- Po ti je e mitur për vete moj vajzë!

Meriyll mblodhi supet pa ditur ç'të thoshte.

- Mirë, shkoni, - shtoi tjetri pas pak.

Ajo zgjidhje iu duk vajzës një mrekulli dhe e falenderoi oficerin disa herë radhazi.

Kur doli bashkë me të vëllanë jashtë portës së rajonit, ishte çliruar disi nga ankthi. Vazhdonte të qante me kokën ulur sa që mjekra i prekte në kraharor. Albi çapitej pranë saj me një pamje plotësisht prej fajtori dhe herë pas here pengohej nëpër trotualet tërë gropa dhe pllaka te shkullura. Për herë të parë motra iu

dhimbs deri në thellësi të shpirtit. Nuk po dinte ç'të bënte për ta qetësuar. Nuk i duronte dot lotët e saj.

- Meri, unë e di... të kam gënjyer, - foli i pasigurtë. - Të kam gënjyer disa herë. Por të premtoj se gjithçka mori fund. Nuk do të më shikosh më me ata...

Meri bëri një gjest lodhjeje.

- Alb, u ngopa me premtimet e tua!

- Të lutem, më beso kësaj here! Të betohem për shpirtin e mamit! Nuk kam vjedhur gjë. Vetëm shita dy varëse që m'i dhanë. Meri, të lutem! Mos më trajto kështu si kriminel.

Ai filloi të qante me dënësë dhe e motra u detyrua t'i hidhte krahun në shenjë pajtimi. E afroi nga vetja, pastaj e përqafoi fort. Vazhduan të ecnin ashtu të përqaftuar deri pranë shtëpisë. Aty Albi u ndal dhe tha gati me inat:

- Tani e kam të qartë se ç'do të bëj. Nuk rrihet më në këtë vend.

- Akoma të gënjen mendja për Italinë? - pyeti e motra.

- Do të shkoj te daja gjallë a vdekur!

- Mirë, mirë. Eja tani, qetësohu njëherë.

Ata hynë brenda pa qenë të sigurtë se kë do të gjenin aty. Qeni angulliu njëherë si me ankim. Atë ditë nuk i kishin hedhur asgjë për të ngrënë. Meri futi kokën në dhomën e ndenjies dhe pa të atin shtrirë në divan. E kishte zënë gjumi si shpeshherë, mbuluar me batanije. Në divanin përballë flinte motra e vogël. Televizorin e kishin lënë ndezur. Meri u fut brenda, e fiku, pastaj i kërkoi Albit të mos bënte zhurmë.

- Eja, shkojmë të flemë, - tha ai. - Mua s'më hahet gjë.

- As mua.

Ata u shtrinë, por asnjëri e as tjetri nuk arriti të mbyllte sy. Albi vriste mendjen se si mund të shkonte në Itali. Merit i kumbonin në vesh fjalët e nënës së Sidit. Mënyra e komunikimit të saj në telefon herën e fundit të linte të kuptoje hapur se ishte fare mirë në dijeni të atyre që po ndodhnin dhe se shoqërimi i Merit me të birin nuk i pëlqente më. Sid, ç'faj kam unë, psherëtiu duke ndjerë për herë të parë një frikë alarmante se shumë shpejt mund ta humbte shokun.

Megjithëse fjeti keq, gjumi i doli herët. U vesh dhe shkoi nga

teta Bardha. Përshëndeti vetëm me një "Mirëmëngjes" dhe iu fut punës. Tjetra e vështroi njëherë e menduar.

- Nëna më tha se më kishe kërkuar dje.
- Më duhej një çikë sodë buke. Kaq.
- Nëna ishte trembur. Ti i ishe dukur shumë e shqetësuar.
- Jo, s'kisha gjë.
- Po babi?
- As babi.

Ato vazhduan punën pa folur më.

Kur Meri u kthye në shtëpi me racionin e zakonshëm të byrekëve në duar, e gjeti të vëllanë me çantën para këmbëve, në mëdyshje. U vështruan fare shkurt.

- Jeta vazhdon, - ia bëri ai.
- Asgjë s'ka ndryshuar, - ia ktheu ajo.
- As që pres ndonjë ndryshim. Meri, më fal, më duhen 10.000 lekë. Apo mos të vijë fare sot në shkollë?

- Me siguri ia ke borxh Kekos.

Ai pohoi. Ajo la byrekët mbi tavolinë duke thënë:

- Do t'i gjej unë.

Doli rishtazi dhe u kthye pas pak me lekët në duar. Albi i mori ato dhe i futi me ngut në xhep. Sapo iu afrua shkollës, vuri re se Keko po e priste me një pamje dyshuese. I foli ftoht.

- Ndaluni pak, - tha tjetri. - Kam një fjalë. Sot nuk kam ndër mend të vij në mësim. Ti... dje... atje në polici?

- Unë nuk jam spiun, - ia ktheu Albi me inat.

- Po sikur të dalë ndryshe?

- Keko, sot s'ta kam shumë qejfin. Na edhe këto se mbarova punë, - Albi nxori nga xhepi lekët dhe ia zgjati. Tjetri i mori ato pa u ngutur.

- Ore, e paske seriozisht ti! Ç'ke, të trembën atje në polici? Hajde rrotë, hajde! I mbushje pse të thanë se do të të çojnë në shkollë të riedukimit? Eh, kështu është kur të kapin për herë të parë. Dëgjo, ata të policisë llapin kot sepse ne jemi të vegjël dhe nuk na kap ligji. E kupton? Nuk e kemi mbushur moshën për burg. Kurse ajo shkolla e riedukimit është gënjeshtër. Në Shqipëri nuk ka shkolla riedukimi si në Amerikë.

Albi e vështroi shtrembër.

- As më interesojnë fare këto gjëra!

Keko u nxeh.

- Ore, mos më bëj si i fortë mua! Në se e ka ndarë mendjen të mos rrish më me ne, ik, mbushu! As na bëhet vonë për dhitsa si puna jote. Veç dije se nuk ke ku shkon. Te ne do të përplasesh përsëri.

Albi i ktheu shpinën duke u trembur nga fjalët e fundit. Ndërsa iu afrua shkallëve të hyrjes së shkollës, dalloi të motrën që u takua me Sidin. Dora e tij u ul për pak çaste në supin e Merit. Albi u shtir sikur nuk e pa atë skenë. Kishte kohë që me Sidin nuk fliste më. Ai ishte munduar t'i afrohej, por Albi i kishte qëndruar froht...

- Meri, prita dje deri vonë të më telefonoje, - tha Sidi.

- Nuk desha të të shqetësoja, - ia ktheu ajo. - Për fat, ai problemi u zgjidh.

- Po babi, e mori vesh?

- Deri tani jo.

- Nuk ke ndër mend t'i tregosh?

- Jo. Albi me babin...

Sidi psherëtiu si padashur.

- Kisha shumë shpresë se babi yt do të ndryshonte një ditë!

Në ato çaste ai as që e imagjinonte se babai i Merit do të bëhej shkak për grindjen më të ashpër mes tij dhe së ëmës.

*

*

*

Ajo grindje ndodhi pas pak ditësh. Sidi së bashku me prindërit po shkonin në këmbë te Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, për të ndjekur një koncert, ku do të luante në piano edhe Ana. Po binte mbrëmja dhe në rrugë kishte shumë trafik. Papritur, aty pranë tyre, u dëgjua një frenim i fortë. Një i dehur ishte futur mes makinave për të prerë rrugën shkurt. Desh e shtypën për pak, por ai nuk mori gjë vesh. Doli në trotuar duke u lëkundur.

Sidi e njohu. Prindërit e tij gjithashtu.

- Duhet ta ndihmoj, - tha djali.

- Si ta ndihmosh?! - u çudit e ëma.

- Ta shoqëroj deri në shtëpi.
- Më duket se ne jemi nisur për në koncert!
- E zgjidhim ndryshe, - ndërhyri Ariani, duke i ngritur dorën një taksie. - Sid, shko merr babanë e Merit. Taksisti do ta çoj deri në shtëpi. Do ta paguaj unë.

Djali kapërceu rrugën me disa kërcime dhe iu afrua Bashkim Gjokës i pasigurtë.

- Xhaxhi Bashkim, do të shkosh në shtëpi? - pyeti.

Tjetri e vështroi njëherë me sy gjysmë të mbyllur.

- Jam Sidi.

- Ah, Sidi! Kam kohë pa të parë mor djalë.

- Eja, mbahu te krahu im. Do të të çoj në shtëpi kjo taksia.

- Unë s'marr kurrë taksi.

- Do ta marrim vetëm sot.

- Sid, ti je një djalë flori.

Taksisti e ndihmoi Bashkimin të futej brenda, pastaj mbylli derën me ngut.

- Shkoni pa merak, - iu drejtua Sidit.

Djali u kthye te prindërit si fajtor.

- Po tani, do të më gënjesh më? - foli e ëma e nervozuar. - Do të më thuash se në familjen e Merit nuk ka asnjë problem? Ky na qenka babai i shoqes tënde të ngushtë?

- Ma, çfarë kërkon nga unë? - ia bëri Sidi i zënë ngusht.

- Kërkoj të pranosh se më ke gënjyer gjithë këtë kohë. Tani e kam plotësisht të qartë se ajo vajzë po të tërheq për hunde.

- Ç'hyn tërheqja për hunde këtu xhanëm?!

- E pse duhet të shoqërohesh akoma ti me atë vajzë?

- E pse jo?!

Elona bëri disa hapa para e nervozuar.

- Arian, kemi një djalë vërtet të papjekur, - tha me keqardhje.

- Më duket se u nisëm për atë drejtim koncerti! - ia priti edhe ai i nervozuar. - Kjo nuk është bisedë për t'u bërë në rrugë.

As Sidi dhe as e ëma nuk u ndien më. Koncertin nuk e shijoi as njëri e as tjetri. Ndonëse Ana luajti bukur në piano, nuk u shkaktoi emocione. Rrugën për në shtëpi e bënë pothuaj pa folur. Makinat ngrinin vazhdimisht pluhur dhe ajo gjë e bezdiste Elonën jashtë mase.

- Në këtë qytet idiot nuk ecet dot në këmbë, - u ankua ajo, pa iu drejtuar askujt. - Pse nuk i fshijnë këto rrugë shkatarraqe?

Sapo hynë në shtëpi, përplasi çantën në një kolltuk dhe qëndroi në këmbë, me duart mbledhur në gjoks.

- Ç'ditë tersi! - shfryu. - Ma prishi humorin. Dhe ta dish Sid se faji është yti.

- E pse o ma?

- Djalë i mbarë, ti duhet t'i japësh fund historisë me atë Merin.

I biri ia nguli sytë i hutuar.

- Pra, t'i them Merit s'dua të shoqërohem më me ty se s'më le mami?

- E saktë!

Tjetri tundi kokën në shenjë mohuese, i vendosur.

- Jo, nuk e bëj dot.

- Domethënë, do të vazhdosh të shoqërohesh me të?

- Po.

- Ti duhet të më bindesh, sepse je im bir!

- Ma, më vjen keq, por Merit nuk i largohem dot në mënyrë kaq të ulët.

- Kjo është një mënyrë fare normale.

- Mua më duket se jo.

Ndërkohë Ariani ishte ndërruar dhe po hynte në studion e tij. E shoqja e vështroi me inat.

- Zotëri, po ty nuk të intereson biseda jonë? - i foli ajo. - Pse nuk i tregon tët biri se ç'duhet të bëjë?

- Unë nuk jam gjeneral që të jap urdhëra, - u përgjigj tjetri getësisht. - Kjo është një familje ku ka demokraci dhe ku respektohen të drejtat e të gjithëve, pa dallim. Besoj se djali im është aq i zgjuar sa të zgjedhë pa u gabuar një njeri të afërt.

- Ashtu?!

Elona u ktheu kurrizin të dyve.

- Mirë, mirë, pa do ta shohim si do të përfundojë kjo punë! - tha e prekur.

14.

Ajo u lëkund për disa ditë, deri sa më në fund, një buzëmbremje, ndërsa ndodhej vetëm në shtëpi, ngriti telefonin dhe kërkoi Merin.

- Po teta Elona, unë jam, - tha vajza.

Tjetra nënqeshi. Është dinake, mendoj. Më quan "teta Elona" për të më marrë me të mirë dhe për të më treguar se nuk po ndodh asgjë.

- Meri, unë desha të të kërkoja diçka.

- Po ju dëgjoj.

- Problemi është se tani shumë gjëra kanë ndryshuar. Ti... domethënë familja jote... Unë mendoj se mes teje dhe Sidit sikur është tepëruar ca. Ju...

- Teta Elona, mund t'i bini shkurt.

- Atëhere, unë kërkoj që ti të mos shoqërohesh më me tim bir. Nuk është se kam gjë kundër teje, por rrethanat... Ti vetë duhet ta kuptosh se nuk është normale të futesh atje ku nuk të takon.

- ...

- Meri, po më dëgjon?

- Po, ju dëgjova fare mirë.

- Atëhere?

Merit filloi t'i dridhej telefoni në dorë. Hapi gojën dhe filloi të fliste pa i besuar as vetë ato që thoshte:

- Ju premtoj se me djalin tuaj nuk do të shoqërohem më. Ju kërkoj falje që deri tani mund t'ju kem shqetësuar.

- Më vjen mirë që më kuptove drejt.

- Më falni, po Sidi, ka të njëjtin mendim?

Elona u kollit në mënyrë krejt të shtirë.

- Dëgjo vajzë e mbarë, ti nuk mund të më kërkosh llogarit Nuk ka fare rëndësi se ç'mendon Sidi. Unë si prind i tij dua që ti të mos shoqërohesh më me tim bir. U kuptuam?

- Sigurisht. Ju kërkoj edhe njëherë falje.

Ajo e lëshoi telefonin si një gjë të frikshme dhe u ul e shu-

shatur në karriken më të afërt. Nuk mundi të qante. Ishte tepër e lodhur. Në ato çaste iu duk vetja e humbur, e braktisur, njeriu më pa fat në botë. Deri atë ditë askush nuk e kishte poshtëruar deri në atë gradë.

Albi e vuri re gjendjen e saj dhe iu afrua i trembur.

- Meri, ç'pate? Me kë fole në telefon?

E motra u mundua të mblidhte veten.

- Asgjë, - tha. - Vetëm jam e lodhur. Po shkoj të shtrihem pak.

- Shkoi në dhomë, ra përmbys në krevat dhe ndenji ashtu deri sa Albi dhe Nora iu lutën t'u jepte darkë.

- Hani njëherë vetë! - thirri ajo. - Shkoni, bëni ç'të doni!

Albi e tërhoqi motrën e vogël për dore.

Meri nuk u ngrit edhe kur u kthye i ati. U shtir sikur e kishte zënë gjumi. Por atë natë ndenjia shtrirë në krevat iu duk tortura më e madhë në botë. Nuk e kuptoi në fjeti dot apo jo. Në mëngjes nuk shkoi si zakonisht nga teta Bardha.

Me të mbërritur në oborrin e shkollës, vuri re se Sidi po e priste. Te ai s'kishte ndryshuar asgjë. Meri e kuptoi pa vonesë se gjithçka kishte ndodhur pa dijeninë e tij. Ajo rrethanë e hutoi edhe më shumë. Si duhej ta bindte Sidin se nuk mund të shoqërohej më me të?

Ai e vuri re leht tronditjen e saj.

- Meri, mos ka ndodhur gjë? - pyeti.

Ajo e pati të qartë se ishte e kotë të shmangej. Truri i shpiku një gënjeshtër bajate.

- Sid, më vjen keq, por me ty nuk mund të rri më. As në bankë.

Tjetri nuk u besoi veshëve.

- E pse?!

- Nuk më lejon babi.

Shoku tundi kokën me vrull.

- Nuk të besoj! Kurrë në botë!

- E pse nuk më beson?

- Sepse të njoh mirë dhe e di që nuk po thua të vërtetën.

- Ti s'mund t'i dish të gjitha ç'ndodhin në shtëpinë time. Unë kam urdhër të prerë nga babi të mos shoqërohem më me ty. Të lutem, shko në një bankë tjetër!

- Unë nuk iki nga banka!

- Atëhere po iki unë.

Në fytyrën e djalit mbeti i skalitur një zhgënjim i thellë.

Meri iu lut Entela Shijakut të ndërronin vendin bashkë. Ajo rrinte zakonisht në bankë me Bledar Belshin. Shoqja nuk kuptoi ç'po ndodhte. Mendoi se do të ishte ndonjë grindje kalimtare dhe pranoi. Ndërsa Bledari u mundua të kapte ndonjë shenjë nga Sidi. Kur e pa se shoku nuk ishte në gjendje të jepte asnjë shpjegim, nuk u ndie.

Ai ndërrim i befasishëm vendesh ra menjëherë në sy. Të gjithë e kuptuan se diçka kishte ndodhur, por se çfarë konkretisht, asnjëri s'mund ta thoshte. Meri ndjeu mbi vete vështrime kureshtare që donin të kuptonin diçka nga shprehja e fytyrës së saj. Ndërsa Sidi i kishte ulur sytë mbi librin e Matematikës, duke u munduar të tregonte se ai ndërrim vendesh ishte thjesht një rastësi. Të nesërmen gjithçka mund të kthehej si më parë.

Tronditja e atyre të dyve i ra në sy të parës mësueses kujdes-tare. Ajo i vështroi me radhë, sikur të donte të pyeste: po ju, ç'kini bërë kështu. Ndërsa mësuesja e Anglishtes nënqeshi lehtazi.

- Streinxh! - ia bëri. - Arbana, pse vetëm sot?

- Më duket se nuk jam vetëm, - ia ktheu Sidi.

- Pa Merin, dukesh vetëm.

- Hej, tiçër, liv dhë kids alon! - ia priti Bledar Belshi me fjalët e një kënge të njohur të grupit "Pink Floyd".

- Okej Belshi, - tha mësuesja duke hapur regjistrin. - Po ju lë rehat. Vazhdojmë mësimin.

Në pushimin e madh dhe pas mësimit Sidi nguli këmbë që Meri t'i jepte ndonjë sqarim, por ajo vetëm përsëriti fjalët e çuditshme "Nuk mund të rri dot me ty".

- Ti nuk ke të drejtë të sillesh me mua kështu! - tha ai i prekur.

- Më duket se unë nuk e meritoj të më fyesh në këtë mënyrë.

- Unë nuk po të fyej aspak.

- Unë dua të di të vërtetën!

Ndonëse ajo kishte bërë të pamundurën për të mbajtur të qarën, nervat e lodhura nuk duruan dot më.

- Të lutem më ler në hallin tim! - tha duke u përlotur. - Nuk e shikon se si jam?

- Meri, po unë dua të të ndihmoj!
- Sid, ti nuk mundesh të më ndihmosh më.
- Unë them se po.
- Më fal, më duhet të iki.

Ai qëndroi në rrugë , duke ndjekur me sy çdo hap të saj deri sa Meri humbi në një kthesë. U kthye në shtëpi krejt i hutuar. Disa herë u mat të telefononte, por e pati të qartë se do të merrte të njëjtën përgjigje. Duhej të ishte tepër i tronditur sepse prindërit e dalluan fare lehtëazi ndryshimin e tij. E ëma e vështrroi disa herë në bisht të syrit.

- Sid, në ç'det të është mbytur anija? - pyeti i ati.

- Këtej afër, - iu përgjigj i biri me inat. - Iu plotësua më në fund dëshira mamit! Meri nuk pranon të shoqërohet më me mua.

Elona u skuq në çast. Po priste me kokën ulur.

- E pse nuk pranon? - vazhdoi babai.

- Nuk e di. Nuk më tregon.

- Eh, kështu e kanë vajzat! Sid, mos u mërzit se do të pajtoheni prapë.

- Po ne nuk u grindëm! Gjithçka ndodhi sot, krejt papritur.

Elona mori njëherë frymë e lehtësuar.

- Meri ka bërë një veprim të zgjuar, - tha. - Tani shkolla po mbaron. Ajo e ka kuptuar se shoqërisë tuaj po i vjen fundi dhe...

Sidi nënqeshi.

- Ma, të lutem mos vazhdo të mendosh se unë jam naiv!

- Për mua Meri ka bërë mirë, pavarësisht se cila mund të jetë arsyeja. Çdo shoqëri e moshës tuaj ka një fund. Tani ti bën mirë të merresh me mësimet. Mjaft më me këtë Merin! Sikur e teprave ca më duket. Apo jo Arian? Edhe ne sikur po tregohemi ca liberalë.

- Nuk më duket ashtu, - ia ktheu i shoqi qetësisht.

Elona shtërngoi nofullat.

- Atëhere, zgjidheni të dy këtë... këtë dramë! - tha duke u futur në dhomë.

- Të gjitha dramat zgjidhen një ditë, - vazhdoi Ariani. - Rëndësi ka të ndihmosh për zgjidhjen e tyre në se ke mundësi.

- Unë nuk kam ndër mend të përzihem në drama të tilla artificiale! - thirri Elona.

Babai vështrroi njëherë të birin, pastaj i ra supit.

- Ej, djalosh, shkundu! S'bën kështu një sulmues me numër këmbë 44.

Sidi u mundua të buzëqeshte.

- Ba, kam frikë se është gjë serioze. E njoh Merin mirë.

- Hajt, se do të rregullohen të gjitha. Jeta duhet marrë pa mërzë. Jetës i duhet buzëqeshur. Sidomos në moshën tënde!

Por Sidit iu dukën të vështira për t'u besuar ato fjalë.

Të nesërmen nuk vuri re te Meriyll asnjë ndryshim. Ajo ndenji gjatë tërë mësimit në një bankë me Bledar Belshin. Dukej e për-humbur. Nuk e kishte fare mendjen në ato që flisnin mësuesit. Me Sidin u përshëndet si zakonisht. Pas mësimit ai u mat të hapte bisedën e djeshme, por shoqja u largua me ngut.

*

*

*

Meri e la çantën te shkallët e verandës dhe u ul pranë qenit. Kafsha zgjati qafën, puliti njëherë qepallat, pastaj ia nguli sytë në mënyrë të çuditshme, sikur ta ndjente që ajo kishte një hall.

Meri i bëri shenjë të afrohej. Sparki tundi bishtin i gëzuar dhe u struk mes këmbëve të saja. Vajza filloi ta përkëdhelte duke mërmëritur:

- Sparki, ti je më i lumturi në botë. Ti nuk e di se si është bota e njerëzve.

Kur Albi hyri në oborr, e gjeti duke folur me vete. U ul pranë saj dhe e shtyu me bërryl.

- Meri, pse rri kështu?

- Kot.

- Unë e di pse je mërzitur. Prej atij rrufepritësit që nuk rri më në bankë me ty.

- Alb, të lutem mos fol për Sidin kështu!

- A hu! Dava llastice mami është edhe ai, si Erlinda.

- Po ajo, pse iku nga banka jote?

- E kishte porositur mami të mos rrinte më me mua. Është djalë i keq, i kishte thënë, nga një familje me probleme.

Meri psherëtiu.

- Më duket se nuk ka thënë ndonjë gënjeshtër.

Albi u tërhoq menjëherë i prekur.

- Domethënë, edhe ti mendon se unë jam djalë i keq?

- Jo, këtë s'e kam menduar kurrë. Por... për familjen... kanë të drejtë.

Albi lëvizi vendit.

- Prandaj unë të them se duhet ikur! Në këtë shtëpi nuk hyn më njeri. Edhe komshinjtë nuk vijnë më si më parë. Meri, asnjë nuk na do më.

Ajo i hodhi krahun të vëllait dhe e afroi nga vetja.

Si edhe të djeshmen, tërë atë pasdite të gjatë maji, e kaloi duke u vërtitur nëpër shtëpi. Librat e shkollës qëndronin hapur mbi tavolinë, por ajo nuk ndjente pikë dëshire për t'u marrë me ta. Edhe kur e bindte veten për të lexuar dy faqe, nuk përqëndrohej dot. Kur e pa se po shushatej fare duke ndenjtur ashtu si ndonjë paciente spitali, i hyri pastrimit të kopshtit dhe ujitjes së luleve.

Të nesërmen në mëngjes përsëri nuk pati dëshirë të shkonte për të punuar te teta Bardha, por u kujtua se nuk kishin asgjë për të ngrënë dhe u detyrua të ngrihej nga krevati. Për fat, teta Bardha nuk e bezdisi me pyetje. Edhe Meri nuk e sqaroi pse nuk kishte ardhur dy ditët e fundit. Vështrimet e tyre u ndeshën disa herë fluturimthi, por vajza ishte e para që i ulte sytë.

Atë ditë në shkollë Sidi këmbënguli rishtazi që Meri t'i thoshte diçka më shumë, por ajo vetëm ngrinte supet.

- Unë më duket se kam edhe telefon, - ia bëri ai i mërzitur. - Apo ke harruar numrin?

Meri e kuptoi se po sillej në mënyrë ca të vrazhdë, por nuk kishte si vepronte ndryshe për t'u larguar nga shoku. Për ca çaste ajo e harroi atë lloj sjelljeje dhe e vështroi Sidin gati me një lloj lutjeje që ai të mos i vinte faj. Tjetrin e hutuan edhe më shumë ata sy lutës që ai dinte t'i lexonte tashmë fare leht.

- Jam i sigurtë që ti nuk më ke thënë të vërtetën, - ia bëri duke u larguar i prekur.

Meri e ndoqi në bisht të syrit duke u munduar t'ia fshihte vetes atë që ndjente në të vërtetë për atë njeri. Sid, më fal, mërmeriti.

Kaluan disa ditë tepër lodhëse e të stërgjatura, deri sa të dielën

paradite në oborr hyri si gjithmonë me zhurmë Klara. I hodhi Sparkit disa ushqime të shijshme, të cilat ai s'i kishte parë me sy prej kohësh, pastaj vështroi nga lulet duke fërkuar duart e kënaqur.

- Meri, më duhen ca trëndafila, - foli. - Meriii!

Klara u befasua nga pamja e fqinjës.

- Meri, si je bërë kështu?! Pse je kaq e mërzhitur? I ka ndodhur gjë babit?

- Jo, - ia ktheu tjetra. - S'kam gjë.

- Atëhere, je prishur me atë Mexhik Arbanën?

Meri u skuq në çast.

- Jo, jemi prapë shokë.

- Meriii! Nuk m'i shet dot mua këto! Të pata thënë që ai s'ishte shok për ty. Familjet e larta kështu e kanë. Me siguri e kanë mësuar prindërit që të mos shoqërohet me një vajzë si ti.

- Nuk është ashtu, jo, - u mundua të kundërshtonte Meri.

- Më lidhshin me zinxhir si Sparkin po nuk ishte si them unë! - nënqeshi Klara. - Por për kaq gjë nuk ia vlen të bëhesh kështu sikur ke dalë nga spitali. Mos e çaj kokën! Më mirë që u prishe me të. Nuk ma ha mendja se ti do të shkosh në gjimnaz me këto halle që ke.

- Nuk e besoj. Duhet të gjej ndonjë punë.

- Kurse ai do të vazhdojë shkollën. Kështu që... të ndarë se të ndarë ishit. A hu! Ti je aq e bukur sa për të të ardhur prapa tre Sidë të tjerë. Dëgjo, të të them një sekret? Nuk të ngelet hatri besoj. Ai Aldo Burimi është bërë si budalla pas teje. I ke pëlqyer shumë.

Meri ngriti të dyja duart si e trembur.

- Klara, të lutem, këto biseda nuk më pëlqejnë.

- Ua, ngadalë ti, se nuk të thashë ndonjë gjë të madhe. Mos bëj kështu si më e urta e dynjasë.

- A do një freskuese me esencë trëndafili? - pyeti Meri për të ndërruar temë.

Klara u kapërdi nga kënaqësia.

- Gjej ndonjë gotë të madhe.

Pas pak Meriyll u kthye duke trazuar me lugë trëndafiladën e përgatitur në një kanë qelqi. Mbushi dy gota, pastaj e la kanë

aty pranë.

- Kur do të niseni për në Greqi? - pyeti.

- Për punë javësh, - tha Klara. - Genci dhe Aldo po merren me vizat.

- Po atje, ku do të qëndroni?

- Genci ka tezen në Athinë.

- Po... prindërit e tu?

- Atyre nuk do t'u tregoj gjë.

Meri e vështroi e tmerruar.

- Do të ikësh nga shtëpia pa leje?!

Klara psherëtiu.

- Nuk kam ç'bëj. Prindërit nuk do të më linin ndryshe.

- Po... nuk ke frikë të shkosh me një djalë aq larg?

- E pse të kem frikë?! Genci më do. Është djalë për së mbari.

Me të do të shkoja deri në Groenlandë ku bëjnë dashuri fokat. Këtu nuk rrihet më moj Meriyll! Mezi shtyhen ditët. Bëjmë edhe ne sikur jetojmë. Pika që s'na bie!

Meri nuk po e mblidhte dot veten.

- Po ti, ke ndonjë të afërm në Greqi? - pyeti Klara pas pak.

- Jo.

- Sa keq! Po të kishe ndonjë njeri andej, kishe shkuar për të punuar e për të ndihmuar shtëpinë. Ju keni mbetur në ditë të hallit. Albi është akoma i vogël.

- E ç'punë do të bëja unë në Greqi?

- Genci thotë se atje ka punë nga më të ndryshmet. Mund të bëhesh edhe top-modele me famë po të jesh e bukur.

- Nuk e kam menduar kurrë një gjë të tillë. Nuk ma mban.

- Eh, sa gjëra nuk kishim menduar më parë! - rënkoi Klara, pastaj piu edhe trëndafiladën që kishte mbetur në kanë, duke shtuar me qejf:

- Tani do të më bësh një tufë të bukur me lule. Është fejuar një kushërira ime dhe duhet t'i shkoj për vizitë. Do jetë e fortë. Ajo ka ftuar edhe shoqërinë e shkollës.

Meri u ngrit, mori një palë gërshërë dhe filloi të zgjidhte trëndafilët më të mëdhenj e më të bukur që i kapte syri. Në mes të tufës futi edhe dy zambakë.

- Fantastike! - ia bëri Klara e kënaqur. - Ku ta gjejë ime kushë-

rirë një tufë si kjo sot. Na vdiqën me ato lulet artificiale. Meri, kam një ide. Pse nuk vjen edhe ti?

Tjetra bëri një gjest të vrullshëm kundërshtimi.

- Jo, nuk mundem. Nuk njoh njeri. Pastaj edhe nuk ndihem mirë.

- Po vazhdove të rrish e mërzhitur këtu brenda, do të shushatesh edhe më keq, - këmbënguli Klara. - Hajde, se ata njerëzit e mi rrëmujë duan.

Meri filloi të lëkundej. Nuk mbahej mend sa kohë kishte pa hyrë në një mjedis të gëzuar ku festohej, kërcëhej e këndohej. Klara kishte të drejtë kur thoshte se po të rrinte brenda duke u sorollatur nëpër oborr e duke folur me vete, do ta pësonte më keq. Ajo që kishte ndodhur pas telefonatës së Elona Arbanës, nuk mund të ndryshohej më. Duhej të harronte shumë gjëra dhe për të harruar duhej të bënte diçka jashtë monotonisë së zakonshme.

15.

Festa e fejesës bëhej në një apartament të madh, korridori i të cilit dhe një dhomë qenë zbrazur, në mënyrë që të kërcenin sa më shumë vetë. Ishte rrëmujë. Dëgjohej muzikë, biseda me zë të lartë, të qeshura. Pjesa më e madhe e të ftuarve ishin maturanët. Blerta, kushërira e Klarës, që po fejohej, ishte një vajzë hollake, me sy të bukur dhe një buzëqeshje të ëmbël. Ajo mbeti e mahnitur kur pa tufën e trëndafilave që solli Klara. U puthën të dyja gjatë e gjatë, pastaj Blerta u njoh me Merin.

- Falemnderit që erdhe! - tha. - Dhe kujdes nga këta shokët e mi se do të të vërsulen për të kërcyer, - shtoi pastaj duke qeshur.

Fjalët e saj u provuan shumë shpejt. Dy prej djemve u afruan te Meri dhe Klara për t'i ftuar të kërcenin.

- Çuna, jemi të vogla ne, s'na le mami të kërcëjmë, - u foli Klara.

Ata qeshën. Klara i hodhi Merit një vështrim pyetës. Ajo i bëri shenjë se nuk mund të kërcente.

- Çuna, dukuni njëherë më vonë, - tha Klara miqësisht. - Na

lini të hamë një copë tortë.

Djemtë pranuan të tërhiqeshin.

- Meri, vërtet s'do të kërcesh? - pyeti Klara.

- Jo, dua vetëm të shoh.

- Atëhere, eja me mua.

Ajo e çoi në një ballkon të gjerë dhe i solli tortë, fruta, pije freskuese. Aty pranë ishte ulur edhe një djalë që, për çudi, mbante mbi gjunjë një fjalor. Pasi gërrmoi nëpër faqet e tij për disa minuta, ai i ngriti sytë nga Meriyll dhe buzëqeshi.

- A e dini se si e zgjidhin problemin vajzat në fiset aborigjene të Paraguajit, kur duan të fejohen me të njëjtin djalë? - pyeti.

Meri ngriti supet.

- Veshin dorezat e boksit dhe ndeshen deri sa njëra të përfundojë për tokë. Domethënë, të ngeli pa fejuar.

Meri u detyrua të qeshte.

- Po pinguinët, a e di se si fejohen? - vazhdoi tjetri.

- Jo.

- Dhjetë pinguinë rrijnë në rresht si ushtarë dhe një pinguinëshë zgjedh njërin prej tyre. Nëntë të tjerët ngelin me gisht në gojë. Çfarë krimi, ë?

Meri u detyrua të mbushte me ngut një gotë me koka-kola sepse torta që po përtypte i shkoi shtrembër nga të qeshurit.

- Të lutem, trego ndonjë gjë tjetër! - iu drejtua djalit.

Por tjetri nuk dinte të tregonte gjëra serioze. Ajo u detyrua të ndërronte vend për të shpëtuar prej tij. U ul pranë një vajze të shëndoshë dhe filloi të ndiqte e menduar ata që kërcenin. Sepse iu dukën ndryshe. Njerëz krejt pa halle e shqetësime. Nuk e kuptoi sa kohë kaloi ashtu e përhumbur, duke dëgjuar një muzikë të ëmbël që dukej sikur vinte nga larg dhe ikte përsëri larg.

E përmendi prekja e Klarës në sup.

- Ke qejf të rrimë akoma? - pyeti ajo.

- Jo, ikim, - tha Meri duke u ngritur.

Ata po çapiteshin duke qeshur me qyfyret e festës kur papritur u ndeshën me Gencin dhe Aldon.

- Ç'është gjithë ky gaz? - tha Genci me ton miqësor. - Na bëni edhe ne të qeshim pak.

- Hë, a e di ti si fejohen pinguinët? - ia ktheu Klara.

Tjetri u mendua një hop.

- Nuk fejohen dot se nuk kanë gisht për unazë, - tha pastaj.

Vajzat filluan të qeshnin edhe më shumë. Aldo po ashtu. Ai i hodhi Merit një vështrim të ndrojtur për të parë në se ajo i mbante mëri. Tjetra e përshëndeti për t'i treguar se asgjë s'kishte ndodhur mes tyre, po ta harronin të dy atë ditën me shi.

Genci i ftoi te uleshin në një lokal aty pranë. Meri u gjend para mëdyshjes së zakonshme. Klara po priste përgjigjen e saj.

- Unë duhet të kthehem në shtëpi, - tha. - Ndonjëherë tjetër...

- Rëndësi ka të mendosh mirë për ne, - foli Aldo.

Meri u detyrua të buzëqeshte për të lënë të kuptohej se s'kishte arsye pse të mendonte keq.

- Mirë, besoj se do të shihemi, - tha Genci. - Klara, mos duhet ta shoqërosh Merin deri në shtëpi?

- Pse të mos e shoqërojmë të tre?

Ata pranuan. E bënë atë copë rrugë që kishte mbetur duke dëgjuar Klarën që tregonte për fejesën e kushërirës së saj. Pastaj Meri përshëndeti dhe nxitoi drejt shtëpisë.

- Mirupafshim! - i foli Aldo nga pas.

- Mirupafshim! - u detyrua t'i përgjigjej ajo.

Aldo vështrroi njëherë Klarën, pastaj shokun e tij.

- Meri do të vij te mua, - tha me mburrje. - Vë bast me ç'të doni!

Genci hapi krahët me habi.

- Ç't'u bë edhe ty fiksim kjo Meri!

- Gjërat e bukura bëhen fiksim, - ia ktheu shoku. - Apo jo Klara?

- S'është habi që ta fitosh bastin, - tha vajza. - Meri duhet të jetë prishur me atë djalin që ka në klasë, atë basketbollistin.

- Aq më mirë! - ia bëri Aldo. - Klara, ti duhet të më ndihmosh. Duhet ta bindësh Merin që unë kam qëllime shumë serioze.

Genci nënqeshi.

- Pse, kështu fitohet basti?

- Rëndësi ka që të fitohet. Klara, si thua?

- Të shohim, - ia ktheu ajo.

- Hajt mo, se goca e një pijaneci është! - shfryu Genci me inat. - Nuk e ka babën ministër. As biznesmen. Ajo ku ta gjej të bashkohet me ne. Të mos na bëj shumë naze po të dojë! Klara, me ty po flas! Është kështu apo jo? Është Aldo që po e lut se të

kisha qenë unë, i kisha bërë dalje me kohë.

- U, ngadalë ti, - ia bëri Klara. - I bukuri i dheut!

Djemtë filluan të qeshnin.

Ndërkohë Meri qëndronte në mes të oborrit me krahët varur, pa i shkuar ndër mend se çfarë bisedohej për të. Vështroi njëherë rrotull gjithçka që e njihte përmendësh dhe e kuptoi se gjallërimi i vakët i asaj të diele kishte marrë fund. Tani e prisnin vetëm punët, përkujdesja për motrën e vogël, librat, meraku i zakonshëm për të atin dhe të vëllanë, që ishte mbyllur në vetvete dhe nuk dilte më nga shtëpia. Vetëm ai e dinte se ç'plane thurte në kokën e tij.

Ajo gati u pendua që e kishte refuzuar ftesën e pakmëparshme të Gencit për të hyrë në lokalin para të cilit ishin takuar. Por të nesërmen ftesa u përsërit, në dukje krejt e rastësishme. Ishin ditët e fundit të shkollës. Orën e pestë Meri kishte Fizkulturë. Mësuesja i kishte njoftuar se do të bënin një vrapim të gjatë dhe ajo vendosi ta linte fare atë orë. Iu lut Bledarit të thoshte se po largohej për arsye shëndetësore.

Ndërsa po çapitej e shkujdesur drejt shtëpisë, u ndesh me Klarën dhe Gencin. Ata e ftuan për një akulllore te "San Marino". Ajo nuk mundi të kundërshtonte. Me të hyrë në lokal, vuri re se në njërën prej tavolinave po priste Aldo Burimi. Ai u mundua të tregojë sa më i befasuar nga ardhja e saj.

- Sa mirë që u bëmë katër, - tha me qejf. - Isha i mërëzitur sot.

- E pse? - pyeti Klara.

- Nuk po duroj dot pa Greqinë. Erdhi koha të nisemi. Apo jo Genc?

Tjetri pohoi me kokë.

Ata porositën akulllore dhe filluan të bisedonin për një grup amerikan rroku që do të vinte së shpejti për të dhënë koncert në Tiranë. Në ato çaste Meri as nuk i kishte shkuar nëpër mend se Sidi mund të hynte aty në lokal. E trembur, ajo vuri re se ai po afrohej drejt tavolinës së tyre. Shikimet e tyre u ndeshën. Ajo u mat të ngrihej. Vetëm atëhere Genci dhe Aldo e vunë re Sidin. Fytyrat e tyre u vrenjtën.

- Mirëdita! - tha Sidi. - Meri, desha të flas pak me ty.

Genci i dha karrikes mbrapsht i nervozuar.

- Çuno, Meri më duket se është e shoqëruar me ne. Ti po deshe, merr një karrike dhe hajde ulu si njeri.

- Jo, nuk kam ndër mend të ulem.

Meri u ngrit me ngut.

- Ja Sid, erdha.

Genci dhe Aldo i ndoqën me sy ndërsa dolën nga lokali.

- Do t'ia thyej turinjte! - ia bëri Aldo.

- Mos u nxeh kot, - tha Klara. - E sqaron Meri gjithçka.

- Ai zdapi na e dhjeu se!

Ata të tre i kthyen sytë nga trotuari që dallohej qartë pas xhameve të mëdhenj të lokalit. Sidi dhe Meri kishin qëndruar pranë njëri-tjetrit. Ajo e mbante kokën ulur. Ai po i fliste, në dukje tepër i shqetësuar.

- Meri, si mund të ndodhi që ti të ikësh nga mësimi dhe të ulesh në lokal me këta njerëz që nuk i njeh?!
- Orës së Fizkulturës nuk ia kisha qejfin. Po ha një akulllore me atë fqinjën time, të fejuarin e saj dhe shokun e tij. Kaq. Ata më duken djem të mirë.

Sidi e vështroi disa çaste i hutuar.

- Meri, çfarë po ndodh me ty?

Ajo ngriti supet.

- Asgjë.

- Unë nuk po të njoh dot më.

- Po ç'të keqe po bëj xhanëm?! Në qoftë se ty të vjen inat pse nuk shoqërohem më me ty, e ke gabim.

Ai u largua edhe më i hutuar. Meri u kthye në tavolinë duke u munduar të tregohej sa më e qetë.

- Më falni, - tha.

- Në se ai tipi të bezdis, e sqarojmë ne, - tha Genci.

- Jo, aspak. E kam shok klase.

- Atëhere, thuaji të mos sillet herë tjetër ashtu si cub.

- Amani dhe ju se s'u bë ndonjë qamet, - ndërhyri Klara. -

Hajt, na tregoni ndonjë gjë të bukur.

Por situata nuk u përmirësua dot, me gjithë përpjekjet e Aldos që tregoi gjerë e gjatë për një udhëtim që kishin bërë në një ishull të largët të Greqisë. Merin e shpëtoi nga situata Klara, që tha papritur:

- Ne të dyja po dalim. Unë duhet të blej nja dy gjëra.
- Mirë, - ia bëri Genci. - Do të të telefonoj pasdite.
- Meri, besoj se do të shihemi prapë, - foli Aldo i pasigurtë.
- Nuk e di, - ia ktheu ajo.
- Këtu jemi, do të shihemi, - tha Klara. - Tani, mirupafshim!
Meri la mbi tavolinë lekët për dy akullore, por Aldo ia ktheu
i prekur.

- Sa të jesh me ne, nuk do të paguash.

- Jo, do të paguaj për vete dhe për Klarën.

Ai nuk e kishte pritur atë kundërshtim të vendosur të saj.

- Në rregull. Unë e kisha me gjithë zemër.

Ndërsa ato të dyja dolën nga lokali, ai vazhdoi t'i mbante
sytë nga dera me një pamje lakmie dhe zhgënjimi të lehtë.

- Nuk e kuptoj ç'drejqin të hipi në kokë me këtë Merin! - tha
Genci.

- Mos u bëj budalla, - ia ktheu shoku. - Atë do ta çojmë në
Greqi. Lëre teatrin që luaj unë me Klarën.

Genci mori një pamje mosbesimi.

- Të gënjen mendja! Mos na harxho kohën kot. Marrim këtë
bibën time dhe ikim. Duhet të ishim nisur tani. A e dëgjoje ç'tha
tezja në telefon?

- Pse të mos i marrim të dyja? E kupton ç'do të thotë t'i çosh
tezës dy llokume si këto? Do të fitonim pa frikë 1 milionë dhrahmi.

- Apo s'të jep tezja 1 milion ore!

- Të paktën 500 000 do të na i japë.

Genci tundi kokën me dyshim.

- Aldo, më duket se po humbim kohën kot. Kjo Meri është
dhelbër. S'e fut dot në dorë.

Tjetri qeshi.

- Ajo dhelbër?! Ajo është më bibë se Klara. Prit, se do ta shohim.
Uf, ma shpifi kjo akullorja! A do të pijmë gjë? Ke nga ato?

- Kam.

*

*

*

Meri shtangu kur hyri në oborr dhe pa se në verandë ishte

ulur mësuesja kujdestare. Po merrej me Norën. Me sa dukej kishte kohë që priste aty.

- Mirëdita! - tha vajza duke u skuqur e tëra.

- Besoj se kësaj here do të më tregosh të vërtetën, - ia ktheu mësuesja.

Meri tregoi gjithçka, pa ndryshuar asnjë detaj. Mësuesja u mendua gjatë pas atyre që dëgjoi.

- Ata të tre i njoh mirë, - tha pastaj. - Nuk e kuptoj, ç'të bashkon ty me ta!

- Asgjë mësuese. Klarën e kam këtu afër shtëpisë dhe... Ajo më duket njeri zemërmirë.

- Afër shtëpisë ti ke dhe vajza të tjera.

- Ato... nuk më afrohen më.

- Nuk është e vërtetë!

Meri psherëtiu me dëshpërim.

- Po, është e vërtetë. Dhe ju e dini fare mirë arsyen. Disa nga shoqet e klasës vinin shpesh në shtëpi. Ndërsa tani... I vetmi që nuk më shikon shtrembër është Sidi.

- Po prej ti, pse je larguar?

- Kam një arsye. Më falni, por nuk mundem t'jua them.

Mësuesja vështroi mënjanë e menduar.

- Po Gencin dhe Aldon, a i njeh mirë? - pyeti pastaj.

- I njoh nga fjalët e Klarës.

- Meri, pavarësisht se Klara mund të jetë zemërmirë, ti nuk duhet t'i besosh askujt. Je një vajzë në një pozicion shumë delikat dhe fare lehtë mund të biesh viktimë. Kjo është kohë viktimash dhe mashtruesish. Më kupton? Mashtruesit dinë t'i zgjedhin viktimat e tyre. Asnjë mashtrues nuk thotë se është i keq. Unë ia kam frikën edhe Klarës. Nuk i besoj asaj fejesës me Gencin.

- Po ata duhen shumë mësuese!

Tjetra nënqeshi me keqardhje.

- Klara mund ta dojë vërtet. Ndërsa ai... Nuk mundem t'i besoj. Ndaj të këshilloj edhe ty të mos shoqërohesh me ta. Unë që po të flas do të jem mësuesja jote edhe për pak kohë. Meri, që kur nëna jote vdiq, ti ke qenë dobësia ime në atë klasë. Jam shqetësuar për ty si për vajzën time. Nuk dua që ti të gabosh. Unë e di se sa e rëndë është kur të tjerët të largohen dhe je e

detyruar të mbyllesh tërë kohën në shtëpi. Por jeta kështu qenka. Duhet marrë si të vijë. Deri sa një ditë gjërat të ndryshojnë për mirë.

Ato të dyja ndenjën duke biseduar aty në verandë rreth një orë. Pastaj mësuesja u ngrit duke thënë:

- Meri, mendohu për të gjitha sa folëm.

Nxënësja i premtoi se do të mendohej.

Pasdite, kur shkoi nga teta Bardha, u hap papritur e njejtja temë. Gruaja shprehu pothuaj të njejtin shqetësim për afrimin me Klarën. Dukej e trembur nga Genci dhe Aldo.

- Teta Bardha, po ç'kanë ata për t'ua patur frikën? - u habit vajza. - Janë djem punëtorë. Së shpejti do të nisen për në Greqi për të punuar.

- Tamam asaj Greqisë i trembem më shumë. A të ka shkuar mendja se mund të të ftojnë edhe ty të shkosh me ta?

- Jo, - u përgjigj Meri e hutuar.

- Sa për Klarën, jam e sigurtë që do ta marrin me vete.

Meri nuk i kishte pritur ato fjalë.

- Po ajo është e fejuar!

- Fejesave të atilla unë nuk u zë besë, - ia ktheu gruaja ftoht.

- Meri, matu mirë në çdo hap që bën!

Pas asaj këshille që nuk linte shteg për diskutime të mëtejshme, ato vazhduan të punonin në heshtje. Meri u kthye në shtëpi e menduar. Aty gjeti vetëm të atin. Ai kishte si gjithmonë atë pamjen e mërëzitur dhe të lëshuar të një njeriu të rënë moralisht. Të paktën nuk paska pirë, mendoj vajza.

- Këto ditët e fundit Albi nuk më duket fort në terezi, - tha babai. - Mos i ka ndodhur gjë dhe nuk tregon?

E bija u kapërdi tërë siklet.

- Jo ba, unë... nuk di t'i ketë ndodhur gjë.

Ra mbrëmja dhe Albi nuk po dukej. Meri shkëmbeu disa herë vështrime me të atin. U mat njëherë të dilte jashtë për të kërkuar, por papritur ra zilja e telefonit. Ishte gjyshja.

- Meri, eja shpejt, - tha ajo e shqetësuar. - Kam Albin këtu.

Po tani, ç'të ketë ndodhur, pyeti vajza veten e hutuar.

- Ba, duhet të shkoj nga nëna, - iu drejtua të atit. - Edhe Albi qenka atje.

Tjetri e vështroi i trembur.

- Nuk do të ktheheni sonte?

- Do të kthehemi patjetër.

Meri u vesh dhe doli me ngut. Ndërsa po ecte trotuarit të Unazës, diku pranë Ministrisë së Jashtme, dalloi një figurë të njohur që kaloi në rrugë me biçikletë. Ishte Sidi. Ndërsa në ndenjësën e pasme metalike të biçikletës që ulur fqinja e tij, Ana. Duart e saj e kishin mbërthyer Sidin për beli. Meri i ktheu sytë mënjanë e turbulluar. Iu duk e largët, tepër e largët, sikur të mos kishte qenë kurrë, ajo kohë kur ulej vetë në ndenjësën e pasme të asaj biçiklete. Atëhere ajo përpiquej t'ia fshihte vetes të vërtetën, por ndjehej e lumtur, më e lumtura në botë, ndërsa biçikleta troshitej nëpër rrugët tërë gropa dhe ajo detyrohej të mbahej pas shokut.

Nuk e mori vesh ku shkeli deri sa mbërriti në shtëpinë e gjyshes.

16.

E gjeti të vëllanë shtrirë përmbys në një divan. Aty pranë tij gjyshja diç mërmëriste me vete.

- Hë, erdhe? - ia bëri ajo sapo pa Merin. - Ta lemë tët atë, po ti, nuk e di ç'mendje ka yt vëlla?

- Në se është fjala për Italinë...

Gjyshja përplasi pëllëmbët në prehër e alarmuar.

- Nga na doli kjo Itali që u prishi mendtë edhe kalamajve! Albi më kërkon të bind tim bir që ta marrë atje. Do iki këtë verë, thotë. Nuk më zë shtatori në Shqipëri. Pikë e zezë! Edhe kjo na duhet. Po kë të rregullojë im bir më parë?

- Asnjeri nuk më do! - thirri Albi. - Asnjeri s'më ndihmon!

- Ja, dëgjoje këtë, - ia bëri gjyshja. - Si more nuk të duam ne?!

Meri u ul pranë të vëllait dhe për një orë rresht e mori me të mira.

- Daja do të vijë këtë verë dhe do të flasësh vetë me të, - i tha në fund. - Hajt, mos e bëj gjyshen merak.

- Daja nuk më merr me vete po nuk e bindi nëna!
- Për kokën tënde që do të flasë me të! - u betua gjyshja.
Albi u ngrit me një pamje të pakënaqur.
- Mirë nëna, mirë, ta mbash mend!
Gjyshja tundi kokën me keqardhje.
- Do ta mbaj mor bir, do ta mbaj. Eh, sikur ta kisha unë në dorë fatin tuaj!

- Natën e mirë! - mermëriti Albi.
- Dale, mos ik ashtu i zemëruar. Prit të të jap një llokume.
Gjyshja shkoi duke çaluar te bufeja dhe mori një kupë qelqi. Ia zgjati të nipit ndërsa dora i dridhej. Ai mori një llokume dhe e futi të tërën në gojë. Pasi e gëlltiti atë, bëri drejt gjyshes dhe e përqafoi fort.

- Të ka nëna zemër, - tha ajo e mallëngjyer.
Meri dhe Albi u nisën drejt shtëpisë në heshtje. Secili mendonte për problemet e veta. Herë pas here përplaseshin në supet e njëri-tjetrit dhe vetëm atëhere kujtoheshin se ishin bashkë. Në rrugën e tyre, pranë pallatit të teta Bardhës, u përmendën nga boria e një veture. U dëgjuan të thirrura në emër të Merit. Ishin Klara, Genci dhe Aldo. Ata e ftuan për një picë.

- Falemnderit! - ua ktheu ajo. - Ndonjëherë tjetër.
- Hajde se do të shkojmë në një vend ku bëjnë pica kryevepër, këmbënguli Klara.

Meri tundi dorën dhe u ktheu shpinën. Boria e makinës ra përsëri. Në timon qëndronte Aldo.

- Ç'janë këta? - pyeti Albi duke vështruar me zili nga vetura. Motra ia tregoi.
- Hajde jetë, hajde! - ia bëri djali. - Veturë, shetitje, pica, muzikë...

- E morëm vesh! - e ndërpreu Meri.
Albi shtyu portën me bërryl. Kanati u lëkund disa herë, pastaj gërrviti vajtueshëm.

- Shembu edhe ti se na plase! - shfryu Albi me inat, pastaj u ul te shkallët duke thënë: - Unë po rri ca këtu me Sparkin.

E motra e ngriti për krahu.
- Futu njëherë brenda, thuaji babit mirëmbrema.
- Si duket ai sonte?

- Mirë. Vinte nga puna.

Ata hynë brenda dhe përshëndetën. Ndërsa babai filloi të bisedonte me Albin për punë shkolle, Meri bëri gati darkën. Ajo ditë iu duk acaruese. Gjithçka kishte ardhur për shkak të uljes në atë drejç lokalit me Klarën, Gencin dhe Aldon. Pak më parë, ata përsëri e kishin ftuar për të shkuar në një lokal tjetër. Ishte e sigurtë se ftesa të atilla do të vazhdonin. Ç'duhet të bëjë, pyeti veten ajo. Iu kujtua biseda me Sidin, fjalët e mësuese Lindës, të teta Bardhës. S'do të shkoj më, vendosi.

Por të pasnesërmen mbeti ngushtë kur Klara erdhi në shtëpi dhe e njoftoi e gëzuar se atë ditë mbushte 16 vjeç.

- Ya! Do të shkojmë te disko "Parajsa"! Do të bëjmë gallatë!

Meri mbërtheu duart me njëra-tjetrën dhe nuk po dinte nga t'i hidhte sytë.

- Ç'pate? U trembe se do të më bësh dhuratë? - qeshi Klara.

- Mos e vrit mendjen për këtë. Nga ty dua vetëm një tufë me lule. Dhuratat m'i bëjnë të tjerët.

- Nuk e kam hallin aty, - tha Meri. - Por... në disko s'kam qenë asnjëherë.

- Aq më mirë! Provoje me këtë rast.

- Sikur të shkonim në ndonjë vend tjetër...

- Meri! Lëri këto budallallëqe se nuk je më e vogël.

Tjetra provoi të kundërshtonte për herë të fundit duke thënë se ishte me provime, por Klara e vështroi e pakënaqur.

- Si?! Nuk do të vish në ditëlindjen time?! Deri në mbrëmje ke kohë plot për të mësuar. Apo të ka kërcënuar ai basketbollisti të mos rrish më me ne ?

- Ai nuk është njeri që bën kërcënime.

- Atëhere të ka mësuar kjo Bardha e byrekëve. Jam e sigurtë që ka llapur kundër meje. Është një turispece ajo që s'e ka shoqen.

- Klara, lëre Bardhën në hallin e vet. Të thashë që kam arsye të tjera.

- Meri, ti duhet të dish një gjë: unë ta afrova shoqërinë time pa hile. Genci dhe Aldo po ashtu. Nuk deshëm që ti të ndiheshe e vetmuar. Kjo është e gjitha. Se ç'flasin të tjerët, mua nuk më intereson. Veç, mos harro se shoqëri kështu s'të afron njeri kollaj. Në se ty të duket se të kemi bezdisur, mund të rrish edhe këtu

brenda me... Sparkin!

Fjalët e Klarës ishin të hidhura, por në to, gjithësesi, kishte një të vertetë.

- Më fal, unë nuk desha të të fyeja, - mëmëriti Meri.

- Një ditëlindje është një ditëlindje, - ia bëri tjetra me një nervozizëm të lehtë. - Kërcehet në disko dhe mbaroi puna.

- Të lutem, mos u mërzit!

Klara iu afrua dhe e përqafoi.

- Me ty nuk mërzitem unë. Inatin e kam me ata që llapin pas shpine. Pikë e zezë! Sikur u kam zënë derën dhe më mbajnë me bukë! Kështu janë shqiptarët. Po nuk futën hundët në punët e tjetrit, nuk i zë gjumi natën. Barkun e kanë bosh, por ama llapa u pret si shpatë. Njerëz injorantë! Po kështu qenka kur nuk shikon njeriu botë me sy. Ufa! Atëhere, si do ta lemë?

- Unë them të shkojmë me ditë që të mos mbesim atje deri natën vonë.

- Mirë. Do të vij unë të të marr. Mos të duhet gjë për të veshur?

- Jo. Do të sajohem si të mundem.

- Po këtë varësen me guacka, akoma e mban?

Meri ngriti dorën dhe i preku guackat si me mall.

- E mbaj. Më pëlqen.

- Vë bast se ta ka dhënë ai gjatovina.

Tjetra nuk foli. Klara nënqeshi.

- Meriyll! Në se vazhdon ta mbash mendjen tek ai, e ke gabim. Kërko diçka tjetër. Të re. Në këto kushte që je ti, duhet të kërkosh një fat më të mirë. Kështu do të ndihmoje edhe familjen.

- E nga ta gjej këtë fat?

- Eh, këtu nuk gjendet fati. Unë prandaj po iki në Greqi.

- Ti je ndryshe.

- Si ndryshe?

- Ke Gencin.

Klara qeshi.

- Nuk është zor për të gjetur edhe ti një si Genci.

Meri ngriti sytë e trembur.

- As nuk ma mban të mendoj të tilla gjëra.

- E dashur, këto janë gjëra që duhen menduar. Nuk shtyhet jeta me byrekët e Bardhës. Nejse, do të flasim ndonjëherë tjetër.

Tani ika!

Meri ndenji me shpresë se mos babai kthehej herët. Nuk donte të dilte pa lejen e tij. Por deri në çastet kur Klara thirri jashtë te porta, ai nuk u duk. Atëhere ajo u detyrua t'i linte porosi Albit.

- Do të shkosh me ata që kanë veturë? - pyeti ai papritur.

- Nuk e di kë ka ftuar Klara, - iu përgjigj e motra.

- Po Sidi, do të jetë?

- Çne?!

- U mor vesh, ka urdhër nga mami të mos shoqërohet më me ty. Ai që dukej aq i mirë, që i binte telefonit dhjetë herë në ditë! Eh, biberoni! Pordhaci i dreqit! Ta ktheu kurrizin me vrap.

Merit i shkaktuan dhimbje ato fjalë.

- Nuk është ashtu, - tha.

- Të gjithë njëlloj janë, - vazhdoi Albi. - Mos mbetsh keq se të largohen sikur të kanë rënë të gjitha sëmundjet ngjitëse të botës.

Meri doli duke u munduar t'i harronte ato fjalë. Albi kishte filluar ta shtangte me ato që thoshte. Që pas vdekjes së nënës, ai qe pjekur dukshëm.

Ndërsa po kapërcente rrugën së bashku me Klarën, sytë i shkuan nga ballkoni i teta Bardhës. Atë ditë nuk kishte shkuar të punonte. As teta Bardha nuk i kishte telefonuar. E vuri re atë pas njërit prej xhameve të mëdhenj të ballkonit ku shiste byrekët. Më pa, tha me vete. Kushedi ç'do të mendojë tani. Uf, e mori dreqi këtë punë! Gjithë faji është imi që jam bërë si pulë e trullorur që nuk di nga shkon.

*

* *

Disko "Parajsa" ishte një nga diskot më të reja në Tiranë dhe shquhej në veçanti për stilin e veçantë të ndërtimit dhe formën. E gjatë dhe me një tavan të lakuar, ajo i ngjante një shpelle gjigande ku muzika ushtonte cep më cep. Në atë orë të buzëmbërëmsjes ajo sapo ishte hapur dhe klientët ishin ende të paktë.

Meri hyri brenda me lëvizje të ngathta dhe duke vështruar majtas e djathtas e hutuar, si të gjithë ata që e provojnë për herë të parë mjedisin e zhurmshëm e gjysmë të errët të diskotekës.

Një djalë që po kërcente krejt i vetmuar, i përshëndeti. Ato zunë një tavolinë.

Dalëngadalë salla filloi të mbushej me djem e vajza të reja. Ia mbërritën edhe Genci me Aldon. Dukeshin në humor. Pasi uruan Klarën për ditëlindjen, ata i shtërnguan dorën Merit dhe u ulën.

- Vdiqa për të kërcyer, - ia bëri Aldo. - Ku je Klara, ku je! Do ta shpartallojmë diskon sonte. Apo jo Meri?

Tjetra ngriti supet si fajtoare.

- Ju e dini, unë nuk kërcëj.

- Sonte do të kërcëjmë bashkë, - këmbënguli Aldo. - Ka mbaruar kjo punë. Mundohu t'i harrosh ato gjërat e trishtuara. Genc, shkojmë marrim ndonjë gjë për të pirë.

Djemtë u ngritën dhe u afruan te banaku i ngushtë i një bari. Genci kërkoi dy birra dhe dy koka-kola.

- Sonte do t'i japim edhe yllit tonë një çikë pluhur magjik, - tha Aldo. - Të shohim pastaj se si do t'i vijë qejfi për të kërcyer.

- Mos trembet, - ia bëri Genci.

- E pse të trembet?! Ajo biba jote nuk është trembur asnjëherë.

- Ajo nuk di gjë ç'i kam dhënë unë.

- Edhe kjo tjetra nuk do të kuptojë gjë.

Aldo nxori nga xhepi dy paketëza të vockla letre. Hapi njerën prej tyre, e bëri letrën si tub, pastaj zbrazi në njerën nga shishet e koka-kolës një pluhur të bardhë, i cili u tret pa vonesë. Genci e trazoi pijen me një pipë plastike. Ato veprime u përsëritën edhe me shishen tjetër, ndërkohë që ata i kishin kthyer shpinën tavolinës ku qëndronin vajzat.

- Po për vete, do të marrim gjë? - pyeti Genci pas pak.

- Pijmë njëherë birrat, pastaj shkojmë në banjo, - ia ktheu shoku.

Ata u kthyen në tavolinë dhe lanë mbi të shishet.

- Gëzuar! - uruan pas pak Klarën. - Njëqind vjeçe!

Në sallë volumi i muzikës u ngrit. Ata që kërcenin u shtuan. Meri ndjeu se si filloi të gjallërohej papritur. Filloi të përplaste duart mbi gjunjë me ritmin e muzikës. Iu duk budallallëk të vazhdonte të qëndronte e mërziur dhe të vriste mendjen; jo më panë, jo s'më panë. E kishte marrë malli për të kërcyer. Në

ato çaste nuk i kujtohej se në ç'festë kishte kërcyer për herë të fundit me shoqet dhe shokët e klasës.

Aldo tërhoqi Klarën për dore.

- Tani është radha ime, - tha me mburrje. - Jam akoma kampion.

Ai filloi të kërcente me një zhdërvjelltësi të habitshme. Bënte ca lëvizje dhe hedhje të frikshme që tërhoqën vëmendjen e të gjithë sallës. Djem e vajza hapën një rreth dhe filluan të përplasnin duart. Klara mundohej të mos mbeste prapa, megjithatë me Aldon nuk krahasohej dot. Ndërsa shikonte ato skena, Meri u gjallërua edhe më shumë.

- Shkojmë edhe ne, - i foli Genci.

Ajo u mat të ngrihej. E kuptoi se ishte një lëkundje që nuk do të zgjaste shumë.

- Meri, hajde! - thirri Klara.

- Meri, mos na lër vetëm! - thirri edhe Aldo.

Vështrimet e atyre që kërcenin u kthyen drejt saj.

- Hajde Meri! Hajde Meri! - filluan të thirrurat në kor.

Ajo u ngrit dhe iu afrua grupit. Lëvizjet e para qenë të ngathta, të ndrojtura, deri sa iu përshtatën ritmit të shpejtë të muzikës. Pastaj ajo e mblodhi veten dhe filloi të kërcente me lëvizje të sigurta. Aty pranë saj Aldo bënte akrobacira duke qeshur.

Kishte kaluar rreth një orë duke kërcyer ashtu kur në sallë hyri Sidrit Arbana me Adrian Priskën, një shokun e vet të ekipit. Ai nuk u besoi syve kur dalloj Merin. Nuk i kishte besuar në fillim as Adrianit, kur shoku i kishte thënë se kishte parë Merin duke hyrë te diskoteka "Parajsa". Ata ishin takuar nga kodrat e liqenit ku zakonisht vraponin mbrëmjeve të verës. Me kë ishte e shoqëruar, kishte pyetur Sidi i shtangur. Njihja vetëm njërin prej tyre, ishte përgjigjur shoku. E quajnë Aldo. E kam patur në lagje. Sid, më vjen keq për Merin. Nuk po kuptoj dot asgjë...

Sidi ia nguli sytë atij njeriu të dashur që deri para pak javësh e kishte patur aq pranë. Po ikën, mendoj me dhimbje. Si ka mundësi të iki kështu, për hiçgjë. Pamja e saj e trembi. S'mbante mend ta kishte parë ndonjëherë ashtu. Dukej krejt e hallakatur. Fytyra i qe mbuluar nga djersët, këmisha i qe zbërthyer, flokët i kishin rënë mbi ballë dhe disa prej rricave ishin ngjitur aty prej

djersës. Ajo qeshte në mënyrë gati të pakontrolluar. Sytë i kishin marrë një shkëlqim të çuditshëm.

Ndërkohë Genci e mbërtheu Aldon për bërryli.

- Prapë ky qorri, - tha me inat.

Tjetri vështroi nga Sidi dhe Adrian Priska duke shtërnguar nofullat.

- Kësaj here do t'ia thyej kockën e hundës, - tha. - Nuk durohet më.

- Po bëre gjë këtu brenda, do të na dëbojnë nga diskoteka, - e këshilloi shoku. - Lëre, ia gjejmë rastin ndonjëherë tjetër.

- Si ta lë?! Ai do të kërkojë Merin. Ne dy zullapë këtu dhe ai qorr librash të na marrë yllin!

- Të shohim yllin ç'do të bëjë.

Ata shkuan të uleshin. Ndërkohë Sidi dhe Adriani ishin afruar. Meri i pa ata rastësisht. Tundi njëherë dorën, pastaj qëndroi. Sidi i foli, por për shkak të muzikës aty nuk dëgjohej asgjë. Atëhere ai i kërkoi të dilnin jashtë për pak minuta.

- Sid, pse s'vini edhe ju të kërceni? - tha ajo duke qeshur. - Diskot s'qenkan edhe aq të frikshme sa kanë namin.

Ai e mbërtheu për krahu.

- Meri, ti duhet të kthehesh në shtëpi! - foli me ton lutës.

- E pse?! - u habit ajo.

- Ty nuk të bashkon asgjë me ata njerëz.

- Uf, Sid, prapë ti me këtë moral? Erdha se Klara kishte ditë-lindjen. Tani dua të kërcej. Ç'ke që s'më le të kërcej?

Ai i gëlltiti ato fjalë qetësisht.

- Meri, më dëgjo, - vazhdoi. - Ne jemi me provime. Ti tani duhet të ishe duke mësuar. Notat e provimeve duhet t'i marrësh të mira me çdo kusht.

- E pse?

- Sepse... do të shkojmë në gjimnaz.

Tjetra qeshi me nënvleftësim të hapur për veten.

- Oh, Sid, desh më binde! Ti e di shumë mirë që unë nuk vij në gjimnaz.

Adriani e preku shokun në sup.

- Sid, sot është e kotë të lodhësh frymën. Ajo është si e dehur. Por tjetri vazhdoi të këmbëngulte.

Në këto e sipër Aldo Burimi u ngrit nga tavolina me mendjen e mbledhur për të nisur sherrin, por kësaj here që Klara që e mbajti.

- Mos u bëj budalla, - nënqeshi. - Ajo do të kthehet prapë këtu. Ja, do ta shohësh.

Aldo u ul i lëkundur.

- Ai qorri është me një çun që më njeh, - tha. - Kam frikë se do t'i flasim Merit keq për mua. Genci, e kupton muhabetin apo jo? I duhet dhënë qorrit një dru që të trembet dhe të na lërë rehat.

- E kuptoj, - ia ktheu tjetri. - Ja, të presim edhe pak.

Pas atyre fjalëve Meri u duk tek po vinte duke dredhuar mes djemve e vajzave që kërcenin.

- Ç'donte ai, kishte humbur syzet? - pyeti Klara duke qeshur.

- A hu! - ia bëri Meri. - Sidi s'donte të kërcente. Kurse unë dua të kërcëj!

- Edhe unë! - ia priti Klara.

Djemtë u vështruan mes tyre.

- Tani me këtë yllin mund të bësh ç'të duash, - tha Aldo. - E ka zënë mirë.

- Jo! Lëre, është hera e parë. Ndoshta e presin në shtëpi. Nuk duhet të vonohemi shumë.

- Atëhere, hajde i fusim edhe një të kërcyer.

Ata u larguan nga diskoteka pas orës 23. Meri u përmend vetëm kur vetura u ndal para shtëpisë. E pa veten në ndenjësën e pasme, pështetur në supin e Aldos. U tërhoq e trembur dhe i vështroi ata të tre e hutuar.

- Hë yll, ia kaluam bukur, ë? - pyeti Klara.

- Ah, po, - mermëriti Meri duke dalë. - Natën e mirë!

- Mirupafshim!

Ajo hyri në oborr dhe nga qetësia rreth e rrotull e kuptoi se duhej të ishte vonë. Gjeti te shkallët Albin që po përkëdhelte Sparkin.

- Hë, e paske bërë diskon telef, - tha ai. - Na trego ndonjë gjë.

- Nesër, - ia ktheu e motra. - Po më dhemb koka. Ku është babi?

- E zuri gjumi.

- A tha ndonjë gjë për mua?

- Jo.

- Unë po shkoj të shtrihem.

Albi e ndoqi ca çaste me sy pa kuptuar dot gjë. Meri hyri në banjo dhe u freskua me ujë të bollshëm, megjithatë ndjeu përsëri turbullim. Ngriti sytë nga pasqyra dhe u tremb nga pamja e vet. Nxitoi të futej në krevat duke shpresuar se të nesërmen gjithçka do të ishte ndryshe.

17.

Por kur u zgjua, gati volli. Koka vazhdonte t'i dhimbte. Trupi po ashtu.

- Meri, ç'dreqin kishe pirë dje? - e pyeti Albi në korridor.

- Vetëm koka-kola, - tha ajo e hutuar.

I vëllai e vështrroi njëherë me dyshim. Vajza dëgjoi lëvizje nëpër shtëpi dhe e kuptoi se i ati ishte bërë gati për të dalë. Priste kafenë e zakonshme.

Ajo u vesh dhe nxitoi në kuzhinë. E përshëndeti babanë pa e vështruar.

- Mirëmëngjesi! - tha ai. - Si e kalove dje?

- Mirë ba. Më fal që u vonova. Nuk do ta përsëris më.

- Kam plotësisht besim te ty.

Babai filloi ta pinte kafënë në këmbë.

- Nuk do të shkosh nga teta Bardha sot? - pyeti.

- Po, - ia ktheu ajo. - Pak më vonë.

Por sapo i ati doli nga shtëpia, nxitoi të futej përsëri në krevat. U përmend pas nja dy orësh nga të shkunduruarat e Albit.

- Është ai i shkurtri në telefon, - ia bëri i vëllai. - Kërkon të flasë me ty patjetër.

Meri mbuloi kokën.

- Nuk jam këtu.

Albi shkoi te telefoni dhe foli me ton ironik:

- Motra ime nuk ndodhet në shtëpi.

- Albi, të lutem! - këmbënguli Sidi. - Është diçka serioze.

Albi iu afrua përsëri së motrës.

- Thotë se është diçka serioze.

- Unë nuk jam këtu! - thirri ajo.

I vëllai e mbërtheu receptorin me inat.

- Megjithëse është gjë serioze, Meri nuk ndodhet këtu, - tha duke e mbyllur telefonin aty për aty.

Por pas një ore Sidi telefonoi përsëri.

- Dua të flas me Merin patjetër! - tha i nxehur.

- Dëgjo, a t'i ka ndërruar mami panolinat sot? - ia ktheu Albi me tallje. - Shko shiko punën tënde dhe na lër rehat!

Meri u tmerrua nga ato fjalë.

- Alb, si guxon t'i flasësh Sidit ashtu? - thirri e prekur.

- E meritonte.

- Ai nuk të ka fyer kurrë dhe ti nuk ke pse e fyen.

Albi ia nguli sytë i hutuar.

- Meri, a je në rregull ti sot?! Me atë Sidin, je prishur apo jo?

Edhe ajo e vështroi e hutuar.

- Alb... si të të them? Unë me të po... kurse ai me mua... jo... Ne... në të vërtetë... domethënë unë... por edhe Sidi...

I vëllai i ktheu kurrizin.

- Desh më sqarove për pak! Po s'ke faj ti! E kam unë që ngre atë dreq telefoni.

Meri mbeti në mes të korridorit me një pamje të vajtueshme. Tërë atë ditë nuk mundi as të bënte punë e as të mësonte për provimin e Matematikës. Plogështia i vazhdoi edhe të nesërmen. U mundua të zgjidhte disa ekuacione e të vërtetonte disa teorema, por pothuaj te të gjitha u ngatërrua. Punëve të shtëpisë vetëm sa u kaloi sipër e sipër.

Nga pasditja telefonoi papritur Klara.

- Meri, a mund të vish pak këtu te shtëpia ime? - foli me ton miqësor. - Do të bisedojmë diçka të rëndësishme.

Meri nuk e kishte pritur atë ftesë.

- Nuk mund të bisedojmë njëherë tjetër? - tha duke dashur të shmangej.

- Jo. Është diçka që nuk pret.

Ajo u detyrua të vishej. Ndërsa iu afrua hyrjes së pallatit, vuri re se teta Bardha po e ndiqte me vërejtje që nga vendi i saj i zakonshëm në ballkon. Vajzën e nervozoi ai detaj. Po kjo, pse

më përgjon, foli me vete.Ç'të keqe po bëj xhanëm?!

Kur hyri te Klara, nervozizmi iu kthye në hutim. Gjeti brenda Gencin dhe Aldon. Ata e përshëndetën shpenguar dhe e ftuan të ulej.

- Nuk kam kohë, - foli Meri pa i vështruar. - Duhet të shkoj të mësoj.

- Është një bisedë pesëminutëshe, - buzëqeshi Aldo. - Ulu të lutem! Na dëgjo.

Ajo u ul në një karrike, pa u pështetur në shpinoren e saj.

- Meri, është diçka në të mirën tënde, - ndërhyri Klara.

- Ne e dimë gjendjen e familjes tënde, - vazhdoi Aldo. - Duam të të ndihmojmë. Të gjithë. Të ftojme me gjithë zemër të vish me ne në Greqi.

Meri lëvizi vendit e trembur.

- Unë... në Greqi?! Çne unë?! Ju falemnderit, por...

Aldo buzëqeshi.

- Pse trembesh kështu?! Atje do të jesh mes njerëzish të mirë. Unë kam familjen. Genci ka tezen. Do të jetë edhe Klara.

- Mendohu njëherë, - tha Genci.

- Ne mund të të presim, - tha Klara. - Mbaro provimet dhe...

Por Meri u ngrit vrulltazi në këmbë.

- Shiko... ne... më duket se jemi keqkuptuar.

- Si keqkuptuar?! - pyeti Aldo.

- Unë nuk kam aspak ndër mend të largohem nga shtëpia.

Ju vazhdoni planin tuaj.

- Prit njëherë! Mendohu. Ne e kemi për të mirën tënde.

- Ju falemnderit! Nuk kam ç'të mendoj.

Meri bëri me ngut drejt derës.

- Më falni, duhet të shkoj.

Të tjerët mbetën të zhgënjyer nga sjellja e saj.

- Aldo, ta kam thënë, po harxhojmë kohën kot, - shfryu Genci me inat. - Mos të të gënjejë mendja se Meri do të bjerë vdekur pas teje.

Tjetri nuk u prek nga ato fjalë.

- Atë do ta shohim! - ia ktheu shokut me inat. - Ti po u mërzite, merr Klarën dhe nisu!

- Ah, tani na kënaqe fare!

- Mos u nxehni kot, - ndërhyri Klara. - Genc, të presim edhe ca.

Ndërkohë Meri po dilte nga pallati. Bardha e thirri.

- Eja pak këtu, - foli me një ton që s'pranonte kundërshtim.

Vajza u bind, por përbrenda ishte gati të shpërthente. Ato kohë e fundit ajo grua kishte filluar të sillej ndaj saj me një afri-mitet të tepëruar. E pyeste për çdo gjë, e këshillonte për çdo gjë. Para disa ditësh kishte paguar te ushqimorja e lagjes një borxh që Meri nuk po e lante dot prej javësh. Ishte çuditur kur shitësja i kishte thënë duke buzëqeshur se nuk i detyrohej më asgjë dhe se lekët i kishte shlyer Bardha...

Por më shumë e kishte turbulluar përkujdesja që gruaja kishte treguar një natë për babanë. Ai qe helmuar me një raki të dyshimtë që qarkullonte nëpër lokale. Ishte bërë petë. Kishte vjellë disa herë radhazi. Atë natë të frikshme teta Bardha ishte gdhirë në shtëpinë e tyre. Disa herë i kishte vënë babait dorën në ballë dhe i kishte fshirë djersët. Atë veprim Meri nuk kishte mundur ta harronte dot...

Hyri në korridor dhe qëndroi në këmbë duke vështruar sa në njerin krah në tjetrin.

- Dua të di ç'të lidh me atë Klarën, - foli Bardha. - Ku ke qenë me veturën e atyre djemve? Po tani, ç'bisedove me ta?

Meri nuk duroi dot.

- E pse duhet t'i dish këto? - iu kthye ftoht. - Me ç'të drejtë?

Gruaja u shtang nga ai ton.

- Si... unë s'paskam të drejtë... të të pyes?! - tha duke u skuqur.

- Pse më more në punë, kjo nuk do të thotë se unë duhet të të jap llogari për çdo gjë, - vazhdoi vajza me të njëjtin ton. - Dhe tani, a mund të të pyes unë ty: pse duhet ta paguaje ti atë borxhin tonë te ushqimorja?

Bardha e humbi. Uli kokën.

- Unë... doja t'ju ndihmoja.

- Unë nuk jam kalama. Dua të di pse ti tërë këtë kohë je kujdesur kaq shumë për familjen time? Pse më pyet gjithmonë për babin?

Gruaja mbuloi fytyrën me duar.

- Në se ti mendon se kam patur ndonjë synim, gaboresh

vajzë e mbarë. Pas këtyre fjalëve, s'na mbeti gjë tjetër për të thënë. Të lutem dil nga shtëpia ime dhe mos shkel më këtu!

Meri ngriu. U mat njëherë të thoshte diçka pajtuese, por e zonja e shtëpisë i tregoi derën.

- Bëj ç'të duash! - thirri e ngashëryer. - Ik, më ler në hallet e mia! Mosmirënjohëse!

Vajza hapi paksa derën dhe doli me ngut. Me të mbërritur në shtëpi, u pendua për atë që kishte bërë, por tashmë ishte vonë. Si arrita ta fyeja atë njeri ashtu, pyeti veten e tronditur. Po tani, kujt do t'i kërkojë ndihmë?

Ngjarjet e papritura të asaj dite e shushatën përfundi-misht. Si kishte arritur puna deri atje sa që Klara, Genci dhe Aldo ta ftonin për të shkuar në Greqi së bashku? Pse kishte folur pikërisht Aldo? Po Klara, pse e kishte afruar aq shumë? Pse e kishte joshur me Greqinë? Ç'lidhje kishte mes Aldos e Klarës?

Ato pyetje lodhëse ia bëri vetes me dhjetra herë deri sa përfundoi me një dhimbje tjetër koke. Provoi të lexonte ndonjë gjë në librin e Matematikës. Por më kot. Rreshtat i ngatërroheshin njëri me tjetrin sikur gërmat të ishin një ushtri e çorientuar milingonash të trembura që nuk gjenin dot rrugën.

*

*

*

Sidi e hapi librin e Matematikës për të tretën herë dhe po për të tretën herë e mbylli pas pak. Njëpër faqe i fanitej vetëm fytyra e Merit. Ajo kishte atë pamjen e frikshme të diskotekës; me sytë që i ndriçonin dhe rricat e flokëve të lagura nga djersa, ngjitur në ballë e faqe. Si arriti të përfundonte me ata njerëz në diskotekë, pyeste ai veten i hutuar. Si arriti të qeshte e të kërcente ashtu? Duhet të gjej pajtetër kush ëshë ky Aldo.

Pas telefonatës së fundit, kur Albi i kishte përmendur mamin dhe panolinet, ai qe nxehur keqazi dhe kishte vendosur të hiqte dorë nga çdo përpjekje për t'u arfruar përsëri me Merin. Në fillim i qe dukur se ajo tallje e hidhur kishte qenë shpikje e saj. Por më vonë, kur inati i qe ftohur, e kishte kuptuar se Meri nuk mund të arrinte deri aty. Budallallëku duhej të kishte qenë i Albit.

U ngrit dhe i telefonoi Adrian Priskës.

- E Sid, do të takohemi sot nga liqeni? - pyeti shoku.

- Adri, sikur ta linim fare atë vrapin sot? Kam nevojë për ndihmën tënde. Të kujtohet ai fytyra me të cilin Meri ishte në disko? Aldo? Më the se e ke patur komshi. Si mund të mësojmë ndonjë gjë për të?

Tjetri u gëlltit si me siklet.

- Sid, vërtet beson akoma te Meri?

- Po. Adri, Merin e njoh mirë. Harroje atë që pe në disko.

- Mirë. Atëhere po të pres para hotel "Dajtit".

Sidi u ndërrua me ngut dhe mori biçikletën.

- Nga po shkon? - pyeti e ëma që nga dera e dhomës së ndenjies.

- Nga liqeni, - ia ktheu i biri.

- Po tutat e sportit, ku i ke?

- Sot nuk do të vrapoj.

Elona bëri disa hapa para.

- Ka ca ditë që të shoh nervoz, - tha. - A mund ta di si e ke hallin?

- Nuk kam asnjë hall.

- Mesiguri është fjala për Merin, apo jo?

- E sikur të ishte për Merin, ti a më ndihmon dot?

Elona nënqeshi.

- E ç'të të ndihmoj? Jam e sigurtë që ajo është lidhur me ndonjë djalë tjetër dhe ti po mërzhitesh si budalla.

Djali e mbërtheu biçikletën me të dyja duart, e ngriti nja një pëllëmbë nga dyshemeja, pastaj e lëshoi me inat.

- Meri nuk është lidhur me asnjë djalë!

- Sid, mua nuk më gënjen dot!

- Ma, ti nuk e njeh atë!

- Po ti, nga e njohe? Apo mban mend atë Merin e klasës së pestë? Sid, ti je pa përvojë dhe ajo vajzë po të vë në lojë. Dije mirë këtë!

I biri tundi kokën me keqardhje.

- Ma, ti i përçmon njerëzit kot, vetëm se nuk kanë para e veturë si puna jote.

- Oh, lëre, goxha fjalë të bukura që na the!

Ai doli duke u munduar që të qetësohej. Përshkoi rrugën e ngushtë mes pallateve, pastaj doli në Unazë. Po ecte në drejtim të hotel "Dajtit", kur papritur një veturë i bllokoi gradualisht kalimin. Sidi u detyrua të ngjitej në trotuar nga krahu i Lanës. Vetura u ndal dhe prej saj dolën me vrull dy djem që ai tashmë i njohte mirë. Ata u afruan me një pamje që pasqyronte vetëm mllef dhe bezdi. Sidi la biçikletën në kambalec dhe qëndroi para tyre me duart në bel.

- Çuno, kemi vetëm dy fjalë me ty, - foli Aldo Burimi. - A ke ndër mend të largohesh nga Meri apo jo?

- Jo, - u përgjigj tjetri qetësisht. - Aspak.

- Po se ç'të punojmë ne, a e di?

- Bëni ç'të doni. Nga Meri duhet të largoheni ju dhe jo unë.

Aldo nënqeshi, pastaj vështroi nga Genci. Tjetri hapi krahun krejt tinëzisht dhe e goditi Sidin në bark me tërë fuqinë. Ai u përkul instiktivisht, por ndërkohë Aldo e goditi në fytyrë. Syzet me skelet metalik ranë të thyera për tokë. Sidi vuri duart në fytyrë dhe ndjeu se nga balli filloi t'i rridhte gjak.

- Mos guxo t'i afrosh më Merit se ka edhe më keq! - thirri Aldo.

Ndërsa Genci mbërtheu biçikletën dhe e vërviti në rrëpirën drejt Lanës. Ajo bëri disa rrokullisje dhe përfundoi në ujin e cekët të përroit. Ata të dy nxituan në veturë dhe u larguan duke lënë pas fishkëllima gomash.

Sidi drejtoi trupin i ndjekur nga vështrimet e trembura të disa kalimtarëve. Futi në xhepin e këmishës syzet e thyera, pastaj zbriti poshtë në Lanë dhe nxori nga uji biçikletën. Ajo kishte pësuar disa dëmtime të vogla dhe një shtrembërim të timonit. Ai e drejtoi atë duke futur mes gjunjëve rrotën e parë. U nis për në shtëpi duke ndjerë një dhimbje të fortë në pjesën e sipërme të hundës. Mbi vendin që rridhte gjak vuri shaminë, e cila u përskuq brenda pak minutave.

Kur hyri në korridor, e ëma vuri duart para gojës duke lëshuar një klithmë të zgjatur. I ati u detyrua të dilte me ngut nga studioja. Ata mbetën të dy të shtangur ndërkohë që i biri pështeti biçikletën pas murit dhe hyri në banjo të lahej. Pritën te dera deri sa ai doli, ende me peshqir në duar.

- Sid, ndonjë makinë? - pyeti Ariani.

- Po ba, u përplasa me një makinë. A më mjekon dot të lutem?

- Sigurisht. Ulu.

Sidi hyri në dhomën e ndenjies dhe u ul në një karrike. Ndërkohë që i ati filloi të merrej me vendin që kullonte gjak, e ëma po e vështronte tërë dyshim.

- Sid, je i sigurtë që ishte përplasje makine? - pyeti papritur.

- Po, - u përgjigj i biri thatë.

- Kurse unë them jo.

- Si jo?! - pyeti Ariani.

- Tët bir e ka goditur dikush.

- E pse duhej ta godiste?!

- Arian, ti e di fare mirë pse ngatërrohen djemtë.

Babai ndërpreu punën.

- Sid, je zënë për Merin?

I biri nënqeshi.

- Ba, ishte një makinë.

- Kujtova se ishte zënë vërtet për Merin, - ia bëri i ati i zhgënjyer.

- Pse, çfarë, sikur të ishte zënë për Merin? - ndërhyri me tërsëllëmë Elona.

- Është burrërore të zihesh për një vajzë.

Ajo ia ngjeshi ballit me dorë.

- Këtë djalë do ta marrësh ti më qafë me këto që i mëson! - thirri. - Ai është futur në sherr për atë Merin e bukur, por nuk ia mban ta pranojë. Ajo, për hakmarrje, ka futur njerëz për t'i zbutur Sidit kurrizin. Ja, kush na doli edhe Meri! Ja, me çfarë tipash është lidhur!

Sidi u bë nervoz në çast.

- Ma, të lutem mos fol ashtu për Merin!

- Meri nuk e ul veten me të tilla gjëra, - e pasoi i ati. - Është vajzë e rrallë. Dhe nuk është lidhur me askënd tjetër! Ajo s'do ta ndërronte Sidin me asnjë djalë tjetër në botë.

- Ashtu, ë? Dale, dale, se do ta shohim. Kushedi se ç'do t'i ndodhë nesër tët biri.

- Elona, na lër të punojmë, të lutem!

Ajo doli nga dhoma dhe u kthye vetëm pasi i biri qe ngritur nga karrikja.

- Po syzet? - pyeti befas.

Sidi nxori nga xhepi syzet e thyera dhe i vuri mbi tavolinë.

- E tmerrshme! - klithi e ëma. - Syzet e blera në Gjermani 300 marka! Arian, po tani? Do të mburreni më me atë trimërinë e të zënit për vajzat?

Sidi e mbante kokën ulur. I ati vështroi syzet. Ato i ngjanin një shpendi krahëthyer që nuk do të ngrihet më kurrë në fluturim.

- Hallall edhe syzet! - ia bëri. - Pas disa vitesh Sidi do t'i mburret Merit: "E dashur, për ty kam lënë dikur në fushën e betejës një palë syze gjermane të cilat mamaja ime e shtrenjtë m'i kishte blerë 300 marka".

Elona ia ngjeshi përsëri ballit me pëllëmbë.

- E tmerrshme! Me kë të flasësh! Ju keni lajthitur të dy. I madh e i vogël!

- Mundet, - ia ktheu i shoqi duke bërë drejt studios. - Jeta ka lajthitjet e veta.

Sidi buzëqeshi me cepat e buzëve, i lehtësuar disi prej asaj që kishte ndodhur. Adriani i telefonoi vonë në mbrëmje.

- Sid, u bëra një orë monument para "Dajtit", - tha me inat. Shoku ia shpjegoi si kishin rrjedhur ngjarjet.

- A ha, qenkan ngatërruar punët keq! - psherëtiu tjetri. - Po tani?

- Tani asgjë. Unë nuk tërhiqem. Do takohemi nesër nga pasditja se paradite jam në provim.

- Në rregull. Ia kalofsh mirë!

18.

Meri u nis për në provimin e Matematikës pa ndonjë emocion të veçantë. Kishte kohë që notat nuk i bënin më përshtypje. Idea se nuk do të vazhdonte gjimnazin apo ndonjë shkollë tjetër si shumë të tjerë, e kishte bërë krejt mospërfillëse ndaj mesatares. Ajo mospërfillje kishte rënë në sy edhe mësueses kujdestare në provimin e Gjuhës. Ndonëse ajo i kishte vënë 9, Meri e kishte patur fare mirë të qartë se nuk meritonte më shumë se 7.

Me të hyrë në oborrin e shkollës, vuri re Sidin që ishte pështetur në njerën prej tabelave të basketbollit. Dukej i lëshuar e i mërzhitur. Kur Meri u afrua, dalloj se në pjesën mes hundës e ballit ai kishte vënë një fashetë elikoplasti. Pjesa nën syrin e djathtë i qe nxirë. Syzet me skelet plastik, me të cilat shkonte zakonisht në stërvitje, i mbante në dorë. Gjëja e parë që ajo mendoi qe ndonjë përplasje me biçikletë apo rrëzim në stërvitje. Priti që ai ta përshëndeste, por Sidi nuk e kishte mendjen.

Ajo u mat t'i afrohej, por ndërkohë mësuesja e Matematikës i thirri të futeshin në palestër ku do të kryhej provimi. Ndërsa Meri po ngjiste shkallët, ndjeu një prekje në sup. Ishte Bledar Belshi.

- E more vesh për Sidin? - pyeti ai me një pamje dyshuese.

- Jo, - u përgjigj ajo. - Ç'i kishte ndodhur ashtu?

Pamja dyshuese e Bledarit u bë edhe më e theksuar.

- Vërtet nuk e di?

- Bled, ç'ke që më shikon kështu?

Tjetri tundi kokën me keqardhje.

- E kishin sulmuar në rrugë ata dy qelbanikët.

- Cilët?!

- I fejuari i asaj Klarës që kemi patur vjet në shkollë dhe një shok i tij.

Meri e vështroi e trembur.

- Bled, a je i sigurtë?

- Ma tha Sidi me gojën e tij.

Meri ndoqi rrugën për në palestër krejt e hutuar. Zuri vendin më të afërt që i doli para. Vonë, vetëm pasi qe hapur zarfi i provimit dhe mësuesja kishte bërë disa sqarime në lidhje me ushtrimet e problemet që kishin rënë në tezë, Meri vuri re se Sidi ishte ulur pas saj. Ndonjë orë ajo ndenji pështetur mbi bërryl, pa e patur fare mendjen te fletat që kishte para vetes. Vetëm kur mësuesja iu afrua pranë, filloi të zgjidhte njërin nga ushtrimet që iu duk më i thjeshti. Mbaroi punë me të pa qenë e sigurtë në se përfundimi ishte i saktë apo jo. Provoi pastaj të zgjidhte një problem gjeometrie, por më kot. Mundimi nuk ia vlejti edhe me një ekuacion.

E nervozuar, ajo u mat të dorëzonte fletën, por mësuesja

nuk e lejoi të ngrihej.

- Nuk mundem më, - tha Meri.

- Përpiqu! - ia ktheu mësuesja. - Ke kohë deri në orën 12.

Ajo filloi të merrej me të njëjtin ekuacion, kur papritur dëgjo zërin e Sidi:

- Meri, mundohu ta kapësh këtë top letre. Po ta hedh te këmbët.

- Jo, - pëshpëriti ajo. - Nuk e dua. Nuk e bëj dot. Nuk mundem të kopjoj.

- E di që nuk ke kopjuar kurrë, por duhet ta bësh, - vazhdoi Sidi. - Vetëm sot!

Meri dëgjo kërcitjen e lehtë të topit prej letre në këmbët e saj. Nuk guxoi të lëvizte. Kaluan minuta me radhë.

- Meri, të lutem merre! - këmbënguli Sidi.

Ajo u lëkund.

- E marr po të më thuash se nuk më vë faj për atë që ka ndodhur.

- Meri, ç'i ke këto budallallëqe? Unë e di shumë mirë se ti nuk hyn fare në atë histori.

Ajo zgjati dorën dhe e mori topin e letrës tërë frikë. E hapi atë dhe filloi të kopjonte duke bërë një shkrim të keq. Sidi i kishte zgjidhur një shprehje shkronjore, një problem me përqindje dhe ekuacionin me të cilin ajo ishte torturuar gati një orë. Meri doli nga palestra me grupin e fundit të nxënësve. Kur dorëzoi fletat, vështrimi iu ndesh me vështrimin e mësueses. Shko, sikur thoshin sytë e saj, zëre se nuk pashë asgjë.

Sidi po e priste në fund të korridorit. Ajo qëndroi pranë tij kokulur.

- I kopjova të gjitha, - tha si fajtoare.

- Nuk do të ndodhë më, - ia ktheu ai. - Harroje!

Ajo ngriti sytë dhe e vështroi.

- Po ti... po ata idiotët... ç'patën me ty? - mermëriti.

Tjetri mblodhi supet.

- Sid, unë... të betohem për shpirtin e mamit... se nuk kam faj.

Ai buzëqeshi me dhimbje e keqardhje përzier bashkë.

- Meri, i vetmi faj i yti është që nuk më tregon pse u largove nga unë.

Ajo ngriti dorën ngadalë drejt fytyrës së tij dhe preku me

gishta fashetën e vendosur midis hundës e ballit. Ndërkohë, mes jakës së hapur të këmishës së saj, ai dalloi rreth qafës varësen me guacka.

- Sid, - mërmëriti Meri. - Nuk e besoj se do të takohemi më. Falemnderit për gjithçka që ke bërë për mua!

Ai u tërhoq mbrapsht si me frikë.

- Jo, ne do të takohemi prapë. Bile këto ditë.

Dora e saj mbeti për ca çaste e zgjatur drejt tij.

- Meri, unë nuk do të të lë vetëm.

Ajo u largua nëpër korridorin e gjatë pa folur. Ndërsa përshkoi oborrin dhe kapërceu portën ku kishte hyrë e dalë me mijra herë në ata vite, shkolla iu duk e largët, si diçka që nuk i përkiste më.

U kthye në shtëpi me një mendim të vetëm në kokë. Ngriti telefonin dhe formoi numrin e Klarës. Por nuk iu përgjigj njeri. E kërkoi atë pasdite disa herë radhazi, deri sa më në fund Klara iu përgjigj me një ton habije:

- Meri, pse më ke kërkuar kaq shumë? Ke ndonjë gjë të bukur për të më thënë?

- Dua të takoj pak Gencin dhe Aldon, - iu përgjigj ajo ftoht.

- Pse, si është puna?

- Flasim më vonë.

- Mirë, ja, dalim bashkë. E kam lënë sonte të takohem me ta te "Peshku i artë".

Meri iu lut të vëllait të kujdesej për shtëpinë.

- Nuk do të vonohem shumë, - tha.

- Do të shkosh prapë në disko? - tha Albi.

- Jo, vetëm do të bëj një shëtitje me Klarën.

Ajo doli pa u kujdesur për pamjen e jashtme. Klara po e priste në rrugë, duke u munduar të nuhaste se ç'kishte ndodhur.

- Pse je kaq e nevrkosur? - pyeti.

Tjetra ia tregoi ç'kishte ndodhur. Klara shfryu njëherë si me bezdi.

- Ata të dy janë budallenj!

Meri nuk i ktheu përgjigje.

- Po ty, akoma të vika keq për atë Sidin?

- Veprimi i tyre është shumë i shëmtuar.

Ato e bënë pjesën më të madhe të rrugës pa folur më. Edhe Klara u bë nervoze. Bar-pastiçeri "Peshku i artë" ndodhej në afërsi të stadiumit olimpiq. Ia kishin vënë atë emër për shkak të një akuariumi të bukur me peshq të vegjël në ngjyrë të artë që ishte vendosur mes pemëve, në një cep të lulishtes së lokalit. Vajzat zunë një tavolinë. Klara porositi dy akulllore.

Kur Genci dhe Aldo ia mbërritën aty me veturë, prania e Merit i kapi të papërgatitur. Megjithatë, u përpoqën të tregoheshin sa më të qeshur.

- Meri, sa mirë që paske ardhur! - ia bëri Aldo duke rrezatuar vetëm ëmbëlsi.

- Erdha vetëm për të sqaruar diçka, - ia ktheu ajo. - Ju nuk keni asnjë të drejtë të prekni Sidin me dorë!

Ata morën një pamje habie.

- Po ne u nisëm për mirë! - tha Genci.

- Unë nuk ua kërkova atë lloj heroizmi.

- Ashtu?! E po, na fal.

- Në se kemi vepruar gabim, jemi gati t'i kërkojmë falje edhe atij Sidit, - vazhdoi Aldo. - Pandehëm se ai po të bezdiste. E kupton? Të lutem, mos u mërzit për kaq gjë.

Ajo u detyrua ta ndryshonte disi pamjen e vrenjtur. Ndoshta ata nuk kanë faj, mendoi. Nuk e dinë pse unë u largova nga Sidi.

- Meri, le ta harrojmë këtë histori, - ndërhyri edhe Klara. - Ta kalojmë këtë mbrëmje pa budallallëqe.

- Ju mund të vazhdoni.

Ata iu lutën të tre me ngulm që të qëndronte. Aldo i bëri shenjë kamarierit të afrohej dhe porositi birra e lëng frutash. Ndërkohë nxori nga xhepi një pako me çamçakizë dhe ua zgjati në fillim vajzave.

- Provojini, s'kanë hyrë ende në Shqipëri. Meri! Të lutem edhe njëherë të na falësh. Ne djemtë edhe ngutemi.

Meri mori një çamçakëz në formën e një karameleje dhe e futi në gojë pa e vështruar. Klara po ashtu.

- Këtu ka një akuarium fantastik, - tha Genci. - Klara, çoje Merin ta shohi.

- Oh, mirë ma kujtove!

Klara e tërhoqi Merin për dore. Ajo u lëkund. Po rri edhe ca,

mendoi. Ja, t'i shoh edhe këta peshqit.

Iu afruan akuariumit me kureshtje. Fundi i tij ishte një imitim i shtratit të detit, me korale dhe bimë të tjera të blerta. Një tufë peshqish të artë lëviznin nëpër to me ngathtësinë e atyre krijesave që e dinë fare mirë se në çfarë hapësire jetojnë. Vetëm një peshk i çuditshëm me ngjyrë gri që ngjitur për xhami me buzët e tij të trasha. Rrinte i palëvizur, si një gozhdë e ngulur në mur.

- Po ky, ç'bën kështu? - pyeti Klara një kamarier që kishte qëndruar aty pranë.

Tjetri qeshi.

- Ai është "Pastruesi i xhamave". Atë punë bën tërë ditën. Jeton me mikroorganizma që ngjiten pas xhamit.

Vajzat ia ngulën sytë peshkut të habitura. Ndërkohë Aldo po i ndiqte me vështrim.

- Sot e ka dozën më të fortë, - iu drejtua shokut.

- Kot lodhesh, - foli Genci. - E nuhas që nga ajo nuk do të dalë gjë.

- Kurse unë nuhas të kundërtën, - ia ktheu Aldo.

Pas pak vajzat u kthyen në tavolinë. Meri sapo ishte ulur, kur përballë, matanë kangjellave që ndanin lokalin nga trotuari, dalloi mësuese Lindën. Ajo ishte bashkë me të shoqin. Po vështronin të dy në drejtim të tavolinës së tyre. Me sa dukej kishin kohë që qëndronin aty. Papritur, mësuesja ngriti dorën duke shpresuar se Meri do t'i përgjigjej. Por nxënësja e saj lëvizi karriken duke kthyer kurrizin nga ana e gardhit. Ndoshta nuk më ka njohur, mendoi.

Të tjerët e vunë re sikletin e saj.

- Ej, ç'pate kështu? - pyeti Klara.

Djemtë vështruan nga gardhi.

- Po kjo, ç'dreqin do? - ia bëri Aldo me inat.

- Shtriga! - shau Genci. - Kushedi sa katra më ka vënë në Gjuhë.

- Mos shikoni andej, - foli Meri. - Ajo po rri aty për mua.

- Mos e vrit mendjen, - ia bëri Klara. - Shkolla e pat.

Meri vazhdonte të qëndronte përkulur mbi gotën me lëng frutash.

Mësuese Linda nuk e kishte besuar se nxënësja e saj do të shtirej se nuk e kishte parë.

- E ke kot, - i foli i shoqi. - Ajo nuk e ka ndër mend të ngrihet. Lëre në punën e vet. Tashmë nuk ke më asnjë lloj detyrimi ndaj saj.

Linda u tërhoq nga gardhi e tronditur.

- Nuk e kuptoj pse shqetësohesh kështu, - tha i shoqi. - Ata janë të rinj. Po pijnë nga një limonadë dhe pastaj do të kthehen në shtëpi.

- Agim, Meri nuk duhej të ishte në atë tavolinë. Më kupton? Në se dikush nuk e tërheq, mund të përfundojë keq.

- Më duket se ti e bëre punën tënde. Shumë më tepër bile. Mësuesja ktheu edhe njëherë kokën prapa.

- Agim, ajo vajzë është një pjesë e jetës sime. Nuk dua që të humbi thjesht se nuk e përkrahu askush kur kishte nevojë. Në se ajo humb, rrëshqet në rrugë të keqe, unë do të humbisja një pjesë timen.

I shoqi e vështroi i menduar.

- E ç'mund të bëjmë tjetër?

- Gjithmonë mund të bëhet diçka. Do të shkoj të bisedoj njëherë me të atin e saj.

- Mendon se mund të arrish gjë me këtë?

- Do të provoj gjithçka që të jetë e mundur.

- Në rregull. Provoje. Megjithatë, jam i bindur se do të zhgënjehesh përsëri.

Ata bënë një copë rrugë.

- A të të pres? - pyeti Agimi kur mbërritën pranë shtëpisë së Merit.

- Jo, më mirë shko, - ia ktheu e shoqja. - Do të përpiqem të mos vonohem.

Ajo trokiti në portën e vjetër me një ndjenjë pasigurie. U dëgjua një e lehur qeni, pastaj zëri i Albit. Ai u befasua kur pa mësuesen të hynte në oborr.

- Urdhëroni, - tha duke i ngritur sytë nga veranda. - Ba, është mësuese Linda.

I gjendur i papërgatitur nga ajo vizitë, në atë orë të mbrëmjes, Bashkimi tregoi i hutuar një karrike.

- Mirë se erdhe zonja mësuese! Më vjen keq që ime bijë nuk është, por...

- Në të vërtetë, unë erdha për ju, - foli Linda me një pamje tepër serioze. - Desha të bisedonim diçka shumë të rëndësishme, që... që lidhet me Merin.

Tjetri ia nguli sytë me një trembje të lehtë.

- A e dini ku ndodhet tani vajza juaj?

- Im bir më tha se ka dalë me një shoqe.

Linda i uli sytë përdhe, pastaj shprehu hapur gjithë shqetësimet e saja. Bashkim Gjoka nuk mundi ta përmbante shtangien.

- Ime bijë nuk mund ta bëjë një gjë të tillë! Ajo të shkojë nëpër lokale me djem të dyshimtë?!

- Për fat të keq...

- Po unë e di që ajo ka shok vetëm Sidritin.

- Edhe unë nuk po e kuptoj ç'po ndodh kështu. Bashkim, Meri ka nevojë për kontroll. Unë e di që ju keni patur halle, por tani duhet të jeni sa më i kthjellët. Besoj se më kuptoni se ç'dua të them.

Ai pohoi në heshtje.

- Mbase edhe unë kam fajin tim, - vazhdoi mësuesja. - Duhet të kisha ardhur më shpejt. Duhej të isha kujdesur për Merin më shumë. Por të gjithë kemi halle, familje.

- Ju falemnderit zonjë! Ju keni bërë shumë për vajzën time. Faji sigurisht që është imi si prind.

- Tani nuk është koha të ndajmë fajin.

Ata të dy ndenjën gjatë duke biseduar aty në verandë, por Meri nuk po kthehej. Ora shkoi 22. Mësuesja vazhdonte t'i mbante sytë nga porta.

- U bë vonë për ju, - tha Bashkimi. - Ju presin në shtëpi.

Linda u ngrit.

- Do të vij një ditë tjetër, - tha e mërzitur. - Më vjen shumë keq që ndodhi kështu. Askush nuk e priste që Meri...

Ajo u largua duke ndjerë keqardhje për situatën që kishte lënë

pas. Ç'mund të bënte një baba i tronditur, që kishte dëgjuar krejt papritur të atilla gjëra për vajzën e vet? Ç'ndjente ai vallë në ato çaste? Po Meri, si mund të reagonte kur ta merrte vesh se mësuesja e saj e kishte kallëzuar te i ati? Linda filloi të lëkundej. Mos vallë kishte gabuar me atë vizitë të vonët dhe më shumë kishte prishur se ndrequr punë?

Bashkimi qëndroi disa minuta te porta.

- Albi, eja këtu! - thirri pastaj i nxehur. - Ku është jot motër? I biri e vështroi i hutuar.

- Duhet të jetë duke shetitur me Klarën.

- Ç'dreq Klare! Ta dish mirë se ajo është një gënjeshtare! Na ka gënjer të dyve.

Djali nuk i ktheu përgjigje. I ati bëri ca ecejake aty para portës, pastaj u nis drejt një lokali aty pranë, që verës rrinte hapur deri vonë.

- Ba, të lutem mos shko atje! - i foli Albi.

Burri nuk e ktheu kokën.

- Po ku dreqin të shkoj? - thirri i dëshpëruar. - Më tregon ti dot ndonjë vend më të bukur?

Ai hyri në lokal duke sharë e mallkuar. Klientët, që ishin kryesisht banorë të lagjes, e vështruan në bisht të syrit. I zoti i lokalit mbeti me duart mbi banak.

- Më jep të pij! - foli Bashkim Gjoka.

Tjetri nuk lëvizi.

- Nuk mundem, - tha. - Nuk hyj në mëkat. Miku im, kthehu në shtëpi se të presin fëmijët.

Bashkimi ia ngjeshi banakut me grusht.

- Mos më mërzit kokën me përralla! Më jep të pij dhe unë do të paguaj. Mëkatet janë të miat e jo të tuat.

Banakieri filloi t'i hidhte sytë sa majtas e djathtas.

- Jepi, - i foli njëri prej klientëve. - Paguaj unë. Burra jemi, edhe do pijmë. E ku mund të shkojmë tjetër përveç këtij lokali?

Banakieri mori si me pendim një shishe rakië dhe mbushi një gotë.

Ndërkohë, në galerinë e disko "Parajsës", nën ritmin e një muzike që të godiste nga të gjitha drejtimet dhe nën vezullimin e dritave që lëshonin në tavan e dysheme njolla marramendëse shumëgjyreshe, Meri kërcente e shoqëruar nga Aldo, Klara e Genci. Ata e kishin lënë barin "Peshku i artë" para ndonjë ore. Idea për të shkuar në diskotekë kishte qenë e Aldos. Ndërsa dëgjonin në lokal një këngë tepër të njohur të grupit "Guns and roses", Meri kishte filluar të këndonte me zë, duke përplasur duart. Për habi, ashtu si edhe herën e parë në diskotekë, kishte ndjerë një gjallërim të pakontrollueshëm. Dritat rreth e rrotull qenë bërë më vezulluese, mjedisi më i bukur, bile edhe peshqit e artë kishin filluar të lëviznin nëpër akuarium si meteorë. Ajo i kishte harruar të gjitha ato që kishin diskutuar më parë. Klara po ashtu kishte filluar të këndonte dhe ishte pështetur pas Gencit. I kishte hedhur atij krahun dhe kishte filluar ta puthte. Pikërisht në ato çaste Aldo kishte thirrur me qejf:

- Hajdeni, shkojmë ia plasim një disko!

Klara kishte fërkuar duart me qejf. Genci vetëm kishte buzëqeshur, ndërsa Meri, mes asaj gjendjeje ngacmuese, që e bënte t'i dukej gjithçka rreth e rrotull një mrekulli e vërtetë, e kishte harruar fare shtëpinë dhe idenë e kohës. Aldo e kishte tërhequr për krahu.

- Meri, hajde të kërcëjmë sonte se deri nesër kushedi ç'bëhet!

Ajo e kishte ndjekur pas, pa e kuptuar se nga i vinte ajo shtytje misterioze që fshinte nga truri gjithçka tjetër...

Por rreth mesnatës, papritur, ndërsa djersa në trup iu ftoh, Meri u kthjellua disi dhe filloi të qante e trembur. Klara e shoqëroi jashtë, në ajër të pastër. Aldo dhe Genci u dhanë te dera.

- Ja, na doli një avaz i ri me këtë debilen, - ia bëri Genci i mërzitur. - Aldo, më plase! Nuk është mall për ne ajo. Mos e shiko nga trupi. Nga mendtë është kalama.

Tjetri shau njëherë nëpër dhëmbë.

- Ajo nuk është kalama, jo! Të gjitha këto i ka filma. Por herën e tretë do t'ia tregoj mirë qejfin! Nuk do ta sjell më në disko.

- Ej, ju, ç'prisni? - u foli Klara.
- Na mbeti në duar si thes me groshë, - shfryu Genci me inat.
- Po shkoj të nxjerr makinën.
- Aldo u afrua te vajzat.
- Yll-i! - iu drejtua Merit gati me tallje. - Mos të bën dëm muzika? Eh, ty të bëjnë dëm të gjitha këtu! Prandaj duhet të vish me ne në Greqi. Më dëgjon?
- Dua të shkoj në shtëpi! - ia ktheu vajza me ankim.

19.

Kur vetura e tyre mbërriti poshtë pallatit të Klarës, Bashkim Gjoka po priste te porta e shtëpisë së tij. E mbërtheu një furi nervozizmi kur pa të bijën të zbriste nga ajo makinë e panjohur dhe të afrohej në një gjendje jonormale. U detyrua të futej brenda duke menduar se ashtu do të mund ta përmbante veten nga ndonjë veprim i pamatur. I biri e ndiqte ndërkohë në bisht të syrit me një pamje të trembur.

Meri hyri në korridor e mbytur në djersë dhe me një fytyrë të shprishur. Ngriti sytë nga i ati dhe e shikoi e përhumbur.

- Ku ishe? - pyeti ai duke iu afruar.

- Në një bar... pastaj... në një diskotekë, - u përgjigj ajo. - Ba... më ler të të sqaroj...

Por nuk mundi të vazhdonte sepse një shpullë e fortë e shkundi të tërën nga vendi. Koka i vajti anash, sytë i shkëndijuan.

- Çfarë do të më sqarosh? - thirri Bashkimi i xhindosur. - Kush ishin ata që të sollën këtu me veturë?

Ai e mbërtheu të bijën për flokësh dhe e goditi përsëri. Meri u nguros. Sytë iu zmadhuan. Shikimi i mbeti drejt të atit, ndërsa goja e hapur. Buzët dhe gjuha i qenë tharë. Nuk mundte ta besonte atë që ndodhi. Ishte hera e parë në jetën e saj që babai e godiste. Ajo nuk po bindej që kishte qenë dora e tij.

Ndërkohë Albi u fut mes të atit dhe të motrës me një pamje kërcënuese. E mbuloi Merin me trup dhe iu drejtua të atit i për-lotur:

- Mos e prek motrën time! Ti nuk ke të drejtë t'i kërkosh asaj llogari!

Vajza u struk pas tij dhe filloi të dridhej. Pas atij veprimi Bashkimi pati një lloj kthjellimi. U tërhoq mbrapsht dhe u ul në një karrike. Sytë vazhdonte t'i mbante nga fëmijët. Ata ishin shtërnguar pas njëri-tjetrit. Albi e mori të motrën për krahu dhe e çoi në dhomë. Pas pak u dëgjua një kërcitje çelësi.

Babai u mat disa herë t'i afrohej derës së dhomës, por këmbët nuk iu bindën. Dëgjoi për disa minuta të qarat e fëmijëve, pastaj nuk mundi të duronte më. U ngrit dhe doli jashtë. Këmbët e shpunë drejt lokalit ku kishte qenë pak më parë.

Dalja e tij u shoqërua nga një lehje e vajtueshme e Sparkit.

- Iku, - i foli Albi të motrës. - Mos ki frikë.

- Nuk kam frikë, - ia ktheu ajo. - Kam në kokë një si alarm. Nuk qetësohem dot.

- E po, kur unë të them të ikim te daja në Itali, ti nuk më dëgjon! Ja, tani. Duro edhe këtë. E kushedi ç'do të vijë prapa.

Natën vonë, kur ishte qetësuar disi dhe Albin e kishte zënë gjumi, Merit iu kujtuan fjalët e fundit të tij. Idea e ikjes nga shtëpia i shkoi për herë të parë nëpër mend. E ç'më pret këtu, pyeti veten. Do të vazhdojë e njëjta histori. Gjinnazin e kam të humbur. Sidin dhe shokët e shoqet e klasës po ashtu. E kush më mbeti tjetër?

Iu kujtua propozimi i Aldos, Klarës e Gencit për të shkuar me ta në Greqi. Nesër, që në mëngjes, do t'i telefonoj Klarës, tha me vete në mëri e sipër. Do të shkoj me të.

Atë natë jeta dhe e ardhmja e saj iu dukën më bosh se kurrë, si një det i trazuar, mbi të cilin qielli i vrenjtur është ulur deri pranë dallgëve, duke zhdukur çdo linjë horizonti apo hapësire rreth e rrotull. Askund nuk dalloj një fije shprese. Njëlloj si ata detarët e trembur nga stuhia, nuk mundi ta zinte gjumi. Arriti të mbyllte sy vetëm nga mëngjesi, kur në kopshtet e shtëpive rrotull filluan të lihnin qentë, që përshëndesnin njëri-tjetrin me gjuhën e tyre misterioze.

Megjithatë, kur u zgjua, idea për t'i telefonuar Klarës, e trembi. Nuk guxoi t'i hidhte sytë nga telefoni. Por e kuptoi, se ndonjë ditë, në gjendje dëshpërimi, mund të dorëzohej para propozimit

joshës të ikjes. Nuk ishte habi që një gjë e atillë të ndodhte.

Nuk lëvizi nga krevati për orë e orë me radhë. Albi i solli aty për të ngrënë e për të pirë. Vetëm pasdite, si gjithmonë kur ishte tepër e mërzitur, përgatiti një tufë me lule, i mbloodhi me një gazetë dhe u nis për në varreza. Kaloi kokulur përmes parcelave të trishtueshme deri sa mbërriti te varri i nënës. Ai kishte mbetur ende pa pllaka mermeri. Me rastin e 1-vjetorit të vdekjes së nënës nuk kishin patur mundësi ta rregullonin. Mbi të ishte vendosur një tufë me lule, ende e freskët. Ajo njohu lulet e kopshtit të saj. E kuptoi se aty duhej të kishte qenë para pak ditësh i ati.

U ul në gjunjë, i la lulet pranë kokës së varrit dhe sapo preku me dorë pllakën ku ishte shkruar emri i nënës dhe vendosur fotografia e saj, sytë iu mbushën me lotë. Ndenji aty gjatë, duke menduar se sa krejt e ndryshme do të kishte rrjedhur jeta sikur nëna të mos kishte vdekur. Ata do të ishin të gjithë të lumtur, pa probleme, pa sherre. Babai nuk do të kishte përfunduar te pija, Albi nuk do të kërkonte të merrte arratinë nga shtëpia, ajo nuk do të ishte katandisur në atë gjendje. Zoti ynë, pse na e shkruajte neve këtë fat, pyeti veten e lodhur. Kush do të na e japë dorën tani përveç teje?

E përmendi prekja e një plake në sup.

- Bijo, nuk është mirë të rrish kaq gjatë pranë varrit, - tha ajo.

Meri u ngrit dhe u largua ngadalë, me hapa gati të pabindur, siç ndodh kur lëmë pas diçka të shtrenjtë. Kur mbërriti në shtëpi, gjeti atje vetëm Albin dhe Norën.

- A shkojmë nga nëna? - e pyeti i vëllai.

- Boll e kemi shqetësuar nënën, - ia ktheu ajo.

- Po këtu, ç'të bëjmë?

Ajo nuk i ktheu përgjigje. As vetë nuk e dinte se ç'mund të ndodhte në mbrëmje, kur i ati të kthehej në shtëpi.

- Të kërkoj kjo Klara, - tha Albi pas pak, pa e vështruar.

- Çfarë donte?

- Nuk e di. Më porositi që t'i telefonoje.

Meri bëri një gjest mospërfilljeje, por në vetvete nuk ishte aspak e sigurtë. Ata dolën në kopshtin prapa shtëpisë dhe ndenjën atje, ulur në një stol të vjetër druri deri në mbrëmje vonë. E ndjenë të atin kur u kthye. Asnjëri nuk pati guximin të ngrihej.

- Po sikur të na rrahi, ç'do të bëjmë? - pyeti Albi.

E motra mblodhi buzët e hutuar dhe i nguli sytë në një drejtim kot, diku në mur. E solli në vete zilja e telefonit. Ishte Klara.

- Dëgjo, për atë problemin, a u mendove gjë? - pyeti.

- Cilin problem?

- Greqinë pra! Erdhi koha të ikim.

Meri u turbullua.

- Më fal, po unë... nuk kam premtuar asgjë.

- Ne menduam se ti... mund të vije.

- Jo... unë...

- Mos ke nevojë të mendohesh akoma?

- Klara, kam frikë ta mendoj këtë gjë! Të lutem mos më kërko më!

Ajo e uli telefonin me ngut, pa i lënë tjetrës mundësi të fliste. Nuk arrinte ta kuptonte dot këmbënguljen e Klarës. Pse ajo, Aldo dhe Genci ishin gati të prisnin, vetëm e vetëm që të shkonin bashkë në Greqi? Vërtet u vjen kaq keq për mua, filloi të pyeste veten Meri ndërsa vinte vërdallë nëpër shtëpi. Ç'ishte gjithë ky afrim mes nesh? Vallë ata janë të vetmit njerëz të cilët mund të mbështetem tani e tutje?

Për të shtyrë tërë atë ditë të gjatë qershori, ajo u ul në hijen e kopshtit së bashku me Albin e Norën dhe filluan të luanin "Mos u nxe". Loja nuk i tërhiqte pa le se çfarë, megjithatë ata e lëshonin zarin dhe numëronin kutitë me durim. Ishin ende të tronditur pas atyre që kishin ndodhur dhe nuk e dinin se si dhe kur do të merrte fund ajo gjendje. Sa herë vështroheshin në sy, pyesnin njëri-tjetrin në heshtje: po me babin, si do t'ia bëjmë.

Ajo situatë lodhëse vazhdoi deri në mbrëmje kur papritur porta u hap pa trokitur dhe në oborr u dëgjua një zë tepër i njohur:

- Meri!

Vajza brofi në këmbë.

- Sidi, - pëshpëriti Albi. - Dëgjo, mos e sill këtej.

- Meri, këtu jeni?

Ajo u çapit drejt oborrit duke u munduar të bënte një rregullim të shpejtë të pamjes së jashtme. Sidi kishte lënë biçikletën në kambalec dhe po priste me një pamje të shqetësuar. Meri përshëndeti.

- Më fal që erdha kështu papritur, - foli ai. - Desha të të them diçka që lidhet me ty.

- Po të dëgjoj.

- Kam pyetur shumë për Gencin e Klarës dhe atë tjetrin, shokun e tij. Meri, duhet të kesh kujdes. Ata përdorin drogë.

Ajo ia nguli sytë e tmerruar.

- Sid... a je... i sigurtë?

- Shumë. Në se nuk më beson mua, të jap numrin e tele-fonit te Adrit të ekipit. Ti e njeh. Ai e ka patur Aldon komshi. Mund të të tregojë shumë gjëra për të dhe familjen e tij.

Meri filloi të dridhej nga frika.

- Ç'ke? - pyeti Sidi.

Por ajo nuk pati guxim t'i tregonte ç'i kishte ndodhur dy herë radhazi që kishin qenë në diskotekë. Vetëm në ato çaste filloi të bënte lidhjen mes gjallërimit që e kishte kapur papritur pas pirjes së koka-kolës herën e parë dhe përtypjes së atij çamçakizit të panjohur herën e dytë. Në të dy rastet, vetëm pas gjysmë ore, ajo kishte ndjerë dëshirë për të kërcyer, për të qeshur e për të thirrur me zë të lartë. Pas atij gjallërimi të paprovuar kurrë më parë, kishte ardhur turbullimi, përzierja e stomakut, dhimbja e kokës, djersët e ftohta, pagjumësia. Tani gjithçka po i dukej e dyshimtë; ftesat për t'u ulur nëpër lokale, këmbëngulja për të shkuar në diskotekë, pritjet e Aldos në rrugë, bisedat e çuditshme për Greqinë, dashmirësia e Klarës, bile edhe ditëlindja e saj. Tronditja sa vinte e po i shtoej. S'kishte pikën e kurajos për t'i ngritur sytë nga Sidi.

- Meri, si ndjehesh? - i foli ai.

- Sid, të kërkoj falje. Sikur të futem brenda?

- Sigurisht. Mund të flasim më vonë. Thuaji edhe Albit se ia kam falur atë shakanë e panolineve. Mirupafshim!

Ai sa po kthente biçikletën për të dalë, kur në oborr hyri Bashkim Gjoka.

- Oh, Sid, qenke ti! - ia bëri duke i zgjatur djalit dorën miqësisht. - Ku ke qenë tërë këtë kohë që s'të kam parë?

Djali nuk e kishte pritur atë sjellje.

- Ja... stërvitja, mësimet, - tha i hutuar.

- Nga shtëpia, mirë jeni?

- Mirë, falemnderit.
- Eja, do të ulesh ca?
- Ndonjëherë tjetër.

Bashkimi vështroi nga e bija. Ajo e mbante kokën mënjanë. Edhe Sidi nuk po dinte nga t'i hidhte sytë. E nuhati se mes Merit dhe të atit të saj kishte ndodhur diçka. U krijua një situatë vërtet e sikletshme.

- Atëhere, gjithë të mirat! - tha Bashkimi duke i shtërnguar Sidit përsëri dorën. Kaloi pranë së bijës pa folur, ngjiti shka-llët e verandës dhe hyri brenda.

- Ndoshta erdha në një kohë të papërshtatshme, - mër-mëriti Sidi.

Meri vazhdonte t'i mbante sytë përdhe.

- Ky ishte babi yt që të ka urdhëruar të mos shoqërohesh me mua? - pyeti ai.

- Duhej të shpikja një gënjeshtër! - psherëtiu ajo.

- Po pse duhej të gënjeje xhanëm?!

- Duhej.

- Meri, të lutem më trego të vërtetën që të shpëtojme të dy nga kjo lodhje e kotë!

- Çfarë të vërtete?

- Pse u largove nga unë?

Ajo nuk mundi të duronte më. I ngriti sytë, e vështroi shokun gjatë, përmes lotëve, pastaj ia tregoi të vërtetën me fare pak fjalë. Ai bëri një hap prapa.

- Meri, jo, nuk ka mundësi!

- Sid, më vjen keq...

- Dhe ti nuk ma the që në fillim?!

- E çfarë të të thoja?

Ai mër-mëriti vetëm një "natën e mirë" dhe doli pa e kthyer më kokën prapa. Ajo mbeti në mes të oborrit, pa ditur ç'të mendonte më parë. Ndjehej e trembur, e alarmuar. Megjithëse i tregoi Sidit atë që e kishte munduar për javë me radhë, nuk provoi lehtësim. Përkundrazi, iu duk se gjërat do të ngatërroheshin edhe më keq.

Gjithësesi, ai detaj nuk ishte edhe aq shqetësues para fjalës drogë. Meri dinte shumë pak gjëra për drogën, edhe ato të pasakta.

Një ditë kishte ardhur në shkollë një psikologe dhe u kishte folur për të. Tani, gjëja e parë për të cilën ajo trembej, ishin pasojat. I dukej sikur brenda trupit të saj kishte hyrë diçka e huaj dhe kishte lënë nëpër vena gjurmë të pashërueshme.

Iu lut Albit të rrinin bashkë deri sa ta zinte gjumi.

- Pse kishte ardhur Sidi? - pyeti ai me kureshtje.

- Për një problem. Ta tregoj ndonjëherë tjetër.

- Tha gjë për mua?

- Tha se ta ka falur atë shakanë e panolineve.

- Vërtet?! Dëgjo, në fakt, ai nuk është çun i keq.

E motra psherëtiu në mënyrë të pakontrolluar.

- Alb, ai është shumë i mirë. Dije se nuk do të njohim kurrë më djalë si ai.

*

*

*

Pamja e Sidit duhej të ishte jashtë mase e tronditur sepse prindërit, që ishin ulur në tavolinën e shtruar dhe po e prisnin për të ngrënë darkë, ia ngulën sytë të trembur.

- Sid, përsëri ndonjë sherr? - pyeti i ati.

Djali u lëshua në një divan me kokën mes duarve.

- S'është punë sherri.

- Atëhere ke humbur ndonjë ndeshje.

- Ba, unë po humb shoqen time të ngushtë.

- Ah, qenka fjala për Merin.

- Po. Dhe po e humb atë me urdhër të mamit.

Elona Arbana u skuq në çast dhe filloi të shikonte nga i shoqi sikur të donte të kërkonte mbështetje. Ai u kthye drejt saj, sikur të kishte para një paciente.

- E dashur, a mund ta di ç'është kjo histori?

- Unë... e bëra për të mirën e djalit tonë.

- Çfarë bëre?

- I kërkoja Merit që të mos shoqërohej më me Sidin.

- E pse?!

- Ti e di shumë mirë arsyen.

Ariani vështroi nga i biri.

- Dhe e bëre këtë gjë pa biseduar me Sidin ?
- Me Sidin nuk mund të bisedohet kur është fjala për Merin.
- Ma, ti nuk kishe të drejtë ta fyeje atë ashtu, - tha djali me zë të dridhur. - Ajo, nga dëshpërimi, mund ta pësojë edhe më keq akoma.

E ëma hapi krahët në shenjë dorëzimi.

- Dakort, ta zemë se unë jam nxituar. Por ama një ditë kjo histori duhej të mbaronte. Apo jo?

- E pse duhej të mbaronte? - pyeti i biri.

- Sepse ashtu erdhën rrethanat. Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi as për të atin e Merit që breddh lokaleve dhe as për të bijën.

- Ajo është shoqja ime e ngushtë!

- Ajo është një vajzë si gjithë të tjerat!

- Jo! Ti fillove ta shikosh shtrembër sapo i ati filloi të pinte nga dëshpërimi. Ata ishin një familje e mrekullueshme. Por pësuan një fatkeqësi, babai i Merit filloi të pinte, kurse ti fillove t'i përçmoje të gjithë. As ti dhe as babi nuk bëtë asgjë për t'i ndihmuar. Nuk lëvizët as gishtin e vogël kur babai i Merit ngeli pa punë dhe filloi pijen.

Prindërit po e vështronin të shtangur. Zëri i djalit u bë edhe më prekës.

- Para syve tuaj u shkatërrua një familje dhe ju me vrap nxituat të më shpëtonit mua nga Meri! Fshehurazi. Sikur Meri do të më ngjiste pa le ç'sëmundje! Ju dini të diskutoni vetëm për shërbime jashtë shtetit, për apartamente të shtrenjtë, për mobilje importi, vetura dhe nuk gjeni kohë të hidhni sytë nga një familje që po shkatërrohet për hiçgjë. Aq më shumë që kjo familje është e shoqes së ngushtë të djalit tuaj! Ju lutem, çfarë njerëzish jeni ju?

Ariani dhe Elona kishin mbetur gojëhapur, sikur t'u ishte parashtruar për zgjidhje enigma më e vështirë në botë.

- Ju lutem, më jepni një përgjigje! - vazhdoi Sidi.

Ariani u kthye nga e shoqja.

- E dashur, a më thua dot, ç'njerëz jemi ne?

- Jemi dy qytetarë të nderuar të këtij qyteti, - foli ajo e prekur. Ai tundi kokën vrullshëm.

- Jo! Djali ynë nuk mendon ashtu. Gjithashtu edhe Meri

mendon të kundërtën e asaj që the ti. Ata janë fëmijët tanë dhe me sa duket na gjykojnë ndryshe. Krejt ndryshe nga ç'mendojmë ne se jemi. Dhe, për fat të keq, ata kanë të drejtë.

- E pse?!

- Sepse janë fëmijë! Janë më të çiltër, më të sigurtë, më të pafajshëm dhe nuk i njohin hiletë e dredhitë e të rriturve. Ata, për fatin e mirë të tyre, nuk e njohin dëshirën e egër për t'u pasuruar e për të bërë një jetë të rehatshme brenda mureve të shtëpisë tënde, ndërkohë që jashtë mureve ka me dhjetra të tjerë që vuajnë. Elona, diçka nuk shkon përderisa djali ynë ankohet. Kam frikë se kjo diçka duhet të jetë shumë serioze.

- E çfarë nuk shkon?

- Sidi ka të drejtë. Ne mund të kishim bërë diçka për familjen e Merit.

- Po ne nuk jemi institut bamirësie!

Ariani nënqeshi.

- E po sikur nesër të na ndodhë neve një fatkeqësi, do të kërkojmë ndonjë institucion bamirësie?

Ajo mbeti me vështrimin fiksuar mbi tavolinë.

- Unë mendoj se nuk kam vepruar gabim, -tha.

- Ti nuk kishe pse ndërhyje te Meri për ta larguar atë nga yt bir! - ia priti i shoqi. - Këtu ke vepruar gabim dhe për këtë duhet t'i kërkosh Sidit falje. Por jo sonte. Ne të dy duhet të bisedojmë shumë gjëra para se të ulemi përsëri me Sidin në tavolinë. Problemi është shumë serioz.

- Ah, tani po ma hidhni tërë fajin mua! Ju lumtë! Unë nuk kam pse kërkoj falje. Gjithçka e bëra për të mirën e Sidit.

- Ti ke fyer një vajzë pa përkrahje dhe ky është një gabim. Po ta përsëris: Sidj ka të drejtë. Të mirën e djalit tonë mund ta kishim kërkuar edhe ndryshe. Duke qenë më pak egoistë. Por edhe tani nuk është vonë.

Ariani u ngrit nga tavolina, u ul pranë të birit dhe i hodhi atij krahun supeve.

- Sid, na jep kohë të mendohemi e të bisedojmë. Të premtoj se nuk do të të zhgënjëm. Kemi edhe ne të metat tona, ndoshta gabimet tona. Dikush duhej të na i thoshte dhe ti bërë mirë që na tregove se je i pakënaqur nga tërë ky egoizëm që të rrethon.

- Edhe unë kam nevojë të mendohem, - tha djali. - A mund të shkoj në dhomën time ?

- Pa darkë?

- Do të ha andej një hamburger.

- Okej! Më pëlqen kjo lloj paqeje e përkohshme, - ia bëri Ariani duke vështruar i menduar nga e shoqja.

- Ai është gatuar njeri fisnik, - tha pasi djali hyri në dhomë. - Për këtë jam i lumtur.

- Sidi ende nuk e kupton se ç'bëhet jashtë fushës së basketbollit, - iu përgjigj Elona. - Është ende i vogël për të ditur se si është jeta matanë asaj fushe. Kam frikë se ai do të bjerë viktimë e shpirtit të tij fisnik. Kjo nuk është kohë për njerëz fisnikë. Sot fisnikët i konsiderojnë budallenj.

- Ndoshta nesër do të jetë ndryshe.

- Nuk e besoj. Sistemi ku kemi hyrë e përjashton fisnikërinë.

- Gabohesh! Njerëz fisnikë ka patur dhe do të ketë në të gjitha kohërat. Eja, hamë njëherë se na pret një bisedë e gjatë.

- Arian, dije se nuk më bind dot.

- Do të përpiqem.

20.

Meri u zgjua nga të lehurat nervoze të Sparkit.

- Në oborr është ajo Klara, - tha Albi që ishte ngritur pak më parë dhe po fshinte qafën e fytyrën me një peshqir të madh. - Ka varur turinjtë.

Meri u vesh dhe doli duke e patur fare mirë të qartë se ç'do të ndodhte. Klara i dha një përsëritje të thatë.

- Nuk e mora vesh, ç'e kishte atë të folur ashtu dje në telefon? - pyeti e vrenjtur.

- Më fal, isha e mërzitur, - tha Meri.

- E pse?

- Klara, doja të të pyesja unë diçka në fillim. A na kanë dhënë Aldo dhe Genci drogë dy herët që kemi qenë në diskotekë?

Tjetra shqeu njëherë sytë sikur të kishte para një të lajthitur.

- Meri, je në terezi ti goce? Mos guxo të flasësh kështu për Gencin tim! Dëgjove? Ai nuk merret me pisllëqe.

- Klara, kam frikë se ata na kanë dhënë drogë fshehurazi.

- Moj, ç'i ke këto budallallëqe? E nga e di ti këtë?

Meri ngeci. Ishte foshnjore të thoshte se atë fakt ia kishte treguar Sidi. Tjetra e kapi atë detaj në çast.

- Të paska shkruar ai basketbollisti yt ndonjë hartim?-ia bëri duke nënqeshur. - Merret vesh! Ai shpif kundër Aldos dhe Gencit se nuk ia del dot ndryshe. Kushedi ç'të ka thënë tjetër! Të gjitha këto i bën për të të larguar nga ne. Ti je matufe që e dëgjon akoma.

Meri bëri një gjest për të treguar se ishte e lodhur.

- Klara, unë dua t'i harroj të gjitha. Ta zemë se Sidi ka shpifur. Nuk më intereson më asgjë. Po të them me sinqeritet se nuk dua të shoqërohem më me ju. Ju lutem, mos më kërkoni më!

Klara e mati njëherë me sy.

- Po ne, unë e para, deshëm të të ndihmonim! Të të shpëtonim nga mërzia!

- Ju falemnderit për kujdesin, por unë nuk mund të largohem nga shtëpia.

Klara mbeti tepër e zhgënjyer.

- Paska qenë tepër tinzare dhe mosmirënjohëse, - foli tërë mllef.

- Ti do ta kërkosh shoqërinë tonë dhe nuk ke për ta gjetur më!

- Shaj ç'të duash, - ia ktheu Meri qetësisht.

- As që kam për të ta parë më surratin! - ia bëri Klara duke dalë. - Ashtu mbetsh! Rrjepacake, duke bërë byrekë me këtë shtrigën e pallatit tim!

Porta u përplas vajtueshëm dhe Meri mbeti në mes të oborrit, me krahët varur.

- Hajde, mos e vrit shumë mendjen, - i foli Albi nga pas. - Mirë ia bëre.

E motra e vështroi e trembur.

- Po ti, e dëgjove bisedën?

- Më erdhën fjalët në vesh vetë. Meri, kot e ke që mban sekrete me mua.

- Çdo njeri ka sekretet e tij.

- Në rregull. Tani më thuaj, ç'do të bëjmë?

Ajo vështroi njëherë rrotull.

- Ia këpusim prapë gjumit, - tha si me përtim.

Ajo ditë u duk dhe më e mërzitshme se e djeshmja. Ndonëse i hapej goja, Meri nuk mundi të flinte më. Nuk e kishte mendjen as te ato që i thoshte i vëllai. Herë pas here i kthente sytë nga telefoni, por zilja e tij nuk po binte.

- Meri, mos ka për të ardhur prapë Sidi? - pyeti Albi papritur.

- Nuk e di, - ia ktheu ajo.

Vapa kishte rënë dhe atyre të dyve u kishte ardhur mërzia tek s'mbante më, kur papritur para portës u ndal një veturë. Meri vështroi njëherë të vëllanë, pastaj u fut brenda e trembur. Ai e kuptoi pa vonesë frikën e saj. Mendoi njëherë të zgjidhte Sparkin, por pastaj ndërroi mendje dhe priti aty në oborr me zemër të dridhur. Por pas një trokitjeje të shkurtër porta u hap dhe brenda hyri një burrë rreth të dyzetepesave, me flokë të thinjur në tëmtha, me syze optike dhe me pamjen e dallueshme lehtazi të një njeriu që punon nëpër zyra. Albi mori frymë i lehtësuar.

- Mos je gjë babi i Sidit? - pyeti.

Tjetri buzëqeshi.

- Unë jam, por nuk luaj basketboll. Ti duhet të jesh vëllai i Merit, apo jo?

Albi pohoi me kokë i hutuar. Nuk po e kuptonte dot qëllimin e asaj vizite.

- Urdhëroni, uluni, - tha duke treguar nga veranda.

- Unë erdha për të takuar babanë tuaj.

- Babi nuk është kthyer akoma.

- Atëhere po e pres. A mund t'i hedh një sy kopshtit? Këtu qenka goxha fresk.

Albi i priu me qejf nëpër rruginën që të çonte prapa shtëpisë.

- Ne kemi edhe qen, - tha. - Quhet Sparki.

- Emër i bukur.

Ndërkohë Meri u doli para, edhe ajo pa kuptuar dot gjë.

- Kurse kjo është motra ime, Meri, - tha Albi.

Arian Arbana qeshi.

- Ah, këtë nuk e dija! Meri, si je? U bë kohë që s'jemi takuar.

Ai i shtërngoi vajzës dorën miqësisht.

- A mund të rrimë pak këtu? - tha pastaj duke treguar një

nga stolat e drunjtë nën pemë. - Po ç'kemi?

Ata të dy ngritën supet.

- Jetë e vështirë zoti doktor, - ia bëri Albi.

Tjetri i ra supit.

- Asgjë nuk është e lehtë or mik! Ja, të pyesim edhe Merin.

- Edhe unë ashtu mendoj, - foli vajza.

Fytyra e mikut iu duk tepër dashamirëse dhe në ato çaste pati një ndjenjë se diçka duhej të kishte ndodhur, diçka që po sillte erë të mbarë.

- Xhaxhi Arian, po ju bëj një kafe, - tha pas pak.

- Me gjithë qejf. Falemnderit!

Ndërkohë që Meri hyri në shtëpi, Albi vështroi nga Arian Arbana në bisht të syrit. Nuk po dinte ç'bisedë të bënte me të.

- A merrni vesh nga qentë? - pyeti pa u menduar gjatë.

- Pak, - ia ktheu tjetri.

- A e dini pse qentë bëjnë çiqin pranë vendit ku banojnë?

- Jo.

- Për të treguar se ai vend ka zot. Ndajnë zonat me njëri-tjetrin. Era e çiqit i largon qentë e huaj.

Tjetri qeshi.

- Interesante! Nuk më kishte vajtur mendja kurrë. Qentë e paskan më të lehtë se njerëzit që ngrenë mure për t'u ndarë nga njëri-tjetri.

Ata ndenjën gjatë në kopësht, duke biseduar, deri sa Bashkim Gjoka u kthye. Fëmijët u vështruan mes tyre të merakosur. Të dy menduan të njëjtën gjë: po sikur babi të ketë pirë. Por ai nuk ua la atë përshtypje.

- Mirë se erdhët doktor! - iu drejtua Arianit.

Burrat ishin takuar nja dy herë në shkollë, në takimet që organizonte mësuese Linda me prindërit dhe në një ndeshje basketbolli ku ekipi i Sidit kishte fituar një kupë.

- Tungjatjeta Bashkim! - tha Ariani. - Më fal që erdha kështu pa lajmëruar.

- E pse duhej të lajmëronit? Në se vetura ka ndonjë defekt...

- Jo, është defekt i një lloji tjetër.

Ata folën në fillim për gjëra të përgjithshme, për gjendjen e rrugëve dhe dëmet që ato u sillnin makinave. Pastaj Ariani mori

një pamje serioze dhe tha:

- Miku im, në se do të më lejosh, desha të bisedonim diçka.

- Patjetër, - ia ktheu i zoti i shtëpisë.

Meri dhe Albi u larguan. Burrat mbetën vetëm, përballë njëri-tjetrit.

- Bashkim, unë erdha këtu si mjek dhe si baba i Sidit, - vazhdoi pastaj Ariani. - Im bir dhe Meri janë shokë. Ata dinë gjithçka për njëri-tjetrin dhe familjet e tyre. Kështu, prej Sidit, edhe unë e ime shoqe, jemi në dijeni të problemeve që ju keni. Që të mos zgjatem, unë do të doja të të ndihmoj. Kuptohet, në se ti do ta mirëprisje ndihmën time.

Bashkimi e kuptoi se ishte fjala për diçka shumë të rëndësishme.

- Po ju dëgjoj doktor.

- Unë mendoj se problemi yt me alkoolin mund të kapërcehet.

- E si?

- Mjaft që ti t'i nënshtrohesh për disa ditë, në spital, një kure kundër alkoolit. Unë kam një shok specialist në këtë fushë. Do të kujdesem vetë nga afër.

- Dhe kjo do të më shpëtonte?

- Në shumë raste kura ka patur rezultat.

Bashkimi ndenji një copë herë i menduar.

- Doktor, e gjitha kjo më erdhi krejt papritur, - foli pastaj i emocionuar. - A mund ta di, pse po ma bëni këtë nder?

Tjetri ngrii paksa syzet me gishtin e madh dhe atë tregues të dorës së djathtë.

- Që të jem i sigurtë deri në fund, duhet të të them pse erdha kaq vonë. Ku isha deri tani. Nganjëherë punët e tua, interesi yt i ngushtë, të vënë përpara. Të bëjnë të harrosh se ç'ndodh rrotull teje. Deri sa dikush të përmend dhe të thotë i prekur: mjaft, ti je mjek, je njeri, nuk mund të vazhdosh më kështu. Ndoshta mund t'ju duket e pabesueshme miku im, por ky njeri qe Sidi.

Bashkimi buzëqeshi, pa e ndryshuar pamjen e menduar.

- Ju detyrohem shumë për tërë këtë doktor. Në se ju mendoni që gjendja ime mund të ndryshojë, unë jam gati t'i nënshtrohem çfarëdolloj kure.

Ariani i zgjati dorën.

- Më vjen mirë që më kuptove drejt. Tani jepi kurajo vetes!
Më e mira do të bëhet.

Ata i shtërnguan dorën njëri-tjetrit.

Para se të largohej, Ariani u thirrri Merit e Albit. I takoi të dy dhe i falenderoi për pritjen.

- Ah, desh harrova, - ia bëri te porta. - Meri, Sidi më porositi të të them se nesër paradite do të jetë në stërvitje.

Vajza tundi njëherë kokën në shenjë pohuese. Ai mund të ma kishte thënë këtë gjë edhe në telefon, mendoi e hutuar. Ende nuk po kuptonte asgjë nga ajo vizitë e çuditshme. Por kur mbeti në oborr vetëm për vetëm me të atin, ai i foli me një zë jo të zakonshëm:

- Meri, desha të të pyes diçka.

Ajo ngriti sytë dhe ata u vështruan për herë të parë që pas asaj ngjarjeje tronditëse që i kishte bërë si të huaj për njëri-tjetrin.

- Babai i Sidit më kërkoi të shtrohem në spital dhe të kurohem kundër alkoolit, - tha babai. - A di gjë ti për këtë?

- Jo, - u përgjigj ajo në çast.

- U ke kërkuar atyre, domethënë Sidit, që të na ndihmojnë?

- Asnjëherë.

- A e beson që Sidi ta ketë bërë gjithçka në kokën e tij?

- Ba, unë nuk e di ç'ka bërë ai. Por tani jam e sigurtë që ka bërë diçka.

- Djalë i çuditshëm! - psherëtiu Bashkimi duke hyrë brenda.

Eh, mor ba, ai më duket i çuditshëm mua që kam kaq vite që e njoh, tha Meri me vete. Ç'të ketë ndodhur vallë në shtëpinë e tyre? Ajo u mat njëherë të telefononte, por pastaj e kuptoi se ato nuk ishin gjëra për t'u biseduar në telefon.

- Ej, po ti, ç'ke mbetur kështu si ato skulpturat e lulishteve?

- i foli Albi. - More gjë vesh pse kishte ardhur xhaxhi Ariani?

E motra i tregoi.

- Çfarë historie është kjo?! - pyeti ai.

- Ndonjëherë tjetër do të të them shumë gjëra, - i premtoi Meri.

Atë mbrëmje ajo u soll më e afruar me të atin. U ul të hante darkë bashkë me të dhe Norën. I thirrri edhe Albit, por ai u shmang

duke u përgjigjur se po ndiqte në televizor një film. Ma sill pjatën time këtu, foli që nga veranda ku vendosej televizori verës. Ajo nuk lëvizi nga tavolina.

- Çoja, - tha babai qetësisht.

Meri mori pjatën dhe ia la të vëllait në prehër.

- Si është situata? - pëshpëriti ai.

Ajo e vështroi njëherë pa ditur ç'të thoshte.

Atë natë ndenji zgjuar nga një ndjenjë ende e vagullt gëzimi.

Diçka e mirë po ndodh, mendonte. Mesiguri duhet të jetë diçka e mirë.

*

*

*

Të nesërmen, ndonëse kishte fjetur fare pak, i doli gjumi herët. U ngrit dhe filloi të fshinte e të pastronte ç'ti dilte para. Megjithatë, i dukej se ora nuk po ecte. I ati e gjeti në oborr duke ujitur lulet. Tha vetëm "mirëmëngjesi", pastaj bëri drejt portës.

- Ba, po del për ndonjë punë? - pyeti ajo.

- Po, kam një shpresë. Shihemi në darkë.

- Paç fat!

Meri filloi të përgatiste mëngjesin dhe kur, më në fund, nuk pati ç'të bënte më, u vesh dhe priti me sytë nga ora e murit deri sa akrepat shënuan 9.

- Ç'ke kështu? - e pyeti Albi duke e vështruar në bisht të syrit.

- Pse, si të dukem?

- Krejt ndryshe.

- Nuk do të vonohem, - ia ktheu ajo duke u munduar t'i shmangej vëmendjes së të vëllait. Doli duke vazhduar të pyeste veten për të kushedi të satën herë se ç'duhej të kishte ndodhur në familjen e Sidit. S'ishte larguar as dyqind metra nga shtëpia, kur një veturë i frenoi përbri. Ajo njohu Gencin që ishte ulur në timon, pastaj pa Aldon që doli me vrull dhe iu afrua. Kishte një pamje të egër që e bëri Merin të dridhej. Nga ëmbëlsia e dikurshme e fytyrës së tij nuk kishte mbetur më asnjë gjurmë. Ai e mbërtheu për krahu duke folur me dhëmbë të shtrënguar:

- U bëre ti moj qelbanike të tallësh me ne? Surrati yt të më bëjë filma mua? Hajde, futu pak në veturë se dua të sqaroj diçka.

- Unë nuk kam asgjë për të sqaruar, - foli ajo e trembur.

- Futu brenda!

Aldo e tërhoqi me forcë drejt derës së hapur të veturës. Meri filloi të kundërshtonte me sa të mundte, por tjetri e goditi me grusht në kurriz dhe ajo mbeti për ca çaste pa frymë. Aldo e shtyu në ndenjësën e pasme dhe vetura u nis e ndjekur nga vështrimet e tmerruara të kalimtarëve që rastisën aty pranë. Genci vështronte sa prapa e anash i nervozuar.

- Po tani, ç'dreqin do të bësh? - i foli shokut.

Aldo e mbërtheu Merin për flokësh dhe e shtriu në ndenjësë.

- Do t'i tregoj kësaj bukuroshes se sa e ndershme është!

Meri filloi të thërriste e të qante e tmerruar, por Aldo e goditi fytyrës pa mëshirë dhe e mbërtheu për fyti për ta detyruar që të mos lëvizte. Ajo mezi po mbushej me frymë. Kur e pa se nuk kishte më shpëtim, filloi të mbrohej me duar e me këmbë. Ajo luftë e dëshpëruar e tërhoi Aldon edhe më keq. Ai filloi ta godiste ku të mundte.

- Aldo, mos bëj budallallëqe! - thirri Genci. - Mos na hap punë me policinë se jemi për të ikur. A dëgjon ç'të them apo jo?

Por tjetri as që kishte ndër mend të ndalej. Ndërsa tërhiqej e mbli dhej kruspull për t'u mbrojtur, Meri ndjeu se koka iu ngjesh pas derës së veturës. Dorezën e saj e kishte fare pranë. Zgjati dorën dhe e tërhoqi atë pa gabuar. Dera u hap dhe nga shpejtësia shkoi prapa si një velë anijeje e këputur.

- Aldo, mjaft! - thirri Genci. - Mos u bëj idiot!

- Jepi makinës! - thirri tjetri.

- Mbaje! Ajo po hidhet! Lëre derën!

Genci u detyrua të frenonte.

- Në se nuk e lëshon, do të prishemi bashkë! - thirri duke e tërhequr Aldon për supi. Disa kalimtarë u ndalën në trotuar. Një burrë u mat të afrohej, por një shoku i tij e mbajti për krahu.

- Aldo, do të na fikësh! - thirri Genci përsëri. - Nxirre jashtë! Unë nuk nisem.

Vetëm atëhere tjetri u detyrua të tërhiqej dhe i dha Merit një

të shtyrë të egër me shkelm. Ajo përfundoi në rrugë duke u munduar të mbronte kokën. Ra në brinjë, pastaj u kthye përmbys instiktivisht për t'u ruajtur nga një makinë që po afrohej. U dëgjuan brenda një çasti klithma të trembura, një frenim ngjethës, fishkëllima gomash, një bilbil polici. Meri ndjeu një goditje të fortë që e shtyu para dhe pas saj humbi ndjenjat.

Kur u përmend, pa se ndodhej në një dhomë spitali. Pranë saj qe ulur një infermiere. Meri vështroi njëherë rrotull, pastaj i ndali sytë te infermierja.

- Çfarë ka ndodhur? - pyeti me zemër të ngrirë.

- Për fatin tënd, nuk të ka ndodhur gjë e madhe, - ia ktheu tjetra duke e prekur butësisht në sup. - Zoti ka qenë me ty. Si mund ta lajmëroj familjen tënde?

Meri i dha numrin e telefonit.

- Të lumtë! - ia bëri infermierja. - Kjo tregon se nga koka je në rregull fare.

Meri mbuloi fytyrën me duar, pastaj filloi të qante.

Kur Albi dhe gjyshja mbërritën në spital, e gjetën me lotët e tharë nëpër faqe dhe vështrimin ngulur në tavan. Ndonëse ajo u mundua të buzëqeshte, ata të dy nuk po e mblidhnin dot veten nga tronditja. Gjyshja mërmëriti një lutje, ndërsa Albi u ul buzë krevatit duke prekur motrën në krah i mallëngjyer.

- Mos kini frikë, - u foli ajo. - Nuk jam edhe aq keq. Ma tha një infermiere.

- Edhe kjo na duhej! - rënkoi gjyshja. - Kur do të mbarojnë njëherë hallet për ne? Nga u gjend ajo makinë e mallkuar që të përplasi?

- Po kaloja rrugën, - tha Meri. - Nuk e pashë.

Ndërkohë Albi ia nguli sytë edhe më i tronditur se në fillim, por ajo nuk iu përgjigj vështrimit të tij. I zgjati dorën gjyshes. Ajo iu afrua, i zbuloi ballin nga rricat e flokëve, pastaj e puthi.

- Shpirt i nënës! - rënkoi përsëri. - Shyqyr që shpëtove!

- Në cilën rrugë po dilje? - pyeti Albi papritur.

Meri bëri çmos që pamja e fytyrës të mos i ndryshonte, pastaj gënjeu.

- E ku po shkoje? - vazhdoi Albi.

- Te shkolla ku bën stërvitje Sidi.

Ai nuk u bind nga ato që dëgjoji, megjithatë nuk foli më.

- Unë po shoh mos takoj ndonjë doktor, - tha gjyshja pas pak. Shkoi deri te dera dhe pastaj u ndal.

- Po Bashkimin, ku do ta gjejmë? - pyeti.

Asnjëri nga fëmijët nuk qe në gjendje të përgjigjej.

- Ai ka shkuar në punë që në mëngjes, - tha Meri.

- Punë zeza! - mermëriti gjyshja duke dalë.

Albi bëri disa ecejake nëpër dhomë.

- Po Sidi, e di? - pyeti pastaj.

- Jo, - u përgjigj e motra.

- A të shkoj t'i telefonoj?

Ajo tundi paksa kokën në shenjë pohuese.

21.

Sidi pështeti biçikletën pas murit dhe lëshoi aty pranë çantën sportive. Brenda ishte vapë. Nëna i linte dritaret gjithmonë mbyllur për shkak të pluhurit. Ai iu afrua frigoriferit dhe mori një kuti me lëng portokalli. Po pinte prej saj me gllënjka të mëdha kur zilja e telefonit ra me nota acaruese. Ishte Albi. Ai foli fare pak fjalë. I tregoi edhe pavionin ku ishte shtruar e motra.

Sidi rrëmbeu biçikletën dhe u nis drejt bllokut të spitaleve. Pas disa sorollatjesh arriti ta gjente pavionin dhe pa gjyshen e Merit që po bisedonte në korridor me një mjek. Futi kokën në disa dhoma deri sa në njerën prej tyre pa Merin me fytyrën kthyer nga dera dhe me një palë sy që prisnin me ankth. Ai hyri i tronditur, pa e vënë re Albin, që ishte ulur në një karrike dhe po shfletonte një revistë.

- Meri, po shkoj të blej një shishe ujë, - tha ai duke dalë me ngut e duke iu shmangur përshëndetjes me Sidin.

E motra u mundua t'i buzëqeshte shokut për t'i treguar se gjërat nuk ishin edhe aq keq. Por lotët e tradhëtuan në çast. Sidi u ul buzë krevatit dhe i zgjati dorën. Ajo e mori atë dhe pështeti aty faqen. Vazhdoi të qante në heshtje. Ai ndjeu në pëllëmbë lotët e ngrohtë. Pa dashur i shkuan sytë te një gërricje e thellë

në qafën e saj. Vuri re se varësja me guacka mungonte.

- Meri, ishin ata të dy...me veturë? - mërmëriti.

Ajo ia nguli sytë thellë, pastaj pohoi qetësisht.

- E pse u treguan kaq kafshë?

- As unë nuk e kuptoj. Nuk ju bëra asgjë të keqe. Ata...

Meri filloi të tregonte gjithçka, pa ndryshuar asnjë presje.

- Sid, të lutem mos dysho për mua! - tha në fund.

- As më ka shkuar ndonjëherë mendja të dyshoj, - ia ktheu

ai. - Tani mbaroi gjithçka. Ti u binde për të vërtetën dhe unë jam fare i qetë.

- Të falemnderit për të gjitha!

- Meri, e kam kokën lëmsh. Më thuaj, pse po vije te mua, në stërvitje?

- Ti më kishe porositur të vija dhe...

- Si unë?!

- Sid, kështu më tha xhaxhi Ariani. Ti... nuk e di që ai erdhi te ne dhe takoi babin?

- Babi im ka takuar babin tënd, te shtëpia juaj?!

- Po. I premtoi se do ta ndihmonte për atë problemin e alkoolit.

Ti...nuk dike gjë?!

- Në fakt dëgjova diçka, - gënjeu ai.

- Sa do të doja që gjërat të ndryshonin!

Djali nuk po e mblidhte dot veten. Ba, je i madh, mendoi. Je më fantastiku në botë. Dhe nuk më tregove asgjë.

- Meri, gjithçka do të ndryshojë për mirë, - tha pastaj.

- Sid, ti i kërkove xhaxhi Arianit ta ndihmonte babin?

- Meri, është histori e gjatë. Të premtoj se do të ta tregoj ndonjëherë tjetër.

Para se Sidi të largohej ajo iu lut të qëndronte edhe pak.

- Dua që të vërtetën ta dimë vetëm ne të dy, - tha. - Më premtton?

- Të premtoj!

Ndërsa Sidi doli në korridor, u ndesh me Albin që po vinte me duart në xhepa, me një pamje të mërzitur.

- Të shkuara motrës! - i foli.

- Falemnderit! - iu përgjigj tjetri pa i ngritur sytë.

- Do të shihemi nesër.

Albi hyri në dhomë dhe e gjeti motrën ende me buzëqeshje

në buzë. Ajo iu duk krejt ndryshe.

- Nuk po marr vesh se kë përplasi makina, ty apo mua, - tha ai.

- E ndjej që do të dalë nga spitali shpejt, - ia ktheu e motra.

- Albi, mundohu njëherë mos gjesh babin.

- Do të mundohem.

Bashkim Gjoka ia mbërriti në spital nga mbrëmja. Albi nuk kishte mundur ta gjente. Ishin takuar vetëm në shtëpi. Ndonëse i biri ishte munduar t'ia paraqiste gjendjen sa më pak alarmante, ai qëndroi para së bijës tepër i tronditur.

- Hë ba, u lodhe sot? - pyeti Meri duke i buzëqeshur.

- Lermë mua! Ti, si je? - foli ai duke zgjatur dorën i pa-sigurtë drejt ballit të saj.

Doktori i kishte thënë gjyshes se kam pësuar vetëm një shembje. Do të dal për punë ditësh.

Dora e tij u ul mbi ballin e saj tërë mundim, pastaj përkëdheli flokët.

- Meri... unë... të lutem të më falësh për atë natë që...

Asaj iu kujtua se si ajo dorë që tani po e përkëdhelte, e kishte goditur aq ashpër natën e kthimit nga diskoteka.

- Jo ba, - foli qetësisht. - Falje duhet të kërkojë unë. E meritoja atë shpullë. Më bëri mirë.

- Unë nuk doja...

- Të besoj.

- Meri, ti je e vetmja që më jep akoma një fije shprese. Nuk duhet të më zhgënjesh. Po më zhgënjëve edhe ti, për mua nuk do të ketë më kuptim asgjë.

Ajo ia mori dorën që binte ende era graso e vaj motorrash dhe ia puthi.

- Ba, nuk do të të zhgënjej më as unë e as Albi.

Kur gjyshja hyri në dhomë, i gjeti ata të dy me duar shtërnguar. Bashkimi u ngrit për t'i lëruar karriken.

- Ti shko në shtëpi se të presin fëmijët, - i foli ajo. - Do të gdhihem unë këtu.

Tjetri puthi të bijën dhe doli.

- Ba, shiko punët e tua, - i foli Meri nga pas. - Mos u merakos për mua.

Gjyshja vështroi njëherë nga dera.

- Është njeri i mirë, - psherëtiu pastaj. - Ime bijë e donte shumë.
- Por jeta të ndryshoka. Të ndryshoka edhe për keq.
- Nëna, babi do të ndryshojë për mirë. Ja, do ta shohësh.
- Dhëntë Zoti të jetë ashtu moj bijë e nënës!

*
* *
*

Sidi u takua me prindërit vonë në mbremje, kur u kthye nga stërvitja e dytë e ditës. Ata po e prisnin si shpeshherë pranë tavolinës së shtruar. Djali ia nguli vështrimin të atit i mallëngjyer. Ariani i shkeli synë çapkënçe.

- Ba, falemnderit për atë që kishe bërë!

- Sid, unë ende nuk kam bërë gjë. Ti ke një baba që nuk do të të lërë në baltë. Të jap fjalën për këtë! Burrash. Nuk do ta humbim as Merin dhe as familjen e saj. Sid, dije se unë dhe mami nuk jemi aq të tmerrshëm sa dukemi. Elona, a kishe gjë për të thënë?

- Jo ba, - ndërhyri Sidi. - Mos e detyro mamin të flasë para kohe. Ajo ende nuk e njeh Merin. Ma ka thënë vetë se ka shumë dyshime për të.

- Mbase mënyra e ndërhyrjes sime te Meri ka qenë e gabuar, - tha Elona me një ton paqësor. - Unë nuk duhej t'i kisha telefonuar asaj sikur të ishte një njeri krejt i panjohur. Por është e drejta ime të dyshoj. Dhe unë do të dyshoj deri sa të bindem se ajo vajzë nuk do ta zhgënjejë një ditë keqazi tim bir.

Ariani vështroi njëherë të shoqen, pastaj të birin.

- Sid, si thua, ta lemë të dyshojë? - pyeti.

- Është më mirë ta lemë, - ia ktheu djali. - Unë e di që mami më do të mirën. Nga dyshimet e saj nuk na vjen asnjë e keqe. Tashmë e keqja u bë. Meri...

Ata ia ngulën sytë të shtangur. Ai u tregoi ç'kishte ndodhur. Elona vuri dorën para gojës, ndërsa Ariani mori një pamje prej fajtori.

- E paskam katranosur unë punën, - tha. - Sid, mos duhet të nisem tani për në spital?

- Po vij dhe unë, - tha Elona.
- Jo, mund të shkoni edhe nesër. Meri dukej mirë. Nuk ka nevojë për ndonjë trajtim të veçantë.
- Nesër sigurisht që do të shkojmë.
- Elona u ngrit e tronditur.
- Arian, mua do të më falni, - tha. - Nuk ndihem mirë. Po shkoj nga dhoma. Ju hani bashkë.
- Shko, nuk ka asnjë problem për ne.
- Babë e bir u vështruan njëherë të menduar.

*
* *

Meri doli nga spitali pas tri ditësh. Ndërsa hyri në oborr, gjithçka iu duk ndryshe.

- Shtëpia sikur është bërë më e bukur, - iu drejtua Albit që doli ta priste bashkë me Norën e Sparkin.

I vëllai vështrroi njëherë rrotull, por gjithçka iu duk si më parë. Duhet ta ketë fajin spitali, mendoi.

E motra filloi ta përkëdhelte qenin me mall.

- Spark, sa simpatik je bërë!

Ajo hyri brenda dhe filloi t'i prekte orenditë e shtëpisë me dorë. Kur pa drekën që kishte përgatitur Albi, filloi të qeshte. Pothuaj e shtroi tavolinën edhe njëherë nga e para. U ulën të katër dhe babai i uroi Merit mirësardhjen dhe të shkuara. Sapo kishin filluar të hanin kur te dera u duk Lira, vajza e teta Bardhës, me një tepsi byreku në duar. Mezi po e mbante.

- Më dergoi mami, - foli duke u skuqur, - ë... më tha që... shyqyr që Meri erdhi shëndoshë.

Albi afroi një karrrike në tavolinë dhe e ftoi të ulej. Meri u zgjat drejt saj dhe e puthi, pa e fshehur dot një turbullim të lehtë. Vuri re se babai po e vështronte. Çfarë ka ndodhur mes teje dhe Bardhës, pyeste vështrimi i tij. Por ajo iu shmang përgjigjes duke e kuptuar se ajo shmangie nuk do të vazhdonte gjatë.

Pasdite u ndje edhe më e gëzuar kur erdhën për vizitë Sidi, Bledari dhe disa nga shoqet e klasës. U ulën në kopësht dhe ndenjën duke biseduar deri vonë. Kujtuan njerën histori pas

tjetrës. Meri e kuptoi se atë vizitë aq të bukur e kishte organizuar Sidi dhe e falenderoi me vete me dhjetra herë.

Në mbrëmje, ndërsa ishte ulur me të vëllanë në verandë, ajo s'ngopej së mbushuri me frymë.

- Alb, a s'të duket edhe ajri më i këndshëm? - pyeti.

Ai e vështroi njëherë në bisht të syrit. Ajri ishte si gjithmonë, bile nganjëherë përzihej me pluhurin që ngrinin makinat në rrugë. Me siguri e ka fajin spitali, mendoi përsëri.

- Limonët janë ende me lule, - tha pastaj.

- Sonte nuk dua të fle, - vazhdoi Meri. - A do të rrish edhe ti me mua?

Por Albit iu hap menjëherë goja. Ajo qeshi.

Të nesërmen që në mëngjes, jashtë në rrugë, u dëgjua një bori makine. Ishte Arian Arbana.

- Tani e kam radhën unë për në spital, - tha babai ndërsa po pinte kafënë në verandë në shoqërinë e së bijës. - Nuk e marr vesh ç'do të dalë nga e gjithë kjo histori. Nuk e di a do të mundem të ndryshoj.

- Ba, diçka e mirë do të bëhet patjetër, - tha Meri.

Ai e vështroi njëherë i menduar, pastaj doli.

*

*

*

Kaluan ditë dhe ajo nuk mundi ta harronte atë vështrim deri sa babai u kthye nga spitali. Kishte një pamje të zbehtë. Ishte hequr në fytyrë. Dukej i ndrojtur dhe sytë i mbante vazhdimisht ulur. Arian Arbana e shoqëroi deri brenda në shtëpi dhe i la Merit disa porosi.

- Bashkim, mjeksia e bëri të veten, - tha pastaj. - Tani është radha jote. Duhet kurajo miku im, vullnet i fortë. Mos e lësho veten për asnjë çast. Gjeji vetes punë. Unë kam besim se do t'ia dalësh mbanë.

- Doktor, falemnderit për të gjitha!

- Ne jemi miq. Sa herë të kesh nevojë, më kërko.

Ariani u përshëndet edhe me fëmijët dhe u largua. Meri dhe Albi mbetën me sytë drejtuar nga i ati. Ai bëri veprimet e

zakonshme të kërkimit nëpër xhepa të paketës së cigareve dhe çakmakut. I nxori ato dhe po i vështronte në mëdyshje.

- Ba, të lutem, mos e ndiz më! - i foli Meri.

Ai e la paketën mënjanë, pastaj këputi një degëz borzi-liku, i mbajti erë dhe me të në dorë filloi të shetiste rrotull shtëpisë. Për disa ditë rresht, pas daljes nga spitali, u ndie i pafuqishëm. Bënte ndonjë punë të vogël në kopësht, pastaj ulej për të lexuar ndonjë gazetë apo për të parë televizor.

Por një mëngjes, para shtëpisë u ndal një furgon i vjetër. Ia mbërriti deri aty i tërhequr. I zoti, një shok i dikurshëm pune i Bashkimit, e vështroi disa herë me inat, siç vështrohet një kalë gërdallë që nuk pranon të eci.

- Më la në rrugë rrangalla, - iu drejtua Bashkimit. - Nesër më duhet të nisem për në Korçë. A më bën dot derman?

Tjetri ia nguli sytë furgonit i pasigurtë. Aty pranë Meri po e ndiqte në bisht të syrit. I ati u kthye drejt saj sikur donte të kërkonte mbështetje. Ba, ti je i zoti, do t'ia dalësh mbanë, i tha ajo me shikim. Mos e humb këtë rast.

- Gani, unë po e filloj njëherë, - tha ai. - Por nuk të jap dot siguri të plotë për nesër.

- Të paça! - ia ktheu tjetri. - Po e zure ti me dorë, ka vdekur ajo punë.

Bashkimi vështroi nga Meri.

- Kam nevojë për ndihmë, - tha.

- Do të të ndihmojmë ne o ba, - iu përgjigj ajo. - Po thërrras edhe Albin.

Ajo e ngriti të vëllanë duke i treguar se ç'i priste. Albi ende nuk kishte filluar të fliste me babanë. Vetëm e përshëndeste nëpër shtëpi pa e vështruar.

- Alb, ke rast të pajtohesh, - këmbënguli Meri. - Babi po pret.

Djali ia nguli sytë i lëkundur.

- Meri, ti beson vërtet se babi do të ndryshojë?

- Po, shumë, - u përgjigj ajo. - Ai do të bëhet si më parë. Ja, do ta shohësh.

- E hu! Sa herë ke thënë ti kështu.

- Kësaj here është ndryshe.

Ai u ngrit nga krevati pa ndonjë gjallëri të veçantë.

- Mirë, më gjej një palë rroba të vjetra.

Meri e përqafoi me mirënjohje.

Furgoni ishte tepër i gjerë për ta futur në oborr dhe ata u detyruan të punonin para portës. Aty rruga ishte e boll-shme dhe trafiku nuk pengohej. Meri që ishte disi më e lirë, kur babai dhe Albi punonin, vuri re se shumë nga burrat e lagjes që kalonin aty pari, vështronin me kurreshtje. Disa u ndalën për të përshëndetur. Vajzës i shkuan disa herë sytë nga ballkoni i teta Bardhës. Ajo ishte aty. Me siguri që nuk i shpëtonte asgjë.

Meri nuk mbante mend ta kishte parë ndonjëherë babanë të lodhej aq shumë. Ai vazhdonte të ishte i zbehtë dhe djersinte jashtë mase. Megjithatë, nuk u bë për asnjë çast nervoz. Edhe kur Albi ngatërronte ndonjë vegël apo tregohej i pakuj-desshëm. Në kohën e drekës pushoi fare pak. Për të ngrënë u mjaftua vetëm me një pjatë supë.

- Vazhdojmë, - iu drejtua të birit.

Albi e ndoqi kokulur. Jasthtë të mbyste vapa. Por babai nuk u ndal më deri sa ra mbrëmja. E ndezi motorrin disa herë për të parë se si punonte. Vetëm kur u bind se furgoni ishte gati për rrugë, u ul në gjunjë, u pështet te porta dhe mori frymë i lehtësuar. I zoti i makinës ia mbërriti pas pak.

- Hë Bashkim, ndonjë llaf të mirë? - ia bëri me padurim.

Tjetri i dorëzoi çelsat.

- Nesër mund të nisesh.

- Hallall të qoftë! - tha shoferi duke nxjerrë nga xhepi i prapmë i pantallonave një zarf me para.

- Gani, janë shumë, - kundërshtoi Bashkimi pasi i pa.

- Janë tamam. Më shpëtove. Dhe dije se vëllai nuk do të të lerë pa punë. Do të sjell këtu gjithë kë njoh.

- Të falemnderit!

Ganiu iu afrua dhe e shtërngoi miqësisht në sup.

- Bashkim, ruaj veten! I ke duart flori. Mos bjer më në atë ves të poshtër. Mos pandeh se ne shokët e vjetër nuk do të të respektojmë më. I dimë hallet që kalove dhe tani duam të të shohim mirë e më mirë. Vëlla, mbaje mendjen të kthjellët se brezi ynë nuk ka më kohë për të humbur.

Bashkimi ia shtërngoi dorën me mirënjohje.

- Gani, vërtet shokët do të më respektojnë? - foli i mallëngjyer.
- Patjetër! Ne të njohim kush je. Hajt, paç mbarësi këtej e tutje!

Bashkimi përshëndeti dhe hyri brenda. I la paratë mbi tavolinë dhe iu drejtua të bijës:

- Meri, merru ti me këto.

Ndërkohë Albi sapo kishte dalë nga dushi. Vështroi njëherë nga i ati që hyri për t'u larë, pastaj nga paratë.

- Kështu punojnë njerëzit edhe në Itali? - pyeti.

- Pse, ti pandeh se ta fal njeri lekun kot? - ia ktheu Meri.

Ai furgon shkatarraq që la para portës njolla vaji e nafte, solli vërtet mbarësi. E pasuan disa vetura radhazi, pastaj filluan të trokisnin te porta shumë të njohur të lagjes që kishin makina. Rrallë ndonjë ditë Bashkimi mbeste pa punë. Oborri u kthye në një ofiçinë pa çati. Meri nuk e pastronte më dot nga njollat. Hekurishte të të gjitha llojeve kishin marrë dhenë. Ato nuk ia vلente t'i pastroje sepse në mëngjes do të shpërndareshin përsëri cep më cep.

Albi u bë dalëngadalë një çirak shembullor dhe e mbërtheu një dëshirë e çmendur për të mësuar makinën.

- Kur të rritem, do të blej një xhip fuoristrada, - i tha një mbrëmje Merit me ton ëndërrimtar. - Do të të bëj edhe ty ndonjë xhiro.

Ndonëse ai ishte përlyer me vaj e me graso, e motra e përqafoi dhe e puthi duke qeshur.

- Shiko këtu, - tha duke treguar disa kartmonedha. - M'i dha babi për ty. Eja, shkojmë blejmë një palë xhinse.

Albi e vështroi me mosbesim.

- Për mua?! Gjithë ato?!

- Pse habitesh? Ti je ndihmës i babit.

- Domethënë, i fitova një palë xhinse?

- Oj të fituar!

Një mbrëmje babai i thirri të dy dhe u tregoi ca të holla mbi tavolinë.

- Dilni sonte, - tha. - Hani ndonjë akulllore. Sikur të ftonit edhe Sidin?

Meri u skuq dhe nuk guxoi të fliste.

- Në fakt, na takon ta ftojme, - tha Albi. - Meri, telefonoji ti. Ata të dy u veshën dhe dolën, por sapo bënë pak hapa, Albi ndërroi mendje.

- Meri, shko vetëm ti. Mua më vjen zor.

E motra e tërhoqi për dore.

- Alb, eja! Ti duhet të pajtohesh me Sidin.

Ai pranoi. U takuan me Sidin te Qendra Ndërkombëtare e Kulturës dhe u ulën në një bar aty pranë. Porositën akullore.

- Alb, ç'thotë jeta? - pyeti Sidi.

- Jetë me makina të prishura. Hekura dynjaja.

- E po, ti nuk je biberon!

- As ti.

Meri vuri dorën para gojës për të mbajtur të qeshurën.

- A ke mendje për ndonjë biznes të vogël? - vazhdoi Albi.

- Foll! - ia priti Sidi.

- Me ça e ndërron një foto të Karl Malones?

- Malones së "Jutaho Xhazit"? Çfarë kërkon ti?

- Një rrip xhinsesh.

Sidi zgjati pëllëmbën e hapur.

- Biznes i mbaruar!

Ata përplasën duart dhe i buzëqeshën njeri-tjetrit.

- Bëtë mirë që më ftuat sonte sepse pasnesër do të nisem me ata të shtëpisë për në Sarandë, - tha Sidi pastaj.

Pas atyre fjalëve Meri nuk e ngriti për një copë herë kokën nga tasi i akullores. U mërzi për herë të parë në ato ditë të bukura që po kalonin. Iu kujtua largimi i vjetshëm i Sidit me pushime dhe ditët plot vapë që i ishin dukur aq të gjata. Tani ato ditë do të përsëriteshin prapë.

Kur po ktheheshin për në shtëpi, Albi u takua me një shok klase dhe Meri mbeti vetëm me Sidin.

- Unë... nuk të kam thënë, - mermëriti. - Atë varësen...

- E di, - foli ai. - Do të të sjell një tjetër. Guacka ka plot në këtë botë, kurse Meriyll vetëm një.

Ajo ngriti sytë dhe i buzëqeshi e mallëngjyer.

- Jo Sid, guacka dhe Meri gjen plot. Si ty, jo. Je shoku më i mirë në botë. Unë... mua...

- Edhe mua...

- Çfarë ty?
- Po ty?
- Fol ti i pari.
- Jo, ti e nise.

Ata filluan të qeshnin duke u vështruar të lumtur. Meri u përmend nga të thirrurat e Albit. U përshëndet me Sidin, pastaj nxitoi drejt të vëllait. Kur mbërritën në shtëpi, e gjetën babanë ulur në verandë me Norën, duke i lexuar asaj një libër.

- Hë, si e kaluat? - pyeti ai.
- Shumë mirë, - iu përgjigjën ata njëzëri.

- Meri, a mund të hidheni një vrap deri te gjyshja juaj? Ajo pyeti për ju në telefon.

- Shkojmë.

- Një minutë. Dua të të jap diçka për të.

Bashkimi hyri brenda dhe pas pak u kthye me një pako të vogël në duar. Meri ndjeu erën e veçantë të kafesë së pjekur.

- Jepja gjyshes, - tha i ati. - Bëji të fala.

Vajza e kuptoi në çast domethënien e asaj porosie.

Motër e vëlla mbërritën te gjyshja duke biseduar në lidhje me ardhjen së shpejti të dajës nga Italia.

- Po turp, s'ju vjen që s'keni ardhur tërë këto ditë? - foli gjyshja me ton qortues.

- Nëna, na fal, po kemi patur shumë punë në shtëpi, - tha Meri duke e përqaftuar.

- Nëna, - iu drejtua Albi, - na gjej ndonjë këtu në pallatin tënd që ka për të rregulluar makinën. Ke pjesën tënde të fitimit.

Gjyshja hapi sytë pa kuptuar dot gjë.

- Meri, ç'thotë ky shejtan? - pyeti të mbesën.

- Ta tregoj më vonë, - ia ktheu vajza. - Albit i është bërë mendja makina. Nëna, babi më dha këtë për ty. Ke të fala.

Gjyshja e mori pakon e kafesë me duar të dridhura.

- Është për mua?! Ma ka çuar Bashkimi?

Meri pohoi me kokë.

- Po si është ai? Kam dëgjuar që lodhet shumë.

- Punon tërë ditën.

- Atë... helmin... e ka vënë në gojë?

- Jo, fare.

Gjyshja psherëtiu.

- Ishalla vazhdon kështu! Të mbesë ai Bashkim që ka qenë. Eh, ta dini mor fëmijë ç'baba keni! E mjera ime bijë që nuk e gëzoi deri në fund atë burrë!

Fëmijët i ngritën sytë nga një fotografi e madhe e nënës së tyre, varur në mur. Ajo buzëqeshte që atje dhe dukej e afërt, tepër e afërt.

- O nëna, a do të vijë shpirti i mamit ndonjë ditë në shtëpi? - pyeti Albi.

- Mbase vjen o bir. Kushedi ç'mrekulli bën Zoti.

Ajo u kthye nga fotografia dhe filloi të qante si gjithmonë kur Meri dhe Albi vinin aty për ta takuar. Fëmijët iu lutën që të pushonte.

- Ja, pushova, - tha ajo duke fshirë lotët me cepin e shamisë. - Nesër do të vij andej nga shtëpia. Do të gatuj për drekë japrakë me gjethe laboti. Mami juaj i bënte gjithmonë sepse babit tuaj i pëlqenin shumë. Engjëjt e nënës! Duajeni dhe respektojini babin sepse edhe ai ju do shumë. Ju tani nuk mund ta kuptoni se sa ju do.

Fëmijët kishin mbetur me sytë ngulur te njëri-tjetri.

22.

Rrjedha e ditëve të asaj vere të vitit 1996 hyri në një mbarësi që askush s'e kishte pritur. Babai kishte ndryshuar dukshëm. Ndonëse punonte nga mëngjesi e deri sa errej, fytyra i qe mbushur dhe faqet i kuqonin. Pije alkoolike dhe duhan nuk kishte futur më në gojë. Oreksi i qe kthyer dhe hante radhë, ç'do gjë që i vihej para. Por kishte mbetur ende i heshtur e i menduar, sikur edhe vetë nuk po i besonte të tëra ato që ndodhnin.

Albi dhe Meri përpiqeshin ta ndihmonin me sa të mundnin në punët e përditshme të riparimit të makinave. Marrëdhë-niet e tyre po bëheshin gjithnjë e më të ngrohta dhe gjurmët e ngjar-jeve të dikurshme sikur kishin filluar të harroheshin. Për të ngrënë uleshin gjithmonë bashkë dhe problemet e shtëpisë i

diskutimin të tre gjithashtu. Ndonëse Meri pyetej më shumë, edhe Albi nuk e ndjente veten të nënvleftësuar.

Fëmijët nuk e mbanin më kokën ulur kur kalonin nëpër lagje apo kur hynin nëpër dyqane, sidomos te ai i ushqi-mores. Fqinjët kishin filluar të bëheshin përsëri të afruar. Disa prej tyre kishin ardhur për vizitë në shtëpi si dikur. Meri dhe Albi dëgjonin fjalë të mira për babanë nga të gjithë dhe ajo gjë e bente të ndjeheshin të barabartë me moshatarët e tjerë rreth e rrotull.

Por sa herë dilte te porta dhe sytë i shkonin nga dyqani i teta Bardhës, Meri ndjente një boshllëk. Nuk po e merrte dot guximin të rikthehej në shtëpinë e saj, deri sa një ditë, ndërsa po uleshin për të ngrënë drekë, babai tha:

- Më ka shkuar mendja për një byrek të mirë.

- Edhe mua! - e mbështeti Albi.

- Dua dhe unë, - e pasoi Nora.

Meri vështroi nga porta.

- Po shkoj të marr një te teta Bardha, - tha. - Si e doni?

Kërkesa që për një byrek me mish e me qepë. Meri iu afrua ballkonit të teta Bardhës e pasigurtë. Ajo u ndodh aty. U vështruan një copë herë në heshtje deri sa vajza u bind se në sytë e gruas nuk kishte pikë mërie.

- A mund të hyj nga dera? - pyeti.

- Urdhëro! - ia ktheu tjetra.

Meri hyri në shtëpi dhe përnjëherë ndjeu mall për atë vend.

- Teta Bardha... si ke qenë? - foli.

- Gjynah të qahemi. Ka edhe më keq se ne. Me se mund të të ndihmoj?

Meri u lëkund.

- Unë... desha... një byrek me mish e me qepë, për ne, të shtëpisë.

Bardha u fut në kuzhinë, preu në katër pjesë një byrek të rrumbullakët, pastaj i mbloodhi ato me një pecetë të bardhë dhe i futi në një qese plastmasi.

- Ju bëftë mirë! - tha duke ia lënë Merit në dorë.

Vajza zgjati lekët.

- Në të vërtetë... unë... erdha edhe për diçka tjetër, - shtoi pastaj. - Dua të të kërkoj falje me gjithë zemër. Kam gabuar me

ty. Jam sjellë shumë keq.

Pamja e gruas ndryshoi në çast. Ajo hapi krahët dhe Meri u afrua kokulur. Bardha e përqafoi me ngrohtësinë që dinë të japin vetëm nënat.

- Meri, mbase edhe unë e tepërova, por dije se të kam dashur të mirën. Ty dhe babit tënd.

- Ne të jemi mirënjohës.

- Bashkimi më duket i ndryshuar. Kam dëgjuar fjalë të mira për të.

- Teta Bardha, ti ke ardhur te ne vetëm kur kemi patur halle. A do të vish ndonjë ditë për vizitë?

- Po, do të vij.

Ndërsa provonte ende ngrohtësinë e asaj gruaje, Meri iu kujtuan vetiu fjalët tronditëse që nëna i kishte thënë atëhere, kur ndodhej në gjendje agonie: "Mund të ndodhë që, më vonë, babi të martohet me një grua tjetër. Ju mos u zemëroni për këtë. Rëndësi ka që ajo grua të sillet mirë me ju dhe t'ju dojë."

Një psherëtimë e zgjatur i doli nga kraharori pa dashur.

- Ç't'u kujtua? - pyeti Bardha.

- Mami.

- Meri, atë askush nuk mund t'ua zëvendësojë më. As ty e as babit tënd.

Ato u vështruan gjatë, në heshtje, në mirëkuptim të plotë.

Ndërsa Meri u kthye në shtëpi dhe vuri mbi tavolinë byrekun, i ati po e ndiqte me sy.

- Ke të fala nga teta Bardha, - tha ajo. - Më premtoi se do të vijë ndonjë ditë për vizitë.

Ai zgjati dorën dhe mori një copë byreku pa folur.

*

*

*

Ndërsa dukej se ajo rrjedhë e qetë jete nuk do të cënohej më nga asgjë dhe askush, një mbrëmje, para portës, u dëgjuan fishkëllima e të thirrura. Albi ngriu. Meri gjithashtu.

- Po këta, ç'duan? - mermëriti vajza e trembur.

- Të betohem që s'di gjë, - ia ktheu i vëllai.

Ishin djemtë e grupit Zero në Kub.

- Mos dil! - iu drejtua Meri Albit. Ata ndodheshin vetëm në shtëpi. Pasi kishte mbaruar punë, babai kishte dalë, gjë që e bënte rrallë dhe ende nuk qe kthyer. Albi filloi të vinte vërdallë nëpër shtëpi. Fishkëllimat e të thirrurat u bënë edhe më këmbëngulëse.

- Po shkoj të shoh njëherë si është puna, - tha ai. - S'ke pse trembesh.

Sapo doli te porta, Keko iu afrua me një biçikletë në duar. Redi dhe Sajmiri ndenjën disi më larg.

- Alb, jemi në hall, - tha Keko. - A e fut dot andej, prapa shtëpisë tënde, këtë biçikletë?

Albi e pati menjëherë të qartë se biçikleta ishte e vjedhur.

- E pse duhet ta fus? - ia ktheu ftoht.

- Sepse nuk kemi ku shkojmë. Po na ndjekin. Më duket se na kanë njohur.

- Keko, unë nuk dua të ngatërrohem me të tilla gjëra.

- Do të marrësh pjesën tënde!

- Të thashë, jo!

- Me gjithë mend e ke? - tjetri filloi të dridhej nga inati.

- Keko, ikim se do të na kapin! - i foli Redi.

- Alb, do të na e paguash këtë! - turfulloi Keko. - Qenke bir...!

Pas asaj sharjeje Albit iu errën sytë. Iu lëshua Kekos me grushte dhe e rrëzoi për tokë me gjithë biçikletë. Dy djemtë e tjerë të grupit nxituan t'i vinin shokut në ndihmë. Albi mbeti vetëm. Ata të tre filluan ta godisnin ku të mundnin. Ndërkohë Meri doli te porta dhe kur pa ç'po ndodhte, nxitoi drejt Sparkit. E zgjidhi atë dhe e lëshoi duke e urdhëruar të shkonte te Albi. Qeni e kuptoi menjëherë situatën. Lehu njëherë kërcënueshëm, pastaj iu vërvit Kekos drejt e në gjoks. Ai thirri njëherë i trembur, pastaj ia krisi vrapit. Redi rrëmbeu biçikletën dhe u zhdruk nga mundi. Vetëm Sajmiri nuk mundi t'ia mbathte. Sparki e kishte mbërthyer për pantallonash.

- Albi, thuaji të më lëshojë, - u lut ai. - Unë nuk të ngacmova.

Meri e urdhëroi qenin të futej brenda. Kafsha u bind. Sajmiri u largua ca, pastaj thirri:

- Ta tregojmë ne ty! Vetëm po të kapëm ndonjë ditë!

Albi fshiu me kurrizin e dorës hundën që po i kullonte gjak, duke vazhduar të vështronte andej nga ishin larguar shokët e tij të dikurshëm. E motra e mori për krahu dhe e ndihmoi të lahej e të pastrohej.

- Më mirë që ndodhi kështu, - tha. - Tani me ta u ndave njëherë e përgjithmonë.

Albi u shtri në një divan pa iu përgjigjur.

- Nuk e kam fare mendjen te ta, - tha pas pak.

Meri vështroi nga ora e murit. E kapi fluturimthi nënkup-timin e atyre fjalëve. Doli te porta dhe vështroi nga ruga. Babai nuk po dukej. Ajo ndenji aty ca, pastaj u kthye te i vëllai.

- Hë? - pyeti ai.

- ...

- Meri, mos ka shkuar... në ndonjë lokal?

Ajo u ul pranë tij pa guxuar të përgjigjej. Ata pritën në ankth deri sa u dëgjua kërcitja e portës. Babai hyri me një pamje të lodhur e të mërzitur. Fëmijët ia ngulën sytë me dyshim. Ai u shtang nga vështrimet e tyre. Mirëmbërëma, përshëndeti. Ata mërmëritën një përshëndetje të ftohtë.

- Pse më shikoni kështu? - foli ai i hutuar.

- Ba, ku ishe? - pyeti Meri me zë të dridhur.

- Unë? Te një shok që punon me mermer. Bisedova për një varr për nënën.

Në fytyrat e fëmijëve mbeti ende pamja e dyshimit. Vetëm atëhere Bashkimi e kuptoi domethënien e atij dyshimi.

- Meri, Albi, ju keni frikë se unë...

Atij iu mblodh një lëmsh në fyt.

- Jo, ju betohem se nuk do të ndodhë më! Ju betohem për shpirtin e nënës tuaj! Unë e di se ju keni vuajtur shumë për shkaku tim. E di që ju kam shkaktuar shumë halle. Por tani e tutje... Ju lutem, kini më shumë besim tek unë! Ju dua shumë të dyve. Ju kërkoi falje për të gjitha ato që ndodhën. U tregova një prind i keq. Por ato nuk do të përsëriten më. Kurrë! Meri, Albi...

Gjithë ai burrë i fuqishëm, me shpatulla të gjera, shpërtheu papritur në një të qarë të vrullshme që e shkundi të tërin. Fëmijët ngrinë. E kishin parë të atin të qante ashtu vetëm kur kishte vdekur nëna. Vajza iu afrua e para dhe i vuri dorën në sup.

- Ba, ne nuk dyshojmë te ty, - tha. - Le t'i harrojmë ato që ndodhën.

Albi u afrua nga krahu tjetër.

- Ba, prind si ti nuk ka në botë, - foli i prekur nga ajo skenë.
- Të lutem, mblidhe veten! Burrat nuk bëjnë kështu.

I ati hapi krahët. Ata të dy e përqaftuan dhe ndenjën ashtu deri sa ai u qetësua.

*

* * *

Nga fundi i korrikut dajë Bardhyli erdhi nga Italia për pushime. Kishte sjellë me vete dy arka me vegla nga më të ndryshmet që i duhen një ofiçine për të rregulluar makina. Bashkimi u mrekullua kur i pa.

- Janë për mua?! - pyeti duke i vështruar veglat sikur të ishin thesare.

- Për ty, - ia ktheu Bardhyli. - Tani më dëgjo me vëmendje. Ti nuk mund të vazhdosh të rregullosh makina në oborr dhe në rrugë. Duhet hedhur themelet e një ofiçine. Hapësirën e ke këtu në kopësht. Fillimisht mund të ndërtohet një tendë, ku të punosh ditëve me shi. Pranverën që vjen ngri muret. Unë do të të ndihmoj me para. M'i kthe kur të mëkëmbesh dhe t'i kesh punët në vijë.

Bashkimi kishte dëgjuar nga e vjehrra se i kunati kishte vendosur ta ndihmonte, por propozimi i tij iu duk tepër i guximshëm. Nuk po e mblidhte dot veten nga hutimi. Ai, pronar i një ofiçine?!

- E shoh që ke nevojë të mendohesh, - tha Bardhyli. - Këto nuk janë gjëra që vendosen kaq shpejt. Veç dije se nuk je ti i pari që ia nis nga hiçi.

Bashkimi vështroi nga ajo pjesë e kopshtit ku një ditë mund të ngrihej ofiçina.

- Bardhyl, po ti, a ke besim te unë? - pyeti.

- Plotësisht, - u përgjigj tjetri. - Deri sa po të besoj paratë e mia...

- Falemnderit!

- Dëgjo, sot ti je njeri në nevojë. Por jetës nuk i dihet. Nesër mund të kem unë nevojë për ty.

Pak ditë pas asaj bisede, muri rrethues i shtëpisë, në të djathtë të portës, i cili ngrihej fare pranë rrugës, u shemb. Në atë pjesë të kopshtit, që tashmë u lidh me rrugën, u prenë dy kumbulla dhe një rrënjë pjergull. Vendi u shtrua me një shtresë të hollë betoni. Bëhej një sipërfaqe ku mund të qëndronin lirshëm dy makina. Mbi disa shtylla druri u ngrit një tendë llamarine. Para asaj ngrehine, që nuk dije ç'emër të vije, u vendos një portë e gjerë hekuri, lyer në të zezë, mbi të cilën Albi shkroi me bojë të kuqe: "Ofiçina Gjoka. Riparime dhe shërbime të ndryshme për furgona dhe vetura."

Para se të nisej për në Itali, dajë Bardhyli erdhi t'i takonte të gjithë dhe qëndroi përballë portës duke buzëqeshur.

- Afrohu pak se të kam një fjalë, - iu drejtua Albit. - Mos e harro kurrë atë që ke shkruar. Dije se për ata që kanë një pronë dhe duan të punojnë, Italia apo Amerika janë këtu. Veçse këtu! Unë po punoj si kalë atje në Itali dhe vetëm më përçmojnë e më shohin shtrembër. Nuk është vendi im. Nuk kam asgjë atje. Vetëm më shfrytëzojnë. Më kuptove? Jo, mos fol! Më shkruaj ndonjë letër më vonë.

Djali iu hodh në krahë.

- Daja, të dua shumë. Ti i ngjan shumë mamit. Në gjithçka.

Bardhyli e mbajti për qafuar disa minuta, pastaj tha i lehtësuar:

- Albi, edhe unë të dua, megjithëse jam larg. Shko tani! Jepi një dorë babit! Ofiçina ka plot punë.

*

*

*

Një paradite fillimshtatori, ndërsa Meri dhe Albi po ndihmonin të atin në punët e zakonshme të ofiçinës, që brenda nga shtëpia u dëgjua zilja e telefonit. As Albi dhe as i ati nuk e ngritën kokën. Meri nxitoi drejt dhomës së ndenjies, duke fshirë duart me një këmishë të vjetër. Ishte Sidi.

- Hë, ç'thotë ofiçina Gjoka? - ia bëri ai.

- Presim klientë, - ia ktheu ajo.

- Meri, këtu poshtë pallatit po më pret Bledari. Do të shkojmë të regjistrohemi te gjimnazi "Ismail Qemali". Ti... vendose gjë?

Meri vetëm psherëtiu. Që kur Sidi ishte kthyer nga pushimet, problemi i ndjekjes së gjimnazit ishte hapur disa herë, por ajo ishte shmangur diskutimit. Në ato rrethana që ndodhej, vazhdimi i shkollës i qe dukur i pamundur. Përveç babait, duhej të punonte edhe ajo. Ndryshe nuk mund të mbahej shtëpia dhe të shlyheshin borxhet e ofiçinës.

- Meri, bisedo njëherë me xhaxhi Bashkimin, - tha Sidi. - Unë e kam të qartë se ç'përgjigje do të të japë ai. Pasdite do të më gjesh në stërvitje.

Meri priti sa afroi ora e drekës.

- Sikur kërkon të më thuash diçka, - iu drejtua papritur i ati.

Ajo e ndërpreu shtrimin e tavolinës.

- Ba, kam vendosur të gjej ndonjë punë, - foli. - Në ndonjë rrobaqepsi apo floktore.

I ati u kthye drejt saj me një pamje tepër serioze.

- E pse?!

- Ne... shtëpia jonë...

- Meri, mos pandeh se i kam harruar ato mëngjeset e dimrit kur ti ngriheshe që me natë për të shkuar te Bardha për të bërë byrekë. Unë e di që ti nuk i trembesh punës. Por tani e tutje për ju dhe për shtëpinë, do të mendoj unë. Nga ty dhe Albi dua vetëm shkollën. Asgjë tjetër. Mund të më ndihmoni ndonjëherë, kur të keni kohë të lirë. Tani shko e regjistrohuni në gjimnaz bashkë me shokët e shoqet. Unë do të punoj për ju deri sa të më rreshtin forcat. Ditën dhe natën. E kam amanet nga nëna juaj.

Vajza iu afrua dhe e përqafoi.

- Meri, unë e di që ti do të më nderosh, - tha babai.

- Të premtoj! - ia ktheu ajo.

Atë pasdite u mat disa herë deri sa i kërkoi të atit një shumë jo të vogël të hollash.

- Dua t'i bëj Sidit një dhuratë, - tha.

Babai hapi një nga sirtarët e bufesë dhe nxorri që aty një zarf me para.

- Merri, - tha. - Blej edhe për vete ndonjë gjë të re. Shkolla po afron.

Ajo u vesh, ndenji gjatë para pasqyrës duke u marrë me flokët e pabindur ku krehëri duhej të bënte rrugën e një ekspedite nëpër xhungël. Për një çast nuk e njohu veten. Fytyra i qe mbushur. Nën vetullat e trasha e të harkuara dhe mes qerpikëve të gjatë që lakoheshin si degë palme, sytë i ndrisnin me një gëzim të paprovuar prej kohësh. Torollake, je ti, i foli vajzës në pasqyrë.

Doli nga shtëpia dhe nxitoi drejt një dyqani që tregtonte artikuj sportivë. Zgjodhi mes topave të ndryshëm të basketbollit një në ngjyrë të kuqe, pastaj iu lut shitësit t'i jepte një stilolaps. Tjetri ia dha duke e ndjekur me kureshtje. Ajo i ktheu kurrizin dhe me gërma të mëdha shkroi mbi top: "JE NUMRI 1 NE BOTE". Shitësi e futi topin në një rrjetë të hollë, pastaj ia la Merit në duar duke thënë miqësisht:

- E gëzofte ai numri 1!

Ajo e bëri rrugën deri te fusha ku stërvitej Sidi gati me vrap. I thirri shokut aq fort sa që pothuaj të gjithë djemtë e ekipit kthyen kokat. Trajneri i bëri Sidit një shenjë, pastaj i fryu bilbilit që stërvitja të vazhdonte.

Sidi u afrua te Meri duke e kuptuar në çast lajmin që ajo kishte sjellë.

- A ta lë stërvitjen dhe shkojmë për akullore? - ia bëri.

- Jo, - kundërshtoi Meri, - do të pres deri sa të mbarosh.

- Po ky top, mos është për mua?

Ajo i buzëqeshi, duke e vështruar me një mall të vjetër që ndoshta kishte nisur që kur ata të dy ishin takuar për herë të parë.

- Shko, - tha pastaj, - vazhdo stërvitjen.

Ndërsa Sidi vraponte nëpër fushë dhe luftonte për top nën tabelë, ulur në një stol aty pranë, Meri nuk ia ndante sytë. Ç'është ky njeri që ma bën zemrën të më rrahë kështu si e marrë, pyeti veten. Si, arriti deri atje sa të ndryshonte jetën time? Pse vallë bëri kaq shumë? A do të kisha bërë edhe unë për të, të njejtën gjë? Sid, kush je ti? A do të ma thuash ndonjë ditë, kush je?

Dy ditë më vonë, të shtunën paradite, Elona Arbana i telefonoi krejt papritur.

- Meri, jam vetëm në shtëpi, - tha. - A mund të vish për një vizitë?

Vajza u mek.

- Unë? Po... ja...do të vij.

Elona e priti me një ngrohtësi të përmbajtur. Ishte tepër serioze si atë ditë kur kishte ardhur në spital për ta parë, pas aksidentit.

- Meri, ne duhet të bisedojmë diçka, - tha kur u ulën përballë njëra-tjetrës. - Më saktë, unë duhet të të kërkoj falje. Jam sjellë me ty vrazhd. Ti nuk e meritoje atë sjellje. Por kjo ndodhi sepse unë nuk të njihja. Tani po e kuptoj se nuk njihja mirë edhe tim bir. Jeta qenka e çuditshme. Arrin në mes të saj dhe befas kupton se nuk e ke njohur, se ka ende shumë për të njohur.

Meri e vështroi tjetrën drejt, në qetësi të plotë.

- Teta Elona, ju jeni nëna e Sidit dhe unë nuk mund t'ju mbaj dot mëri asnjë grimë. I kam harruar ato që ndodhën. Ju keni një djalë të mrekullueshëm. Nganjëherë edhe mua më duket se ende nuk e njoh. Aq i mirë është.

Tjetra buzëqeshi.

- Unë do të doja që ti dhe Sidi të mbeteshit dy shokë të mirë sepse në jetë, njeriu, në radhë të parë, ka nevojë për një shok. Shumë gjëra mund t'i arrish në jetë me lehtësi ose me fat, vetëm shokët e mirë është e vështirë t'i gjesh. Shumë e vështirë. Këto që po të them i kam nga përvoja ime.

Meri pohoi me kokë e menduar.

*

* *

Ishte një ditë vjeshte dhe ndërsa po dilte nga porta e gjimnazit, Meri vuri re mësuese Lindën që po e priste. Ajo ngriti paksa dorën dhe buzëqeshi. Vajza iu afrua dhe e përqafoi.

- Ah, Meri, Meriyll! - tha mësuesja duke i futur krahun. - Eja, po të shoqëroj deri pranë shtëpisë. Kam dëgjuar fjalë të mira për ty dhe familjen tënde. Më dukesh ndryshe, krejt ndryshe. Sikur je zbukuruar edhe më.

Vajza u skuq.

- Mësuese, më fal, duhej të kisha ardhur unë t'ju takoja.

- Kjo nuk ka edhe aq rëndësi.

- Shpesh kam dashur t'ju pyes se pse kujdeseshit aq shumë për mua.

Linda psherëtiu dhe vështroi diku larg, në një pikë të pacaktuar.

- Sepse fatin tënd e kam kaluar edhe unë. Më la nëna në moshën 13 vjeçe. Isha fëmija më i madh dhe më ranë mbi supe tërë hallet e shtëpisë. Një motër dhe një vëlla më të vogël i rrita me duart e mia. Natën rrija deri vonë për të mësuar. Shpesh më zinte gjumi mbi libra. E doja shumë shkollën dhe arrita të bëhesha mësuese. Ne ishim shumë fëmijë dhe kur unë dola në punë, vazhdoja të ndihmoja e të kujdesesha për motrat e vëllezërit më të vegjël. Ndenja gjatë pa u martuar vetëm prej tyre. Im shoq më donte prej vitesh dhe më priti. Sot pyes veten shpesh se a ia vlejten tërë ato sakrifica dhe a do të më shpërblehen një ditë.

- Unë them se po, - foli Meri.

- Edhe unë ashtu mendoj. Ti më kujtoje veten time të dikurshme ndaj kujdesesha për ty më shumë se për të tjerët. Ja, ky ishte sekreti im.

Vajza e përqafoi përsëri.

- Tani dua të të tregoj edhe diçka të trishtueshme, - vazhdoi pastaj mësuesja. - E mësova para pak ditësh. Klara ka përfunduar keq. Shumë keq. Im shoq punon në Ministrinë e Rendit, në Drejtorinë e Interpolit. Prindërit e Klarës ishin interesuar për të sepse është zhdukur pa gjurmë. Policia greke ka dërguar të dhëna se ajo ka përfunduar prostitutë. Ai, i fejuari i saj, duhet ta ketë shitur te ndonjë grup mafiozësh që merren me prostitucion.

Meri ia nguli sytë e tmerruar.

- Mësuese, a jeni e sigurtë?

- Për fat të keq... Klara u tregua shumë mendjelehtë.

- Ajo s'kishte faj. E donte atë Gencin.

- Ndoshta e donte vërtet, por këto punë kërkojnë pjekuri. Të papjekurit bien gjithmonë viktima, bashkë me më të dobëtit e të pambrojturit.

Më në fund Meri e pati gjithçka të qartë nga lidhja e saj me Klarën, Gencin dhe Aldon. Sid, ç'do të kishte ndodhur po të mos kishe qenë ti, pyeti veten. Pas shumë ditëve të bukura e pushtoi një dëshpërim i vjetër dhe filloi të qante.

- Mësuese, jam edhe unë fajtores. Unë e dija që Klara do të

ikte në Greqi dhe nuk fola. Vërtet nuk shkova pas saj, por as u mundova ta ndaloja.

- Mos e mundo veten për këtë. Për Klarën jemi fajtorë të gjithë. Në këtë shoqëri ku jetojmë, është e vështirë të ndahet faji.

Mësuesja i hodhi krahun dhe u mundua ta qetësonte. Ato u ndanë në një kryqëzim të çrregullt dhe Meri mori rrugën e shtëpisë ende e tronditur. Kishin rënë shirat e parë të vjeshtës dhe gropat e shumta qenë mbushur me ujë. Nga gjërmimet dhe ndërtimet e reja, asfalti i mbetur pothuaj qe mbuluar nga balta. Megjithatë, ajo rrugë iu duk Merit më e dashur se kurrë. Ishte rruga e shtëpisë.


FUND

Diskutojmë për romanin
– *Shtojcë analize ideo-artistike për nxënësit* –

Përgatitën:
Kreuzza Bardhi, Aida Fekollari

Të kuptojmë përmbajtjen


Shiko me kujdes figurat. Vendos numrin që duhet në kuti duke u mbështetur në rrjedhën e ngjarjeve të romanit.



Të analizojmë

Analiza e personazheve dhe e mjedisit

- I. Cilat janë personazhet që veprojnë në këtë roman? Shëno më poshtë karakteristikat fizike dhe sociale të tyre.



Etj.

- II. Vini në dukje aspekte të kundërta të personazheve.

Personazhet	Cilësi të kundërta	Veprime të kundërta

- III. Në pjesën më të madhe të romanit veprojnë personazhe femra. Shkruaj emrin e personazhit përbri mbiemrave duke u mbështetur në cilësinë e karakterit dhe të veprimeve që kryejnë.




E bukur _____
Ekstravagante _____
E dashur _____
Egoiste _____
Shpirtmirë _____
E kujdesshme _____
E pangopur _____
Arrogante _____

(Për t'ju ndihmuar po japim emrat e personazheve femra: gjyshja, Klara, Meriyll, Bardha, Elona, mësuesja kujdestare, halla, mësuesja e anglishtes.)

IV. Gjyko mbi veprimet e personazheve të mëposhtëm duke dhënë komentin tënd.

Personazhet	Veprimi	Komenti
1. Babai i Merit		
2. Elona		
3. Mësuesja e gjeografisë		
4. Klara		
5. Andi		

V. Shkruaj disa veprime që bën babai i Meriyll që të shtyjnë ty të mendosh se ai nuk e përmbush detyrën e tij si prind.



VI. A ndryshojnë personazhet në roman? Si dhe pse?

VII. Duke u mbështetur në ndryshimet e mësipërme ç'përfundime nxirrni?

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____
- e) _____

VIII. Në leximin letrar të klasës së tetë ti je njohur me elementët e subjektit që është një pjesë e rëndësishme në hartimin e një vepre letrare. Përcakto shkurtimisht elementët e subjektit në romanin “Meriyll”

Parashtrimi: _____

Pika e lidhjes: _____

Zhvillimi: _____

Pika kulminante: _____

Zgjidhja: _____

IX. Në cilat mjedise zhvillohen ngjarjet e romanit? Zgjidh dhe përshkruaj njërin prej tyre. Natyrisht që përshkrimi mund të shoqërohet me vizatime ose me mokete.

(P.S: duke u ndihmuar edhe nga mësuesja, nxënësit mund të hapin një ekspozitë ku të vendosin të gjitha punimet e bëra prej tyre. Kujdes mos harroni t'i vini një titull)

XII. Cila gjendje ose ngjarje vë në lëvizje zhvillimin e veprimit:

- 1- Momenti _____

- 2- Qëllimi _____

- 3- Aktorët _____

- 4- Bashkëpunëtorët _____

- 5- Viktimat _____

- 6- Rezultati final _____

Vëzhgimi im

Duke lexuar romanin “Meriyll” vura re se në të trajtohen këto probleme:

- 1) Droga një problem shqetësues për të rinjtë.
- 2) Ndikimi negativ i alkoolit në familje e shoqëri.
- 3)
- 4)
- 5)
- 6)

Lojë në çift

- I. Ndërto disa pyetje tërësore mbi cilësitë, veprimet dhe mjedisin ku veprojnë personazhet. (Por kujdes, ju do të kërkonti nga shoku që përgjigjja e tij të mos jetë po ose jo, por me fjalë të tjera që shprehin pohim ose mohim.)

P.sh.



A zhvillohen ngjarjet e romanit në vitet '90-të



Është e vërtetë, zhvillohen

Kujdes! Nëse shoku juaj përgjigjet po ose jo, ai digjet.

Dilema sociale

Drejtuësja e organizatës "X" që ndihmon në luftën kundër alkoolit dhe drogës është shumë e shqetësuar për rritjen e numrit të përdoruesve të këtyre substancave, veçanërisht nga adoleshentët dhe të rinjtë. Ajo ka njoftuar organizimin e nje konkursi ku të rinjtë mund të ofrojnë zgjidhje të ndryshme ndaj këtyre problemeve. Edhe ti do të marrësh pjesë në konkurim. **Cilat nga këto zgjidhje do të propozojë?**


1. Ndërgjegjësimin e të rinjve për rreziqet e alkoolit dhe të drogave të tjera.
2. Shmangia e kontakteve me njerëz të panjohur që dyshohet se mund të jenë trafikantë.
3. Prania e policisë në mjediset shkollore.
4. Të gjejmë brenda vetes forcën dhe vullnetin e duhur për të përballuar dhe kapërcyer të gjitha vështirësitë pa menduar se rrugëzgjdhja e vetme është droga, apo alkooli.

Unë do të propozoj _____

Sepse _____

Shtysë për të diskutuar, reflektuar e krijuar

- I. Duke u mbështetur në ngjarjet e romanit dhe në përvojën e deritanishme shpreh mendimin tënd rreth konceptit "Miqësi".



- II. Cilat gjëra do të vlerësoje më shumë tek shoku? Shëno me x cilësitë që ti çmon më shumë.

- | | |
|---------------------------------------|--|
| <input type="checkbox"/> Bukurinë | <input type="checkbox"/> Forcën fizike |
| <input type="checkbox"/> Singëritetin | <input type="checkbox"/> Egoizmin |
| <input type="checkbox"/> Pasurinë | <input type="checkbox"/> Veshjen |
| <input type="checkbox"/> Besnikërinë | <input type="checkbox"/> Zgjuarsinë |
| <input type="checkbox"/> Pastërtinë | <input type="checkbox"/> Dinakërinë |
| <input type="checkbox"/> Trimërinë | <input type="checkbox"/> Ndhmën |

- III. Çfarë cilësish duhet dhe nuk duhet të ketë një shok? (vazhdo listën e mëposhtme)

Një shok duhet:

- të jetë i durueshëm
- të jetë gjakftohtë
- të jetë i komunikueshëm
-

Një shok nuk duhet:

- të jetë i dhunshëm
- të fyejë e të flasë me ton të ashpër
- të mendojë vetëm për vete
-

IV. Miqësia kërkon edhe sakrificë. Listo disa prej tyre.

- Të dish të dëgjosh
- Të jesh besnik
-
-
-

V. Një vend të rëndësishëm në romanin “Meriyll” zë figura e prindërve, marrëdhëniet që ata krijojnë me fëmijët e tyre. Po ju ç’ marrëdhënie keni ndërtuar me prindërit tuaj? A ndikojnë ata në ëndrrat, dëshirat, interesat tuaja? Tregohuni sa më të sinqertë.

VI. Bëj një ese me temë: “Unë jam zot i të ardhmes sime”

VII. Sidriti mbetet miku më i mirë i Meriyllit gjatë gjithë romanit. Ç’mendoni ju për këtë ndjenjë të thellë miqësie të sinqertë? A mendoni se ekziston me të vërtetë një ndjenjë e tillë midis bashkëmoshatarëve të tu?

VIII. Me cilin prej personazheve të romanit mund ta identifikosh veten dhe pse?


IX. Personazhi që pëlqej dhe të cilit dua t'i ngjaj.

X. (Punë në çift) Krijoni një intervistë imagjinare duke e vendosur njërin nga shokët e klasës në rolin e njërit prej personazheve të romanit dhe veten në atë të gazetarit.

XI. Shkruaji një letër mësuese Almës në të cilën i shpjegon pse nuk je dakort me qëndrimin e saj.



XII. Krijò portretin e mësuesit tënd ideal.



XIII. Këshilla prindërve

(Bëj një listë me këshilla që do të doje t'ua jepje prindërve të tu. Ne po të ndihmojmë me disa. Bëjua të ditur edhe prindërve këto këshilla dhe merr mendimin e tyre.)

- 1) *Mos përdorni forcën me mua. Kjo më mëson se vetëm forca ka rëndësi.*
- 2) *Mos bëni premtime, ndoshta nuk do të keni mundësi t'i mbani ato. Kjo do të më humbasë besimin te ju.*
- 3) *Mos bëni për mua gjëra që mund t'i bëj vetë. Kjo më bën të ndihem bebe.*
- 4) *Trajtomëni siç trajtoni shokun tuaj. Unë mësoj më shumë nga një model sesa nga një kritik.*
- 5)
- 6)
- 7)
- 8)
- 9)

Fëmija juaj


Në fushën e leksikut:

- I. Gjatë leximit të romanit mund të jesh ndeshur me fjalë e shprehje të panjohura më parë. Mjaft prej tyre mund t'i kesh kuptuar duke u mbështetur në kontekstin në të cilin janë përdorur. Sidoqoftë burimi më i saktë mbetet fjalori i gjuhës së sotme shqipe. Provoje veten duke plotësuar tabelën e mëposhtme:



Fjala e panjohur	Kuptimi i nxjerrë nga konteksi	Shpjegimi i fjalorit	Vlerësimi (i saktë ose i gabuar)

Të luajmë teatër



Erdhi koha për të shfaqur aftësitë e tua si aktor i vogël e i talentuar. Së bashku me shokët e tu mund të organizosh një shfaqje të vogël teatrale duke u mbështetur në ngjarjet që ju kanë lënë më tepër mbresa. Është e nevojshme që të jepet kontributi i gjithë klasës. Diskutoni së bashku për të gjetur ngjarjen më të bukur si dhe aktorët më të mirë.

Thuaj mendimin tënd

Sipas teje libri është:

- | | |
|---|---|
| <input type="checkbox"/> I mrekullueshëm | <input type="checkbox"/> Shumë i gjatë |
| <input type="checkbox"/> I vështirë për t'u kuptuar | <input type="checkbox"/> Zbavitës |
| <input type="checkbox"/> I pëlqyeshëm | <input type="checkbox"/> Shumë i shkurtër |
| <input type="checkbox"/> I pakëndshëm | <input type="checkbox"/> Interesant |
| <input type="checkbox"/> I bukur | <input type="checkbox"/> I mërzitshëm |

Cila pjesë e librit të ka tërhequr më shumë? Po më pak?

Cilët personazhe kanë rrëmbyer më shumë simpatinë tënde? Po më pak?

Cili episod të ka prekur më shumë?

Çfarë mendimesh dhe emocionesh kanë përcjellë tek ty ngjarjet e këtij romani?

Çfarë do të ndryshoje në këtë roman ?

A të kanë lindur gjatë leximit të romanit pyetje për të cilat do të doje të merrje përgjigje? Shkruaj disa prej tyre.

Të vlerësosh veten

Besoj se tani në fund të leximit jashtëklase ti mund të jesh i aftë të vlerësosh veten rreth përgatitjes për këtë roman. Për të bërë këtë të ndihmon edhe tabela.

Sa i kënaqur mbetët nga përgatitja juaj?		
Shumë i kënaqur	I kënaqur	Jo i kënaqur sepse...

